

PERCEPTIMET E PERSONAVE BILINGUAL MBI ARRITJET E TYRE NË JETË

MsC. Alma Vögeli (Peto)

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Departamentit të Shkencave Sociale

Në përmbushje të detyrimeve
për Doktoraturën në Psikologji

Prof. Dr. Edmond Dragoti

Punimi përmban 51 000 fjalë

Tiranë, 2016

DEKLARATË AUTORËSIE

Nën përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punim është shkruar prej meje dhe nuk është prezantuar si i tillë para një institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër përveç rasteve të cituara dhe referuara.

E drejta e autorit © 2016

Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit

Alma Vögeli (Peto)

FJALË HYRJJE

Gjuha është padyshim një mjet jetik. Jo vetëm se është një mjet për të komunikuar mendimet, ndjenjat dhe idetë, por nëpërmjet komunikimit lidhen miqësitë, kulturat, marrëdhëniet ekonomike e sociale. Adresimi i çështjeve dhe përfitimeve të dygjuhësisë janë në qendër të studimeve të mijëvjeçarit të ri. Ky studim sjell një këndvështrim të ri mbi perceptimet e personave bilingual ose të rriur me dy gjuhë në Shqipëri. Kjo është një temë për të cilën ka nevojë për studime dhe hulumtime në vazhdimësi.

Origjina e faktit se pse ka gjuhë kaq shumë të ndryshme ka intriguar mendjen e dijetarëve dhe linguistëve për shekuj me radhë dhe do të vazhdojë të mbetet një pyetje intriguese edhe në kohërat që do të vijnë. Në shumë kultura ekzistojnë mite, por edhe dorëshkrime, që ka ekzistuar një gjuhë e përbashkët në të gjitha kombet. Por më pas një hyjni, Zot ose genie e mbinatyrshme, në shumë mite flitet që u zemërua me sjelljet e njerëzve dhe i ndau ato duke i bërë të flasin gjuhë të ndryshme. Segmentimi i njerëzve për të krijuar gjuhën e tyre është një mit, por që shpesh besohet. Tregimet dhe dorëshkrimet që ekzistojnë edhe sot si “Kulla e Babelit”, historia e Hinduve mbi “Pemën e Dijes”, madje edhe historia amerikane “Përmbytja e madhe”, tregojnë për rëndësinë e njohjes dhe studimit të shumë gjuhësive që prej shumë shekujve më parë.

Gjatë gjithë historisë, shumë dijetarë kanë reflektuar mbi rëndësinë e gjuhës. Benjamin Whorf ka vërejtur se gjuha formon mendimet dhe emocionet, përcaktimin e dikujt për perceptimin e realitetit. John Stuart Mill ka thënë se “Gjuha është drita e mendjes.” Gjuhëtari Edward Sapir, ka thënë se gjuha nuk është vetëm një mjet për shprehjen e mendimeve, perceptimeve, ndjenjave dhe vlerave karakteristike të një komuniteti; ajo gjithashtu paraqet një shprehje themelore të identitetit shoqëror.

Ky studim sjell gjetje interesante përsa i përket personave bilingual në Shqipëri, sa ka ndihmuar fakti i të qenët bilingual në arritjet e tyre personale dhe suksesin e tyre në jetë.

ABSTRAKTI

Ky studim fokusohet në eksplorimin dhe hulumtimin mbi perceptimet e personave bilingual dhe atyre monolingual në Shqipëri, lidhur me bilinguizmin dhe ndikimin e tij në arritjet dhe avantazhet në jetë.

Metodologjia e përdorur në studim është gërshetimi i metodologjisë sasiore dhe cilësore. Subjekte të studimit janë bërë 128 persona bilingual mbi moshën 35 vjeç dhe 120 persona monolingual. Kampionimi i përdorur është një ndërthurje e kampionimit të qëllimshëm dhe atij në formë orteku. Personat bilingual të këtij studimi kanë referuar persona të tjerë po bilingual, bazuar në kriteret e studimit. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur si instrument pyetësorët e strukturuar dhe intervistat gjysmë të strukturuar. Gjithashtu, janë përdorur edhe intervista të strukturuar me individë, të cilët janë protagonistë të dygjuhësisë, e kanë përjetuar atë dhe sjellin përvijën e tyre më të zgjeruar.

Nga studimi rezultoi dhe u vërtetua hipoteza e studimit se fakti i të rriturit si bilingual ndikon pozitivisht në arritjet në jetë. Personat bilingual gjatë jetës së tyre e kanë patur më të lehtë të mësojnë një ose më shumë gjuhë të tjera, përveç dy gjuhëve të mësuara që në vegjëli. Ata kanë një vetëvlerësim dhe siguri të lartë në vetvete, dhe kanë një karakter të fortë.

Nga studimi rezultoi se personat bilingual kanë talente dhe aftësi në fushat artistike si në instrumentet e ndryshme muzikore, pikturë, art dhe kërcim. Ata kanë një rreth të konsiderueshëm shoqëror dhe miqësor me njerëz nga kombësi të ndryshme, kjo e lidhur ngushtë me njohjen e dy ose më shumë gjuhëve.

ABSTRACT

This research is focused on the exploration and studying about the perception of bilinguals and monolinguals in Albania as well as its influence in life's achievements.

Methodology used in this study is the interweaving of quantitative and qualitative methodology.

Subject of this research have been 128 bilingual individuals over 35 years old and 120 monolingual individuals. Sampling used is an interweaving of intentional sampling and avalanche-like sampling. Bilingual subjects have been addressed as part of this research, taking into account the criteria and other bilingual individuals they have social relations with. Structured questionnaires and half-structured interviews have been used as a data collecting tool. Also, interviews with individuals who are protagonists of bilingualism, who have experienced it and bring their extended delineation, have been used.

From the research, the hypothesis that the fact of growing up as a bilingual has a great benefit and influences in life's achievements, has been verified. Bilingual individuals have managed to easily learn one or more other languages during their life, besides the two languages learned during their childhood. They show a firm self-esteem and confidence in themselves, as well as a strong character.

From the study it resulted that bilingual individuals have talents and abilities in the artistic fields, such as using various musical instruments, painting, art and dance. They have a considerable social and friends circle with people of various nationalities and this is closely related to the knowledge of two or more languages.

MIRËNJOHJE

Mirënjohja në formë falënderimi shkon për të gjithë personat që ndihmuan në realizimin e studimit.

Një falënderim i veçantë i shkon udhëheqësit shkencor, prof. dr. Edmond Dragoti për ndihmën dhe mbështetjen e tij.

Së dyti, falënderoj për bashkëpunimin të gjithë personat që pranuan të ndajnë eksperiencat personale në këtë studim dhe të jenë një vlerë e shtuar për temën e bilinguizmit në Shqipëri.

Falënderoj një ndër kolosët e kinematografisë shqiptare, z. Timo Flloko, profesor z. Qemal Xhomo, znj. Lili Tirana, z. Luan Belegu, znj. Luli Kraja dhe në veçanti znj. Hatixhe Xhoxhi-Balla, të cilët i dhanë ngjyra këtij studimi.

Së fundi, falënderoj familjen time për mbështetjen e tyre të madhe, si dhe miqtë e mi.

TABELA E PËRMBAJTJES

DEKLARATË AUTORËSIE	2
FJALË HYRJE	3
ABSTRAKTI	4
ABSTRACT	5
MIRËNJOHJE	6
LISTA E GRAFIKËVE	11
LISTA E SHKURTIMEVE	12
KAPITULLI I: HYRJE.....	13
1.1. Gjuhët e huaja në Evropë.....	13
1.2. Gjuhët e huaja në Shqipëri.....	16
1.3. Pse është zgjedhur të kryhet ky studim	18
1.4. Hipoteza	19
1.5. Përkufizimet operacionale.....	19
1.6. Qëllimi.....	19
1.7. Objektivat	19
KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS	21
2.1. Shoqëria shqiptare dhe raportet e saj me bilinguizmin si një dukuri globale.....	21
2.2. Shqiptarët dhe marrëdhëniet me gjuhët e huaja.....	22
2.3. Bilinguizmi në Kosovë	32
2.4. Reforma kurrikulare në të gjithë veprimtarinë e shkollës në kontekstin kohor, në optikën e bilinguizmit real në Shqipëri	36
2.5. Objektivat arsimore, procesi dhe mjeshtëritë e të pyeturit në dy a më shumë gjuhë	37
2.6. Bilinguizmi dhe teknikat e të mësuarit individual.....	38
2.6.1. Përvetësimi i gjuhës së dytë tek bilingualët dhe monolingualët	38
2.6.2. Si funksionon mësimi i gjuhës	40
2.6.3. Mësimi i dy gjuhëve njëkohësisht nga një fëmijë	43
2.6.4. Synimi i mësimit të gjuhëve.....	44
2.7. Pedagogjia e gjuhës dhe teoritë e të nxënës të gjuhës	45
2.8. Dallimi mes teorive të shumëgjuhësisë	47
2.9. Kultura e edukimit dhe e të nxënës	47

2.10. Të nxënit e gjuhëve dhe ndryshimi në mjedisin e pedagogjisë së gjuhës . . .	50
2.10.1. Dallimet kognitive	50
2.10.2. Interpretime gjuhësore	51
2.11. Teoritë të cilat kundërshtojnë dygjuhësinë dhe kultura e edukimit.	51
2.12. Zhvillimi i bilinguizmit apo i dygjuhësisë te fëmijët.	52
2.12.1. Interferencat	54
2.13. Strukturat përgjegjëse të trurit për verbalizim.	55
2.13.1. Detyra dhe humbje	60
2.13.2. Stimulimet dhe lesionet	62
2.13.3. Trungu i trurit (cerebral).	63
2.13.4. Funksionimi i dygjuhësisë në tru	64
2.14. Mosha optimale për mësimin e gjuhëve	71
2.15. Parime bazë dhe ndikime në mësimin e gjuhës.	74
2.16. Ndryshimi i kodit (Codeswitching) si një tregues i veçantë për dygjuhësi- në	75
2.17. Mësimi i gjuhës së dytë	75
2.18. Dygjuhësia: sa personalitete dhe yje të kinemasë e muzikës e kanë pasur këtë favor?	80
2.19. Fëmijët janë e ardhmja.	82
2.19.1 Të filluarit që në moshë të vogël	82
2.20. Lehtësimi i procesit të mëimit të gjuhëve – Në kërkim të praktikave më të mira	83
2.20.1 Arsye se pse të rinjtë duhet të mësojnë gjuhë të huaja.	83
KAPITULLI III: METODOLOGJIA	87
3.1. Historiku i kërkimit, përshkrimi i fazave të kërkimit	87
3.2. Pjesëmarrësit	88
3.2.1. Kampionimi i personave bilingual	88
3.2.2. Kampionimi i personave jo bilingual	89
3.3. Instrumentet e studimit	91
3.3.1. Pyetësi për personat bilingual	91
3.3.2. Pyetësi për personat monobilingual	93
3.3.3. Intervista gjysmë e strukturuar	94
3.3.4. Procedura	96
3.3.5. Analiza e të dhënave.	97

3.3.6. Qëndrueshmëria dhe vlefshmëria e studimit	98
3.3.7. Çështjet etike	100
3.3.8. Pikat e forta dhe kufizimet e studimit	101
KAPITULLI IV: REZULTATET E STUDIMIT	103
4.1. Të dhënat bazë të subjekteve të studimit	103
4.1.2. Statusi civil	104
4.2. Dëshira për t'u rritur si person me dy gjuhë ose jo?	105
4.3. Bilinguizmi dhe superioriteti	106
4.4. Gjuhët e huaja	107
4.5. Bilinguizmi dhe talentet artistike	108
4.6. Bilinguizmi dhe arritjet në jetë	109
4.7. Rezultatet e të dhënave cilësore	110
4.7.1. Superioriteti dhe bilinguizmi	110
4.7.2. Njohuritë dhe talentet në fushat artistike	111
4.7.3. Disavantazhet e bilinguizmit	111
4.7.4. Bilinguizmi dhe arritjet në jetë	112
4.7.5. Çfarë sjell njohja e një gjuhe të dytë që në vegjëli	113
4.7.6. Mësimi i gjuhës së huaj nga të rinjtë	113
KAPITULLI V: DISKUTIMI	115
5.1. Mësimi i gjuhëve të huaja	115
5.2. Inferioriteti nga padija	116
5.3. Gjuha e huaj, një domosdoshmëri në shoqërinë globale	117
5.4. Të flasësh më shumë gjuhë ndihmon në mbajtjen aktive të trurit	118
5.5. Bilinguizmi si avantazh për socializim	119
5.5.1. Avantazhet e të qenët bilingual	124
5.5.2. Përfitimet që sjell në karrierën tuaj, fakti i të qenët bilingual	125
5.6. Bilinguizmi dhe ndikimi pozitiv në shëndetin mendor	127
5.6.1. Mosha	128
5.6.2. Strategjitë	128
5.6.3. Faktorët ndikues	128
5.6.4. Interferencat	130
5.7. Bilinguizmi dhe kultura	131
5.8. Bilinguizmi përpara viteve 40-të në Shqipëri	134
5.9. Arritjet e personave bilingual në jetë	135

5.10. Bilinguizmi dhe prirjet artistike.	136
5.11. Avantazhet e mësimit të gjuhës së huaj tek të rinjtë	138
KAPITULLI VI: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.	141
KAPITULLI VII: SUGJERIM PËR STUDIME TË TJERA	144
SHTOJCA 1	145
SHTOJCA 2	146
SHTOJCA 3	149
SHTOJCA 4: INTERVISTAT	152
BIBLIOGRAFIA	176
Burime nga interneti	180

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1 — Subjekte monolingual.	103
Grafiku 2 — Subjekte bilingual.	103
Grafiku 3 — Arsimi i subjekteve bilingual	104
Grafiku 4 — Arsimi i subjekteve monolingual	104
Grafiku 5 — Statusi civil i personave bilingual	104
Grafiku 6 — Statusi civil i personave monolingual	105
Grafiku 7 — SB dhe preferenca për t'u rritur si bilingual.	105
Grafiku 8 — SM dhe preferenca për t'u rritur si bilingual	106
Grafiku 9 — SB dhe superioriteti përballë personave monolingual	106
Grafiku 10 — SM dhe inferioriteti përballë personave bilingual	106
Grafiku 11 — A kanë personat bilingual talente artistike?	108
Grafiku 12 — A e stimulon trurin mësimi i një gjuhe të re?	108
Grafiku 13 — A lidhet bilinguizmi me arritjet dhe sukseset në jetë?	109
Grafiku 14 — A ka disavantazhe fakti i të rriturit si bilingual?	110

LISTA E SHKURTIMEVE

Për lehtësi në këtë studim do të përdoren disa shkurtesa të termave kyç. Termat dhe shkurtime të përdoruar vijojnë si më poshtë:

Lingua 1 - L1

Lingua 2 - L2

Monolingual - Person që është rritur dhe ka mësuar vetëm një gjuhë

Bilingual - Në këtë studim i referohet një personi, i cili ka mësuar dhe është rritur me dy gjuhë njëkohësisht që nga lindja.

Interferenca - Në studimin e gjuhësisë, me interferencë nënkuptojmë devijimin apo transferimin e zanoreve, fjalëve apo rregullave se si është formuar fjalia apo pozicionimi i fjalëve në të.

E.SH. - Edukimi shumëgjuhësh

M.GJ.D. - Mësimi i një gjuhe të dytë

KAPITULLI I: HYRJE

Mësimi i gjuhëve të huaja ka zënë një vend të veçantë dhe është vlerësuar gjithmonë ndër shekuj. Edhe në ditët e sotme ne gjejmë personalitete si: akademikë, politikanë, artistë, të cilët inkurajojnë mesimin e gjuhëve të huaja. Kështu, edhe para viteve 90-të në Shqipëri, regjimi i kohës inkurajonte në mënyrë të herëpashershme masat e gjera popullore dhe akademikët e kohës me shprehjen e famshme të Marksit se “Një gjuhë e huaj është një armë në luftën e jetës”.

Evropa është një kontinent i dallimeve të mëdha gjuhësore dhe kulturore, dhe evropianët kanë qenë gjithmonë të vetëdijshëm për larminë gjuhësore. Shpërndarja e gjuhëve është e pabarabartë. Në rajonet ku numri i gjuhëve indigjene është relativisht i vogël (Evropa Perëndimore), hasim numrin më të madh të gjuhëve të imigrantëve. Në Evropën Lindore, nga ana tjetër, numri i gjuhëve indigjene është dukshëm më i madh, por numri i gjuhëve të imigrantëve është më i vogël krahasuar me Evropën Perëndimore. Përqendrimi i gjuhëve është më i madh në rajonin e Kaukazit. Në këtë rajon fliten më shumë se 50 gjuhë. Nga perspektiva e linguistikës historike, historia e Evropës është historia e indo-evropianizimit të saj.

1.1. Gjuhët e huaja në Evropë

Nevoja për të mësuar gjuhë të huaja është një nevojë po aq e vjetër sa edhe vetë historia e njeriut. Nëse flasim për origjinën e edukimit gjuhësor modern, ajo daton në shekullin e 16-të me mësimin e gjuhës latine. Kjo gjuhë për shumë shekuj ishte gjuha dominuese e arsimit, tregtisë, fesë dhe qeveritë në shumë vende të botës perëndimore e bënë gjuhën latine si të detyrueshme për t’u mësuar në shkolla. Në fundin e shekullit të 16-të, rëndësia e gjuhës latine filloi të zbehej disi dhe iu dha më shumë përparësi mësimi të gjuhëve të tjera si frëngjisht, italisht dhe anglisht. John Amos Comenius ishte një nga shumë gjuhëtarë të kohës, të cilët u përpoqën ta kthenin këtë tendencë. Ai hartoi një kurs të plotë për të mësuar gjuhën latine në shkolla, kurs i cili mbulonte tërë kurrikulën e shkollës, duke kulminuar në veprën e tij “Opera Didactica Omnia”, në vitin 1657.

Me anë të kësaj nisme, Comenius theksoi teorinë e tij të përvetësimit të gjuhëve të huaja. Ai është një nga teoricienët e parë që ka shkruar në mënyrë sistematike për mënyrën se si mësohen gjuhët e huaja dhe për metodologjinë pedagogjike për përvetësimin e gjuhëve. Ai mbështeti tezën se për të mësuar gjuhë të huaja duhet një dëshirë e madhe dhe shpesh ka lidhje edhe me ndjesinë dhe përvojën. Sipas Comenius, mësimdhënia duhet të jetë me gojë. Klasat duhet të jenë të pajisura me modele të sendeve dhe koncepteve që shpjego-hen, dhe në mungesë të tyre mësuesi duhet të ketë fotografi për të ilustruar konceptet në gjuhë të huaja. Si rezultat, ai botoi për herë të parë librin me ilustrime për fëmijë në botë, “Orbis Sensualium Pictus”.

Por dalëngadalë gjuha latine e humbi rëndësinë e saj si gjuha kryesore e politikës, arsimit dhe tregëtisë dhe filloi të përdorej si një lëndë mësimore në programin shkollor. Por kjo tendencë nuk kaloi pa u vënë re nga linguistët dhe psikologët e kohës. Studiuesit e asaj kohe nxorën tezën se studimi i gjuhës latine ndikon pozitivisht në zhvillimin e aftësive in-telektuale. Kjo gjetje u vlerësua dhe si rrjedhojë filloi më gjerësisht studimi i gramatikës së gjuhës latine si një fushë më vete.

“Shkolla Gramatike” nga shekulli i 16-të deri më shekullin e 18-të fokusohej kryesisht në mësimin e aspekteve gramatikore të gjuhës klasike latine. Studentët më të avancuar vazh-donin studimet në ciklin më të lartë të gjuhës me shtimin e retorikës. Deri në shekullin e 18-të studentët e gjuhëve të huaja u fokusuan kryesisht në studimin e rregullave strikte gramatikore dhe përkthime të shumta, shumë herë dhe abstrakte. Studentët mësonin për-mendsh rregulla gramatikore dhe më pas duhet ti zbatonin dijet e tyre në deshifrimin dhe përkthimin e tekste të shkruara në gjuhët e caktuar. Kjo metodë e frymëzuar nga tradita e mëparshme në mënyrat e të mësuarit u bë e njohur si metoda gramatikë-përkthim.

Mësimi i gjuhëve të huaja në shekullin e 19-të dhe 20-të

Risitë në mësimin e gjuhëve të huaja fillojnë në shekullin e 19-të dhe u bënë shumë të njohura dhe të zbatueshme në shekullin e 20-të. Henry Sweet ishte një figurë e rëndë-sishme e asaj kohe në krijimin e traditës së aplikuar në mësimin e gjuhëve të huaja. Gjuhëtarë shumë të njohur si Jean Manesca, Heinrich Gottfried Ollendorff (1803-1865),

Henry Sweet (1845-1912), Otto Jespersen (1860-1943), dhe Harold Palmer (1877-1949) punuan në vendosjen e parimeve të mësimdhënies së gjuhëve dhe qasjet e bazuara në teoritë gjuhësore dhe psikologjike. Ata studiuan dhe hulumtuan rreth metodave të ndryshme dhe shumë herë kontradiktore me njëri tjetër, por me qëllimin për të sjellë një përmirësim mbi metodat e mëparshme të mëimit të gjuhëve të huaja.

Edhe pse gjetjet dhe risitë ishin shumë inovative për kohën historia e arsimit në gjuhë të huaj në shekullin e 20-të dhe metodat e mësimdhënies shpesh vlerësohen si dështim, krahasuar me ditët e sotme. Shumë pak studentë vlerësoheshim me “aftësi minimale profesionale”.

Megjithatë, ky “dështim” në mësimin e një gjuhë të dytë apo të huaj lidhet me dështimin e programeve dhe pedagogjinë e mëimit të gjuhës. Metodat e vjetra të tilla si metoda e përkthimit gramatik, kanë rezultuar se nuk janë shumë të efektshme në përvetësimin e gjuhës së huaj.

Ithtarët e metodave të reja të mëimit të gjuhëve të huaja besonin fort se idetë e tyre ishin kaq të reja dhe korrekte, saqë edhe një i moshuar mund të përvetësonte gjuhë të huaja lehtësisht. Ekzistojnë dy degë të mëdha në fushën e mëimit të gjuhëve: empirike dhe teorike. Në periudha të ndryshme kohore, një një moment fitonte terren njëra dhe në një momet tjetër kishte prioritet dega tjetër. Shembuj të studiuesve që mbështesnin studimet empirike janë Xhesperson, Palmer dhe Leonard Bloomfield. Këta studiues promovojnë mimikën dhe mësimin përmendësh me stërvitje sipas modeleve të dhëna. Mësimi i një gjuhe të dytë për studiuesit dhe mbështetësit e tezës empirike ishte i njëjtë me mësimin e një sjelljeje të re.

Në anën e metodës teorike gjejmë shembuj të studiuesve si Francois Gouin, M.D. Berlitz dhe Elime de Sauzé. Teoritë e tyre të gjuhës përputhen me gjetjet e bëra nga studiuesi Noam Chomsky dhe të tjerë racionalistë. Këta studiues sollën si risi për kohën një shumëllojshmëri të gjerë të metodave të mësimdhënies së gjuhës së huaj.

Këto metoda rrjedhin nga pozicioni racionalist me të cilin lind njeriu. Aftësia për të menduar dhe përdorimi i gjuhës janë tipare unike njerëzore që e dallojnë njeriun nga speciet

e tjera. Duke pasur parasysh se gjuhët të ndajnë shumë tipare të përbashkëta, ideja është se njerëzit kanë një gramatikë universale e cila është ndërtuar në strukturën tonë të trurit. Kjo na lejon për të krijuar fjali që ne kurrë nuk i kemi dëgjuar më parë, por që ende mund të kuptohen duke folur.

Si konkluzion, mund të thuhet se mësimi i gjuhëve të huaja në Evropë ka patur një rëndësi të veçantë që në shekullin e 16-të. Ndër shekuj studiuesit dhe gjuhëtarët janë përpjekur për të gjetur metodat më efektive të mësimdhënies dhe mësim nxënies për përvetësimin e gjuhëve të huaja. Metodatat shpesh kanë qenë kontradiktore dhe kanë rezultuar gjithashtu si jo të efektshme. Por mësimi i gjuhës së huaj është vlerësuar i një rëndësie madhore.

1.2. Gjuhët e huaja në Shqipëri

Shqipëria është një shtet etnik homogjen. Gjuha zyrtare e shtetit është gjuha shqipe. Brenda gjuhës shqipe ka dy dialekte kryesore: dialekti toskë, i cili flitet në pjesën jugore të vendit dhe dialekti gegë, i cili flitet në pjesën veriore të Shqipërisë dhe në Kosovë. Gjuha letrare është e bazuar në dialektin toskë. Por shumica e shqiptarëve flasin gjithashtu italisht, greqisht, frëngjisht, rusisht dhe anglisht, kjo për shkak të marrëdhënieve politike që Shqipëria ka pasur me vende të ndryshme përgjatë periudhave të ndryshme politike dhe për shkak të emigrimeve të shumta nga shqiptarët në këto vende.

Shqipëria konsiderohet si një nga kombet më poliglot në Evropë. Gjuha greke është shumë e folur në pjesën jugore të Shqipërisë për shkak të minoriteteve greke aty. Komuniteti grek i Shqipërisë flet një dialekt të gjuhës moderne jugore të Greqisë, i cili njihet ndryshe si dialekti i vorio-epiriotëve grekë. Ky komunitet ka edhe disa shprehje të vjetra dhe fjalë që nuk përdoren më në gjuhën greke aktuale. Emigrimi i madh drejt Greqisë që pas viteve 90-të si një vend shumë i afërt fqinj është një faktor tjetër shumë i rëndësishëm që shumë shqiptarë flasin greqisht rrjedhshëm.¹

Gjuha italiane është një gjuhë tjetër e huaj që shqiptarët e flasin shumë mirë. Italishtja kishte një status zyrtar kur vendi ishte protektorat i Italisë. Shumica e shqiptarëve nuk

1. Marrë nga: "Minoritetet etnike në Shqipëri" <http://ungarisches-institut.de/dokumente/pdf/19211002-1.pdf> aksesuar më 31 janar 2013. Komentet dhe përpunimi: ODA

e kanë mësuar gjuhën në klasa apo nga librat, por duke parë programe televizive dhe duke dëgjuar radio italiane. Gjatë regjimit komunist, shqiptarët që jetonin në qytetet përgjatë bregdetit të Adriatikut kanë patur më shumë mundësi të ndjekim televizionin italian, p.sh., në Durrës, Vlorë, Shkodër, Tiranë etj. Shumë shqiptarë, në mënyrë të fshehur dhe duke krijuar mjete rrethanore për të kapur valët e radios dhe televizioneve italiane, arritën të mësojnë këtë gjuhë. Në ditët e sotme, një numër i madh i njerëzve të moshës mesatare dhe të rinj e zotërojnë shumë mirë gjuhën italiane. Gjithashtu, gjuha italiane zotërohet edhe nga një pjesë e vogël e të moshuarve. Në vitin 1933 mbreti Zog lëshoi një dekret ku kërkonte që në të gjitha shkollat shqiptare të futej gjuha italiane si e detyrueshme për t'u mësuar. Shumë persona të atij brezi që sot janë shumë të moshuar, kanë njohuri të gjuhës italiane.

Gjuha ruse u bë gjuha e huaj kryesore që mësohej në shkolla gjatë sistemit komunist në vitet 1950. Rusishtja ishte “lingua franca” për vendet e bllokut lindor, pjesë e së cilës ishte edhe Shqipëria. Mësimi i gjuhës ruse vazhdoi deri në prishjen e marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik në fillim të vitit 1961. Shumica e atyre që mësuan rusisht në atë kohë kanë njohuri të shumta të gjuhës ruse edhe sot.

Pas polemikave ideologjike me Bashkimin Sovjetik, Shqipëria dhe Kina lidhën marrëdhënie të ngushta politike. Një numër i konsiderueshëm studentësh shkuan në Kinë për të studiuar dhe mësuan gjuhën kineze atje. Pas rënies së komunizmit në Shqipëri, në vitin 1991, shumë të rinj shqiptarë udhëtuan drejt Kinës pasi njihnin gjuhën e këtij vendi.

Liceu francez në Korçë dhe Gjirokastrë operoi gjatë periudhës komuniste. Udhëheqësi i vjetër i Shqipërisë komuniste, Enver Hoxha, kishte studiuar në Universitetin e Montpellier në Francë dhe kishte një respekt dhe dobësi për frëngjishten duke bërë që kjo gjuhë të mësohej në këto lice. Shqipëria është gjithashtu anëtare e Frankofonisë. Shumica e frëngjisht folësve në Shqipëri mund të gjenden në këto dy qytete dhe zonat përreth, por edhe në vende të tjera në vend.

Gjuha angleze është gjuha e huaj më e folur nga brezi i ri në Shqipëri. Pas viteve 90-të anglishtja u bë gjuha e huaj kryesore që duhej të mësohej në sistemin arsimor në Shqi-

përi. Nga të dhënat e vitit 2006 më shumë se 65% e fëmijëve që ishin në shkollë mund të flisnin anglisht në një nivel mesatar. Gjuha angleze erdhi në Shqipëri që në vitin 1921. Që atëherë, Shkolla Shqiptare Profesionale ose Shkolla e Zanatçinjve siç quhej në atë kohë, filloi t'u mësojë studentëve të saj gjuhën angleze me mbështetje nga Kryqi i Kuq Amerikan. Kjo shkollë ushtroi veprimtarinë e saj deri në vitin 1933 dhe qeveria shqiptare e asaj kohe vendosi që anglishtja të ishte gjuha e huaj që do të mësohej në shkolla.

Në librin e shkruar në vitin 2006 nga Mimoza Rista-Dema, e cila ka një gradë Ph.D. në linguistikë në universitetin e Indianës në Amerikë, ajo e përshkruan mësimin e gjuhës angleze në Shqipëri gjatë regjimit komunist si më poshtë:

“Edhe pse anglishtja mësohej nëpër shkolla, ajo konsiderohej si gjuha e imperialistëve perëndimorë, dhe si rrjedhojë elementë të kulturës dhe civilizimit perëndimor transmetoheshin të cungët dhe në mënyrë selektive tek nxënësit dhe studentët që mësonin anglisht.”

1.3 Pse është zgjedhur të kryhet ky studim

Bilinguizmi është një fushë e studiuar gjerësisht në Evropë, Amerikë dhe më gjerë. Përfitimet që ka një person i rritur me dy gjuhë janë vërtetuar shkencërisht se janë të shumta, si nga mbajtja e trurit në një gjendje më të mirë funksionale dhe deri tek hapja më lehtë e dyerve për shkollim, punësim dhe për më shumë mundësi.

Shqiptarët konsiderohen si popull që mësojnë lehtë gjuhë të huaja. Historia ka vërtetuar se shqiptarët e kanë me të vërtetë dëshirë dhe pasion mësimin e gjuhëve. Në Shqipëri ka shumë fëmijë që janë rritur si bilingual. Martesat e shqiptarëve me të huaj të kombësive të ndryshme kanë qenë të shumta. Megjithatë, deri më tani nuk ekziston asnjë studim për bilinguizmin në Shqipëri. Nuk ka të dhëna se këta persona të rritur si bilingual kanë patur një dallim nga të rriturit si monolingual. Studiuesja është vetë nënë e dy fëmijëve të rritur si bilingual, me gjuhën shqipe dhe gjermane njëkohësisht dhe gjatë përvojës së saj jetësore dhe punës ka qenë në kontakte të vazhdueshme me fëmijët bilingual. Bilinguizmi i studiuar nën këndvështrimin psiko-social gjeneron të dhëna interesante në kontekstin shqiptar, të dhëna të cilat mungojnë.

1.4. Hipoteza

Nga studimet e kryera gjerësisht në botë rezulton se personat e rritur si bilingual kanë patur shumë arritje pozitive në jetë, kjo e lidhur ngushtësisht me faktin e të rriturit me 2 gjuhë. Pyetjet kërkimore, të cilat do të udhëheqin këtë studim janë:

- Çfarë mbart tjetër një person bilingual, përveç faktit të të mësuarit e dy gjuhëve që në vegjëli?
- Sa lidhen arritjet në jetë të këtyre personave, me faktin e të qenët bilingual?

Ky studim do të bazohet në hipotezën si më poshtë:

Personat bilingual në Shqipëri perceptojnë se arritjet e tyre në jetë, kanë ardhur si pasojë e bilinguizmit, aftësisë për të folur dy gjuhë që në lindje.

1.5. Përkufizimet operacionale

Për të patur një standard udhëheqës në këtë studim, termat kryesore që do të përdoren gjerësisht do të përkufizohen në mënyrë operacionale si më poshtë:

Person bilingual në këtë studim i referohet të gjithë personave që kanë lindur nga martesë e dy prindërve me kombësi të ndryshme, një shqiptar dhe një i huaj ose në zona të pakicave kombëtare në Shqipëri dhe jashtë saj, dhe që në vegjëli janë rritur me dy gjuhë të ndryshme.

Persona VIP bilingual në këtë studim i referohen të gjithë atyre personave të lindur nga martesë e një prindi shqiptar dhe një prindi me kombësi tjetër dhe si pasojë e arritjeve të tyre në jetë njihen gjerësisht nga publiku shqiptar. Ata janë njerëz të botës akademike, artist dhe të shkencës.

Arritje në jetë në këtë studim i referohet mbarimit të një shkolle të lartë, gjetjes dhe sistemimit në një punë, krijimit të një familjeje dhe të qenët pjesë e një grupi shoqëror

1.6. Qëllimi

Qëllimi i studimit është eksplorimi i perceptimeve nga personat bilingual dhe monolingual në Shqipëri lidhur me bilinguizmin dhe ndikimin e tij në arritjet në jetë.

1.7. Objektivat

Bazuar në qëllimin kryesor të studimit, objektivat që synohen të arrihen vijojnë si më poshtë:

1. Hulumtim i perceptimeve të personave bilingual në Shqipëri në lidhje me ndikimin e bilinguizmit apo rritjes me dy gjuhë në arritjet e tyre në jetë.
2. Identifikimi i avantazheve dhe disavantazheve që sjell bilinguizmi në jetën e një njeriu të rritur me dy gjuhë.
3. Eksplorim mbi perceptimet e personave monolingual lidhur me bilinguizmin.
4. Identifikimi i lidhjes së bilinguizmit me talentet dhe prirjet artistike.

KAPITULLI II: SHQYRTIMI I LITERATURËS

Kapitulli i shqyrtimit të literaturës do të paraqesë artikuj shkencorë, dokumente të ndryshme dhe gjetje të studimeve të realizuara mbi bilinguizmin në të gjithë botën. Secili studim dhe artikull shkencor është përzgjedhur dhe shqyrtuar duke marrë në konsideratë objektivat e studimit që po realizohet. Literatura e shqyrtuar është e ndarë sipas nënçështjeve, duke i sjellë këtij studimi një bazë teorike të vërtetuar dhe provuar shkencërisht nga përvoja botërore rreth bilinguizmit.

2.1. Shoqëria shqiptare dhe raportet e saj me bilinguizmin si një dukuri globale

Për vlerësimin e raporteve të shoqërisë shqiptare me bilinguizmin si një dukuri globale, në vijim do të paraqitet shkurtimisht një kronologji e institucionalizimit të gjuhës shqipe. Më pas, nëpërmjet fakteve historike, do të shqyrtohen marrëdhëniet e gjuhës shqipe me gjuhën greke, edhe në kontekstin e bilinguizmit si një dukuri globale dhe e pashmangshme midis këtyre shteteve fqinje.

Kongresi i Elbasanit dhe rëndësia e tij për konsolidimin e gjuhës shqipe

Kongresi i Elbasanit i quajtur ndryshe edhe si “Kongresi i Shkollave Shqipe”, u mbajt nga data 2 deri në datën 10 shtator të vitit 1909 në qytetin e Elbanit. Ky kongres ka një rëndësi themelore për institucionalizimin e gjuhës shqipe. Pushtuesit turq të kohës synonin që turqishtja të ishte gjuha që duhej të flitej në Shqipëri. Në këtë mënyrë, duke mos lejuar mësimin në shkolla të gjuhës shqipe, pushtuesit do ta kishin më të lehtë për të asimiluar shqiptarët si popull. Përpjekjet e qeverisë turke ishin të shumta në shuarjen e gjuhës shqipe.

Sipas studiuesit Avzi Mustafa¹, menjëherë pas Kongresit të Manastirit dhe, sidomos pas Kongresit të Dibrës, turqit e rinj dhe përkrahësit e tyre shqiptarë kërkonin që xhamitë t’i kthenin në vende politikopropagandistike kundër alfabetit dhe shkollës shqipe, dhe jo që ato të shërbenin si vende adhurimi. Gjuha shqipe në Kosovë u urdhërua nga Ministria e Arsimit të Turqisë të asaj kohe të mësohej me shkronja arabe. Fatkeqësisht, i njëjti urdhër u dha edhe për prefekturën e Elbasanit.

1 Avzi Mustafa (9 korrik 2009): “Kongresi i Elbasanit, vepër me rëndësi për historinë e arsimit dhe të gjuhës shqipe”, f. 38

Kongresi i Elbasanit gjatë punës së tij shqyrtoi çështje bazike për mësimin e gjuhës shqipe, mes të cilave hapja e një shkolle pedagogjike, që u quajt Shkolla Normale, me seli në Elbasan. Në kongres u vendos të caktohej një qendër e përgjithshme për grumbullimin dhe mirëmbajtjen e shkollave e organizimin e punës edukativo-arsimore. Kjo qendër caktoi rregullat e udhëheqjes dhe të kontrollit të shkollave dhe për herë të parë, fillon puna e Inspektoratit të shkollave shqipe.

Në Kongresin e Elbasanit u hodhën bazat e arsimit kombëtar shqiptar për dituri e kulturë, duke mbështetur fort idenë e gjuhës së shkruar shqipe. U hodh poshtë shkollimi mbi baza fetare, duke mbështetur fort shkollimin laik. Të gjitha sa më sipër e bëjnë Kongresin e Elbasanit unik dhe të pazëvendësueshëm për institucionalizimin e gjuhës shqipe.

2.2. Shqiptarët dhe marrëdhëniet me gjuhët e huaja

Shpesh shqiptarët janë shquar për dëshirën e tyre për të përparuar, edhe pse historikisht kemi të dhëna që këto nisma janë thyer apo ndaluar nga forca apo fuqi më të mëdha se ata vetë. Gjithësesi, dëshira e parardhësve tanë edhe pse e zbehur vende-vende nga vështirësitë e kohës, sërish ka triumfuar si një bimë që lëshon sytha për t'i treguar botës se ekziston dhe jo vetëm kaq, por dhe do të jetë si motrat e saj.

Në gjysmën e dytë të viteve 80-të, shtypi shqiptar raportonte në formë avokatie për trendin që po përhapej në mësimin e gjuhëve të huaja nëpër shkollat shqiptare të kohës. Si një trend që po përhapej rreth viteve 1980 ishte dhe mësimi i gjuhëve të huaja në Shqipëri në shkollat e vendit. Por tashmë si “moto” e pranuar e ideologjisë përdorej thënia e Marksit: “një gjuhë e huaj është një armë në luftën e jetës”.

Sigurisht që u morën masa për promovimin e kësaj levizjeje dhe dëshire për të përparuar. Në atë periudhë ekzistonin edhe konkurset mes shkollave të mesme e gjimnazeve në promovimin e anglishtes e frëngjishtes. Po ashtu, edhe promovimi i Shqipërisë në dokumentarë të kohës të shoqëruar me komente në gjuhën angleze, i shërbenin në dukje këtij qëllimi (Gazeta “Mësuesi”, 22 mars 1988).

Por ky fenomen, i cili nxori krye në këtë kohë, nuk ishte i ri për shqiptarët. Prej shekujsh shqiptarët punonin, mësonin dhe jetonin si të barabartë në vende të ndryshme të botës ku

jo vetëm flisnin gjuhën e vendeve përkatëse, por dhe drejtonin nëpër zyrat qeveritare të këtyre vendeve. Kjo është një dëshmi e ekzistencës së faktorit të gjuhëve të huaja të pranishme në jetën e shqiptarëve.

Në kohën e monarkisë kemi studentë të cilët studiuuan në vende të ndryshme si Turqi, Itali, Francë etj. Këta studentë u kthyen në vendin e tyre me ide të reja dhe me një mendje të hapur për të ndryshuar dhe moderuar Shqipërinë. Në atë periudhë kemi kthimin e shumë mjekëve, inxhinierëve dhe profesionistëve të diplomuar, të cilët vinin në atdhe me vizione të qarta për të mirën e vendit. Disa prej tyre tashmë të fejuar apo martuar me gra të huaja, pranuan të vinin dhe jetonin bashkë me to në Shqipërinë e asaj kohe, duke marrë parasysh edhe vështirësitë dhe mundësitë e kufizuara për një jetë më të mirë.

Edhe pas luftës së dytë botërore, ku në Shqipëri sundimi u mor nga partia komuniste, lidhjet e kohës me fuqi të ndryshme krijuan mundësinë e shumë studenteve të shkonin me studime në Rusi, ish-BRSS apo dhe në Kinë. Vetë ambasadori kinez në Shqipëri shprehet se ka shumë persona që e njihnin gjuhën kineze prej studimeve të tyre rreth viteve 1970, në këtë vend.

Duke qenë se Shqipëria është shtet kufitar me Greqinë, marrëdhëniet e fqinjësisë janë të pashmangshme. Në kontekstin e këtyre marrëdhënieve, rol parësor ka kontakti midis gjuhëve. Në vijim do të shqyrtohen marrëdhëniet midis gjuhës shqipe dhe gjuhës greke. Në rrethin e Gjirokastrës ndodhet grupi më i madh i minoritetit grek në Shqipëri. Këtu janë gjithsej 33 fshatra të banuara nga popullsia minoritare. Në Dropull, çdo fshat ka kopsht për fëmijë dhe shkolle fillore në gjuhën greke. Ka, gjithashtu, 4 shkolla tetëvjeçare dhe një shkollë të mesme, po ashtu në gjuhën greke. Një zhvillim të dukshëm ka marrë media e shkruar në gjuhën greke. Kështu, në rrethin e Gjirokastrës dalin dhe qarkullojnë një numër revistash e gazetash, si “Laiko Vima”, gazetë që ka dalë vazhdimisht që prej vitit 1945 (Zëri i Omonias)².

Edhe në rrethin e Sarandës ka një numër të konsiderueshëm fshatrash minoritare. Janë 33 (ndonëse disa prej tyre kanë popullsi të përzier). Edhe këtu paraqitet po ajo tablo. Shko-

2 “Minoriteti grek në Shqipëri”, Dr. Dimitris Hristopoulos, 2002

llat greke në fshatra, si dhe në qytetin e Sarandës funksionojnë rregullisht. Në rrethin e Delvinës nga 37 fshatra, 18 janë pothuajse krejt minoritare. Në çdo fshat ka shkollë në gjuhën greke. Në qytetin e Delvinës ka po ashtu një shkollë tetëvjeçare. Kjo gjendje e ka bazën në traditën e një bashkëjetese miqësore midis pakicës dhe shumicës. Shqiptarët e jugut flasin përgjithësisht një dialekt të vorio-epiriotëve grekë. Gjithashtu, ata kanë shumë shprehje dhe fraza që nuk përdoren më në greqishten e sotme.

Aftësia e shqiptarëve për të mësuar gjuhë të huaja

Në shkollat shqiptare mësohej si fillim gjuha ruse. Shqiptarët filluan të mësojnë gjuhën ruse gjatë regjimit komunist, por kjo e fundit erdhi duke u shuar sërish gjatë rënies së këtij të fundit. Duke lënë rusishten mënjanë, shqiptarët drejtohen nga gjuha italiane dhe angleze. Kështu fillon afrimiteti drejt interesit ekonomik, duke ndjerë nevojën e një ndryshimi radikal.

Gjatë viteve '80 gjuhët e huaja bëhen pjesë e jetës si një formë thelbësore edhe për të kaluar kufijtë. Edhe pse gjatë komunizmit gjuhët e huaja dhe gjithçka që lidhej me jashtë ishte e paligjshme, shqipëtarët e gjenin gjithmonë mënyrën për të patur kontakt me to, duke përfshirë këtu dhe ndjekjen e televizioneve të huaja, ku dominonin ato italiane. Dëshira për të parë dhe mësuar se çfarë ndodhte përtej kufijve ishte e fortë. Nga këtu nisi mësimi i gjuhës italiane dhe duhet përmendur se mësimi i gjuhës vetëm nëpërmjet televizionit është një aftësi e rrallë që vetëm shqipëtarët e kanë. (Vögeli, Alma 2013).

Ndihmesë në këtë aftësi janë edhe elementet fonetike dhe shkronjat, të cilat gjuhë të tjera nuk i kanë, një avantazh ky që i bën shqipëtarët mbase edhe pa dashje të mësojnë gjuhët e huaja më me lehtësi.

Në fillim të viteve 90-të, me ardhjen e demokracisë, shqiptarët filluan të ndjekin programe të ndryshme jo vetëm të vendit, por edhe të huaja e sidomos ato italiane. Dëshira për të mësuar se ç'ndodhte jashtë kufirit, si dhe kurioziteti për të mësuar më shumë për botën bëri që shqiptarët ta mësonin gjuhën italiane nga televizioni. E çuditshme, por e vërtetë! Kjo është aftësi e rrallë, që vihet re kur shikon se një shqiptar dhe një italian kuptohen me njëri tjetrin fare thjeshtë. Nëse e pyet për sa kohë e ka studiuar italishten përgjigja është:

“...nuk kam studiuar kurrë, por e kam mësuar nga televizori”. E për më tepër nuk ka qenë kurrë në Itali. Është vërtetë e çuditshme se si një njeri mund ta mësojë dhe përmirësojë një gjuhë të huaj vetëm nga televizioni!

Përveç intuitës për të mësuar gjuhë, siç u përmend edhe më sipër, një ndihmë të madhe jep edhe struktura fonologjike dhe gramatikore e gjuhës shqipe apo kohët e gjuhës. Alfabeti i një gjuhe ndihmon një person për të përvetësuar sa më mirë dhe për të mos patur vështirësi në përdorimin e një gjuhe tjetër. Emigrimi, gjithashtu, ka ndikuar shumë në mësimin e asaj që për shqiptarët ishte e ndryshme.

Vitet 90-të janë ato që ndikuan thellësisht në ndryshimin e jetës së shqiptarëve. Njerëzit emigruan drejt Italisë dhe Greqisë, duke qenë dhe më afër kufirit me Shqipërinë. Një arsye thelbësore është edhe vajtja e shumë studentëve shqiptarë në Itali. Shqiptarët janë ata që përfaqësojnë në Itali komunitetin më të madh të të huajve të regjistruar në universitet. Midis vështirësive të përditshme dhe mundësisë për t’u formuar profesionalisht, shqiptarët kanë patur gjithmonë aftësi dhe ia kanë dalë me sukses të studiojnë në të gjitha vendet ku kanë shkuar.

Në tjetër element i cili ndihmon në këtë fakt, është politika që zbatohet nga të dyja vendet, për t’i dhënë mundësinë të rinjve të studiojnë në Itali dhe anasjelltas. Provimi i gjuhës italiane CELI, një provim i cili certifikon njohjen e gjuhës italiane, bëhet nga të gjithë studentët shqiptarë, të cilët duan të studiojnë në Itali, dhe kalimi me sukses është trampolina e tyre për një botë tjetër të re; ndryshe por jo të lehtë.

Gjithsesi, aftësia e shqiptarëve për gjuhët nuk mbetet mbrapa edhe kur flitet për gjuhë të tjera. Këtu bëhet fjalë për greqishten, anglishten, spanjishten, gjermanishten etj. Shihet se aftësia e rrallë e tyre për të mësuar gjuhë të huaj nuk është e rastësishme, por e imponuar ose më saktë e shtyrë nga faktorë të ndryshëm. E megjithatë, mund ta quajmë një dhunti.

Aspektet pedagogjike të gjuhës amtare dhe edukimi bilingual

Në bazë të shumë kërkimeve pedagogjike, ekziston një mit ku thuhet se një student mëson më mirë një gjuhë të huaj pa mësuar më parë gjuhën amtare. Fokusi i kësaj teme është kërkimi pedagogjik dhe fakte se si mund të krijojmë kushte sa më të favorshme mësimi

për fëmijët dhe të rriturit. Cili është ndikimi i edukimit në gjuhën amtare në të mësuarit dhe performancën, dhe për sa vite duhet të marrin fëmijët edukimin në gjuhën amtare? Veç kësaj, do të shikojmë balancimin e rekomanduar midis edukimit në gjuhën amtare dhe futja në gjuhën e dytë, ku të dyja duhet të jenë të zotëruara.

Rreziku që ekziston kur nuk ofron edukimin në gjuhën amtare, në bazë të disa kërkimeve, është që studentët nuk do të mund të zotërojnë mjaftueshëm asnjë gjuhë për ta përdorur në shkollë. Kjo pasi është e nevojshme për fëmijën të zhvillojë të kuptuarit e gjuhës dhe zotërimin e konceptit të një niveli të caktuar, para se ai të mësojë një gjuhë të re. Nëse studenti – fëmijë apo i rritur – nuk zotëron gjuhën amtare, atëherë është gjithnjë e më e vështirë për të mësuar një gjuhë tjetër. Fëmija nuk do të zhvillojë të kuptuarit e nevojshëm në konceptet e avancuara dhe do të hasë vështirësi në mësimin e lëndëve të tjera, siç janë historia dhe matematika në gjuhë të dytë. Në këtë mënyrë, ekziston rreziku që fëmijët, të cilët nuk kanë mësuar mjaftueshëm asnjë nga gjuhët, do të kenë një nivel më të ulët në shkollë dhe si pasojë do të kenë mundësi më të pakta në tregun e punës.

Në mënyrë që të krijohen kushte sa më optimale për studentët, duhet ekzaminuar për sa kohë është i nevojshëm edukimi në gjuhën amtare dhe ç’lloj balance duhet të ekzistojë midis gjuhës së dytë dhe gjuhës amtare nëse studentët do të zotërojnë të dyja gjuhët. Shpesh, edukimi i pamjaftueshëm gjuhësor do të jetë “i padukshëm” në vitet e para. Fëmijët e emigrantëve janë në gjendje në një moshë shumë të vogël të flasin rrjedhshëm danishten dhe disa fëmijë afrikanë janë në gjendje të flasin 2/3 e gjuhës vendase, por e gjitha kjo nuk do të thotë që janë në një nivel të mjaftueshëm gjuhësor për t’u përdorur në shkollë.

Duke qenë se gjuha është e lidhur në shumë aspekte, është e rëndësishme për të shqyrtuar lidhjen midis gjuhës së folur me atë të shkruar. Jo të gjitha gjuhët janë gjuhë të shkruara, dhe në këto raste edukimi gjuhësor duhet të organizohet në një mënyrë të veçantë. Përveç kësaj, nëse nxënësve do t’u ofrohet edukimi cilësor gjuhësor, ku janë të përfshirë mësues të disponueshëm me të drejtën pedagogjike dhe trajnimin kultural, nxënia e gjuhës do të kishte rrënjë të shëndosha dhe nuk do të habiteshim për mosnjohjen e saj në faza të mëte-

jshme. Prandaj, duhet të konsiderohet se çfarë i duhet një mësuesi edukimi për të siguruar gjuhën amtare dhe edukimin bilingual cilësor.

Shqipëria dhe interesi për mësimin e gjuhëve të huaja

Rreth viteve 1987-1988, lehtësisht mund të kujtosh emisionet për mësimin e gjuhëve të huaja që filluan të transmetoheshin në TVSH, i cili ishte kanali i vetëm televiziv në vend, duke dhënë leksione në gjuhën angleze e frënge, e më pas duke vijuar edhe me gjuhën gjermane dhe italiane. Si një kërkesë edhe e inteligjencës së vendit apo e disa shkrimtarëve me emër, mësimi i gjuhëve kishte marrë përmasa realisht të konsiderueshme edhe pas vdekjes së diktatorit. Por jo vetëm kaq, mësimi i gjuhëve të huaja filloi të përhapej tashmë përmes mësimi autodidakt apo mësimdhënies në ambiente private kundrejt pagesave në dorë. Ndërsa regjimi i kohës me lezet mbyllte sytë përpara këtij fenomeni, sigurimi i kohës habitej me këtë tolerancë, por pa pasur fuqinë të ndryshonte asgjë. Ky fenomen kishte marrë përmasa të tilla, që edhe në mediat e huaja, në vitin 1998, u pasqyrua në një shkrim si:

“Studimi i gjuhëve të huaja aktualisht po promovohet gjerësisht në radhët e opinionit publik shqiptar, ku në të shkuarën vetëm një sasi e pakët të përgjedhurish ishin të lejuar të mësonin. Në të njëjtën kohë, përkthimi i letërsisë së huaj po inkurajohet. Vëmendja në rritje që po u jepet atyre, është në linjë me rritjen e kontakteve që vendi komunist po synon me botën e jashtme.” (shih: “Foreign Languages and Books Win Favor in Albania”, RAD Background Report / 163 ALBANIA, 22 Aug. 1988, By Louis Zanga). (gazetadrita.al)

Në fakt, shqiptarët, edhe në një pikëpamje historike kanë shfaqur e vijojnë të shfaqin interes të veçantë për mësimin e gjuhëve të huaja. Mjafton të përmendim se italishtja për shembull, sidomos në kohë të caktuara (sigurisht edhe sot e kësaj dite), perceptohet ndër shqiptarët si një gjuhë, e cila përthithet ndoshta pa iu nënshtruar domosdoshmërisht asnjë seance të mirëfilltë mësimore, duke hasur në një masivitet të konsiderueshëm. Sidoqoftë, ky trend ishte shumë i përhapur në fundvitet 80-të e fillimvitet 90-të, për t’ia lënë vendin apo zgjeruar me gjuhë të tjera, që u mundësuan pas ardhjes së demokracisë e lëvizjes së shqiptarëve në vendet e huaja.

Ismail Qemali, e nisi si përkthyes

Në fakt, shqipëria dhe shqiptarët, edhe në pikëpamjen kulturore apo interesa të caktuara, kanë shfaqur ndër vite interesin për të mësuar gjuhë të huaja, p.sh., Ismail Qemali,

karrierën e tij e nisi si përkthyes. Por edhe në kohët e hershme, nën sundimin romak, bizantin, venedikas apo osman, shqiptarët shfaqnin aftësi të veçanta jo vetëm si luftëtarë apo nëpunës të zotë, por edhe si mendjendritur, dhe në këtë kontekst edhe si përkthyes. Mjafton të kujtojmë fazat e para të angazhimit zyrtar në shërbim të Perandorisë osmane të “babait” të shtetit shqiptar, Ismal Bej Vlora, i cili duke pasur një bagazh intelektual e gjuhësor, punoi si përkthyes i disa gjuhëve të huaja në Ministrinë e Jashtme osmane, para se t’i nënshtrohej një karriere të shkëlqyer, që e katapultoi atë me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në postin e Kryeministrit të parë të vendit.

Raste shqiptare përgjatë historisë

Në artikujt e shkruar nga korrespondentë të kohës apo vizitorë të viseve shqiptare, rreth viteve 90-të, kemi dëshmi se gjithandej mund të dëgjosh se në Korçë “...gjithandej mund të dëgjosh anglisht, pasi thuajse çdo i rritur i familjeve korçare ka qenë në Amerikë” (shih: “A New Nation In An Old World”, Scribner’s Magazine, by Viola Paradise and Helen Campbell, Feb. 1923). Po aty, konstatimi bëhet edhe më evident, ndërsa theksohet se:

“Shqiptarët kanë një dhunti për gjuhë të huaja. Pajisja me turqisht, greqisht dhe serbisht, bullgarisht apo rumanisht, alternativë ndaj shqipes, është e zakonshme. Mes atyre që kanë pasur mundësinë të kenë një edukim të huaj, frëngjishtja, gjermanishtja dhe italishtja – shpesh të trija së bashku – përbëjnë kanale interaktive të komunikimit. Shqipëria nuk e ka përzier urrejtjen me gjuhët e huaja, siç bëjnë shpesh kombe të tjera. Ajo i edukon të rinjtë e saj në Itali, Francë e Austri, të gjitha këto vende të cilat kanë qenë dikur pushtuesit e saj. Shumë shqiptarë lexojnë në persisht, duke e renditur atë si njëra ndër gjuhët e tyre klasike.”

Këto tendenca vijuan (sigurisht se ndërkohë, numri i atyre që njihnin turqisht, osmanisht, persisht e arabisht, sa vinte e ulej) e madje u konsoliduan edhe më tej gjatë monarkisë shqiptare e viteve të Luftës së Dytë. Në një esë kritike rreth çështjes së botimeve në gjuhën shqipe, në vitin 1944, Muzafer Pipa shkruante diku se:

“Është koha kur libri sjell fitim! O burra! Të rrokim penët! E mbijnë atëherë veprat si kërpudhat pas shiut! Përkthimet morën dhenë. Kush është ai që nuk e njeh një drejtë gjuhe moderne? E kush është ai i marrë që nuk përkthen ndonjë send?” (shih: “Frenezia e Botimeve”, Revista “Fryma”, Nr. 4, 1944, fq. 151154).

Rusishtja si gjuhë

Direkt pas luftës, pati një lëvizje të re në mësimin e gjuhëve të huaja, ku si direktivë apo si tendencë u vu re mësimi i gjuhës ruse (me lëvizjet e kohës, pati tendencë të futej në shkolat shqiptare edhe mësimi i serbokroatishtes), një risi kjo për shqiptarët, por jo për kohën

kur gjysma e botës tashmë kishte rënë nën ndikimin sovjetik e ku “gjuha e Leninit” kishte marrë të drejtën e qytetarisë, duke shërbyer si gjuha bazë e komunikimit mes vendeve të ish-Demokracive Popullore. Interesant është fakti se rusishtja vijoi të mësohej e ushtrohej me përparësi deri në rënien e komunizmit në Shqipëri, duke u shoqëruar ndoshta paralelisht edhe nga gjuha frënge, e cila prapë se prapë mbeti deri në fund një aset i inteligjencës moniste shqiptare, pa mundur dot të depërtojë tek masat e gjera.

Gjatë periudhës së demokracisë kjo gjuhë ka pasur luhatjet e saj, herë në rënie, herë në zbehje dhe herë në ngritje, ku prezenca e Departamentit të Gjuhës Frënge në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe ajo e Aleancës Franceze dhe anëtarësimi “pro forma” i Shqipërisë në Klubin Ndërkombëtar të Frankofonisë, kanë tentuar në dukje ta pengojnë atë. Në periudha e kontigjente të caktuara, tendenca, ose le të themi më mirë orientimi, zhvendosej paksa edhe nga italishtja e anglishtja, në terma publikë e masivë, pasi sigurisht gjuhët e fqinjëve apo ajo arabe, kineze, spanjishtja etj, i nënshtroheshin trendeve të veçanta. Me gjithë këtë udhëtim në të cilin ka kaluar mësimi i gjuhëve nga masat intelektuale, gjithmonë kjo tendencë ishte në varësi dhe e orientuar nga interesa ekonomike dhe zhvillime politike.

Gjuhët e huaja rreth viteve 80-të

Ishin këto vitet kur shtypi i kohës njoftonte në formë avokatie për trendin që po përhapej në mësimin e gjuhëve të huaja nëpër shkollat shqiptare të kohës. Patjetër këtu si “armatim” i mirë ideologjik përdorej thënia e Marksit: “një gjuhë e huaj është një armë në luftën e jetës”. Si masa të tjera për promovimin e këtij trendi përdorreshin edhe konkurset mes shkollave të mesme dhe gjimnazeve në promovimin e gjuhës angleze dhe asaj frënge. Po ashtu, edhe promovimi i Shqipërisë në dokumentarë të ndryshëm shoqëruar me komente në gjuhën angleze, i shërbenin në dukje këtij qëllimi (Shih: Gazeta “Mësuesi”, 22 mars 1988). Po në atë periudhë, gazeta “Zëri i Popullit” botonte një artikull që fliste për kërkesën e madhe që kishte populli për hartimin dhe pajisjen me fjalor dy-gjuhësh. Kështu, nga të dhënat e ish-Komitetit Qendror të PPSH-së, (shih: Zëri i Popullit, 31 korrik 1988) njoftohej se përgjatë 15 viteve të fundit, ishin botuar gjithsej 25 fjalorë dygjuhësh me nga 50 000 fjalë

secili. Po kështu, gazeta vinte në pah faktin se ishte e vështirë të gjendej në librari ndonjë kopje e fjalorit frëngjisht-shqip që ishte botuar tashmë 10 vjet më parë dhe se kur një fjalor anglisht-shqip ishte futur në treg 7 vjet më parë, 8 000 kopjet e tij, ishin shitur brenda pak ditëve. Ndërkohë, 15 000 kopjet e fjalorit italisht-shqip botuar së fundmi në atë kohë, dhe 25 000 kopjet e fjalorit tjetër të botuar vetëm dy vjet më parë, anglisht-shqip, ishin mbaruar pak ditë pas daljes në treg. Nga ana tjetër, edhe një fjalor gjermanisht-shqip (botuar në 15 000 kopje) po shitej me shpejtësi, sikurse edhe disa doracakë bisedimorë anglisht-shqip e gjermanisht-shqip. Interesant është fakti se tashmë theksi po shkonte gjithnjë e më shumë drejt gjuhëve perëndimore dhe megjithëse rusishtja vijonte të ishte akoma gjuha numër 1, e cila mësohej në sistemin arsimor shqiptar, fakti se fjalori i fundit rusisht –shqip, (përveç njërit mbi terminologjinë teknike, me 50 000 fjalë), i botuar tashmë para 35 viteve, në vitin 1954, me 25 000 fjalë, fliste më së miri për këtë fenomen.

Përkthimet dhe letërsia e huaj

Është koha kur interesi për mësimin e gjuhëve të huaja, kryesisht i atyre të mëdha perëndimore, po shoqërohej me shpejtësi edhe nga numri i lartë i përkthimeve që po bëheshin nga letërsia e huaj. Në një takim të organizuar në Tiranë nga Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, me përkthyes të letërsisë së huaj, (shih: Revista “Nëntori”, maj 1988), ish-kreu i saj, prof. Dhimitër Shuteriqi, i vinte theksin faktit se letërsia, filmat etj, duhej t’u vinin në ndihmë individëve për t’u lidhur e përshtatur më mirë me njerëzit e kombeve të tjera. “Ka pasur periudha, - theksonte Shuteriqi, - kur letërsia e huaj dhe veprat bashkëkohore, ishin lënë vërtet pas dore. Gjatë dy viteve të shkuara janë bërë përpjekje për mbushjen e këtij vakuumi, dhe se për këtë duhej të aktivizoheshin më shumë përkthyes.” Sipas tij, kishte ardhur koha të zbuloheshin edhe letërsia amerikanolatine, ajo arabe dhe ajo irlandeze, duke e renditur këtë të fundit si njëra nga letërsitë më të mëdha e më me tradita, përveç përkthimeve të tjera nga gjuha angleze, frënge, italiane, gjermane spanjolle etj. Po kështu, ai vlerësonte mjaft letërsinë gjermane, që rrënjët e saj – sipas tij – i kishte vendosur që në kohërat e Martin Luterit dhe nga ajo e humanizmit evropian, e duke vazhduar me letërsinë bashkëkohore. Në këtë kontekst, prof. Shuteriqi bënte apel

për një ngritje profesionale të përkthyesve të rinj. Ai theksonte se në Shqipërinë e asaj periudhe kishte pak përkthyes kompetentë dhe se në këtë aspekt gjërat duhet të ndryshonin dhe t'i përshtateshin kërkesave të kohës. Nga ana tjetër ai rekomandonte se pas viteve të studimit, të cilat për studentët e gjuhëve të huaja ishin 12 vjet teori, pas kësaj kohe studentët të dërgoheshin jashtë vendit në praktika për gjuhët përkatëse, për të mësuar veshin dhe për t'u rritur profesionalisht.

Një mbështetës i kësaj lëvizjeje u bë edhe profesori i letërsisë gjermane, Robert Schwartz, se këto gjëra duhet të kishin zënë fill që përpara 10 apo 20 vjetëve. Herë pas here rezultonte që udhëheqësi komunist i kohës, Enver Hoxha, t'u jetë drejtuar intelektualëve me kërkesën për rritjen e numrit të përkthyesve në gjuhët e huaja, porse trendi më shumë ishte ai i kohës; ishte ai i përkthimit të veprave të letërsisë shqiptare dhe atyre me përmbajtje ideologjike, ku fillimisht qëndronin veprat e vetë Hoxhës drejt gjuhëve e vendeve të huaja, sesa e kundërta. Sipas vlerësimeve të bashkëkohësve të Hoxhës, dëshmitë tregojnë se vetë Hoxha kishte një admirim për letërsinë e huaj, por kjo e kufizuar ndoshta vetëm tek letërsia klasike greke dhe ajo franceze e shekullit të 19-të apo ajo e fillimshkullit 20-të. (Vögeli, Alma 2013).

Përkthimet sot dhe gjuhët e huaja

Me zhvillimin e demokracisë, sigurisht që nëse mësoje një gjuhë të huaj nuk përbënte më asnjë rrezik, por për më tepër ishte një “armë”, të cilën, me shumë mundësi do të vinte rasti të përdorej. Në aspektin masiv, vendin e gjuhës ruse dhe asaj frënge tashmë e kishin zënë gjuha angleze dhe italiane, duke u pasuar më vonë nga gjuha gjermane, e cila ka njohur progres në terma relativë, sidomos në moshat e reja përgjatë viteve të fundit. Po ashtu, një interes të veçantë sidomos femëror, është edhe mësimi i gjuhës spanjolle, i cili po tenton të rritet kohët e fundit, falë edhe telenovelave spanjolle të shfaqura në trojet shqiptare. Ndërkohë, edhe mësimi i gjuhës greke ka pësuar rritje, porse duhet theksuar se kjo është e lidhur ngushtë me kontigjentin e qytetarëve dhe fshatarëve që shkojnë e vijnë në Greqi, si pasojë e kushteve ekonomike.

Në terma profesionalë, përkthimet nga letërsia apo botimet në gjuhë të huaj, kanë njo-

hur një rritje të vërtetë, megjithatë e gjitha kjo ka shkuar si një kosto në cilësinë e përkthimeve, për të cilën është folur e debatuar shpesh në publik. Në fakt, vlerësimi më eksplisit dhe më kritik në lidhje me aftësinë e shqiptarëve për të mësuar gjuhë të huaja, është vënë në dukje nga studiuesi Robert Elsie, i cili vite më parë, përveç nxjerrjes në pah të aftësisë së shqiptarëve për të mësuar gjuhë të huaja, ka kritikuar hapur mungesën e përkthyesve të specializuar të cilët do të mundësonin përcjelljen e vepërave të letërsisë bashkëkohore shqipe në gjuhë të huaj. Nga ana tjetër, ai ka kritikuar direktivën e kohës së monizmit për t'ia ngarkuar këtë rol vetëm shqiptarëve (madje në shumicën e tyre, ishin të burgosurit politikë) e shumë pak apo aspak të huajve, të cilët, sigurisht se duke ardhur nga jashtë, do të njihnin më mirë gjuhët e tyre përkatëse (shih revista "Ars", Tiranë, 26.10.2003, f. 22.).

Një sërë problemesh të tjera që vijnë si pasojë edhe e tendencave aktuale të tregut të lirë apo edhe e shkaqeve e fenomeneve të tjera të veçanta që mbart ndoshta vetëm Shqipëria, ndërthurur me nivelin e përkthyesve (por jo numrin e tyre) dhe ndonjëherë edhe shpërblimin apo edhe licencimin e tyre bashkë me krizën në tregun e librit, kanë bërë që në mënyrë paradoksale, thirrja e Prof. Shuteriqit për rritjen e nivelit të përkthimeve në vitin 1988, të tingëllojë aktuale, sot më shumë se kurrë më parë.

2.3. Bilinguizmi në Kosovë

Dygjuhësia si dukuri është e pranishme gjithandej nëpër botë dhe pothuajse nuk ka ent shoqëror apo shtetëror që është krejtësisht njëgjuhësh. Pothuajse në çdo vend, dukuria e bilinguizmit i ka tiparet dhe karakteristikat e veta specifike. Kjo dukuri, e cila shfaqet si rezultat i kontakteve gjuhësore, është shumë komplekse dhe variabël, e ndërlidhur ngushtë me zhvillimet e përgjithshme shoqërore, politike e kulturore. Ndryshimet e këtyre faktorëve ndikojnë drejtpërdrejt edhe në aspekte të bilinguizmit në kuadër të enteve shoqërore dygjuhëshe. Duke qenë dukuri aq komplekse, dygjuhësia paraqet një sfidë komplekse për planifikimin e gjuhës, sidomos për planifikimin e statusit dhe të funksioneve të gjuhës, sepse ky planifikim reflekton edhe qasjen dhe nivelin e tolerancës së shoqërisë në raport

me gjuhët. Planifikimi gjuhësor shpërfaq synimin e bashkësisë shoqërore për të stimuluar dominimin gjuhësor, ose e kundërta: synimin për të promovuar barazinë gjuhësore.

Në kuadër të shembujve të ndryshëm të planifikimit gjuhësor të dygjuhësisë, të cilët mund të gjenden gjithandej nëpër botë, rasti i dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë paraqet një shembull mjaft me interes për t'u studiuar. Dygjuhësia shqip-serbisht në Kosovë shfaqet si dukuri e bilinguizmit asimetrik dhe si rrjedhojë e kontaktit dhe konfliktit gjuhësor (Munishi, 2010). Në të kaluarën ky bilinguizëm ka qenë subjekt i ndërhyrjes planifikuese, i cili ka pasur për qëllim, në radhë të parë, përcaktimin e statusit të shqipes dhe të serbishtes, por edhe planifikimin e funksioneve të tyre, sidomos në rrafshin zyrtar dhe administrativ. Problemet dhe tiparet e këtij planifikimi gjatë periudhës 1945-1990 janë trajtuar në mënyrë më të thelluar nga Gazmend Zajmi dhe sidomos, Rexhep Ismajli. Sa i përket planifikimit të statusit të shqipes dhe serbishtes në Kosovë gjatë viteve 1945-1990, mund të thuhet se përkundër avancimit gradual të pozitës së shqipes pas vitit 1945, sidomos pas vitit 1974, kur u përcaktua statusi i barabartë për shqipen dhe serbishten në Kosovë, megjithatë serbishtja ishte në pozitë më të favorshme për faktin se në kontekstin e përgjithshëm të ish-Jugosllavisë, si gjuhë e shumicës shërbente edhe si "lingua franca" e federatës së atëhershme jugosllave. Për të përcaktuar statusin e shqipes në raport me serbishten, Ismajli kishte përdorur tipologjinë e Heinz Klossit, me këtë rast kishte konstatuar me të drejtë se shqipja kishte statusin e gjuhës zyrtare bashkë me një gjuhë tjetër (Ismajli, 1991). Vlen të përmendet fakti se shqiptarët dhe serbët në Kosovë në atë kohë, ndonëse ishin bashkësi folëse të ndryshme, përbënin një bashkësi komunikuese, sepse kishin ndërveprim dhe ndërkomunikim të përditshëm me njëri-tjetrin, dhe këtu komunikimi zhvillohej kryesisht në kodin dominant që ishte serbishtja. Pas vitit 1990, gjuha shqipe, praktikisht, u bë gjuhë e ndaluar dhe përdorimi i saj u kufizua vetëm në domenet e familjes, në rrethin shoqëror, që përbëhej kryesisht prej shqiptarëve, në ato punë me të cilat merreshin shqiptarët nën okupacionin serb dhe në ato pak media që kishin mbetur në gjuhën shqipe. Në një situatë të tillë, statusi i shqipes u degradua deri në pikën më të ulët (Munishi, 2006).

Pas përfundimit të luftës në Kosovë dhe largimit të pushtetit serb (1999) u krijuan rrethana të reja politike, ekonomike e kulturore, të cilat patën ndikim të drejtpërdrejtë në procesin e zhvillimit të bilinguizmit shqip-serbisht. Evoluimi i statusit të shqipes dhe të serbishtes në Kosovë pas vendosjes së Misionit të OKB-së është trajtuar nga Ismajli (Ismajli, 2002, 2003) dhe Munishi (2006, 2009, 2010). Kohë më parë, në dy raste jemi përpjekur të trajtojmë statusin e shqipes në kontekstin rajonal dhe europian (Munishi, 2009) dhe, konkretisht, statusin e shqipes në Kosovë (2010). Kriteri demografik është një kriter kyç që luan rol kryesor në raportet midis shqipes dhe serbishtes në Kosovë. Në anën tjetër, si pasojë e luftës, marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve janë ftohur në masë të madhe dhe kjo ka çuar pothuaj në ndarjen fizike të tyre. Sot, serbët jetojnë kryesisht në disa qytete e fshatra të Kosovës në bashkësi kompakte, të cilat kryesisht janë të ndara jo vetëm nga popullsia shqiptare, por edhe nga bashkësitë e tjera etnike që jetojnë në Kosovë. Me fjalë të tjera, domenet e kontakteve midis shqipes dhe serbishtes janë kufizuar ndjeshëm. Kontaktet e përditshme, sidomos ato joformale, midis shqiptarëve dhe serbëve janë reduktuar në masë të madhe dhe kjo është reflektuar edhe në komunikimin gjuhësor reciprok. Nëse dikur shqiptarët dhe serbët në Kosovë përbënin bashkësi komunikuese, sot shqiptarët dhe serbët janë bashkësi pothuajse të ndara gjuhësore.

Ndërkommunikimi i reduktuar, gjithashtu, ka ndikim të drejtpërdrejtë zbatimin e bilinguizmit shqip-serbisht në Kosovë. Institucionet e Kosovës janë duke bërë përpjekje që t'i integrojnë pakicat në Kosovë dhe mund të ndodhë që kjo situatë të ndryshohet në një të ardhme të afërt. Megjithatë, ndarja fizike ka bërë që brezat e rinj të mos jenë në gjendje ta mësojnë gjuhën e njëri-tjetrit. Njohja e gjuhës paraqet problem themelor për zbatimin e bilinguizmit shqip-serbisht. Edhe pse për shkak të epërsisë që kishte dikur serbishtja shqiptarët e Kosovës, brezat e mesëm dhe të vjetër, në masë të madhe ishin bilingual, sot ata hezitojnë të flasin serbisht në rastet kur duhet të komunikojnë me serbët. Në anën tjetër, edhe brezat e mesëm dhe të vjetër të serbëve, duke jetuar në fqinjësi me shqiptarët e kuptojnë dhe e flasin shqipen, por hezitojnë ta flasin kur komunikojnë me shqiptarët, mbase për shkak të sedrës së tyre. Qëndrimet reciproke ndaj gjuhës serbe, respektivisht shqipe,

janë gjithashtu një element i rëndësishëm që ndikon në bilinguizmin shqip-serbisht. Një tjetër zhvillim ka të bëjë me mësimin e gjuhëve dhe dy gjuhët zyrtare të Kosovës nuk mësohen më as në sistemin arsimor. Nxënësit shqiptarë në shkollat e tyre mësojnë anglishten dhe jo më serbishten, ndërkohë që nxënësit serbë nuk e mësojnë shqipen.

Të gjitha këto rrethana kanë ndikuar që edhe pse në Kosovë ka dygjuhësi zyrtare të deklaruar dhe të vendosur në kushtetutë, megjithatë, në realitet, dygjuhësia është e reduktuar vetëm në funksione e domene formale, por edhe në këto funksione epërsia e shqipes për shkak të kriterit demografik është domethënëse. Këto janë vetëm disa nga problemet më evidente të bilinguizmit zyrtar shqip-serbisht.

Politika gjyqësore që është ndjekur në Kosovë mund të cilësohet si politikë progresive, që shkon përtej standardeve më të larta të Bashkimit Evropian dhe standardeve të tjera të përshkruara në dokumentet e ndryshme ndërkombëtare, të cilat rregullojnë çështjet e politikave dhe të planifikimit gjuhësor. Një politikë e tillë është sanksionuar edhe në planifikimin e statusit të gjuhëve në Kosovë, ku gjuhës serbe, e cila ka më pak se 10% folës burimorë në Kosovë, i është dhënë statusi i gjuhës zyrtare.

Megjithatë, zbatimi i kësaj politike gjuhësore është në shpërputhje me realitetin në terren dhe i ka vështirësitë e veta reale. Këto vështirësi kanë të bëjnë me rënien e nxënies së gjuhës serbe dhe me reduktimin e dëndurisë së komunikimit dhe të domeneve të kontaktit. Po ashtu, problem tjetër paraqet edhe mungesa e stimulimit të shqiptarët, që përbëjnë shumicën e banorëve të Kosovës, për ta nxënë dhe për ta përdorur gjuhën serbe.

Në anën tjetër, mund të supozojmë se probleme pak a shumë të ngjashme ka edhe te serbët. Humbja e privilegjeve të kaluara, sedra e prekur dhe paragjykimet negative ndikojnë që edhe ata të mos e mësojnë dhe të mos e përdorin shqipen. Megjithatë, duket që rrethanat e reja politike dhe ekzistenciale në Kosovë do të kenë ndikim të fuqishëm që tek ata që të fillojnë ta mësojnë dhe ta përdorin gjuhën shqipe. Si rrjedhojë e kësaj, zhvillimi më i pritshëm është që bilinguizmi asimetrik që ka ekzistuar dikur në Kosovë, do të ndërrojë kahun. Serbët do të jenë të detyruar ta mësojnë shumë më tepër shqipen, ndërkajshqiptarët do të jenë në situatë që sa më pak ta njohin dhe ta përdorin serbishten. Kriteri

demografik do të jetë vendimtar në përcaktimin e drejtimit të zhvillimit të dygjuhësisë. Prandaj, mendojmë se do të ishte me interes që shoqëria dhe institucionet e Kosovës të gjejnë mënyra për ta nxitur dhe për ta stimuluar mësimin e gjuhës shqipes te serbët.

Në fund mund të thuhet se fqinjësia dhe komunikimi i paevitueshëm ekonomik me botën sllave do të jenë gjithnjë një motiv për shqiptarët për ta mësuar serbishten, por një gjë e tillë do të bëhet në bazë të vullnetit të mirë e jo në bazë të detyrimit. Edhe përparimi dhe risitë në fushën e teknologjisë së informacionit do të mund të kenë ndikim pozitiv në komunikim. Softuerët e përkthimit si “Google Translation”, dita-ditës po përmirësohen dhe po bëjnë të mundur përkthim sa më të saktë në të gjitha gjuhët e botës, rrjedhimisht edhe në atë shqipe e serbe. Përkundër faktit që faktori njeri mbetet vendimtar, avancimi i teknologjisë, megjithatë do ta lehtësojë në një masë komunikimin.

Në përmbyllje, të theksojmë se përmirësimi eventual i raporteve politike midis shqiptarëve dhe serbëve do të ketë ndikim në relaksimin e kontakteve dhe të ndërkomunikimit, dhe mbase do të jetë nxitje për njohjen reciproke të gjuhëve. Heqja e paragjytimeve ndaj gjuhës është sigurisht pikënisja e parë në këtë drejtim.

2.4. Reforma kurrikulare në të gjithë veprimtarinë e shkollës në kontekstin kohor, në optikën e bilinguizmit real në Shqipëri

Politikat arsimore janë baza që promovojnë mësimin e një ose më shumë gjuhëve të huaja për brezat e rinj. Reformimi i arsimit bazë, që filloi në vitin 1994 dhe reforma e arsimit bazë e kryer në vitet 2003-2007, kanë si produkt të punës kurrikulën aktuale për klasat e nënta. Ndryshimi që u krye në strukturën e arsimit bazë (nga 8 vjet (4+4) në 9 vjet (5+4)), u bë shkak i domosdoshëm edhe për reformën e kurrikulës (2003-2007) të këtij niveli shkollimi, që u mbështet edhe nga dy dokumente zyrtare:

- Ligji për Arsimin Parauniversitar (1995);
- Strategjia Kombëtare për Arsimin (2004-2015)³.

Kurrikula e arsimit bazë në Shqipëri është e organizuar në bazë të lëndëve dhe jo në bazë të fushave; kurrikula e arsimit të mesëm të lartë (gjimnazi) është e organizuar në fusha

3 MASH, Instituti i Zhvillimit të Arsimit, Analiza krahasuese e kurrikulës aktuale të arsimit bazë me atë të vendeve të tjera, maj 2011.

të të nxënit, të cilat janë: edukim fizik, sporte dhe arte; gjuhë shqipe, letërsi dhe gjuhë e huaj; karrierë dhe aftësim për jetën, matematikë, shkenca natyrore, shkenca shoqërore, teknologji etj. Kurrikula në arsimin fillor është e organizuar në bazë të lëndës dhe ajo përmban gjithsej 11 lëndë: matematikë, dituri natyre, gjeografi, histori, gjuhë amtare, gjuhë e huaj, edukatë shoqërore, edukim figurativ, edukim muzikor, mësim pune, edukim fizik dhe sporte. Kurrikulën e organizuar me bazë lënde e gjejmë edhe në arsimin e mesëm dhe të ulët, dhe përmban gjithsej 14 lëndë: matematikë, fizikë, gjuhë amtare, gjuhë e huaj, kimi, biologji, gjeografi, histori, edukatë shoqërore, edukim fizik dhe sporte, edukim muzikor, edukim figurativ, aftësim teknologjik, kompjuter. Aktualisht, në klasën e parë dhe të dytë të arsimit fillor nuk mësohet gjuhë e huaj. Nga klasa e tretë deri në klasën e shtatë, në Shqipëri, nxënësit mësojnë dy orë në javë gjuhë të huaj dhe në klasën e tetë dhe të nëntë kurrikula aktuale përmban tri orë gjuhë të huaj në javë. Gjuha e huaj është anglisht, italisht dhe frëngjisht, në varësi të shkollave dhe qyteteve të vendit. Në planin mësimor të arsimit bazë është lënë një hapësirë kohore prej 12 orësh mësimore në javë, për lëndët me zgjedhje dhe veprimtari ekstrakurrikulare, duke ua lënë kështu shkollave të drejtën e planifikimit. Pra, në përfundim mund të thuhet se kurrikula në shkollat shqiptare e përfshin mësimin e gjuhëve të huaja si në arsimin fillor (përveç klasës 1^{-të} dhe të 2^{-të}), edhe në arsimin e mesëm.

2.5. Objektivat arsimore, procesi dhe mjeshtëritë e të pyeturit në dy a më shumë gjuhë

Mësuesit që punojnë në shkolla bilinguale duhet të jenë kompetentë në edukimin special bilingual. Përveç se të komunikojnë në dy gjuhë, shumë e rëndësishme për ta është të njohin dhe të përshtaten me kulturat e këtyre gjuhëve. Mësuesit duhet të demonstrojnë praktikisht këto aftësi gjatë procesit të mësimdhënies (Cummis & Swain, 1990; Baca & Cervantes, 1989).

Për të realizuar një proces optimal të mësimdhënies dhe edukimit, mësuesit në shkollat bilinguale duhet të kenë disa aftësi thelbësore për punën e tyre (Trueba, 1987):

- Njohje teorike dhe praktike të të dyja gjuhëve;

- Njohuri teorike dhe pedagogjike e gjuhës së dytë dhe aftësi për ta integruar atë në kontekstin e shkollës ku janë të punësuar;
- Njohuri rreth natyrës së bilinguizmit dhe procesit se si një fëmijë bëhet bilingual (flet në dy gjuhë);
- Njohuri dhe aftësi për të dalluar diferencat në aspektin psikosocial dhe pedagogjik të një fëmije me një gjuhë dhe të një fëmije bilingual;
- Aftësi për të realizuar kurrikulën mësimore duke integruar të dyja gjuhët.

Sipas një studimi të realizuar nga Rodrigues (1997), mësuesit dhe stafi pedagogjik janë aktorët kryesorë për mësimdhënien në shkollat bilinguale. Të pyesësh dhe të shpjegosh mësimin në dy ose më shumë gjuhë, nuk do të thotë të njohësh teorikisht, në të folur, shkruar dhe lexuar, të dyja gjuhët, pasi shumë persona mund ta bëjnë këtë. Mësuesit që punojnë në shkolla bilinguale, duhet të kenë studiuar për edukim bilingual special dhe të bëjnë trajnime dhe seminare të herëpashershme për pedagogjinë e mësimdhënies në shkollat bilinguale.

Një rol esencial në edukimin bilingual, përveç mësuesve që janë në kontakt të drejtpërdrejtë me nxënësit, kanë dhe hartuesit e kurrikulave dhe specialistët përkatës, që punojnë për shkollat bilinguale (Several, 1990). Ata duhet të bëjnë studime në shkolla dhe shtete të ndryshme, me nxënës që vijnë nga prindër me kombësi të ndryshme dhe, rrjedhimisht, fëmijët njohin që në vegjëli dy gjuhë, në mënyrë që të shohin nevojat që lindin në procesin e mësimdhënies. Duke bërë studime dhe vëzhgime konkrete, specialistët e hartimit të kurrikulave për shkollat bilinguale do të jenë më produktiv në punën e tyre.

2.6. Bilinguizmi dhe teknikat e të mësuarit individual

Në këtë çështje do të eksploroheh teknikat e të mësuarit individual në raport me bilinguizmin.

2.6.1. Përvetësimi i gjuhës së dytë tek bilingualët dhe monolingualët

Gjuha e njeriut dhe përfaqësimi i saj në tru kanë kuriozuar shkencëtarët për vite me radhë. Progres në këtë drejtim është bërë në identifikimin e fushave të rëndësishme të gjuhës në tru, si Broca-së dhe zonat Wernicke-së. Përgjithësisht, hulumtimet janë fokusuar në

njerëzit që flasin vetëm një gjuhë. Megjithatë, disa studiues kanë bërë të interesuar në trurin e njerëzve që kanë mësuar një gjuhë të dytë. Shumë pyetje mbeten pa përgjigje në lidhje me ngjashmëritë dhe dallimet mes mësimin e një gjuhe të parë dhe të dytë, si dhe ruajtjen dhe përdorimin e secilës gjuhë.

Studimet tregojnë se ekziston një periudhë kritike për mësimin e gjuhës së parë. Periudhë kritike konsiderohet ajo periudha kohore gjatë së cilës një person duhet të jetë i ekspozuar në gjuhën e folur në mënyrë që të mësojë. Në shumicën e rasteve, në qoftë se një person nuk është i ekspozuar ndaj një gjuhe gjatë periudhës kritike, ai ose ajo kurrë nuk do të jetë në gjendje të flasë gjuhën, si dikush që mësoi gjuhën normalisht. Edhe pse personi mund të jetë në gjendje për të mësuar, fjalët e reja, sintaksa dhe struktura e fjalisë nuk do të arrijë asnjëherë një nivel normal.

Këtu vlen të përmendim rastin e studimit të marrë në librin “The boy who was raised as a dog”. Ky fëmijë që nga lindja dhe deri në moshën 7 vjeç qëndroi i mbyllur në një kafaz ku mbahej qeni. Për fëmijën u kujdes një burrë, vetëm duke i hedhur ushqim në darkë dhe në mëngjes. Ky fëmijë u neglizhua në një mënyrë ekstreme. Personi që e rriti kishte probleme të shëndetit mendor dhe askush nuk ishte në dijeni të fëmijës deri në moshën 7 vjeçare. Ky rast ka ndodhur në Amerikë dhe ka bërë bujë të madhe kur është zbuluar. Në kuadrin e çështjes së gjuhës që studiohet, në këtë studim vlen të theksohet se ky fëmijë nuk ka qenë në kontakt me asnjë njeri që të mësonte gjuhën dhe komunikimin. Ai ulërinte dhe lëshonte britma pa kuptim për të komunikuar me njerëzit. Edhe pse me këtë fëmijë u punua intensivisht nga grupe multidisiplinare psikologësh, linguistësh, mjekësh dhe terapistësh të ndryshëm, fëmija asnjëherë edhe kur u bë madhor nuk arriti të zhvillonte një gjuhë dhe nivel komunikim si bashkëmoshatarët që kishin patur një jetë normale dhe ishin në kontakt me gjuhën që në lindje.

Edhe pse është vërtetuar se ekziston një periudhë kritike për mësimin e gjuhës së parë, nuk dihet nëse ka një periudhë të ngjashme kritike për një gjuhë të dytë. Për shembull, nëse gjuha juaj e parë është anglisht, kur duhet të fillojmë për të mësuar spanjisht, rusisht etj? Cila është ajo pjesë e trurit që lejon dhe ndoshta kërkon për të mësuar gjuhë në moshë të re?

Hulumtimet sugjerojnë se të mësuarit e një gjuhë të dytë ose të tretë është më e lehtë për fëmijët e vegjël, dhe disa gjetje dëshmojnë për disa zona të trurit që mund të përfshihen në këtë mësim. Disa studime kanë lidhur me mësimin e gjuhës së dytë zonat e Broca-së dhe Wernicke-së. Studiuesit kanë krahasuar funksionin e trurit tek njerëzit që ishin bilingual me trurin e personave që filluan të mësonin një gjuhë të dytë gjatë periudhës së pubertetit.

Personat bilingual rezultoi të kishin një përdorim të ngjashme dhe mbivendosje të zonave të Broca-s dhe Wernicke-së për të dyja gjuhët. Ndërsa personat monolingual që kishin mësuar një gjuhë të dytë gjatë periudhës së pubertetit rezultoi të kishin një mbivendosje të zonës Wernicke-së për të dy gjuhët, por ato zakonisht përdornin ndryshe, edhe pse ngjitur, rajonet e zonës së Broca-s për çdo gjuhë.

Informacioni dhe gjetjet shkencore në lidhje me përvetësimin e gjuhës mund të jenë të dobishme në përcaktimin e strategjive më të mira për të mësuar të dytë, të tretë apo të katërt.

2.6.2. Si funksionon mësimi i gjuhës

Fëmijët i mësojnë më mirë dhe më lehtë gjuhët e reja në tetë vitet e para të jetës. Në moshën 3-6 vjeç, një nga gjërat që i zbavit dhe u pëlqen fëmijëve është të mësojnë gjëra të reja dhe kjo mund të ndodhë pa sforcim⁴. Çdo njeri merr në jetë të paktën një gjuhë nënë si dhuratë pa u munduar, por me fat janë ata, të cilëve u dhurohen më shumë se një gjuhë. Fëmijët e vegjël, sipas mënyrës së tyre, i vëzhgojnë apo i studiojnë gjuhët me shumë përqendrim dhe vëmendje. Ata dëgjojnë se si dhe çfarë flasin prindërit, dhe kështu ndikohen pa vetëdije nga gjuha dhe kultura. Fëmijët kanë aftësinë ta kuptojnë një gjuhë shumë shpejt, shpesh edhe pa e përdorur në mënyrë aktive.

Që prej moshës një vjeç e gjysmë, fëmijët kuptojnë më shumë se sa po u thoni atyre. Edhe pse duket sikur fëmija nuk reagon në një mënyrë aktive, gjuha është e pranishme dhe fëmija e praktikon, dhe duke folur, e perfeksionon atë. Fëmijët janë të rrethuar nga gjuhët, edhe pse ato janë të ndryshme. Ata i kuptojnë dhe i dallojnë që herët gjuhët e ndryshme. Fëmijët dygjuhësh dallojnë dhe ndajnë që në fillim se cilën gjuhë do të përdorin. Atyre nuk u duhet shumë kohë që t'i zotërojnë dhe t'i flasin rrjedhshëm të dyja gjuhët.

4 Joan Back, "How to raise a brighter child", f. 123125.

Të flasësh shumë gjuhë, shpëton trurin⁵.

Në këto studime paraqiten të dhënat të veçanta të cilat parandalojnë degjenerimin cerebral, si dhe këto të dhëna na sjellin në kuptimin më të mirë se çfarë u ndodh neuroneve të një personi i cili flet shumë gjuhë, gjë që për secilin është një avantazh. *Zanafilla* është një punim i realizuar nga Gitit Kave nga Tel Avivi në vitin 2008, punim i cili u publikua më pas në revistën “Psychology and Aging”. Në atë artikull ai shkruante se njohja e dy ose më shumë gjuhëve ndihmon në parandalimin e humbjes së aftësive njohëse të moshuarit mbi 75 vjeç.

Por në ç’kushte ndodh kjo dhe cila është arsyeja? Shkencëtarët sot i kanë idetë më të qarta. Avantazhet janë jo vetëm për personat që zotërojnë që në vegjëli dy gjuhë, por edhe për të tjerët që në moshë madhore kanë praktikuar mësimin e gjuhëve të ndryshme.

Pohimi i fundit për këtë çështje vjen pas një studimi të kryer tek 200 të moshuar (rreth 70-vjeçarë), i cili u realizua nga Magali Perquin, një studiuese nga Luksemburgu. Ky studim u paraqit në Kongresin e Akademisë Amerikane të Neurologjisë, ku ai theksonte se zotërimi i të paktën tri gjuhëve, ka pasoja pozitive për kujtesën. Studime të tjera të kryera nga York University i Torontos, dalin në përfundimin se fakti i të folurit në shumë gjuhë minimizon në mënyrë domethënëse dëmtimin konjuktiv (njohës) shkaktuar nga Alzheimeri. “Të flasësh më shumë se një gjuhë, të ndihmon që të mbash nën kontroll dëmtimet e shkaktuara nga sëmundja, duke bërë të mundur ruajtjen më gjatë të funksioneve cerebrale”, - thekson Ellen Bialystok, një psikologe kanadeze.

Perspektiva është tërheqëse dhe studimet janë të shumta mbi këtë çështje. “Këto studime kanë baza të forta. Natyrisht që ka gjuhë, të tilla si ajo kineze, ku variacionet varen nga ndryshimet e tonit dhe është e vështirë ta kuptosh në thellësi ndikimin mbi zhvillimin konjuktiv (njohës). Të gjithë e dimë se zotërimi i dy gjuhëve ofron shumë avantazhe”, - thotë një studiues i gjuhës. Nuk ka dyshim se shumë prej këtyre avantazheve e kanë origjinën nga mënyra e sjelljes, p.sh., mund të kuptohet lehtë se ai që di shumë gjuhë, ka një komunikim më të pasur.

5 <http://www.sciencedaily.com/releases/2008/05/080507152419.htm>

Me shumë gjasa, kjo është edhe arsyeja që individët, të cilët flasin dy gjuhë, duke u bazuar kryesisht në studimet e fundit, janë më socialë dhe të gatshëm për të biseduar apo për të krijuar marrëdhënie jo vetëm me ata që flasin gjuhën e tyre. Për më tepër, sipas disa studimeve të bëra nga Teresa Bajo në Spanjë dhe studiues të tjerë nga Universiteti i Kolumbisë në Britani, reagimi i bebeve 4-muajshe, të cilat kanë dëgjuar gjuhë të huaja para lindjes, shfaqet më me pak ankthioz ndaj idiomave që nuk i njohin. Ata arrijnë të lexojnë saktë shprehjet e fytyrës dhe emocionet e personit që po komunikon me ta.

Mbase mund të jetë edhe vetë sjellja, megjithatë nuk ka dyshim që është struktura e vetë trurit, i cili përfshihet në efektin mbrojtës të gjuhëve mbi zhvillimin e tij të mëtejshëm. Duke pasur parasysh këtë pikë, është me vend të shtrohet pyetja: çfarë e dallon gjuhën nga llojet e tjera të të ushtruarit të mendjes? Dhe si ndikon ajo mbi trurin tonë?

“Është e habitshme që ne mendojnë se gjuhët e huaja mund të përvetësohen lehtë dhe nuk e kuptojmë se kemi të bëjmë me një fenomen kompleks. Kur nisim të mësuarit një gjuhë të re, përqendrimi bie vetëm te fjalori, sintaksa dhe gramatika”, thekson studiuesi i gjuhës. Mësimi i gjuhëve të huaja pësoi ndryshime në gjysmën e dytë të viteve 1900 nga Noam Chomsky, i cili, ndërkohë që analizonte strukturat matematikore në bazë të idiomave të ndryshme, konstatoi se gjuhët kishin një farë ADN-je të përbashkët që e përmbante edhe vetë truri ynë e që përkon me variacionet e pafundme që ne njohim. “Nga ky përfundim, mund të themi se mësimi i një gjuhe, do të thotë ‘vënia në lëvizje’ e informacioneve që mësohen me aparatit me të cilin kemi lindur, duke memorizuar disa nga hapat e mundshëm dhe duke fshirë disa të tjerë”, - shpjegon ai.

Një analizë me teknika të përparuara nga pikëpamja fiziologjike, tregon se te një individ, i cili që në moshë të vogël flet dy gjuhë, aktivizohen në mënyrë të ngjashme disa nga hapësirat e hemisferës së majtë të trurit të lidhura me funksionet gjuhësore, kjo në rastet kur përdoret njëra gjuhë ose tjetra. “Vërehet një ndryshim në aktivizim, që varion sipas llojit të detyrës së propozuar, kur gjuha e dytë është mësuar më vonë”, shpjegon një docent i neuroshkencave njohëse, në Universitetin e Shën Rafaelit. “P.sh., në provat e të sjellurit, aktivizimi cerebral është mjaft i madh kur njihet gjuha e përdorur, sepse nuk

është e vështirë të arrish kuptimin e fjalëve. Kur flasim, truri aktivizohet edhe më shumë në momentin bëhet fjalë për një gjuhë, të cilën nuk e njohim dhe e zotërojmë mirë.”

Çështja është aq e ndërlikuar, saqë gjithnjë e më shpesh studiuesit përdorin bilinguizmin si një lloj “bisturie konjuktive” për të kuptuar se si funksionon truri. P.sh., tek një individ që zotëron dy gjuhë, kur kalon nga njëra gjuhë në tjetrën teksa flet, është vëzhguar se aktivizohen hapësira të ndryshme të trurit sipas frazës në të cilën ndodh kalimi. Për më tepër, euroshkencëtarët kanë dalë në përfundime se truri është në gjendje të ndajë një gjuhë të vërtetë nga një e sajuar. Për të parë lidhjen ndërmjet mësimi të gjuhëve, shkencëtarët amerikanë po financojnë studime të reja.

2.6.3. Mësimi i dy gjuhëve njëkohësisht nga një fëmijë

Nëse doni t’i mësoni fëmijës dy gjuhë, atëherë pozicionimi juaj është vendimtar. Ju vetë duhet të ndiheni të sigurt në atë gjuhë, qofshi prind, edukator apo mësues, sepse vetëm kështu ju mund t’i transmetoni besueshmëri fëmijës. Të kërkosht t’i mësonsh fëmijës të flasë në një gjuhë, kjo nuk është e zgjuar, por duhet t’i mësonsh se si kjo gjuhë të bëhet bota e tij dhe përjetimi i tij. Gjuha duhet të përjetohet prej fëmijës dhe vetëm atëherë ai e ka mësuar atë.

Një fëmijë që mëson një gjuhë, duhet ta dëgjojë atë në mënyrë të rregullt dhe të shpeshtë, përndryshe do ta harrojë. Mos ia përktheni fjalën në një gjuhë tjetër, për shembull, *karri-gia (stuhl)*. I flisni fëmijës në gjuhën e huaj.

Rekomandohet që, ndërsa flisni apo bëni fjali, mos i ndërtoni ato në të dyja gjuhët. Përdorimi i gjuhës mund të varet dhe nga vendi ku përdoret ajo, për shembull, në shtëpi apo te gjyshërit, me një dado apo në kopsht ose shkollë, në makinë etj. E rëndësishme është që fëmija të dijë se si të flasë dhe ta përdorë këtë gjuhë, pra të flasë në mënyrë të vazhdueshme, më pas gjithçka ndodh në mënyrë të natyrshme. Në këto kushte, për fëmijën është e rëndësishme të krijojë një marrëdhënie të mirë dhe pozitive me personin që po i mëson gjuhën, në mënyrë që mësimi i gjuhës t’i japë kënaqësi dhe të perceptohet prej tij si diçka e mirë.

2.6.4. Synimi i mësimit të gjuhëve

Në shumë vende, po përkrahen gjithnjë e më tepër dimensione të ndryshme të edukimit dygjuhësh dhe/apo shumëgjuhësh. Kjo shpesh nënkupton se:

1. një pjesë e caktuar e kurrikulës mësohet në një gjuhë tjetër nga ajo amtare;
2. përmbajtja e lëndëve mësimore përvetësohet në ndonjë gjuhë tjetër nga ajo amtare;
3. mësimdhënia (tradicionale) e gjuhës vazhdon të ketë rol kyç, duke iu përshtatur mjedisit të posaçëm shumëgjuhësor të nxënies.

Vitet e fundit, kjo metodë ka nisur të quhet “Të Nxënit e Integruar të Përmbajtjes së Gjuhës” ose shkurt “NIPGJ” (Marsh & MarNGJDnd, 1999). Terminologjia përkatëse nuk është thjesht lojë fjalësh edhe pse kjo shkurtesë është sinonim i mësimdhënies së gjuhës të mbështetur në përmbajtje. Ajo nënkupton një spostim domethënës të vëmendjes nga mësimdhënia përkundrejt të nxënit.

Po ashtu, ky debat zhvillohet duke pasur parasysh një debat tejet të rëndësishëm, të nxitur nga zhvillimet në Unionin Evropian dhe të përkrahur nga Këshilli i Evropës për Gjuhë (www.fuberlin.de/elc): Si mund të arrihet fakti nëse qytetarët evropianë do të duhet të mësojnë dy gjuhë, nëse ekzistojnë mangësitë fare të qarta të metodës tradicionale të mësimit të gjuhës?

Për më tepër, si mund të anashkalohen argumentet klasike kundër edukimit dygjuhësh/shumëgjuhësh, siç janë:

1. Edukimi shumëgjuhësh (ESH) është i dëmshëm, për shkak se pengon procesin e të nxënit;
2. ESH do të ndikojë në mosnjohjen e gjuhës amtare;



Figura 2. ©2015 BlackYouthProject.com.

3. ESH do të ngadalësojë kompetencën e të nxënit;
4. ESH është i vlefshëm për fëmijët e emigrantëve, por jo për fëmijët vendas;
5. Sot, kur fëmijët përfundojnë shkollimin, janë pothuajse shumëgjuhësh (Van de Craen, 1999).

Në përfundim të kësaj çështjeje, edhe disa fjalë për terminologjinë: në këtë tekst, *edukimi shumëgjuhësh* do të përdoret për emërtimin e çfarëdo forme të arsimimit gjuhësor, ku lën-da mësohet në një gjuhë të huaj apo të dytë. Këtu mund të përdorej edhe emërtimi *edukim dygjuhësh* apo *gjithëpërfshirje*, por termi “edukim shumëgjuhësh” tingëllon më neutral dhe përkon me ndryshimet aktuale në Bashkësinë Evropiane dhe në Këshillin e Evropës për Gjuhë. Gjithashtu, nuk kemi ndonjë argument bindës shkencor kundër emërtimit të edukimit dygjuhësh si edukim shumëgjuhësh. Në mbyllje, në shumicën e shteteve, ku nëpër shkolla praktikohet edukimi dygjuhësh apo gjithëpërfshirës, rëndom mësohen më shumë se dy gjuhë.

2.7. Pedagogjia e gjuhës dhe teoritë e të nxënit të gjuhës

Teoritë e nxënies, ashtu si edhe teoritë e të nxënit të gjuhës, janë të larmishme, edhe pse mund të themi se bazat e teorisë ideale të të nxënit të propozuara nga Hill (1980) janë ende të vlefshme. Sipas Hill, një teori e tillë karakterizohet nga sa vijon dhe do të duhej të:

1. përfshijë tërësinë e të nxënit simbolik njerëzor dhe shkathtësinë e zgjidhjes së problemeve;
2. të ndihmojë sjelljen elastike, pra të gatshme për përshtatje;
3. të sqarojë përshtatjen kognitive dhe aspektetin e tij universal;
4. proceset zhvillimore të mbahen nën vëmendje;
5. të përqendrohet në ndikimin e të nxënit të hershëm e në atë të mëvonshëm;
6. të përdorë motivimin dhe stabilizimin e fuqizimin.

Duket se në pamje të parë teoria e Hill është tejet e komplikuar, është interaktive dhe bie në kundërshtim të plotë me teoritë e thjeshta, që mund të merren si mjaft naive për të nxënit e gjuhës, të frymëzuara nga teoria e Chomskyt. Për nxënësit e këtij grupi “target”,

të nxënit e gjuhës duket si një ushtrim i thjeshtë aritmetik. (Wexler & Culicover, 1980; Pinker 1994, 1999).

Teoria e Hillit, gjithsesi, ishte e avancuar për kohën e tij, duke marrë parasysh se u botua në vitin 1964 për herë të parë. Sot, shqyrtimi i të nxënit simbolik dhe i aftësive njohëse, hulumtimi i dimensionit universal dhe këmbëngulja në rëndësinë e nxitjes dhe përsëritjes, përputhen gjithsesi me idetë bashkëkohore të teorive të të nxënit të gjuhës, të cilat janë shkëputur nga rryma gjenerative e të menduarit dhe ajo tradicionale. Teoritë e të nxënit të gjuhës, të ndërthurura me shumëgjuhësinë dhe edukimin, bazohen kryesisht në teoritë interaktive dhe jo aq shumë në pikëpamjet llogaritëse. Këto teori fokusohen në radhë të parë në të dalluarin e të nxënies së gjuhës së dytë (dygjuhësi) nga të nxënit e gjuhës amtare apo gjuha baze ose gjuha e nënës (Segalowitz, 1997); së dyti, i shqyrtojnë përparësitë/mangësitë e të nxënies eksplicite, domethënë të orientuar nga forma apo gramatika kundrejt asaj implicite, domethënë të orientuar nga biseda e kuptimi (Ellis 1990, 1994); së treti, në aspektet kognitive të trurit shohin ndikimin e aftësisë shumëgjuhëshe (Albert & Obler, 1978; Cook, 1997; Paradis, 1997; Fabbro, 1999).

Duke pasur parasysh vërejtjet e Hillit lidhur me teorinë ideale të të nxënit, faktin e përshtatshmërisë së sjelljes dhe të të njohurit, proceset e zhvillimit, të nxënit të vonshëm dhe të hershëm dhe të vonshëm, si dhe rolin e përforsimit dhe motivimit, një pikëpamje e dobishme me shumë mundësi mund të formulohet në mënyrë të tillë që të studiojë ndryshimet në proceset individuale të të nxënit pa u ndaluar së tepërmi në aspektet universale të të nxënit. Këtu shohim pikërisht teorinë e Segalowitzit (1997). Duke u ndërlidhur me kornizën e përpunimit të të dhënave kognitive të Ackermanit dhe Andersonit (Ackerman, 1989; Anderson, 1976), Segalowitzi sugjeron një model që i ndërthur së bashku: aktivitetin gjuhësor, zhvillimin e njohurive dhe aspektet kognitive.

Modeli i nxënies përshtatet me përvojën e specialistëve të gjuhës si, p.sh., arsimtarët e gjuhës. Pavarësisht nga përparimi i të nxënies individuale, proceset nga të cilat rrjedh ky përparim, siç edhe mund të shihet nga sjellja e nxënësit, janë të gërshetuara me aspektet e lartpërmendura, pra, me gërshetimin e aspekteve kognitive dhe aktivitetin gjuhësor.

Një faktor tjetër është se modeli i të nxënit përshtatet me të dhënat e fundit të shkencës së neurologjisë. Sipas Kutasit: "... mund të gjendet një raport përkatësisht i drejtpërdrejtë mes proceseve të përgjithshme kognitive dhe proceseve të të nxënit të gjuhës" (Kutas, 1998:968). Modeli përshtatet me sugjerimet e Hillit (Hill, 1980), lidhur me një teori ideale të nxënies.

Sidoqoftë, të nxënit nuk mund të kufizohet brenda kërkimit apo zbatimit të modeleve. Ai zhvillohet nëpër shkolla, nëpër institucione, atje ku njerëzit organizojnë aktivitetin e njerëzve të tjerë. Këto institucione e modelojnë kulturën e vet, që ndikon konsiderueshëm në brumosjen e të nxënit përgjithësisht, po ashtu dhe në të nxënit e gjuhës.

2.8. Dallimi mes teorive të shumëgjuhësisë

Për më tepër, nuk është i lehtë të përkufizohet dallimi mes teorive të shumëgjuhësisë kundrejt atyre të përvetësimit të gjuhës së dytë (bilinguizmit). Pra, kur krahasojmë teoritë në pjesën më të madhe të rasteve, teoritë e përvetësimit të gjuhës së dytë dhe ato të shumëgjuhësisë duhen parë jo si kundërshtuese, por si plotësuese. Sidoqoftë, duhet pasur parasysh se hulumtimet e përvetësimit të gjuhës së dytë nuk mund të aplikohen në çdo rast në ambientet e të nxënit të përfshirë të përmbajtjes së gjuhës.

As fusha e dokumentuar mirë, lidhur me krahasimin e të nxënit ekspllicit kundrejt atij implicit, nuk e pasuron mjaftueshëm pedagogjinë e gjuhës. Studimi i Ellisit (1994) dëshmon qartë se debati i këtyllë në rastin më të mirë nuk sjell përfundim, dhe në atë më të keq, nuk sjell asnjë dobi për pedagogjinë e gjuhës. Për fat të keq, mund të përfundojmë se: tani për tani, nuk ka asnjë teori për të nxënit e gjuhës, në të cilën do të mbështetej edukimi shumëgjuhësh dhe shumëgjuhësia. Përkundër këtij fakti, shkrimi i mëposhtëm do të jetë një përpjekje për të ofruar një model, i cili do të mund të shfrytëzohej për fushat problematike të përmendura më sipër.

2.9. Kultura e edukimit dhe e të nxënit

Në një nga artikujt e mëvonshëm, në një studim të gjatë të tij (Sapir, 1939), Sapiri e krahason studimin "statistik" të leximit të fëmijëve me këndvështrimin "psikiatrik", që

ka në fokus hulumtimin e rolit, funksionit të personalitetit, domethënies dhe leximit në zhvillimin e fantazisë. Sapiri e përkrah këndvështrimin e dytë se vetëm nëse e studion personalitetin e përgjithshëm njerëzor mund të dalësh në përfundime të caktuara. Edhe Bruner (1996) i sjell po këto argumente kur analizon për raportet mes “llogaritarizmit” dhe “kulturalizmit”. Bruner po ashtu, është i interesuar për “fuqinë e mendjes individuale dhe mënyrat se si e ndihmon apo e pengon kultura realizimin e saj”




Figura 3, Teoria e të mësuarit sipas Bruner

Marrë nga: http://cmapspublic3.ihmc.us/rid=1196472420562_2001954926_5548/Bruner

(Bruner, 1996:13). Sipas Bruner kultura e “ndikon” edukimin dhe “mishërimi kryesor i stilit jetësor të një kulture është edukimi” (Bruner, 1996:13). Bruner vazhdon me identifikimin e disa parimeve dhe rëndësinë e tyre për edukim. Perspektivë e realitetit mund të ishte pikëpamja e emigrantëve për shkollimin e sotëm dhe pikëpamja përkatëse zyrtare për këtë. Bruner dëshiron ta qartësojë këtë perspektivë.

Parimi i kufizimeve: Edukimi dhe kultura lënë të kuptohen dy lloj kufizimesh: (1) kufizimet që ndikojnë në kulturën dhe mendjen e njerëzve dhe (2) kufizimet e shkaktuara nga gjuha. Edhe pse Bruneri e përmend hipotezën e Sapirit dhe Whorfit, ai këmbëngul se këto kufizime mund të “kthehen 360 gradë” dhe të tejkalohen nga studentët me aftësitë e tyre “metalinguistike”. Edukimi duhet të përfshijë edhe zhvillimin e kësaj aftësie.

Parimi i konstruksionit: Të perceptuarit se realiteti nuk është “i gatshëm”, por “i konstruktuar”.

Parimi i interaktivitetit: Ky parim përfshin rolet mes “mësimdhënësve” dhe “nxënësve”. Bruner kundërshton metodën tradicionale të “transmetimit” në të mirë të atij të “vendit të ngjarjes”.

Parimi i eksternalizimit: “Flitet për prodhimin e aktiviteteve apo “veprave” të për bashkëta, me synim krijimin e unitetit grupor dhe të mënyrave të ndarjes së mendimeve në grup” (Bruner, 1996:23). Një model i zbatimit të këtij parimi do të ishte vazhdimësia e grupit të njëjtë të mësimdhënësve dhe të nxënësve gjatë shkollës fillore.

Parimi i instrumentalizimit: Nënkupton “zbulimin” dhe “përdorimin” e talentit si p.sh., themelimi i klubit të basketbollit dhe shahistëve në një shkollë në geto (si shembulli i Brunerit), që u jep mundësinë nxënësve të flasin me dialektin e vet në një situatë të institucionalizuar (shembulli im).

Parimi i institucionalizimit: Parasheh përgatitjen për pjesëmarrje nëpër institucione.

Parimi i identitetit dhe vetëbesimit apo vetëdijësimit: Për aftësitë personale, për t’i tejkaluar situatat e padëshirueshme duke shfrytëzuar mjetet për vlerësimin e tyre, kështu, rrjedhimisht, rritet ndjenja e vlerësimit të vetvetes.

Parimi narrativ: Për arsye se stili narrativ shihet si burim i kohezionit dhe i domethënies. Edhe pse është e vështirë të vlerësohen idetë e Brunerit në mënyrë vlerësuese këtu gjithçka është e qartë. Edukimi do të thotë shumë më tepër sesa një lojë mësimi. Ai e përfshin tërësinë e personaliteteve përkatëse dhe, nëse kjo nuk kuptohet, nuk mund të ketë asnjëherë përparim. Rëndësia e pikëpamjeve të Brunerit mbështetet në pikëpamjen e tij gjithëpërfshirëse rreth edukimit. Edukimi gjuhësor mund ta studiojmë në një hapësirë tejet të ndjeshme gjuhësore si p.sh., në Bruksel, Belgjikë. Pastaj kjo mund të krahasohet me mësimdhënien e gjuhës frënge në një sistem shkollor në Holandë (Van de Craen & D’hondt, 1997), po ashtu në vende të tjera si Zvicra, me ndarjen dhe kantonet e saj, si dhe me mësimdhënien e gjuhës angleze në shkollat e mesme në Holandë, që është një hapësirë gjuhësore më pak e ndjeshme (Huybregtse, Admiraal & Coleman, 2000).

Qëllimi i Brunerit është të vërtetojë se krahasimi i të dhënave, nëse ky krahasim do të bëhej i mundur, nuk ka kuptim nëse nuk marret parasysh domethënia e të qenët shumëgjuhësh në një shoqëri shumëgjuhëshe, të tillë si Brukseli, si dhe të qenët shumëgjuhësh në Holandë, po ashtu dhe në Zvicër, ku kantonet flasin gjuhët e tyre dhe shkollat kanë programet e decentralizuara. Parimet në lidhje me këto dy hapësira janë kaq të ndryshme, saqë është vështirë të krahasohet mënyra e përjetimit të edukimit (gjuhësor).

T'i kthehemi edukimit shumëgjuhësh. Nxënia e integruar e përmbajtjes së gjuhës apo cilado formë e edukimit shumëgjuhëshor është një metodë e përqendruar te kuptimi, ku njohuria e gjuhës nuk është qëllimi i fundit, por thjesht një mjet ligjërues. Synimi i mësimi të brendësuar të gjuhës dhe përmbajtjes së saj është i dyfishtë: të nxënit e lëndës, njëkohësisht me nxënien e gjuhës. Mirëpo, të Nxënit e Integruar të Përmbajtjes së Gjuhës është pikësëpari një pikëpamje e edukimit ku përfshihen “lloje metodash të ndryshme” dhe nuk është vetëm “përdorimi i një gjuhe tjetër në mësimdhënie” (Marsh, 1999:38). Thënë ndryshe, të Nxënit e Integruar të Përmbajtjes së Gjuhës është projekt pedagogjik që përmbledh çdo aspekt të edukimit, sipas kuptimit të Brunerit. Në radhë të parë shqyrtohet ambienti shoqëror, si në rastin e shkollave fillore në gjuhën holandeze, në Bruksel; së dyti, theksohet edhe aspekti pedagogjik i gjuhës.

2.10. Të nxënit e gjuhëve dhe ndryshimi në mjedisin e pedagogjisë së gjuhës

Duket qartë se shkolla shumëgjuhëshe mund ta ndryshojë atmosferën shoqërore për mirë. Po nëse gjuha e dytë mësohet në një ambient të edukimit shumëgjuhësh? Nuk ka dyshim se nxënësit do të kalojnë sërish në të tria fazat. Por, të nxënit e gjuhës së dytë këtu has një ndryshim të madh. Fakti që përqendrimi te gjuha nuk ekziston, por që ekziston përdorimi i gjuhës për diçka, për nxënien e lëndës përkatëse, kjo e bën të dallojë klasën shumëgjuhëshe. Shkurtimisht do të flas për (1) dallimet kognitive, (2) dallimet e njohurive dhe (3) dallimet në interpretimin e efektshëm.

2.10.1. Dallimet kognitive

Fillimisht, në fazën e parë nxënësi ka një peshë të madhe për shkak të ngarkesës kogni-

tive, të shkaktuar nga materia e lëndës dhe njëkohësisht nga nxënia e gjuhës. Por, në fakt nuk ndodh kështu. Le të shikojmë dy aspekte që mund të merren si një veti e klasave shumëgjuhëshe: ndërkomunikimin, dhe vetëpërmirësimin.

Ndërkomunikimi nënkupton ndërhyrjen joformale dhe të paplanifikuar dhe të mësimdhënësit dhe/ose të nxënësve të tjerë për ta përmirësuar dhe/ose zgjeruar atë që është thënë.

Një shembull tipik mund të ishte ky me të cilin përballemi shumë herë nëpër klasat shumëgjuhëshe: zhvillimi i fshehur, që nënkupton kohën mes njohjes të një forme (njohuria deklarative) dhe përdorimit të saj (njohuria procedurale), toleranca, që e nënkupton nivelin e tolerancës që ekziston përpara se folësi i lindur ta korrigjojë formën, dhe reagimi me vonesë, që ka kuptimin e reagimit të ngadalshëm të nxënësve të GJ2 në një mjedis komunikativ. Në klasat shumëgjuhëshe, korrigjimi luan një rol tjetër dhe shihet ndryshe në krahasim me klasat tradicionale, sepse ndryshon natyra e proceseve të ndërhyrjes dhe e shumicës. Këtu luan një rol vendimtar dhe kultura e komunikimit si një aspekt i cili i përshtatet gjuhës, e cila trajtohet në atë klasë (pra, kultura e varur nga gjuha).

2.10.2. Interpretime gjuhësore

Për shkak të ngarkesës së ulët kognitive, e cila mundëson përforsimin e përvetësimit të diturisë, interpretimi do të përshpejtohet në një mjedis të Nxënës të Integruar të Përmbytjes së Gjuhës. Nga kjo pikëpamje, të nxënës e gjuhës mund të shihet në lidhje reciproke me materien e lëndës, ashtu siç mund të shihet luajtja në kitarë në lidhje reciproke me dëshirën për të dëgjuar një melodi të bukur.

2.11. Teoritë të cilat kundërshtojnë dygjuhësinë dhe kultura e edukimit

Nëse rishohim pesë kundërgargumentet klasike për edukimin shumëgjuhësh:

- 1. Edukimi shumëgjuhësh është i dëmshëm, sepse ndërhyr me procesin e të nxënës. Është e vërtetë që kjo metodë ndërhyr në të nxënës, por në këtë rast ajo ndërhyr për mirë, sepse të nxënës e gjuhës, ashtu si edhe e lëndës, do të përforsohen.*
- 2. Edukimi shumëgjuhësh shkakton mosnjohjen e gjuhës amtare. Nuk është e qartë si mund të ndodhë kjo. Kur flitet një gjuhë, numri i orëve nuk është faktori vetëm për të*

nxënit e gjuhës. Ambienti shoqëror dhe aftësia e nxënësit luajnë po ashtu rol të rëndësishëm.

3. *Edukimi shumëgjuhësh ngadalëson kapacitetin e të nxënit.* Këtu mendoj që kam arritur të jap mjaft tregues për të vërtetuar se ndodh pikërisht e kundërta.

4. *Edukimi shumëgjuhësh është i dobishëm për fëmijët emigrantë, por jo për ata vendas.* Është e vërtetë se me metodat e ngjashme me të Nxënit e Integruar të Përmbajtjes së Gjuhës janë arritur një numër i konsiderueshëm rezultatesh të mira të fëmijëve të emigrantëve. Kjo do të ishte një arsye shumë e mirë për përhapjen e kësaj metode të nxënies.

5. *Sot, fëmijët janë pothuajse shumëgjuhësh pasi mbarojnë shkollimin e tyre.* Kjo bindesh me raportet e numrit më të madh të vendeve në Evropë.

Për më tepër, të nxënit e Gjuhës duket se ofron njohuri interesante për teorinë e nxënies (të gjuhës) dhe mjedisin kulturor dhe shoqëror. Në lidhje me përvojat e të Nxënit të Integruar të Përmbajtjes së Gjuhës në vendet e ndryshme, mund të shpresojmë se do t'i pasurojnë studimet në lidhje me të nxënit e gjuhës përmes materies së lëndës. Natyrisht, ngelin një sërë problemesh organizative: edukimi i mësimdhënësve të gjuhës duhet të jetë më intensiv, nevojitet zhvillimi i kurrikulës së të Nxënit të Integruar të Përmbajtjes së Gjuhës dhe duhen bërë më shumë hulumtime për sa i përket ndikimit të faktorëve të mjedisit. Përkundër kësaj, mund të themi se e vetmja mënyrë për të fituar mbi krizën e tanishme të të nxënit të gjuhëve, duket se është mësimdhënia e gjuhëve përmes mësimdhënies së lëndëve. Kjo mund të jetë edhe një përgjigje ndaj kërkesës për një qytetar të ri multilingual të Evropës.

2.12. Zhvillimi i bilinguizmit apo i dygjuhësisë të fëmijëve

Studime të reja tregojnë se përfitimet e të qenët i rritur në një familje bilinguale hasen që në fazë të hershme dhe janë më të mëdha nga ç' mendohej më përpara. Që në moshën 6-vjeçare, fëmijët të cilët janë të ekspozuar ndaj më shumë se një gjuhe, kanë më shumë avantazhe sesa bashkëmoshatarët e tyre monolingual. Kur foshnjave bilinguale u tregohet në mënyrë të përsëritur i njëjti imazh në një libër me figura, ato shfaqin shpejt shenja

mërzie dhe mezi presin që të shohin imazhe të tjera; këto janë tendenca të cilat kanë lidhje me shkallën e tyre të inteligjencës më vonë gjatë jetës.

Studiues nga Universiteti Kombëtar i Singaporit dhe nga Instituti i Singaporit për Shken-
cat Klinike, bashkëpunuan me spitale të ndryshme në qytet për të vëzhguar më nga afër
efektet e bilinguizmit. Singapori ka një numër të madh familjesh bilinguale krahasuar
me shumë vende të tjera, duke u lejuar kështu mjekëve dhe shkencëtarëve që të jenë në
kontakt lehtësisht me të rinjtë që u nevojiten për studimet e tyre.

Leher Singh i Departamentit të Psikologjisë në Universitetin Kombëtar të Singaporit dhe
autori kryesor i studimit u shpreh: “Për ne të rriturit, mësimi i një gjuhe të dytë kërkon
shumë mund dhe përkushtim dhe disa herë këtë vështirësi ia transmetojmë edhe fëmijëve
tanë të vegjël, duke menduar se truri i tyre i vogël nuk ka aq vend sa për të përballuar
mësimin e dy gjuhëve dhe se do të krijonte pështjellim për ta. Megjithatë, një numër i
madh studimesh kanë treguar se foshnjat janë në një pozicion mjaft të mirë dhe unik për
të përballuar sfidat e mësimi të një gjuhe tjetër dhe, për më tepër, ata mund të përfitojnë
shumë nga ky rrugëtim i të mësuarit.”

Ndërkohë që studimet e mëparshme janë përqendruar në avantazhet që gëzojnë bilin-
gualët, kur vjen puna për aftësitë linguistike, Singh dhe bashkëpunëtorët e saj ishin të
interesuar të gjenin faktin nëse përfitimet e të pasurit më shumë një gjuhë amtare kanë
një qasje më të gjerë, në ndikim të aftësive kognitive në përgjithësi. Për të zbuluar ndonjë
nga këto efekte, studiuesit përdorën materiale testimi pamor në një metodë të quajtur
“përshtatja pamore”.

Matja e aftësisë së foshnjave për të përpunuar informacionin nuk bëhet në mënyrë të
drejtpërdrejtë dhe përshtatja pamore është një nga të paktat veprime që foshnjat mund të
kryejnë, e cila është një parashikues i fortë për një shkallë inteligjence të mëvonshme. Në
studimin e Singh u vëzhguan 114 fëmijë 6 muajsh nga Singapori, të cilëve iu tregua një
pamje e një kukulle prej pelushi që përfaqësonte një ari ose një ujë. Sapo fëmijët humbën
interesin e tyre në këtë pamje, atyre iu tregua një kafshë tjetër, që nuk e kishin parë.

Fëmijët të cilët ishin rritur në një mjedis bilingual, filluan të mërziteshin më shpejt me

pamjen e parë dhe treguan më shumë interes në pamjen e kukullës së re. Shkalla e rënies së interesit që foshnjat kanë ndaj një pamje dhe tërheqja ndaj një stimuli të ri, kishin lidhje me performancën në një shtrirje sferash kognitive, që tregonte se fëmijët 6-muajsh bilingualë i kanë tashmë aftësitë ndërtuese të organizuara, për të shkëlqyer më vonë në fusha të ndryshme të jetës. Këto efekte nuk ishin specifike për një gjuhë të caktuar, por u hasën përgjatë studimit të të gjithë gjuhëve çift.

Sipas studiuesve, një shpjegim që mund t'u jepet këtyre rezultateve mund të jetë që fëmijëve bilingualë, thjesht u duhen aftësi më të mëdha të përpunimit të informacionit, për të përballuar sfidat që hasin përpara. Ata, jo vetëm që po mësojnë 2 gjuhë për të cilat janë të ekspozuar ndaj një fjalori të minimizuar, por ata po e bëjnë këtë gjatë kohës që po mësojnë të bëjnë dallimin ndërmjet të dyja gjuhëve. Efektshmëria që zhvillohet tek ata për ta arritur këtë qëllim, duket se është mjaft e qëndrueshme për gjatë gjithë jetës së tyre.

2.12.1. Interferencat

Në shkencën e gjuhësisë ashtu si edhe në mësimin e gjuhëve është një aspekt i rëndësishëm edhe interferenca e gjuhëve. Në studimin e gjuhësisë me interferencë nënkuptojmë devijimin apo transferimin e zanoreve, fjalëve apo rregulleve se si është formuar fjalia apo pozicionimi i fjalëve në të. Pra, spostime nga një gjuhë në tjetrën (Mackey 1968 fq. 569). Sipas (Kiehofer dhe Jonekeit 1993, fq 64) me konceptin “interferencë” nënkuptohet mbivendosja e rregullave të të 2 gjuhëve dhe si pasojë ndodhin gabime në strukturim. Kjo për dëgjuesin e jashtëm i cili nuk e njeh fenomenin kuptohet si gabim në fjali ose në të shprehur. Por duhet theksuar që në këtë rast të interferencës nuk flitet për çrregullime të të folurit ose gjuhës. Por kjo interferencë vjen si pasojë e ndikimit të gjuhës më të fortë, pra, të mësuar më mirë, mbi gjuhën më të dobët.

Interferencat mund të shfaqen (Kiehofer/Jonekeit 1993) si në gjuhën e shkruar dhe në atë të folur, dhe ky fakt merr një ndikim dhe kuptim se sa rëndësi marrin gjuhët për individin. Sipas (Jedik 2002 a) ekzistojnë tri forma me të cilat shfaqen interferencat:

- **Interferenca fonetikofonologjike**—në këtë pjesë preken bashkëtingëlloret dhe ritmi i fjalëve në fjali. Po ashtu, preket dhe intonacioni.

- **Interferenca në morfologjinë sintaksës**—këtu transferohen dhe mbivendosen rregullat dhe modelet sintaksore, si në rastin e studiuesit ku gjuha L1 qëndron mbi gjuhën e dytë, L2, kështu fjalitë duket sikur nuk janë korrekte.
- **Interferenca leksikosemantike**—këtu përfshihet marrja apo transferimi i disa fjalëve (Jedik 2002.a) nga njëra gjuhë në tjetrën dhe këtu flitet për fjalë që në të dy gjuhët kanë të njëjtin kuptim.

Nëse duam të thellojmë kërkimin tek interferencat e gjuhëve, një rol të madh do të luajë edhe krahasimi i gjuhëve dhe studimi i tyre në një kënd më të gjerë, i cili do të përfshijë studimin e ndryshimit ndërmjet gjuhëve, si dhe krahasimin alfabetik ndërmjet gjuhëve. Kështu, kur gjuhët krahasohen, kemi automatikisht rrjedhoja të gabimeve apo interferencave, të cilat na çojnë në përfundime më të sakta empirike. Kështu që studimet marrin vlera dhe përfundime të bazuara në fakte të pa revokueshme.

2.13. Strukturat përgjegjëse të trurit për verbalizim

Korteksi

Këtë figurë të trurit e ka në mend çdo njeri që nuk e njeh anatominë: një strukturë në formë helmete, një sipërfaqe e përshkruar nga harqe dhe nga brazda.

Kjo pjesë e jashtme e trurit – e mbrojtur nga kafa dhe cipa e trurit që gjendet poshtë saj është *cortex cerebri*, korja e madhe. Shpesh quhet thjesht *Cortex*, fjala latine për kore. Truri me dy gjysmat e tij – hemisferat – lidhet nga e ashtuquajtura *corpus callosum* e cila nga historia e evolucionit është pjesa më e re e trurit. Po më i madhi, truri i madh, zë 85% të masës së gjithë trurit. Nëse tërheqim palcën e trurit të ndodhur në brendësi dhe të përbërë nga fije nervore të ndërthurura me ganglione basale, mbetet korteksi, një shtresë me 25 mm trashësi. Kjo shtresë quhet edhe substanca gri sepse ajo është e pasur me qeliza nervore, të cilat i japin asaj një ngjyrë gri. Numri i qelizave nervore (neuroneve) në koren e trurit të madh është afërsisht 23 miliardë në trurin e meshkujve dhe afërsisht 19 miliardë në trurin e femrave, megjithatë, duhet marrë parasysh se trupi mesatar mashkullor është më i madh se ai femëror.

Vetëm korja e trurit të madh (korteksi) zë pothuajse gjysmën e volumit të trurit. Kjo

bëhet e mundur nëpërmjet gyrive dhe brazdave të thella të cilat quhen *sulci* ose *fissurae*. Njëlloj si me një pecetë buke të bërë shuk brenda një gote, në të njëjtën mënyrë krijohet shumë sipërfaqe në një hapësirë të vogël, një hile e evolucionit për të krijuar vend të mjaftueshëm për detyrat e shumëllojshme të korteksit me gjithë vëllimin e kufizuar të kafkës. Volumi i kafkës duhet të minimizohet për shkak të gjerësisë së rrugëve femërore të lindjes në të cilat ka një hapësirë të kufizuar.

Nga sinjalet e shqisave dhe nga rajonet e aktivizuara të trurit, në korteks lind përshtypja për mjedisin. Përveç kësaj, ai mund të ruajë informacione, pra, është themeli biologjik i kujtesës sonë, logjikës, veprimeve të qëllimshme, jetës shpirtërore; shkurt, gjithçka që ndodh brenda njeriut, kapaciteti mendor dhe proceset e të mësuarit do të ishin të pamundura pa koren e trurit.

Struktura e inteligjencës dhe vetëdijes

Struktura tipike e korteksit të gjitarët është zhvilluar ngadalë nga historia gjenealogjike. Fillimisht u zhvillua pjesa përgjegjëse për shqisën e të nuhaturit, prandaj ai quhet *palaeokorteks*, pra korteks i vjetër. Po ashtu, u zhvillua shumë herët i ashtuquajti *archikorteks* i cili shumë shpesh i atribuohet sistemit limbik. Te njerëzit ai përfshin pjesë nga korja e trurit të cilat janë përgjegjëse për reagimet emocionale, sjelljet për ruajtjen e llojit (species) dhe të riprodhimit. Përveç kësaj, vjen dhe *hippocampusi*, i cili është i rëndësishëm për kujtesën. Këto areale të vjetra bëjnë vetëm një të dhjetën e kores së trurit të madh. Pjesa e mbetur prej 90% emërtohet si *neokorteks*. Me zhvillimin e mëtejshëm dhe më të madh të shqisave, u bë dhe neokorteksi më kompleks, megjithëse të gjitarët përfshihen dhe shqisat e të gjithë lëkurës, mukoza dhe muskulatura ashtu si edhe retina e syrit, shqisat e të shijuarit dhe veshi i brendshëm me sistemin e dëgjimit dhe të ekuilibrit. Veç kësaj, ai përfshin areale, të cilat drejtojnë veprimet tona të qëllimshme (të vullnetshme). Megjithatë, pjesën më të madhe e formojnë zonat e kores së trurit, të cilat informacionin nga shumë sisteme shqisore e bashkojnë në një pamje gjithëpërfshirëse të mjedisit dhe rregullojnë vëmendjen dhe aktivitetin tonë. Këto pjesë quhen *korteksi i asociuar*.

Korja e trurit, korteksi, mbulon gati të gjithë pjesën e trurit që shihet nga jashtë. Ai është

shumë i rrudhosur dhe i mbuluar me brazda të shumta, prandaj lindin edhe zona të kufizuara nga njëra tjetra. Çdo gjysmë truri disponon për shembull rreth 4 lobe, të cilat shihen nga jashtë. 90% e korteksit përbëhet nga neokorteksi i cili është më i riu (menduar nga historia e evolucionit) dhe që përbëhet gjithandej nga 6 shtresa qelizash. Paleokorteksi, (menduar më i vjetri nga historia e evolucionit), ndryshon nga neokorteksi nga ndërtimi i tij citologjik. Nëse vëzhgojmë prerje nga kjo kore e “re” në mikroskop, do të vëmë re një ndërtim shumë të njëjtë. Duken 6 prerje qelizore, për të cilat janë përkatësisht karakteristike lloje dhe renditje të ndryshme të neuroneve. Megjithatë, ekzistojnë variante zonale të cilat janë tipike për zona të caktuara të kores së trurit. Përkundrazi, pjesët më të vjetra të kores së trurit kanë pak a shumë 6 shtresa. Ky organizim qelizor i korteksit quhet *citoarkitektonik*.

Për të vizatuar një hartë funksionale dhe citoarkitektonike të zonave të ndryshme të sipërfaqjes së korteksit, na ofrohen brazdat e thella si nënndarje. Kështu, mund të dallohen 4 lobe: pjesa balllore ose *lobi frontal*, pjesa e sipërme të maja e kokës ose *lobi parietal* dhe në pjesën anësore kemi tërësinë, pjesë e cila quhet ndryshe *lobi temporal*. Mbrapa gjendet pjesa e pasme e kokës ose *lobi oksipital*.

Në anë gjendet *lobi ishull* i cili është i palosur plotësisht nga brenda dhe i padukshëm nga sipërfaqja. Nëse duhet të rafinoni hartën mund të përdorni edhe harkimet individuale.

Një ndarje thelbësore dhe të saktë të kores së trurit ka bërë përgjatë 100 vjetëve neurologu gjerman Korbinian Brodmann dhe neurologia Cecile dhe Oscar Vogt. Bazuar në ndryshimet e imëta në ndërtimin qelizor, u identifikuan nga Brodmann 43 fusha të ndryshme koreje të njerëzit. Ato njihen edhe sot si arealet e Brodmannit. Çuditërisht, duket të vlejë akoma parimi i vjetër i formimit “forma ndjek funksionin”. Megjithëse të ndara qartësisht sipas anatomisë së tyre qelizore, arealet e Brodmannit kategorizohen në funksione të caktuara.

Nëse ne dëgjojmë, shikojmë ose perceptojmë diçka, sinjalet nga organet e ndryshme shqisore përfundojnë në korteks. Sinjalet e hyra përcillen nga qelizat nervore në talamus dhe transferohen në zona të ndryshme të korteksit, të cilat renditen sipas funksioneve të caktuara.

Në rastin e të parit aktivizohet korja primare e të parit në *lobin oksipital*. Ajo përpunon informacionin dhe e përcjell atë në zonat pamore të kores të cilat mundësojnë performancë komplekse, si njohjen e sendeve dhe të fytyrave. Fushat primare somatosensorike e marrin informacionin e shqisave nga prekja, vibrimi, shtypja, zgjerimi ose dhimbja, e përpunojnë dhe e përcjellin tek fushat më të larta të kores, nga ku pastaj, p.sh., nga prekja e një sendi, lind një përshtypje rreth formës së tij. Analogia vlen dhe për dëgjimin. Nga perceptimi i frekuencave të ndryshme në koren e parë (primare) të të dëgjuarit perceptimi i një melodie lind në fusha të larta të kores.

Siç janë përgjegjëse qendrat sensorike për ndjesitë shqisore, ka qendra motorike për drejtimin e lëvizjeve. Atje renditen pjesë të caktuara të trupit, madje grupe të veçanta muskujsh dhe lëvizjesh, arealesh, për shembull të dorës së djathtë, një zonë në të majtë të lobit frontal. Sistemet e kapacitetit kujdesen për lidhjen me pjesët e shtrira thellë të trurit dhe së fundmi me pjesën përkatëse të trupit.

Kuptimi i kores së trurit të madh

Nga funksionet e shumëllojshme të kores së trurit të madh rrjedhin pasojat e mundshme të lëndimeve lokale ose humbjeve. Nëse preket qendra primare e të parit, ndodh të ketë verbëri. Edhe pse sytë funksionojnë, nëse dështojnë fusha të caktuara të kores së lartë, njeriu shikon por nuk njeh fytyra, ngjyra ose lëvizje në bazë të vendndodhjes së shqetësimit. Në rast të një dëmtimi të çerekut të pasëm të lakimit të poshtëm të lobit frontal, qendrës Broka dëmtohet aftësia e të folurit por jo aftësia e të kuptuarit të gjuhës. Plagët në pjesën e përparme të lobit frontal çojnë në ndryshim të personalitetit dhe pakësim të aftësive intelektuale.

Arealet e korteksit renditen sipas funksioneve të veçanta, të cilat asnjëherë nuk çlirohen dhe aktivizohen vetë, por janë të ndërthurura në mënyrë komplekse me areale të tjera dhe pjesë të tjera të trurit. Prandaj ne nuk mund të flasim për qendra të veçanta, por për nyje në një rrjetë komplekse neuronale.

Në anën tjetër: Nëse është fjala për të deshifruar ose kuptuar një tekst si ky ose për funksione të tjera të mëdha mendore, përgjegjës është korteksi, shtresa e jashtme e dy

gjysmave tona të trurit të madh. Këtu përpunohen përshtypjet shqisore, ruhen informacione; këtu mendojmë dhe zhvillojmë plane, këtu drejton truri jonë veprime si të ecurit, të folurit, ose të shkruarit; këtu lind ndërgjegjja jonë.

Truri i vogël

Truri i vogël është i strukturuar saktë dhe ndodhet mbrapa kafkës. Por ndërtimi i tij i njëtrajtrashëm mashtrohet. Ai koordinon në mënyrë të saktë lëvizjet dhe duket të jetë i përfshirë në një sërë aftësish emocionale dhe konjitive.

Truri i vogël ndodhet mbrapa kafkës poshtë trurit të madh dhe mbrapa shtyllës së trurit, latinisht cerebellum. Nga jashtë shihen mirë dy gjysmat e tij, të cilat emërtohen njësoj si dy gjysmat e trurit të madh, si hemisfera. Ato lidhen me njëra tjetrën me vermisin në formë të fryrë (krimbin e trurit të vogël).

Kur neurologu anglez Gordon Holmes (1876 – 1965) vizitoi në vitin 1917 ushtarë me dëmtime në trurin e vogël, ai kuptoi se truri i vogël mund të shihet si një organ i cili mbështet lëvizjen. Në të vërtetë, këtë e vërtetojnë ndërkohë metoda të cilat na japin një tablo: që truri i vogël koordinon dhe modelon lëvizjet. Nëse kapim filxhanin e kafes, luajmë në piano ose bëjmë një salto, në trurin e vogël ndizen neuronet. Por Holmes e nënvlerësoi “vëllain e vogël” të trurit të madh.

Ndërtimi dhe struktura

Truri i vogël disponon rreth 5 herë më shumë neurone se truri i madh, megjithëse zotëron vetëm 1/6 e volumit të trurit të madh. Për të nxënë një masë kaq të madhe nervash në një hapësirë aq të vogël, korja e trurit të vogël është shumë e rrudhosur. Rrudhat horizontale të krijuara nëpërmjet emërtohen si gjethe (*foliae*). Nëse ndajmë një nga hemisferat e trurit të vogël në formë gjatësore atëherë kuptohet arsyeja e këtij emërtimi. Substanca e bardhë e përbërë nga fije nervore degëzohet në brendësi si degët e një peme. Anatomistët e quajnë atë pemën e jetës (*arbor vitae*). Në degët e saj rrudhat e kores së trurit të vogël duken si gjethe të varura. Rrënjët e pemës formojnë kërcejt e trurit të vogël, të cilat shtrihen nga truri i vogël deri te shtylla e trurit.

Nëpërmjet këtyre fijeve truri i vogël merr dhe dërgon informacion. Pema e jetës preket

nga substanca gri e qelizave nervore. Dhe siç tregon dhe fusha mikroskopike edhe kjo është e strukturuar jashtëzakonisht saktë.

Në të gjithë koren e trurit të vogël të parë nga jashtë, brenda gjenden 3 shtresa të njëjta qelizore: shtresa molekulare, shtresa qelizore purkinje dhe shtresa qelizore kokrizë. Bie në sy në mënyrë të veçantë shtresa e mesme, në të cilën ndodhen qelizat e mëdha purkinje, të rreshtuara me rregull njëra pas tjetrës si një shtresë qershish në tortë. Ato janë pika qëndrore koordinuese e kores së trurit të vogël. Pema e tyre e dendriteve, e cila është shumë e degëzuar, merr informacion ngacmues dhe frenues nga pothuajse të gjitha neuronet e kores. Në një pemë dendritesh mund të gjenden deri në 200 000 sinapse. Sinjalet e tyre drejtojnë qelizat purkinje tek bërthamat e trurit të vogël, një bashkësi qelizash nervore e ndodhur thellë në substancën e bardhë. Nga atje impulset arrijnë nëpërmjet kërcellit të trurit të vogël në zona të tjera të trurit, jashtë trurit të vogël.

2.13.1. Detyra dhe humbje

Studime të reja të lenë hamendësosh se truri i vogël nuk është përgjegjës vetëm për motorikën. Neurologia Catherine Limperopoulos dhe kolegja e saj nga universiteti “McGill” në Montreal vizituan në vitin 2005 fëmijë, të cilët kishin lindur me lëndime në trurin e vogël. Krahas problemeve motorike, pacientët e vegjël kishin edhe vështirësi me proceset konjitive si: komunikimi, sjellja shoqërore dhe perceptimi pamor (vizual). Përveç kësaj, metodat imazherike tregojnë se gjatë kryerjes së aktiviteteve të shumta shndrit aktiv sinjali në trurin e vogël, për shembull, te detyrat e kujtesës afatshkurtër, të kontrollit i sjelljes impulsive, te dëgjimi dhe nuhatja, dhimbja, uria, vështirësia në frymëmarrje dhe shumë më tepër. Shkencëtarët e neurologjisë nuk e dinë akoma se cilin rol luan truri i vogël te këto detyra të ndryshme. Një hipotezë e përhapur thotë se truri i vogël është përgjegjës për koordinimin kohor.

Pavarësisht nga deficietet e përmendura konjitive, në plan të parë qëndrojnë problemet motorike në lëndimet në trurin e vogël. Ato korrespondojnë më së shumti me ato të cilët Holmes i kishte vëzhguar tashmë te pacientët e tij dhe të cilët neurologët i quajnë si “ataksi” të ndryshme. Të prekurit kanë probleme në ekuilibër dhe koordinim, ecja është

e lëkundur dhe e ngjashme me një të dehur. Nëse këta pacientë kapin diçka, dora e tyre dridhet më fort sa më shumë i afrohet objektit. Shpesh i drejtojnë lëvizjet jashtë objektit. E folura e tyre tingëllon e ndërprerë (e copëtuar). Tensioni i muskujve të tyre është shpesh i reduktuar, aq sa trupi duket i lëshuar. Bien në sy edhe lëvizjet e syve të pacientit. Shikimi lëviz me hope, sytë duken sikur dridhen dhe shpesh duhet të korrigojohet disa herë pozicioni i syve në mënyrë që një objekt të fiksohet.

Akrobatët, pianistët ose lojtarët e bejzbollit na demostrojnë punën e trurit të vogël. Por edhe vetë kapja e një filxhani të mbushur me kafe është komplekse. Ku qëndron filxhani? Ku ndodhet dora, e cila duhet ta kapë atë? Truri i vogël integron informacione të shumta të rëndësishme, koordinon aktivitetin e një mori muskujsh dhe teston vijueshmërinë e lëvizjes. Është e paqartë akoma se si punon ekzakhtësisht dhe sa ndikon në detyrat e tjera të shumta. E qartë është megjithatë, se emri dhe volumi i vogël mashtrojnë. Truri i vogël nuk është aspak inferior karshi trurit të madh, as në kompleksitetin e detyrave të tij dhe as në numrin e neuroneve.

Krimbi i trurit të vogël dhe një shirit i gjerë sa gishti djathtas dhe majtas formojnë së bashku *spinocerebellum*. Ai kujteset që ne të ecim dhe të qëndrojmë pa qenë të detyruar që të mendojmë për këtë. *Spinocerebellum* mëson nga palca kurrizore se në çfarë pozicioni gjenden krahët, këmbët dhe trangu, por edhe se cilët muskuj janë të tensionuar dhe cilët janë të relaksuar. Këtë informacion e përpunon dhe e dërgon në trangu cerebral. *Pontocerebellum* përbëhet nga dy hemisfera. Ai është i lidhur fort me trurin e madh nëpërmjet bërthamës së urës në trangu cerebral. *Pontocerebellum* është i përfshirë kurdoherë që ne duam të lëvizim diçka me dëshirë. Detyrat e tij arrijnë nga kapja në mënyrë të saktë, deri në koordinimin e muskujve të laringut gjatë procesit të të folurit. Nga kjo, *pontocerebellum* mund të krahasohet me një dirigjent. Në vend të muzikës ai studion lëvizjen nëse ajo është e saktë për “muzikantët” e tij (muskujt) dhe koordinon lojën e tyre të përbashkët. Notat i korrespondojnë një plani të përafërt lëvizjeje i cili përcillet nga truri i madh. Nëse shkon diçka keq ai ndërhyr, p.sh., nëse dyshemeja papritur është e pabarabartë ose nëse

filxhani i kafes është bosh (më i lehtë seç mendohej). Korrigjime si kjo janë padyshim të rëndësishme për të mësuar lëvizjet.

Studiuesit e trurit i njohin detyrat e 3 zonave të *cerebellumit* (trurit të vogël), por deri tani ata nuk e kuptojnë akoma si saktësisht i zgjidhin të gjitha këto detyra motorike *vestibulo-cerebellum*, *spinocerebellum* dhe *pontocerebellum*.

2.13.2. Stimulimet dhe lesionet

Nëse stimulojmë amigdalan te kaviet me një elektrodë, reagimi varet nga fakti se cilën zonë kemi prekur. Nëse është grupi i bërthamës i ndodhur në sipërfaqe, kafsha do të fillojë të mbllaçitet (përplasë buzët) duke bërë lëvizje përtypjeje ose lëpirjeje. Përveç kësaj, do të ngacmohet jargavitja. Nëse elektroda do të stimulojë në të kundërt pjesën e thellë të amigdalës, kafsha do të ngrejë kokën, pupilat e tij do të zmadhohen dhe do të shikojë me vëmendje rreth e rrotull. Nga impulset e forta vëmendja e rritur do të shndërrohet në frikë ose zemërim. Amigdala vepron mbi të gjitha si një përforcues emocional. Se në çfarë reaksioni çon një stimulim, kjo varet edhe nga njeriu, se në çfarë gjendjeje emocionale ndodhet personi i testuar në atë moment. Personat e testuar raportuan se kishin halucinatione të ngjashme me kujtimet gjatë stimulimit ose edhe një eksperiencë “déjàvu”, pra, ndjesinë e një situate të jetuar njëherë më parë.

Funksioni i amigdalës kuptohet më mirë nëse vëzhgojmë se çfarë ndodh nëse ajo mungon, për shembull te majmunët, te të cilët ajo është shkatërruar qëllimisht në të dyja gjysmat. Si rrjedhim, kafshët shfaqin më pak emocione se më parë por mbi të gjitha atyre u mungon çdo sjellje agresive ose vetëmbrojtëse. Majmunët nuk tregojnë asnjë shenjë frike edhe atëherë kur gjenden në një rrezik të vërtetë, si për shembull kur ndeshen me një gjarpër. Si rezultat, ata e perceptojnë plotësisht ngacmimin e jashtëm të ardhur nga prania e gjarpërit por pa amigdalan mungon refleksi korrespondues i trembjes.

Dhe jo vetëm kjo, por pa amigdalën kafshët kanë vështirësi dhe për të mësuar asociimet emocionale, për shembull, një send të caktuar ata e lidhin me një shpërblim ose me një ndëshkim. Përveç kësaj, ata nuk kërkojnë më asnjë kontakt me majmunët e tjerë dhe si rrjedhojë së shpejti izolohen në grup. Në një mënyrë të ngjashme funksionon edhe te

njerëzit. Kështu e përshkroi psikiatri britanik Robin Jacobsen një pacient, tek i cili ishte larguar me operacion amigdala nga të dyja anët për arsye shëndetësore. Personi si rrjedhojë kishte vështirësi të njihte fytyra dhe mbi të gjitha nuk dallonte dot saktë shprehjen e fytyrës së personit përballë. Nga kjo u dëmtua fort edhe sjellja shoqërore e të prekurve. Një dëmtim të tillë e shkakton edhe sindroma e Urbach Wiethe, një sëmundje e rrallë gjenetike nga e cila sklerotizohet amigdala. Të sëmurët janë gjithashtu shumë të kufizuar në jetën sentimentale dhe sociale. Fjalës “frikë” nuk ia dinë kuptimin.

Amigdala luan gjithashtu një rol në kujtesë, dhe më konkretisht, në kujtesën emocionale. Normalisht, ne na kujtohet më mirë një situatë nëse në të ishim të përfshirë emocionalisht, pra, specifikisht, nëse përjetuam frikë ose ankth. Njerëzit të cilët e kanë të dëmtuar amigdalën nuk e shfaqnin këtë efekt.

2.13.3. Trungu i trurit (cerebral)

Ai është i madh sa një gisht dhe pothuajse s’bie në sy, por trangu cerebral është i një rëndësie jetësore. Është ai i cili kontrollon dhe rregullon sistemet më të rëndësishme jetësore të trupit, qarkullimin i gjakut, frymëmarrjen apo gjumin.

Krahasimi i trungut cerebral (*truncus cerebri*) me një trung peme është mjaft i goditur, megjithëse madhësia e tij është sa gishti i madh i dorës. Ashtu si trungu i pemës, i cili fshihet poshtë shumë gjetheve dhe nuk shihet, edhe trangu cerebral mbulohet pjesërisht nga truri i madh dhe truri i vogël. Dhe, si një trung peme, edhe ai ka funksione mbështetëse, sepse trangu cerebral lidh pjesët e sistemit nervor qendror. Lart i bashkohen truri i mesëm dhe truri i madh, mbrapa truri i vogël.

Nga poshtë, trangu cerebral kalon i pandërprerë në palcën kurrizore. Kjo zonë më e ulët quhet *medulla oblongata*, si palcë kurrizore e zgjatur dhe siç nënkupton dhe emërtimi është e vështirë të vihet një kufi i qartë. Disa anatomistë e shikojnë atë atje ku degëzohet (ndahet) nervi i parë i palcës kurrizore. Të tjerë e caktojnë kufirin diçka më sipër, në “kryqëzimin e piramidës”. Atje shumë nga tufat nervore të ardhura nga gjysma e majtë e trurit ndryshojnë drejtim për në të djathtë dhe anasjelltas.

Nga historia evolucionare trangu cerebral është pjesa më e vjetër e trurit dhe kështu ndry-

shimet midis njeriut dhe kafshës janë relativisht të pakta. Funksionet e tij janë të shumë llojshme dhe ai është kritik për funksionimin e trurit dhe të gjithë organizmit. Anatomisti nga Frankfurti, Helmut Wicht, e quan trungun cerebral si “qendra e teknikës” së trurit.

2.13.4. Funksionimi i dygjuhësisë në tru

Në dhjetëvjeçarin e fundit, neurofiziologët (në fokusin e të cilëve është dygjuhësia) janë në gjendje të na tregojnë se cilat pjesë të trurit, si për shembull tek e folura ose te dëgjimi i gjuhës së nënës apo edhe në dygjuhësi, bëhen aktive. Për fëmijët bilingualë dhe fëmijët monolingualë, shkenca nuk e ka të unifikuar mendimin. Oskar Mbron këndvështrimin se te monolingualët, hemisfera e majtë luan funksionin më të rëndësishëm (Lambeck, 1984: 5052). Por në rastet kur truri pëson një dëmtim, ndodh që hemisfera e djathtë mund të marrë zotërimin dhe funksionimin e gjuhëve. Friederici & Hahne janë të këndvështrimit që në vitet e para të verbalizimit të gjuhës (*spracherwerbs*), hyn në funksion veçanërisht hemisfera e djathtë, ndërsa hemisfera e majtë është më përgjegjëse për pjesët morfologjike dhe sintaksën.

Prej shumë kohësh, funksionimi i gjuhëve ishte i ndarë në dy drejtime: në pjesën e majtë të trurit ishte *BrocaAreal*, e cila ishte përgjegjëse për funksionimin e gjuhës, ndërsa *WernickeAreal* ishte përgjegjëse për funksionimin e gjuhës. Por Friederici nuk e mbështet plotësisht këtë version. Ai zhvillon një model tjetër të përpunimit të gjuhës. Friederici, funksionimin e gjuhës nuk e kufizon vetëm në një hemisferë, por e ndan atë në disa pjesë të trurit. Kështu, sipas tij, pjesët e trurit (Grosshirnin de) janë të specializuara për procese të ndryshme. Për të gjetur se cila pjesë e trurit merret me përpunimin e sintaksës dhe semantikës, shumë studiues studiuhan aktivitetin e trurit dhe panë që përsëri *WernickeAreal* ishte e prekur, pra pjesa e mesit dhe e pasme ishin të përdorura në mënyrë të ndryshme dhe vende-vende të forta, kështu që përpunimi i gjuhës nuk bëhej vetëm në *WernickeAreal*, por me sa duket edhe në pjesët e majta të trurit.

Studimet e tjera arritën në përfundimin se përpunimi i melodisë së fjalisë në mënyrë të veçantë ndodhte në hemisferën e djathtë që në fakt, sipas rregullit, përpunon informacionin emocional, pra, shkencëtarët dalin në konkluzionin se hemisfera e majtë dhe hemi-

sfera e djathtë duhet të bashkëpunojnë, në mënyrë që gjuha të përpunohet në mënyrë të drejtë. Dhe, për sa i përket fenomenit “bilinguizëm”, është zbuluar se në bilinguizmin e hershëm, pra në moshë të hershme, përdoren të njëjtat zona të trurit dhe në bilinguizmin e vonë zonat e afërta bien në funksion. Kjo shpjegon edhe faktin pse fëmijët mund të mësojnë në kaq kollaj një gjuhë tjetër. Ndërkohë, *BrocaAreal* regjistron gjithë përpunimin e gjuhës së re, ndërsa të rriturit duhet të fusin në punë një pjesë të re të caktuar të trurit, kështu pra, i jepet përgjigje diskutimit për sa i përket moshës optimale për të mësuar gjuhët.

Është e nevojshme që në fëmijërinë e hershme të mësohet më shumë se një gjuhë, për ndryshe, nëse gjuhët do të mësohen në moshë të rritur, atëherë kjo jo vetëm do të krijojë nevojën e hapjes së një vendi të ri të caktuar në tru, por në një moshë të caktuar, mësimi i gjuhës do të bëhet edhe më i vështirë.

Për sa i përket psikologëve të zhvillimit dhe neurobiologëve, është e vlefshme teza se fëmijët përpara moshës shkollore janë më të aftë për të mësuar më shumë dhe më shpejt gjuhë të reja sesa në një moshë të rritur. Kjo ndodh sepse në moshën e hershme fëmijët mësojnë në inkoshiencë dhe po në të njëjtën mënyrë imitojnë dhe mësojnë këtë gjuhë. Ata nuk e mësojnë një gjuhë tjetër si diçka të detyrueshme, nuk e trajtojnë gjuhën e re si një gjuhë të huaj, por u vjen natyrshëm; ata e përballin gjuhën e re me motivin e lartë dhe flasin pa ndrojtje.

Një avantazh për fëmijët është se ata gjuhën e dytë, në më të shumtën e rasteve, e zotërojnë më mirë sesa personat, të cilët mësojnë një gjuhë të re në një moshë të madhe. Dygjuhësit e hershëm zotërojnë aftësi gjuhësore, të cilat në dëgjim dhe në shqiptim i dallojnë ata nga të tjerët. Dygjuhësia në fëmijërinë e hershme bën që fëmijët, nëpërmjet kontakteve me miq, kultura të ndryshme, të paraqesin një tolerancë dhe një bujari ndryshe nga bashkëmoshatarët e rritur me një gjuhë apo të izoluar nga ambiente me njerëz të kulturave të ndryshme. Pra, edhe nga ana pedagogjike këshillohet që në shoqërizimin e fëmijëve me fëmijë të tjerë, t’u mësohet atyre të jenë pozitivë ndaj grupit dhe tolerantë ndaj reagimeve jo të njëjta.

Krahasimi i trurëve bilingualë dhe monolingualë: Një hetim i përpunimit sintaktik dhe gjetja e mundshme e një “firme neurale” e bilingualizmit, i kryer me anë të rezonacës magnetike.

A e përpunon gjuhën ndryshe truri i një personi bilingual nga ai i një monolingual? Ne krahasuam mënyrën se si bilingualët dhe monolingualët i përdorin zonat tipike të trurit në përdorimin e gjuhës për të reaguar ndaj një detyre të dhënë për përdorimin e gjuhës dhe pyetëm nëse ekzistonte një “shenjë neurale” e bilinguizmit. Në këtë studim morën pjesë persona bilingualë, të cilët ishin mjaft të aftë në anglisht dhe spanjisht që në moshën e tyre të hershme. Gjatë pamjeve të shfaqura të rezonancës magnetike (fMRI), pjesëmarrësit kryen një “detyrë mbi gjykimin e fjalisë” [Caplan, D., Alpert, N., dhe Waters, G. Efektet që kanë struktura e sintaksës dhe numri “propositional” në format që merr kalimi i gjakut në zonat cerebrale *Journal of Cognitive Neuroscience*, 10, 541-552, 1998].

Fjalitë përmbanin ndryshime ndërmjet tipareve linguistike të gjuhës angleze dhe asaj spanjolle, duke na dhënë mundësinë të zbulonim ngjashmëritë dhe ndryshimet në reagimet neurale dhe të sjelljes ndërmjet bilingualëve dhe monolingualëve dhe ndërmjet 2 gjuhëve të një bilinguali. Nëse përpunimi neural i bilingualëve ndryshon përgjatë përdorimit të dy gjuhëve, atëherë duhet kryer vëzhgimi i formave neurale dhe sjelljes së ndryshueshme në përdorimin e gjuhës spanjolle dhe angleze. Rezultatet treguan se në gjuhën angleze, duke e parë nga ana e reagimit/sjelljes, bilingualët dhe monolingualët kishin të njëjtën shpejtësi dhe saktësi, megjithatë, siç u parashikua edhe nga ndryshimet strukturore nga gjuha spanjolle në atë angleze, bilingualët kishin një formë të ndryshme të performancës në gjuhën spanjolle. Analizat e rezonancës magnetike (fMRI), zbuluan se edhe monolingualët (në një të vetme gjuhë) edhe bilingualët (në secilën gjuhë), kishin një rritje të parashikuar të aktivizimit të zonave klasike të trurit për përdorimin e gjuhës (p.sh.: korteksi ballor inferior i majtë, LIFC), me çdo ndryshim neural ndërmjet dy gjuhëve të bilingualit, gjuhë të cilat u përdorën në bazë të një rregulli të caktuar dhe të parashikuar në bazë të ndryshimeve morfosintaktike ndërmjet secilës gjuhë (anglishtes dhe spanjishtes). Sidoqoftë, një ndryshim i rëndësishëm që u vu re ishte se bilingualët, gjatë rezonancës magnetike kishin një rritje të dukshme të sinjalit BOLD në momentin që përpunonin gjuhën angleze, më shumë sesa monolingualët anglishtfolës.

Studiuesit kanë siguruar dëshmi të forta, që tregojnë se bilingualët ndryshojnë krejtësisht

nga monolingualët, veçanërisht në lidhje me ekzistencën e leksikut dual të diferencuar, ekzistencën dhe natyrën e lidhjeve ndërmjet paraqitjeve të tyre të leksikut dual të diferencuar, si dhe në kontrollin e nevojshëm për të përdorur një njësi leksikore kundrejt tjetrës. Është vënë re që bilingualët arrijnë të përkthejnë fjalë konkrete më shpejt sesa fjalë abstrakte (Van Hell dhe De Groot, 1998b) dhe studiuesit kanë treguar gjithashtu, që bilingualët mund të jenë semantikisht të përgatitur në njëren gjuhë për të prodhuar një fjalë në gjuhën tjetër.

Shumë kërkime zhvillimore psikolinguistike të kryera tek fëmijët, mbështesin pikëpamjen që fëmijët bilingualë janë në zhvillim të dy sistemeve linguistike të diferencuara, që në moshën e tyre më të vogël e deri në fëmijëri (Petitto dhe Kovelman, 2003; Holowka, Brosseau-Lapr , dhe Petitto, 2002; Petitto etj., 2001; De Houwer, 1999; Pearson, Fernandez, dhe Oller, 1993; Genesee, 1989). Kjo pik pamje bie ndesh me bindjet e hershme të shumë viteve të mëparshme, se dy gjuh t e f mij ve bilingual  janë të “shkrira” në një sistem të p rgjithsh m gjuh sor gjat  mosh s s  hershme dhe nuk diferencohen në dy sisteme gjuh sore, deri në mosh n 4 apo 5 vje are. (Vihman, 1985; Volterra dhe Taeschner, 1978).

Edhe pse disa k rkime bashk kohore dhe zhvillimore janë në p rputhje me pranin  e shfaqjeve të diferencuara të gjuh s te f mij t bilingual , kjo nuk do t  thot  q  dy gjuh t e nj  bilinguali nuk nd rveprojn  me nj ra-tjetr n. D shmit  e ndikimit t  nd rlinguistik tek f mij t kanë sugjeruar q  t  pakt n disa aspekte t  nj r s gjuh  ndikojn  tek disa aspekte t  gjuh s tjet r. (Paradis dhe Navarro, 2003; Nicoladis, 2002; Doepke, 2000; Schelletter, 2000).

Nd rhyrja nd rlinguistike te f mij t,  sht  gjetur në shumë aspekte ky  t  kompetenc s linguistike, nd r t  cilat: kuptimi i fjal ve (semantik t; Kohnert, Bates, dhe Hernandez, 1999), formimi i fjal ve (morphologji; Nicoladis, 2002), perceptimi i tingullit (fonetika; Fennell, ByersHeinlein, & Werker, 2006) dhe struktura e fjalis  (sintaksa; Paradis & Navarro, 2003; Mueller & Hulk, 2001)

Ashtu si tek f mij t, edhe t  rriturit shfaqin shenja t  ndikimit nd rlinguistik. Kjo  sht  ve an risht e p rhapur tek bilingual t e m vonsh m dhe m  pak t  aft , kur p rpunimi i gjuh s s  dyt  ndikohet shum  nga gjuha e par  m  mbizot ruese. Hernandez etj. (1994)

shqyrtoi strategjitë morfosintaksore që “qeverisin” përpunimin e fjalive dygjuhësore nga brenda një “Kuahri modeli kompjuterik” (Bates dhe MacWhinney, 1989), i cili sugjeron se të kuptuarit e gjuhës është një proces gjatë të cilit një grupim formash gjuhësore konkurron për t’i hapur rrugë një interpretimi të veçantë. Hernandez etj., sugjeroi se të rriturit bilingualë përdorin më shumë një strategji “amalgamë” (përzierjeje) të kombinimit të formave morfosintaksore të marra nga të dyja gjuhët, sesa një strategji “diferencuese” të përdorimit të formave gjuhësore specifike për secilën gjuhë të tyre. Një sugjerim tjetër është se bilingualët mund të jenë në gjendje të përpunojnë dy gjuhë në mënyrë të pavarur, por paralelisht (Grosjean, 2001), duke i sfiduar më shumë studiuesit që të përcaktojnë se cilat raste të të folurit të bilingualëve janë shembuj të “amalgamës”, “mbizotërimit”, “paralelizmit” të të përpunuarit të dy sistemeve gjuhësore “të diferencuara”

Trurët bilingualë e përpunojnë informacionin në mënyrë më të efektshme (Artikull nga Julie Deardorff, 7 nëntor 2014⁶)

Mos u merrni me lojërat, për të cilat mendoni se mund t’ju zhvillojnë trurin; të folurit e shumë gjuhëve e ushtron trurin në mënyrë të rregullt.

Sipas një studimi i cili tregon se folësit bilingualë e përpunojnë informacionin në mënyrë më të efektshme dhe më lehtësisht sesa ata që dinë vetëm një gjuhë, të folurit e më shumë sesa një gjuhë është e dobishme për trurin.

“Arsyeja e dobisë është sepse truri bilingual i aktivizon të dyja gjuhët në mënyrë të vazhdueshme dhe zgjedh se cilën prej tyre të përdorë dhe cilën jo”,

- tha Viorica Marian e Universitetit Veriperëndimor, autore e studimit dhe profesoreshë në departamentin e shkencave të komunikimit dhe çrregullimeve, e Shkollës së Komunikimit. Studiuesit kanë vënë re se kur truri ushtrohet vazhdimisht në këtë mënyrë, nuk ka pse të mundohet shumë për të kryer detyra kognitive.

“I ngjan një semafori, - thotë Marian, - bilingualët ndezin gjithmonë dritën jeshile për njëren gjuhë dhe dritën e kuqe për gjuhën tjetër”.

Në karrierën e saj të hershme, Marian regjistroi lëvizjet e syve për të gjurmuar frenimin dhe aktivizimin e njëkohshëm. Ajo vuri re se kur bilingualët e dëgjonin fjalën në njëren gjuhë, si p.sh., fjalën “marker” (lapustil) në anglisht, ata shpesh lëviznin sytë drejt objekteve, emri

6 Marrë nga <http://www.northwestern.edu/newscenter/stories/2014/11/bilingualbrainsbetterequippedtoprocessinformation.html>

i të cilëve ngjasonte me një fjalë në gjuhën tjetër që ata dinin, si p.sh., fjala “marka”, që në rusisht do të thotë “vulë”.

Ajo ka arritur që të shikojë vetë trurin, me anë pamjeve nga rezonanca magnetike, në të cilat dukej rrjedha e gjakut nëpër zona specifike gjatë kohës që personin kryente një detyrë kognitive. Sa më shumë oksigjen ose gjak të



Figura 4. Copyright: © IOTAGLOBAL

kalonte në zonën specifike, aq më shumë punonte ajo pjesë e trurit.

Në studimin e saj më të fundit, vullnetarëve iu kërkua që të kryenin disa detyra në lidhje me të kuptuarin e gjuhës. Gjatë kohës që dëgjonin fjalën, atyre u tregoheshin pamje të katër objekteve. P.sh.: pasi ata dëgjonin fjalën “cloud”(re), atyre u tregoheshin katër pamje, ku përfshihej një pamje e një “reje” dhe një pamje e një objekti tjetër që kishte ngjashmëri në tingull, si p.sh., fjala “clown” (klloun). Vullnetarët duhet të dallonin fjalën e saktë dhe të anashkallonin fjalën tjetër me tingullin e njëjtë. Studiuesit vunë re se bilingualët kishin më shumë aftësi në “filtrimin” e fjalëve konkurruese, sepse truri i tyre përdorej për të kontrolluar dy gjuhët, duke frenuar fjalët që nuk kishin lidhje me pamjen.

Duke iu referuar skanimeve të rezonancës magnetike, Marian u shpreh se truri i monolin gualëve kishte më shumë aktivitet në zonat kontrolluese të frenimit sesa ai i bilingualëve; atyre u duhej të mundoheshin më shumë për të kryer detyrën që iu caktua.

Studime të tjera sugjerojnë se trutë e efektshëm, kanë dobishmëri në jetën e përditshme. P.sh.: fëmijët bilingualë ishin më të aftë për të mos vënë shumë re zhurmën që bëhej në klasë, në krahasim me fëmijët të cilët flisnin një gjuhë të vetme.

“Kontrolli frenues është një tipar dallues i aftësisë kognitive,” - u shpreh Marian. “Qoftë duke i dhënë makinës, qoftë duke kryer një operacion kirurgjik, ajo

që vlen më shumë është përqendrimi në më të rëndësishmen dhe anashkalimi i asaj që është më pak e rëndësishme”.

Marian u shpreh gjithashtu se fakti që personat bilingualë e përdorin më shumë kontrollin e frenimit, mund të shpjegojë arsyen se pse bilingualizmi i ka të gjitha gjasat të ofrojë një avantazh mbrojtës kundër sëmundjes së Alzheimerit dhe demencias.




Figura 5. Marrë nga: (<http://cercor.oxfordjournals.org/content/early/2011/06/22/cercor.bhr161/F2.large.jpg>)

Vihet re aktivizim për: 1) emërtimin dhe leximin me zë të lartë, minus gjendjet semantike (analizimi 1) dhe 2) emërtimin dhe leximin me zë të lartë, minus artikulin “1,2,3” (analizimi 2). Intensiteti = $P < 0.001$; $k > 30$ kubikë. Pas një korrigjimi të bërë për krahasim të shumëfishtë përgjatë gjithë trurit ($P < 0.05$ gabim i korrigjuar), zonat që ishin aktivizuar gjatë emërtimit dhe leximit me zë të lartë më shumë sesa vendimet semantike për monolingualët dhe bilingualët, përfshinin: *giruset precentrale dhe postcentrale bilaterale, kortekset temporale superiore bilaterale, cerebelin bilateral dhe talamusin e majtë, dhe korteksin motorik shtesë*. Nga ana tjetër, zonat që ishin aktivizuar gjatë emërtimit dhe leximit me zë të lartë më shumë sesa artikulimi (monolingualë dhe bilingualë) përfshinin: *korteksin fuziformë anterior të majtë, anterior cingulat, premotor dorsal girusin, temporal superior të majtë, operkulumin frontal të majtë dhe cerebelin bilateral*.

(Autorë: Oivi Parker Jones, David W. Green, Alice Grogan, Christos Pliatsikas, Konstantinos Filippopolitis, Nilufa Ali, Hwee Ling Lee, Sue Ramsden, Karine Gazarian, Susan Prejawa, Mohamed L. Seghier and Cathy J. Price. Marrë nga: <http://cercor.oxfordjournals.org/>)

“Kjo është pjesa më interesante, - tha ajo, - përdorimi i një gjuhe tjetër i siguron trurit ushtrimet që ai vetë i ka të ruajtura në brendësi të tij. Nuk është e nevojshme të merresh me lojëra shkathësie, pasi truri është tashmë një “zhongler” që vazhdimisht luan me dy gjuhë. “Nuk është asnjëherë vonë për të mësuar një gjuhë tjetër. Përfitimet që ka mund t’i shihni qoftë edhe vetëm pas një periudhe të shkurtër studimi”.

2.14. Mosha optimale për mësimin e gjuhëve

Shpesh, në diskutimet e njerëzve dhe të prindërve ngrihet pyetja: “Cila është mosha optimale për të mësuar gjuhët e tjera?”

Siç e pamë edhe më lart, fëmijët, të cilët që në moshë të hershme mësojnë dy gjuhë njëkohësisht, përdornin atë pjesë të trurit, e cila do të funksiononte për një gjuhë, ndërkohë që të rriturve u duhet të hapin një zonë tjetër regjistrimi në trurin e tyre, dhe kjo, shpeshherë, duket e vështirë për ta.

Sipas linguistëve, për psikologët e zhvillimit dhe neurobiologët, në lidhje me mësimin e gjuhëve të huaja, vlen teza që vërteton se fëmijët në moshën parashkollore janë të aftë të mësojnë gjuhë të tjera pa ndonjë sforcim. Nga sa u përmend edhe më sipër, fëmijët mësojnë në mënyrë të natyrshme që në moshë të hershme, pa ndonjë vetëdije të veçantë se çfarë dhe cilën gjuhë po mësojnë.

Arti i mëimit të gjuhëve të reja nuk është diçka e detyrueshme për ta, por nëse prindërit dhe edukatorët apo kujdestarët, gjyshërit e fëmijës flasim me ta më shumë se një gjuhë, fakti që fëmijët janë të aftë të thithin dhe të imitojnë tingujt, të cilët përfaqësojnë një gjuhë të caktuar, i bën ata të aftë, pa ndonjë sforcim të veçantë, ta mësojnë, regjistrojnë dhe ta flasin atë gjuhë apo dy gjuhë në të njëjtën kohë, pa e pasur problem dhe pa ndonjë ndrojtje dhe nga ana gramatikore.

Ata janë më të saktë sesa të rriturit, të cilëve u duhet ta mësojnë gjuhën në një moshë të madhe, ku përveç fakteve të sipërpërmendura, si hapja e një hapësirë të veçantë në trurin e tyre, një faktor i cili e bën më të vështirë të folurin e gjuhës, është edhe ndrojtja apo hezitimi që të rriturit kanë duke qenë të vetëdijshëm se edhe mund të gabojnë apo t’i shqiptojnë gabim fjalët dhe të mos kuptohen nga bashkëfolësi i tyre. Këto hezitime bëjnë që ata të mos flasin dhe, rrjedhimisht, të mos e thellojnë gjuhën më tej.

Pra, mësimi i gjuhëve në moshë të hershme, siç e përmendëm edhe më lart, ka avan-

tazhe jo vetëm në zhvillimin dhe në aftësimin e fëmijës për të mësuar më vonë edhe gjuhë të tjera me më shumë lehtësi se ata të cilët mësojnë në moshë të madhe, por i bën fëmijët më të ndjeshëm ndaj kulturave të ndryshme. Zakonisht, këta fëmijë rezultojnë më tolerantë dhe më të mirëkuptueshëm në shoqërinë globale, sesa ata, të cilët janë rritur me një gjuhë apo nuk kanë dalë kurrë nga fshati, qyteti ose qyteza e tyre. Kështu mund të përmendim disa emra të shquar, të cilët në intervistat e tyre, kur janë pyetur për fëmijërinë apo prejardhjen, janë shprehur se kanë qenë me fat që prindërit e tyre u përkisnin shteteve të ndryshme dhe të cilët bashkë me gjuhët e reja, kanë sjellë me vete edhe kultura e zakone, të cilat ua kanë bërë atyre më të lehtë përshtatjen në shoqërinë e sotme globale.

Kur flasim për kuptimin e fjalës apo shqiptimin e saj, natyrisht kuptojmë që prindër, të cilët flasin dy gjuhë (dhe janë me prejardhje nga vende gjeografike të ndryshme) kur lindin fëmijë dhe u flasin atyre në të dyja gjuhët njëkohësisht apo gjyshërit nga të dyja palët, xhaxhallarët, dajat, tezet, hallat i flasin pa ndonjë sforcim gjuhët e tyre në ambiente ku këta fëmijë po rriten, kjo bën që këta të fundit ta perceptojnë po aq natyrshëm si gjuhën, ashtu dhe kulturën e sjelljen.

Edhe pse ka njerëz që mundohen t'u edukojnë fëmijëve të tyre dygjuhësinë, është e rëndësishme të kihet parasysh se nga studimet rezulton se një person duhet t'i paraqitet fëmijës me një gjuhë apo një gjuhë në një ambient ose kontekst të caktuar, duke qenë se pjesa e një personi një gjuhë ka qenë më e përhapur dhe respektivisht më e studiuar, nuk e përjashton tjetrën, e cila na tregon se nëse një gjuhë mësohet në një ambient apo vend të caktuar, gjithashtu, në moshë të hershme ka po aq vlerë sa e para. Dhe njëkohësisht prindërit duhet të flasin secili gjuhën e vet amtare. Një princip i tillë u ndoq edhe nga Maurice Gramond, në një nga letrat e tij në vitin 1908, pas lindjes së djalit të tij, ai rekomandon se prindërit duhet të flasin secili gjuhën e vet.

Në studimin tim vërej se përdorimi i këtij sistemi si më sipër, është shumë i efektshëm. Te fëmija S., e folura e prindërve në gjuhë të ndryshme, respektivisht shqip dhe gjermanisht, rezulton se nuk sjell ngatërresa, por në moshën 7-vjeçare, duke qenë se familja shkon në

Itali me pushime te disa miq, për një javë u vu re se fëmija S. jo vetëm që përdorte gjestikën e trupit, por filloi të fliste edhe me fjali të thjeshta në gjuhën italiane, një gjuhë të cilën më parë e kishte dëgjuar vetëm në mënyrë sporadike nga miq apo vizitorë, të cilët vinin për vizitë në shtëpinë e tij.

Në rastet e fëmijëve bilingualë, të cilët banojnë në të njëjtën zonë ose në një shtet të caktuar për një kohë të gjatë, shkojnë në kopsht apo në shkollë, në atë vend gjuha e vendit duket sikur bëhet më e fortë, si në rastin e fëmijës S. apo dhe në studimin e fëmijëve të tjerë, rezulton se gjuha e vendit ku ndiqet kopshti apo shkolla bëhet më e fortë. Megjithatë këtu këshillohet që familja të trajtojë më mënyrë sistematike dhe pa hezitim gjuhën tjetër, që në dukje duket më e zbehur.

Pra, është e rëndësishme që të dyja gjuhët të mbeten po aq të forta sa do të ishin edhe pa frekuentimin e një shkolle me një gjuhë të caktuar, sepse fëmija në mënyrë direkte dhe pa sforcim mëson si gjuhën e nënës, ashtu edhe atë të babait. Edhe në rastet kur fëmija duket sikur e ka më të dobësuar njëren gjuhë, është shumë e rëndësishme që prindërit, nëse duan që kjo gjuhë të ketë të njëjtën peshë te fëmijët dhe për t'i motivuar ata më shumë, të udhëtojnë në vendin e gjuhës “së dobët”, në mënyrë që kontakti me gjuhën, qoftë kjo gjuha e nënës apo e babait, të mbetet dhe të thellohet.

Një metodë e mirë do të ishte edhe grupimi apo miqësia me familje që kanë fëmijë të së njëjtës moshë dhe ku prindërit kanë të njëjtin profil. Pra, në pamundësi për të udhëtuar në shtetin përkatës të gjuhës së dobësuar, fëmija mund të luajë me bashkëmoshatarin, i cili flet të njëjtën gjuhë; kështu bëhet më e lehtë mirëmbajtja e saj dhe në të njëjtën kohë mirëmbahet jo vetëm gjuha, por edhe kultura e zakonet.

Në takimet e folësve bilingualë, por që flasin të njëjtën gjuhë, është vërejtur se njerëzit nuk përqendrohen në dialogun e tyre për të folur vetëm njëren gjuhë (atë që ata njohin dhe që i gjithë grupi njeh), por hidhen nga njëra gjuhë në tjetrën, pra e ndryshojnë atë si pas rastit. Ky ndryshim quhet *Codeswitching* dhe është një karakteristikë e veçantë për folësit bilingualë.

2.15. Parime bazë dhe ndikime në mësimin e gjuhës

Nëse fëmijës në mënyrë të pavarur i mësohen dy gjuhë, gjë e cila mund të ndodhë në mënyrë krejt të natyrshme apo të stimuluar, është mjaft e rëndësishme që të ruhen disa principe bazë, nëse duam që mësimi të rezultojë i suksesshëm. Zhvillimi gjuhësor te fëmija pasqyron një peshë të veçantë, si nga ana emocionale, ashtu edhe nga ana gjuhësore. Kështu, lidhja me prindërit bëhet edhe më e fortë dhe sigurisht, sa më e mirë të jetë marrëdhënia ndërmjet fëmijës dhe prindërit, aq më e dashur është gjuha respektive për fëmijën. Nëse fëmija nuk është gjithmonë aktiv në një gjuhë, atëherë mund të ndodhë që ai mund ta kuptojë atë gjuhë, por mund të mos të dojë ta flasë, dhe gjithmonë kjo është e lidhur me emocionin pozitiv apo negativ që i jep atij një gjuhë. Sipas Kielhöfer & Jonekeit prestigji social ka ndikim te dygjuhësia.

“Për funksionimin e dygjuhësisë, një rol të rëndësishëm zë edhe pranimi i kësaj gjuhe në rrethin social apo në shoqërinë ku ndodhet bilinguisti. Nëse njëra nga gjuhët do të kishte pranim më të madh në prestigjin social apo në grupin social, kjo do të ndikonte në një pozicionim negativ të dygjuhësisë dhe në një stepje për të përdorur gjuhën më pak të pranuar”. (Kielhöfer & Jonekeit, 1983:16, 23).

Shpesh te fëmijët, mësimi i gjuhës së dytë varet shumë edhe nga ndikimi që ka personi që e flet këtë gjuhë në rrethin apo në vendin ku ai po e mëson. Nëse personi ka një status të ulët në atë grup social, ashtu vlerësohet edhe gjuha—si e pavlerë. Kështu kjo ndikon te vlerësimi që fëmija do t'i bëjë më pas asaj gjuhe.

Pra, varet shumë nga prindërit apo kujdestarët që ndihmojnë fëmijën. Ata duhet që në moshë të hershme t'u mësojnë fëmijëve të vlerësojnë gjuhët apo kulturat, në mënyrë që të krijojnë një barazpeshë ndërmjet gjuhëve. Është shumë e rëndësishme që fëmijët gjuhën që duket më e dobët, të mund ta mësojnë edhe me persona të tretë, pra me persona, të cilët nuk janë anëtarë të familjes, si p.sh., me dado apo kujdestarë të fëmijës. E rëndësishme në këtë rast është që, duke respektuar moshën dhe zhvillimin e fëmijës, ata të përdorin për mësim materiale gjuhësore, si për shembull, libra me histori dhe figura, kaseta, video apo lojëra, të cilat shërbejnë që kjo gjuhë të forcohet më shumë, por jo duke anashkaluar gjuhën që tashmë është më e fortë se tjetra.

E rëndësishme është që fëmija të stimulohet që, përveç gjuhës që është e fortë, të mësojë

edhe gjuhën që është e dobët, jo vetëm për ta folur, por edhe ta lexojë dhe ta shkruajë atë. Këtë proces duhet ta mbështesin prindërit, në mënyrë që të lexuarit dhe të shkruarit ta ushtrojnë dhe ta praktikojnë me të. Siç e kemi përmendur edhe më lart, gjuha e dobët jo vetëm duhet stimuluar, por duhen bërë udhëtime në shtetin e gjuhës, të cilat i mundësojnë fëmijës jo vetëm kontaktin me gjuhën, por, në aspektin emocional, edhe kulturën apo çdo gjë tjetër që është e lidhur me të bërën sa më të dashur atë gjuhë (Cunningham Andersson, 2004:76).

2.16. Ndryshimi i kodit (Codeswitching) si një tregues i veçantë për dygjuhësinë

U përmend edhe më lart që, nëse ti takon njerëz që janë dygjuhësh, ata shpesh, në rrethe të njëjta sociale apo grupime të njëjta, përdorin ndryshimin e gjuhëve sipas rastit dhe pa ndonjë vështirësi të veçantë. Në lidhje me fenomenin “bilinguizëm”, përkrah *Codeswitching*, ata i shoqërojnë edhe dukuri të tjera, për shembull, Hamers & Blanc rreshtojnë si një tjetër tregues *Codemixing* (Hamers & Blanc, 2000:58).

Deri në vitin 1970, *Codeswitching* apo *Codemixing* u panë si gabime gramatikore apo gabime në formimin e fjalisë. Më vonë, këta dy faktorë u trajtuan si nga studime empirike, ashtu edhe nga ana teorike, dhe më pas u pranuan si fenomene, të cilat ndodhin kur ke të bësh me persona dygjuhësh (Hamers & Black, 2000:258).

2.17. Mësimi i gjuhës së dytë⁷

Mësimi një gjuhe të dytë (MGJD) është procesi me anë të të cilit personat mësojnë një gjuhë të ndryshme nga gjuha e nënës. Gjithashtu, mësimi i një gjuhe të dytë konsiderohet si disiplina shkencore që i përkushtohet studimit të atij procesi. Fusha e të mësuarit të një gjuhe të dytë është një nëndisiplinë e linguistikës së zbatuar, por të cilës i kushtohet një vëmendje edhe nga një llojshmëri disiplinash të tjera, të tilla si psikologjia dhe arsimi. Një temë kryesore në studimet e MGJD është ajo e ndërgjuhësisë, pra, ideja se gjuha që përdoret prej atyre që e mësojnë nuk është thjesht rezultati i ndryshimeve ndërmjet gjuhëve që ata tashmë dinë dhe ndërmjet ndryshimit të gjuhës që po mësojnë, por që në vetvete

7 Mitchell, R. and Myles, F. 1998. Second Language Learning Theories. London: Arnold.

është një sistem gjuhësor i plotë, në të gjitha rregullat e tij sistematike. Ndërkohë që individët po mësojnë një gjuhë specifike, kjo e fundit zhvillohet gradualisht kur ata bien në kontakt me të. Rendi me të cilin nxënësit i fitojnë tiparet e gjuhës së re që po mësojnë, qëndron konstant në mënyrë të dukshme, madje edhe për nxënës me gjuhë të ndryshme amtare, pavarësisht se ata kanë marrë ose jo udhëzime. Sidoqoftë, gjuha që nxënësit dinë tashmë, mund të ketë një ndikim domethënës në procesin e të mësuarit të një gjuhe të re. Ky ndikim njihet si transferimi i gjuhës.

Faktori kryesor që shërben si motor për mësimin e një gjuhe të re është informacioni që marrin nxënësit e asaj gjuhe. Sa më shumë që ata janë të “zhytur” në gjuhën që po mësojnë dhe sa më shumë kohë që ata kalojnë duke lexuar literaturë, aq më shumë ata përparojnë në atë gjuhë. Modeli monitorues shkon deri atje sa të pohojë që informacioni është gjithçka që duhet për të mësuar gjuhën. Megjithatë, puna pasuese e tillë si hipoteza ndërvepruese dhe hipoteza e rezultatit kuptimor, ka sugjeruar që mundësitë për rezultate dhe për ndërveprime mund të jenë të nevojshme për nxënësit, në mënyrë që ata të arrijnë nivele më të përparuara.

Kërkimet në mënyrën e saktë se si nxënësit e mësojnë një gjuhë të re, zgjerohen në një numër fushash të ndryshme. Qasjet kognitive për studimet mbi MGJD merren me proceset e trurit, procese të cilat formojnë bazat për mësimin e një gjuhe, për shembull, si ndikon vëmendja ndaj gjuhës në aftësinë për ta mësuar atë ose lidhja që ka mësimi i gjuhës me kujtesën afatshkurtër dhe afatgjatë. Qasjet social-kulturore nuk e pranojnë nocionin që mësimi i një gjuhe duket sheshit që është një fenomen psikologjik dhe kështu bëhet për pjekja për ta shpjeguar atë në kontekstin social. Qasjet linguistike e konsiderojnë gjuhën të ndarë nga llojet e tjera të njohurive, dhe bëhen përpjekje për të përdorur konkluzione nga studimet më të gjera rreth linguistikës. Por ka gjithashtu edhe një numër të konsiderueshëm studimesh, të cilat shprehin se si mësimi i gjuhës së dytë mund të ndikohet nga faktorë individualë, të tillë si mosha dhe strategjitë e përdorura për mësimin e asaj gjuhe. Së fundi, studimet në klasë merren me efektin që ka udhëzimi i gjuhës në mësimin e saj

Të kuptojmë bilingualizmin dhe çrregullimin gjuhësor.⁸

Shkallët në të cilat zhvillohet një fëmijë janë të ndryshme dhe aq më shumë kur ata janë në moshë më të vogël. Prandaj, shkalla e asaj që quhet si zhvillimi tipik, është shumë e madhe. Pavarësisht kësaj, është e rëndësishme të dihet se deri në ç’pikë duhet të ndërmerren hapa dhe të tregohet kujdes shtesë për të ndihmuar një fëmijë, gjuha e të cilit është e prapambetur. Me gjithë respektin që kam për të gjithë ata fëmijë, të cilët flasin më shumë se një gjuhë, ka shumë njerëz të cilët e kanë të vështirë të vendosin për faktin se ka arsye për t’u shqetësuar, kur një fëmijë duket se flet më pak anglisht se fëmijët e tjerë. Qëllimi i këtij artikulli është për të ndihmuar profesionistët e fushës në procesin e marrjes së këtij vendimi, si dhe të ndërmarrin hapa mbështetës.

Bilinguizmi nuk shkakton vonesë në përdorimin e gjuhës

Ka shumë gjasa që pothuajse 10% e fëmijëve priten të kenë vështirësi me zhvillimin e gjuhës. Kjo vlen si për fëmijët bilingual, ashtu edhe për ata monolingualë. Arsyet e këtyre vështirësive janë të larmishme dhe komplekse, por bilinguizmi nuk është njëri prej tyre. Bilinguizmi nuk është një barrë për fëmijët dhe nuk është diçka pështjelluese për ta. Në fakt, të gjitha dëshmitë që kemi deri në ditët e sotme, tregojnë se bilinguizmi, në rastin më të mirë sjell avantazhe kognitive dhe në rastin më të keq nuk sjell asnjë ndryshim të monolingualët kur bëhet fjalë për një shkallë të gjerë të testimeve që kanë të bëjnë me inteligjencën. Në testimet për gjuhën, fëmijët tipikë bilingual shfaqin një performancë që është brenda shkallës së tyre normale në të paktën njërin prej gjuhëve të tyre.

Sigurisht që fëmijët mund të mos kenë patur aq shumë kontakt me gjuhën angleze, sa për të qenë në nivelin që presim prej moshës së tyre. Por me informacionin e duhur që mbështet zhvillimin e gjuhës dhe nëse nuk ka vështirësi të pashfaqura të zhvillimit të saj, kjo gjë do të rregullohet vetë në kohën e duhur. Të qenët një nxënës i një gjuhe të dytë dhe të pasurit e një çrregullimi gjuhësor, janë dy gjëra të ndryshme.

Si mund të identifikojmë një çrregullim të foluri tek fëmijët bilingual

Nëse një fëmijë shfaq një çrregullim gjuhësor, kjo do të duket në gjuhën e tij/saj që për-

8 Nga Dr. Susanne Döpke, maj 2006 (<http://www.bilingualoptions.com.au/consTXTDelay.pdf>)

dor më shumë. Këtu është e rëndësishme të kuptohet se cilën gjuhë përdor më shumë fëmija. Shpesh supozohet fakti që vetëm për shkak se prindërit nuk vijnë nga një vend anglishtfolës, fëmijët do të flasin atë gjuhë që flasin edhe prindërit e tij/saj. Është shumë e rëndësishme që të mos krijohen supozime, por të bëhen kërkime në lidhje me këtë.

Në shumicën e rasteve, prindërit janë burimi më i mirë i informacionit rreth aftësisë së fëmijës së tyre për të përdorur gjuhën në shtëpi. Por për një numër arsyesh – shumë prej tyre kulturore – pritshmëritë e prindërve për fëmijët e tyre rreth asaj që fëmijët e tyre duhet të jenë në gjendje të bëjnë dhe të thonë, mund të jenë të ndryshme nga pritshmëritë e mësuesve dhe profesionistëve të tjerë të arsimit.

Prindërit, gjithashtu, mund të hasin vështirësi në diferencimin ndërmjet sjelljes së duhur së fëmijës në një situatë rutinë në shtëpi dhe në të kuptuarit e fëmijës rreth asaj që i është thënë ose shpjeguar më parë. Papajtueshmëria rreth asaj që është thënë shihet zakonisht nga prindërit si mungesë dëshirë për të bashkëpunuar nga ana e fëmijës, në vend të faktit që fëmija nuk e ka kuptuar atë që i është komunikuar. Shumica e prindërve që rrisin një fëmijë si bilingual kanë eksperiencë të kufizuar, pra vetëm me fëmijët e tyre. Ata nuk kanë qenë pjesë e trajnimeve rreth prindërimit bilingual dhe, rrjedhimisht, nuk ka vend për të gjykuar aftësinë e tyre për t'u mësuar në mënyrën më të mirë fëmijëve të tyre dy gjuhë njëkohësisht. Në shumë vende ka konsulentë specifikisht për bilinguizmin dhe mënyrën se si prindërit duhet të mësojnë fëmijën e tyre të flas dy gjuhë njëkohësisht.

Vëzhgimet dhe studimet rreth ndërveprimit të fëmijës me prindërit do të sillnin disa tregues shumë të rëndësishëm rreth aftësisë së fëmijëve gjithashtu. Nëse fëmija dhe prindërit komunikojnë për një kohë të caktuar dhe më pas fëmija është i aftë të merr drejtimin e bisedës, kjo është një tregues i rëndësishëm dhe një shenjë që mënyra e komunikimit në shtëpi është e mirë dhe në rrugën e duhur për zhvillimin e mëtejshëm gjuhësor të fëmijës. Mund të pyetet prindi rreth asaj që fëmija ka thënë së fundmi ose të inkurajohen në terma të përgjithshëm rreth temave për të cilat fëmija duhet të flasë më shumë. Për të ndihmuar fëmijën në zhvillimin e mëtejshëm të komunikimit rekomandohen të bëhen pyetje, të tregojë rreth diçkaje që ka ndodhur, të organizojë lojëra të supozuara, të bëjë plane edhe në nivelin abstrakt, të

parashikojë një ngjarje që mund të ndodh dhe gjëra të tjera të ngjashme.

Një fëmijë mund të ketë çrregullime të të folurit kur ndonjë nga kushtet e mëposhtme është i pranishëm:

1. Prindërit janë të shqetësuar rreth zhvillimit të të folurit të fëmijës.
2. Fëmija nuk është i aftë të kuptojë fjalë që janë tipike pjesë e fjalorit familjar të fëmijës dhe që bashkëmoshatarët i kuptojnë me lehtësi edhe pse mund të kenë marrë ndihmë nga profesionistë që punojnë në fushën e logopedisë.
3. Fëmija nuk arrin të ndjekë udhëzime dhe instruksione komplekse që janë për moshën e fëmijës, të paktën për njërën nga gjuhët që po mëson.
4. Fëmija nuk është i aftë të thotë dhe të mësojë fjalë të cilat janë të zakonshme për të folurën e fëmijëve në të njëjtën moshë. Kjo përfshin mungesën e aftësisë për të mbajtur mend artikullimin korrekt të fjalës dhe mungesën e aftësisë për të mësuar fjalë të reja, pavarësisht ndihmës që i është dhënë nga profesionistët e fushës.
5. Fëmija shfaq probleme sociale dhe të sjelljes që janë të lidhura me mungesën e zhvillimit gjuhësor ose mënyra e komunikimit të fëmijës është shumë ndryshe dhe shumë herë e pakuptueshme nga ajo e bashkëmoshatarëve me prejardhje kulturore të ngjashme.
6. Fëmija shfaq vonesa, gjithashtu, edhe në fusha të tjera të zhvillimit, p.sh., zhvillimi i motorikës fine dhe asaj globale, aftësia për të imituar, kujdesi vetjak etj .

Duhet bërë kujdes që mos të dilet me përfundime të pabaza dhe të nxituara, duke gjykuar aftësinë e një fëmije për të mësuar dy gjuhë njëkohësisht, por mungesa e aftësisë për të mësuar fjalë dhe fraza të reja në kushte optimale është një tregues i rëndësishëm, i cili dëshmon se diçka nuk po shkon mirë dhe se fëmija mund të ketë probleme të të folurit. Studimet tregojnë se ka shumë raste që prindërit e neglizhojnë ose i fshehin problemet e të folurit të fëmijës dhe kjo, rrjedhimisht, vetëm e dëmton fëmijën.

Nëse dyshohet se fëmija ka vështirësi në të mësuar anglisht, për shkak të një vonese gjuhësore, e cila është e dukshme edhe në gjuhën që fëmija flet në shtëpinë e tij/saj, ndalimi i të folurit të gjuhës që flitet në shtëpi nuk ka për ta përmirësuar aftësinë e të folurit të gjuhës tjetër (në rastin tonë, të anglishtes). Kur bëhet fjalë për gjuhën, nuk bëhet fjalë për

çështjen “sa më shumë, aq më mirë”, por “sa më e pasuruar gjuha, aq më mirë”. Prindërit, të cilët nuk janë shumë kompetentë në gjuhën angleze ose janë të lidhur ngushtë me gjuhën e tyre të fëmijërisë më shumë sesa me anglishten, ka shumë mundësi që të flasin më pak anglisht kur u kërkohet që të flasin vetëm anglisht. Në të vërtetë, ata nuk kanë për ta ndjekur këtë këshillë gjatë gjithë kohës dhe mund të vënë në efekt përzierjen dhe ndryshimin aty për aty të gjuhëve (*switching and mixing*). Gjithashtu, ata mund të mos jenë të sinqertë më në raportimin e tyre, gjë e cila do ta vështirësonte akoma më shumë vlerësimin e aftësive të vërteta gjuhësore të fëmijës. Vendimi për të përdorur vetëm gjuhën angleze në shtëpi, ka gjithashtu edhe pasojat e veta në mirëmbajtjen e gjuhës tjetër për fëmijët e tjerë dhe për kohezionin në familje në përgjithësi, fakt i cili duhet të merret në konsideratë nga profesionistët e fushës si dhe bashkëpunimi i prindërve gjatë dhënies së këshillimit për ta.

Ndërkohë që familja eksperimenton vetëm me të folurën anglisht në shtëpi, fëmija i cili në të vërtetë ka çrregullime gjuhësore, thjesht do të ngelet mbrapa. Ndërprerja e gjuhës që flitet në familje nuk është një masë riparuese për fëmijët me vështirësi në zhvillimin e gjuhës dhe për më tepër nuk ka dëshmi të rezultuara nga studimet, të cilat mund ta mbështesin këtë gjë. Por ekzistojnë dëshmi nga studimet, që tregojnë se kjo gjë nuk funksionon.

Përfundimi

Është shumë e rëndësishme të vlerësosh çdo herë familjen dhe nevojat e pjesëtarëve të saj. Kjo përfshin gjithashtu respektimin e gjuhës që ata kanë zgjedhur të flasin në shtëpi. Bilingualizmi nuk shkakton asnjë lloj çrregullimi gjuhësor, dhe të vendosurit për të përdorur vetëm një gjuhë në shtëpi, nuk bëhet shkak për një çrregullim gjuhësor.

2.18. Dygjuhësia: sa personalitete dhe yje të kinemasë e muzikës e kanë pasur këtë favor?

Më poshtë do të renditen disa të dhëna dhe fakte se si personazhe të famshëm të artit dhe kinematografisë kanë pasur favorin dhe privilegjin të jenë fëmijë bilingualë.

Barack Hussein Obama u lind më 4 gusht të vitit 1961 në Honolulu, Hawai. Babain e kishte me origjinë nga Alego, Kenia, ndërsa nëna ishte amerikane nga Wichita, Kansas.

Sandra Annette Bullock u lind në Arlington, Virxhinia. Babai i saj ishte nga Birmingami, Alabama, kurse e ëma ishte nga Gjermania.

Jessica Alba nëna e saj është me origjinë daneze dhe franceze, kurse babai është njëqind përqind meksikan. Ajo e konsideron avantazh këtë përzierje shumetnike:

“Të qenët e lindur në një përzierje kulturash, të ndihmon të përshtatesh menjëherë në çdo ambient. Nuk jam as hispanike dhe as e bardhë njëqind për qind. Jam pak nga njëra e pak nga tjetra, dhe për këtë nuk qahem. Si fëmijë, kam frekuentuar një shkollë dygjuhëshe, angleze dhe spanjolle. U jam falënderuese prindërve, të cilët këmbëngulën në vendimin e tyre.”

Shakira Isabel Mebarak Ripoll. Babai i këngëtares Shakira, don William Mebarak Chaidid, u lind në NjuJork dhe ka prejardhje libaneze. Mamaja e saj, Nidia Carmen Ripoll Tirrado, është kolumbiane me prejardhje spanjolle dhe italiane.

Christina María Aguilera u lind në Staten Island, NjuJork, dhe ka jetuar në Manhatan, ku edhe është rritur. Babai i saj ishte ekuadorian, kurse e ëma ishte me prejardhje amerikane, gjermane, irlandeze, uellsiane dhe holandeze.

Mario Gómez u lind më 1985 në Riedlingen, ai është biri i një nëne gjermane dhe i një babai spanjoll. Aktualisht, futbollisti luan me Gjermaninë.

Gjergj Leka, kantautor shumë i njohur shqiptar. Babai i tij ishte Kostandin Leka, i lindur në Trieste, Itali; shkrimtar fantastiko-shkencor, specialist i foto-kinematografisë dhe sistemeve multimediale-audiovizive, fizikan, si dhe krijues në radio dhe televizion. Gjergj Leka u lind në Trieste të Italisë nga një nënë italiane (triestine) dhe baba shqiptar nga Durrësi, për shkak se familja e babait të tij kishte emigruar në Trieste për arsye ekonomike.

Inva Mula, lindur në Tiranë në vitin 1963, është një këngëtare soprano shqiptare me famë ndërkombëtare. Babai i Invës, Avni Mula, është shqiptar dhe nëna e saj është ruse. Inva u rrit si një fëmijë bilingual.

Timo Flloko lindi në Pejë më 26 prill 1948 dhe pa mëdyshje mund të quhet një yll i kinematografisë shqiptare. Ai është nga të paktët aktorë shqiptarë të cilët karrierën e tyre ia kanë kushtuar ekskluzivisht filmit. Hyri në kinema shumë i ri, kur ishte vetëm 19 vjeç. Timo është rritur si një fëmijë bilingual dhe gjatë karrierës e jetës së tij ka mësuar edhe gjuhë të tjera të huaja. Ai është gjithashtu një nga pedagogët më të respektuar të Akademisë së Arteve. Prej disa vitesh ka zgjedhur të jetojë duke ndarë kohën e tij mes

Amerikës dhe Shqipërisë. Gjatë qëndrimit të tij prej 7 vitesh në Amerikë, ai arriti të hyjë edhe në botën e Hollivudit, ku pati mundësinë të luante në disa filma. Pas kthimit nga Amerika, ai u kthye në Tiranë dhe tani punon si pedagog në Akademinë e Arteve në degën e aktrimit dhe regjizurës.

2.19. Fëmijët janë e ardhmja

Ashtu siç është shprehur edhe komisioneri Ján Figel' (përgjegjës për edukimin, trajnimin, kulturën dhe multilingualizmin): “Sot, brezi i ri do të japë shumë kontribut në pasurimin e shoqërisë multilinguale të Evropës”

Në bazë të një studimi të bërë nga komuniteti Evropian për gjuhët në Evropë, janë analizuar perceptimet e evropianëve për fëmijët si nxënës të gjuhëve dhe veçanërisht koha se kur fëmijët duhet të fillojnë mësimin e gjuhës dhe pse është parë si e rëndësishme që fëmijët të dinë gjuhë të huaja.

2.19.1 Të filluarit që në moshë të vogël

Sot, shumica e evropianëve besojnë se mosha më e mirë për të filluar mësimin e një gjuhe tjetër përveç gjuhës amtare, është mosha nga 6 e sipër; me fjalë të tjera, që në shkollën fillore. Grupmosha 6-12 vjeç marrin mbështetjen më të gjerë kur konsiderohet gjuha e huaj e parë (55%) dhe gjuha e huaj e dytë (64%).

Në përputhje me idenë e të filluarit që në moshë të vogël, 39% e qytetarëve evropianë pranojnë idenë e të mësuarit e një gjuhe për fëmijët nga 0 deri 5 vjeç, kur bëhet fjalë për gjuhën e parë të huaj që është për t'u mësuar. Ndërsa për gjuhën e dytë të huaj, numri i qytetarëve evropianë të cilët pranojnë idenë e të mësuarit e një gjuhe për fëmijët nga 0 deri 5 vjeç, është shumë më i vogël, rreth 17%. Nga ana tjetër, afërsisht nga 1 deri në 10 (11%) qytetarë mendojnë se gjuha e dytë e huaj duhet të mësohet vetëm pas moshës 12 vjeç.

Rezultatet, në bazë të vendit variojnë në mënyrë të konsiderueshme. Për gjuhën e parë të huaj, në Mbretërinë e Bashkuar (56%), Spanjë (56%) dhe Maltë (54%), shumica e qytetarëve janë me idenë e mësimit të një gjuhe tjetër që në moshë të vogël, pra, përpara moshës 6-vjeçare. Në pjesën tjetër të vendeve të anketuara (Greqi (92%) dhe Qipro

(90%), pjesa më e madhe e personave të pyetur mendojnë se moshë më e mirë për të filluar mësimin e gjuhëve të huaja është nga 6 e sipër.

Kur bëhet fjalë për mësimin e gjuhës së dytë të huaj, pjesa më e madhe e personave të pyetur në çdo vend, mendojnë se fëmijët nuk duhet të fillojnë ta mësojnë përpara moshës 6-vjeçare. Këtë pikëpamje kanë edhe 79% e personave të anketuar në Luksemburg, 78% e qytetarëve në Danimarkë; në Republikën Çeke, në Estoni dhe në Lituani. Pra, mbështetja më e madhe e idesë që një fëmijë duhet të fillojë mësimin e një gjuhe të dytë të huaj që në moshë të vogël (ndërmjet moshës nga 0 deri në 5 vjeç), gjendet në Spanjë (39%) dhe në Mbretërinë e Bashkuar (33%).

2.20. Lehtësimi i procesit të mësimin të gjuhëve – Në kërkim të praktikave më të mira

Një nga hapat që ndihmojnë arritjen e objektivit në kuadrin e strategjisë për shumëgjuhësi, pra, identifikimin e praktikave më të mira në nxënien dhe mësimin e gjuhëve, është gjetja e mënyrave të të mësuarit, të cilat qytetarët evropianë i perceptojnë si mënyrat më të efektshme dhe më të përshtatshme.

Shumica e evropianëve i mësojnë gjuhët në shkollë. 65% e qytetarëve evropianë tregojnë se mësimi i gjuhëve të huaja në shkollë është një nga mënyrat që ata kanë përdorur për t'i mësuar, në ndryshim nga 22% e tyre, të cilët janë shprehur se gjuhët i kanë mësuar me anë të një mësuesi privat. Ndërsa pjesa tjetër, 16% dhe 15% e personave, shprehen për mësimin e gjuhëve të huaja në rrethanat e jetës së përditshme, qoftë duke pasur komunikim me një folës të asaj gjuhe apo të qenët në vendin ku flitet ajo gjuhë.

2.20.1 Arsye se pse të rinjtë duhet të mësojnë gjuhë të huaja

Një pjesë e madhe e qytetarëve evropianë mendojnë se arsyeja që të rinjtë duhet të mësojnë gjuhë të huaj është për të rritur mundësitë e punësimit (73%). 38% e qytetarëve mendojnë se mësimi i një gjuhe tjetër të huaj është faktor i mirë, për shkak se ajo gjuhë flitet gjerësisht në botë, ndërsa 30% shprehen se mësimi i gjuhës së huaj është avantazh kur shkohet me pushime jashtë vendit. Dhe për t'i shtuar kësaj liste, ka edhe mendime të tjera të përgjithshme nga qytetarë të ndryshëm (28%), të cilët shprehen se mësimi i

gjuhëve të huaj është avantazh për të qenë një person shumëgjuhësh ose që ajo gjuhë e huaj është mirë të mësohet, për aq kohë sa përdoret brenda për brenda Evropës (28%).

Në çdo vend ku u krye anketimi, pjesa më e madhe merr në konsideratë mendimin e mundësive më të mira të punësimit, ku kjo e fundit është arsyeja kryesore se pse të rinjtë duhet ta kenë me përparësi mësimin e një gjuhe të huaj. I tillë është rasti i vendeve si Greqia (92%), Danimarka (84%) dhe Qipro (83%), ku edhe pse në fund të kësaj liste, 55% e qytetarëve të Mbretërisë së Bashkuar ishin dakord me të njëjtin mendim. Ndërsa për vendet e tjera (15) faktori i dytë motivues për mësimin e një gjuhe të dytë të huaj është fakti se ajo gjuhë flitet më gjerësisht në botë.

Vënia e theksit tek avantazhet e punësimit është mjaft i dukshëm dhe ky trend u vu re kur të anketuarit u pyetën që të rendisnin arsyet që do t'i nxisnin ata për të mësuar gjuhë të huaja. Si përfundim, mund të thuhet se në ditët e sotme, kompetencat në përdorimin e një gjuhe të huaj shihen shpesh si mjete për përfitimin e një punësimi më të mirë.

Kjo përputhje mendimesh shfaqet gjithashtu edhe mes grupeve social-demografike. Të gjitha kategoritë (ku këtu bëjnë pjesë persona pensionistë 68% dhe 78% nga ata që kanë lindur në Evropë, por që vendi i tyre është jashtë BE) preferojnë alternativën që të rinjtë duhet të mësojnë një gjuhë të huaj për të rritur mundësitë e tyre në tregun e punës.

Duke pasur parasysh profilin e një “evropiani shumëgjuhësh”, kur bëhet fjalë për mundësitë e punësimit, aftësitë gjuhësore janë parë si një avantazh shumë i madh tek të rinjtë që kanë një prejardhje multikulturore, të cilët janë nxënës aktivë të mësimin të gjuhëve të huaja dhe të cilët janë zotërues të disa gjuhëve.

KAPITULLI III: METODOLOGJIA

Në këtë kapitull të studimit do të përshkruhen pjesëmarrësit, instrumentet dhe procedura e studimit.

Në këtë studim do të përdoret një gërshetim i metodave sasiore dhe metodave cilësore. Metodatat do të përdoren njëkohësisht për mbledhjen e të dhënave të studimit, por nuk kanë status të njëjtë. Metodatat cilësore kanë një peshë më të madhe në studim. Të dhënat që do të gjenerohen nga intervistat me personat bilingual që kanë jetuar në Shqipëri edhe përpara viteve 90-të kanë një peshë më të madhe në studim se të dhënat sasiore të gjeneruara nga pyetësorët. Gërshetimi i të dyja metodologjive eksploron problemin ose fenomenin më hollësisht (Harmensley, 1996).

Kërkimi cilësor ka si qëllim të përshkruajë dukuri dhe sjellje sociale nëpërmjet të dhënave kontekstuale të larmishme. Ndryshe nga kërkimi sasior, numërimi nuk është objektiv i tij. Kërkimi cilësor përpiket të eksplorojë dhe shpjegojë botën nëpërmjet përvojave të aktorëve socialë (Mays & Pope, 1995) dhe duke nxjerrë në dritë të dhëna që nuk janë shumë lehtë të aksesueshme nga kërkimi sasior. Vlera e një perspektive të tillë ka rritur nivelin e pranueshmërisë dhe përkrahjes edhe në kërkimin që lidhet me shëndetin dhe sjelljen sociale (Pope & Mays, 1995; Day, 2001; Malterud, 2001). Sipas Corbin dhe Strauss (2008), të bësh kërkim cilësor do të thotë ta shohësh botën me sytë e pjesëmarrësve, të arrish një kuptim të thelluar të fenomenit nga perspektiva e njerëzve. Sipas Nurani (2008), kur aplikohet kërkimi cilësor, kërkuesi interpreton popullatën ose fenomenin që ka nën vëzhgim, duke përdorur zërat e pjesëmarrësve në studim. Wiersma (1986) theksonte se nëpërmjet kërkimit cilësor, kërkuesi mund të arrijë njerëzit dhe të ndërveprojë me ata, të shikojë sesi sillen ata dhe të mësojë se cilat janë shqetësimet, pikëpamjet dhe përjetimet e tyre.

Kërkimi cilësor është bërë një mjet shumë i dobishëm, nëpërmjet të cilit nxirren në pah përvojat e njerëzve që pësojnë ndryshime në kontekstin e zhvillimit (Tinker, 1990). Kërkimi cilësor është i efektshëm në sigurimin e informacioneve specifike, që kanë të

bëjnë me vlerat sociale, opinionet, besimet, qëndrimet dhe emocionet e një popullate të veçantë.

Është e rëndësishme të theksohet se thelbi i kërkimit cilësor bazohet në atë që është natyrore, duke studiuar personat e vërtetë në mjediset natyrore sesa në izolim artificial (Marshall, 1996). Kërkimi cilësor i ka bazat në një pozicion filozofik, që është gjerësisht “interpretues”, në kuptimin që përqendrohet në atë sesi është interpretuar, kuptuar, përjetuar ose krijuar bota sociale (Beauchamp & Childress, 1985). Në këtë kontekst, duke pasur parasysh qëllimin e studimit, janë përdorur analiza dytësore e të dhënave dhe metoda cilësore e mbledhjes së të dhënave nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuar.

Së pari, me anë të metodave sasiore synohen të mblidhen të dhëna për personat bilingual dhe monolingual në Shqipëri.

Në këtë studim, si pjesë e metodave për mbledhjen e të dhënave janë përdorur edhe intervistat e strukturuar. Si veçori e intervistës së strukturuar, Mayeri përcakton se pyetësi me pyetjet e tij të hapura shërben edhe si bazë për intervistën. Duke përdorur pyetësin në mënyrë konsekuente rritet nga njëra anë krahasueshmëria e të dhënave, dhe nga ana tjetër vetë i intervistuari mund t’u përgjigjet lirshëm pyetjeve. Pyetësi shërben edhe si skelet për të mos anashkaluar pyetjet thelbësore kërkimore të çështjes.

Pasi janë gjeneruar të dhënat sasiore, metodat cilësore synojnë të eksplorojnë në detaje çështjet e bilinguizmit dhe më konkretisht mënyrën se si janë rritur dhe çfarë ndikimi ka patur bilinguizmi tek personat e rritur me dy gjuhë.

Metodologjia e përdorur i përshtatet secilit prej objektivave të vendosura në këtë studim. Analiza është bërë sipas modelit “gjashtë shkallësh” të Mayer. Përgjigjet për secilën tematikë janë nënvizuar në tekstin e intervistës. Më pas janë nxjerrë prej tyre informacionet e veçanta që lidhen me temën e studimit, në mënyrë që të mos zgjateshim në gjëra dytësore. Pyetësoret janë analizuar dhe paraqitur në skema dhe tabela, për ta nxjerrë përfundimin edhe të pasqyruar vizualisht. Një teknikë tjetër e përdorur si pjesë e metodologjisë është dhe analizimi i literaturës. Duhet theksuar se në Shqipëri mungojnë studimet përsa i përket bilinguizmit. Rrjedhimisht, janë analizuar dhe shqyrtuar gjetjet të studimeve të realizuar

në Evropë dhe Amerikë. Gjetjet e këtij studimi më pas janë ballafaquar me gjetje të studimeve në vende të tjera dhe janë nxjerrë konkluzione dhe rekomandime për studime të tjera në fushën e bilinguizmit.

3.1. Historiku i kërkimit, përshkrimi i fazave të kërkimit

Kërkimi filloi me përzgjedhjen e fushës së studimit në fillim të vitit 2012 dhe përfundoi me paraqitjen shkrimore të tij në vitin 2016.

Kërkuesja është vetë nënë e dy fëmijëve bilingual. Gjithashtu, rrethi miqësor dhe shoqëror i saj e ka bërë që të ketë përvojë me fëmijët dhe të rriturit bilingual. Eksperiencat e mëparshme si dhe realizimi i mikrotezës në nivel master lidhur me bilinguizmin e fëmijëve, ka ndihmuar kërkuesen që të hulumtojë në thellësi dhe të eksplorojë bilinguizmin dhe avantazhet e tij në shoqërinë e sotme globale.

Faza e parë e kërkimit u fokusua në rishikimin e literaturës. Në këtë fazë kërkuesja u përqendrua në gjetjen e kërkimeve të ngjashme, për të shmangur përsëritjen dhe për t'u njohur me gjetjet dhe kornizat teorike të studimeve ekzistuese. Rishikimi i literaturës ka shërbyer edhe si një kornizë për të krahasuar rezultatet e kërkimit me ato të kërkimeve të tjera.

Në fazën e dytë, studiuesja ka diskutuar me profesionistë të fushës së psikologjisë bren-
da dhe jashtë vendit, për të riorientuar qëllimin dhe objektivat e studimit, si dhe për të specifikuar pyetjet kërkimore të tij.

Gjatë fazës së tretë të kërkimit studiuesja është ndalur në përcaktimin e metodave të kërkimit, instrumentave të kërkimit dhe popullatës që do të përfshihet në kërkim. Ajo ka analizuar me kujdes informacionin e mbledhur në fazën e parë dhe të dytë, duke u bazuar në qëllimin e kërkimit dhe nga pyetjet kërkimore të ngritura në fillim të studimit. Bazuar në pyetjet kërkimore është përzgjedhur metoda e rishikimit të literaturës përmes analizës së të dhënave dytësore, si dhe metoda cilësore përmes intervistave gjysmë të strukturuar.

Në fazën e katërt janë realizuar pyetësorët e strukturuar me personat bilingual, si dhe intervistat gjysmë të strukturuar; dhe më pas është kaluar në transkriptimin të dhënave të mbledhura, kodimin dhe analizimin e tyre.

3.2. Pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit e studimit janë 128 persona shqiptarë, të cilët kanë një prind shqiptar dhe një të huaj, me kombësi tjetër të papërcaktuar paraprakisht. Gjithashtu dhe persona që janë pjesë e pakicave kombëtare në Shqipëri. Këta persona janë rritur me dy gjuhë. Tetë prej këtyre personave bilingual janë intervistuar si një model i arritjeve dhe suksesit në Shqipëri. Arritjet dhe suksesi i tyre njihet gjerësisht nga publiku në Shqipëri. Pasi janë kontaktuar dhe është marrë miratimi i tyre, janë realizuar pyetësorët, duke ruajtur absolutisht konfidencialitetin dhe respektuar etikën mbi të cilën mbështetet puna kërkimore. Për të eksploruar më tej perceptimin e bilinguizmit dhe korrelacionin e tij me arritjet pozitive në jetë, pjesë e studimit janë bërë 120 persona monolingual, pra të lindur nga dy prindër me kombësi shqiptare.

3.2.1. Kampionimi i personave bilingual

Për të eksploruar dhe hulumtuar mbi perceptimet e personave bilingual dhe atyre monolingual lidhur me bilinguizmin dhe korrelacionin e tij me arritjet pozitive në jetë, kampioni i përzgjedhur është 248 persona, nga të cilët 128 të rritur bilingual dhe 120 të rritur monolingual.

Kufiri i moshës u vendos mbi 35 vjeç. Ky kufi moshe është zgjedhur duke vlerësuar faktin se tek një person mbi moshën 35 vjeç mund të maten arritjet në jetë, si: përfundimi i një shkolle të lartë, pozicionimi në një punë të caktuar, krijimi i një familjeje. Për moshën maksimale nuk është vendosur një kufi. (Mayer, 2009. Interview und schriftliche Befragung..., f 37.38.41).

Lloji i kampionimit: kampionim në formë orteku

Për identifikimin dhe përzgjedhjen e personave bilingual është përdorur metoda e kampionimit në formë orteku. Së pari, është përzgjedhur një person bilingual. Më pas ky person ka referuar një person tjerë bilingual e kështu me radhë. Në këtë mënyrë janë arritur të gjenden 120 subjekte bilingual të këtij studimi.

Për tetë personat të cilësuar si VIP në këtë studim është përdorur kampionimi i formës së

qëllimshme. Qëllimisht për të hulumtuar perceptimet e personave VIP bilingual të njohur nga publiku i gjerë shqiptarë, studiuesja ka përzgjedhur këto tetë persona.

3.2.2. Kampionimi i personave jo bilingual

Pjesë e studimit janë bërë edhe 120 të rritur monolingual. Kampionimi i përdorur është i qëllimshëm. Vlen për tu theksuar se grupi i personave monolingual nuk janë një grup krahasimi dhe për këtë arsye është zgjedhur kampionimi i qëllimshëm. Qëllimi i studimit është eksplorimi i korrelacionit të bilinguizmit me arritjet në jetë edhe nga perceptimet dhe këndvështrimet e personave monolingual në Shqipëri. Në mënyrë të qëllimshme janë përzgjedhur 120 persona të përzier, meshkuj dhe femra të moshave nga 35 deri në 65 vjeç, nga të cilët 30% arsimtarë, 30% me arsim të mesëm, 30% akademikë dhe 10% me profesione të tjera si kujdestare, kuzhinierë, elektrikist dhe marangoz. Kjo përzgjedhje është bërë për të sjellë një gamë sa më të gjerë të perceptimeve.

Një nga dallimet kryesore midis kërkimit cilësor dhe atij sasior është se kërkimi cilësor përfshin zakonisht kampionimin e qëllimshëm, ndërsa kërkimi sasior përfshin zakonisht kampionimin me probabilitet, pra, të rastësishëm, d.m.th., zgjedhje e rastit. Kampionimi është një moment me rëndësi themelore në hulumtimin (studimin) cilësor, veçanërisht në hulumtimin e temave të ndjeshme, ku përzgjedhja rastësore e njerëzve nga një grup i marginalizuar mund të jetë praktikisht e pamundur apo jo etike.

Gerson dhe Horowitz (2002) theksojnë që në këto raste studiuesi duhet të jetë i kujdesshëm dhe i vetëdijshëm në përzgjedhjen e pjesëmarrësve, duke qenë kështu në dijeni të paragjykimëve të mundshme që mund të dëmtojnë përzgjedhjen e duhur; ata pohojnë se në të gjitha hulumtimet “qëllimi është për të zgjedhur një grup të intervistuarish që janë në pozicion strategjik për të hedhur dritë mbi forcat më të mëdha dhe proceset nën heitim” (Gerson & Horowitz, 2002). Qëllimi është të kampionohen (përzgjidhen) incidentet dhe jo pjesëmarrësit, të mblidhen të dhëna që do të ndihmojnë në forcimin e kategorive të identifikuara më parë, dhe të sigurohet një kuptim më i mirë i dukurive në studim. Në varësi të të dhënave të analizuara, krahasuara dhe evidentuara, lindin pyetje të tjera, që do të kërkojnë rekrutimin e vazhdueshëm të më shumë pjesëmarrësve. Sa më shumë të

dhëna të mblidhen, aq më shumë do të shtohen ato tek të dhënat paraprake që janë mbledhur dhe analizuar dhe që, për rrjedhojë, do të forcojnë identifikimin e kategorive. Pra, procesi i kampionimit dhe ai i analizimit duhet të bëhen me radhë njëri pas tjetrit (Strauss & Corbin, 1998). Pyetjeve të tilla si “Çfarë do të ndodhte nëse...?”, “Kur?”, “Si?” dhe “Ku?”, kanë rëndësi t’u jepet përgjigje gjatë procesit të analizimit të të dhënave, sepse ato përbëjnë bazën e procesit të përcaktimit të kampionit (Strauss & Corbin, 1998).

Në përgjithësi, kampioni në kërkimet cilësore është më i vogël se në kërkimet sasiore (Cohen, Manion, et al., 2007). Një kampion i përshtatshëm për një kërkim cilësor është ai

Required Sample Size [†]								
Population Size	Confidence = 95%				Confidence = 99%			
	Margin of Error				Margin of Error			
	5.0%	3.5%	2.5%	1.0%	5.0%	3.5%	2.5%	1.0%
10	10	10	10	10	10	10	10	10
20	19	20	20	20	19	20	20	20
30	28	29	29	30	29	29	30	30
50	44	47	48	50	47	48	49	50
75	63	69	72	74	67	71	73	75
100	80	89	94	99	87	93	96	99
150	108	126	137	148	122	135	142	149
200	132	160	177	196	154	174	186	198
250	152	190	215	244	182	211	229	246
300	169	217	251	291	207	246	270	295
400	196	265	318	384	250	309	348	391
500	217	306	377	475	285	365	421	485
600	234	340	432	565	315	416	490	579
700	248	370	481	653	341	462	554	672
800	260	396	526	739	363	503	615	763
1,000	278	440	606	906	399	575	727	943
1,200	291	474	674	1067	427	636	827	1119
1,500	306	515	759	1297	460	712	959	1376
2,000	322	563	869	1655	498	808	1141	1785
2,500	333	597	952	1984	524	879	1288	2173
3,500	346	641	1068	2565	558	977	1510	2890
5,000	357	678	1176	3288	586	1066	1734	3842
7,500	365	710	1275	4211	610	1147	1960	5165
10,000	370	727	1332	4899	622	1193	2098	6239
25,000	378	760	1448	6939	646	1285	2399	9972
50,000	381	772	1491	8056	655	1318	2520	12455
75,000	382	776	1506	8514	658	1330	2563	13583
100,000	383	778	1513	8762	659	1336	2585	14227
250,000	384	782	1527	9248	662	1347	2626	15555
500,000	384	783	1532	9423	663	1350	2640	16055
1,000,000	384	783	1534	9512	663	1352	2647	16317
2,500,000	384	784	1536	9567	663	1353	2651	16478
10,000,000	384	784	1536	9594	663	1354	2653	16560
100,000,000	384	784	1537	9603	663	1354	2654	16584
300,000,000	384	784	1537	9603	663	1354	2654	16586

† Copyright, The Research Advisors (2006). All rights reserved

Figura 1 Për kampionin e marrë në studim në bazë të përlllogaritjes së mësipërme rezultatit marzhi i gabimit 5% dhe besueshmëria 95%.

që i përgjigjet në mënyrën e përshtatshme pyetjes kërkimore. Në praktikë, numri i subjekteve të nevojshme bëhet zakonisht i dukshëm gjatë kohës që studimi progreson dhe nuk shfaqen kategori ose tema të reja nga të dhënat e mbledhura (Marshall, 1996).

Shumica e studiuesve të kërkimit cilësor të bazuar tek intervistat sugjerojnë kampionin e qëllimshëm (pjesë e kampionimit pa probabilitet). Kampionimi i qëllimshëm bazohet në përpjekje të vetëdijshme nga ana e studiuesit, për të përzgjedhur përfituesit që të plotësojnë në kriteret për hulumtim dhe që mbulojnë të gjitha variablat e kërkuara, të tilla si mosha, gjinia, etnia (Coyne 1997). Kampionimi i qëllimshëm është një përgjigje ndaj kufizimeve praktike për kohën e një studiuesi dhe ndaj qasjes së subjekteve që kufizon aftësinë për të përdorur një kampion të madh rastësor. Studiuesi duhet të njihet me zonën e subjektivit dhe popullsinë, dhe mundësisht të ketë ndërmarrë studime ose kërkime të mjaftueshme në terren dhe të jetë në gjendje të përzgjedhë pjesëmarrësit, për të përmbushur qëllimet e kërkimit shkencor (Schatzman & Strauss 1973).

Gabime sistematike

Performanca përcaktohet se sa i afrohet vlera e matur reale e variablit. Instrumenti i saktë ose ideal duhet t'i ketë perfektë: ndjeshmërinë, përsëritshmërinë pa shpërndarje të vlerave dhe duhet të jetë brenda standardeve të aplikueshme. Megjithatë, në shumicën e matjeve do të kemi pasaktësi në rezultate, si rezultat i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Devijimi nga perfeksioni i prirur quhet gabim.

3.3. Instrumentet e studimit

Në këtë çështje do të përshkruhen në mënyrë të hollësishme instrumentet e përdorura për mbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore.

3.3.1. Pyetësi për personat bilingual

Në këtë studim është përdorur **modeli i pyetësit të strukturuar të përzier** . Pyetjet janë ndërtuar në linjë logjike bazuar në hipotezën dhe objektivat e studimit. Pyetësi përmban 20 pyetje dhe është i ndarë në dy sesione. Pasi janë marrë gjeneralitetet, si: mosha, gjinia, statusi civil, vijohet me sesionin e parë.

Sesioni i parë përmban 9 pyetje. Të gjitha pyetjet e këtij sesiioni janë të hapura. Natyra e pyetjeve është e tillë që kërkon përgjigje shumë të shkurtra me dy ose tre fjalë. Në këtë sesiion synohen të gjenerohen të dhëna rreth profesionit që ka secili subjekt i studimit, kombësinë e prindërve të tij, gjuhët që kanë mësuar që në vegjëli.

Lloji i kampionimit : kampionim në formë orteku

Për të eksploruar më tej çështjen e gjuhëve është ndërtuar edhe një pyetje e cila synon të marrë informacion nëse personat bilingual kanë arritur të mësojnë gjuhë tjetër përveç dy gjuhëve që kanë mësuar që në vegjëli. Nga shqyrtimi i literaturës rezulton se personat bilingual në botë dinë më shumë se dy gjuhë të mësuara që në vegjëli. Kështu që kjo pyetje synon të gjenerojë të dhëna për personat bilingual në Shqipëri dhe njohuritë që kanë mbi gjuhët e tjera të huaja. Për t'u thelluar më tej në lidhjet që kanë mësimi i një gjuhe të huaj me të tjerat vijohet me pyetjen nëse i ka ndihmuar fakti i të qenët bilingual subjektet e studimit, në mësimin e një gjuhe tjetër të tretë ose të katërt.

Sesioni i dytë i pyetësorit përmban 11 pyetje. Pyetjet në këtë sesiion janë 1 pyetje e hapur dhe 10 pyetje të mbyllura. Pasi është marrë informacioni i përgjithshëm në sesiionin e parë, kalohet në marrjen e të dhënave më të hollësishme në sesiionin e dytë. Për të evidentuar nëse një person bilingual ndihet superior krahasuar me bashkëmoshatarët ose kolegët si pasojë e njohurisë së disa gjuhëve, është ndërtuar pyetja e mbyllur në mënyrë që subjektet të përgjigjen me “po” ose me “jo”. Për të eksploruar më tej nëse subjektet përgjigjen me “po”, vijohet me pyetjen e hapur, e cila synon të marrë informacion se çfarë i bën personat bilingual të ndihen superiorë krahasuar me kolegët e tyre. Kjo është një pyetje me shumë interes për eksplorimin e çështjes së bilinguizmit dhe vetëvlerësimit të personave bilingual.

Nga shqyrtimi i literaturës rezulton se personat bilingual në vende të ndryshme të botës kanë të zhvilluar gjithashtu shumë talente dhe prirje artistike. Talentet dhe aftësitë artistike tregojnë shumë në lidhje me zhvillimin e trurit dhe aftësive të secilit individ. Në këtë studim do të evidentohen edhe informacione në lidhje me prirjet artistike. Kështu që, pyetësori vijon me dy pyetje të hapura në lidhje me njohuritë dhe talentet artistike dhe sa prej tyre njohin dhe praktikojnë personat bilingual të marrë në këtë studim.

Për të eksploruar më thellësisht bilinguizmin, subjekteve të studimit u kërkohet të rendisin të paktën katër avantazhe që ata evidentojnë tek vetja si pasojë e faktit që janë persona bilingual. E njëjta gjë u kërkohet subjekteve edhe për disavantazhet, pra, a shikojnë tek vetja disavantazhe që kanë ardhur si pasojë e mësimi të dy gjuhëve njëkohësisht që në vegjëli. Pyetja e 17-të e sesionit të dytë është një pyetje e hapur që lidhet drejtpërsëdrejti me hipotezën e studimit, pra, *personat bilingualë kanë më shumë arritje dhe suksese në jetë si avantazh i bilinguizmit, krahasuar me personat jo bilingual*. Në këtë pyetje subjekteve bilingual të studimit u kërkohet t'i përgjigjen pyetjes se sa lidhet bilinguizmi me arritjet dhe sukseset e deritanishme që ata kanë pasur.

Një fëmijë lind bilingual si pasojë e dy prindërve me kombësi dhe dy gjuhë të ndryshme. Pra, mësimi i dy gjuhëve që në vegjëli është një gjë që fëmija nuk e zgjedh dhe nuk ka mundësi ta ndryshojë. Për të eksploruar se sa shumë e vlerësojnë dhe e dëshirojnë faktin e të qenët bilingual, është ndërtuar pyetja se nëse do kishin mundësi të zgjidhnin, a do të dëshironin të rriteshin si persona bilingual apo si monolingual, pra të mësonin vetëm një gjuhë që në vegjëli. Për të vijuar më tej me eksplorimin e kësaj çështje, për subjektet e studimit që kanë fëmijë kërkohet të merret informacion nëse fëmijët e tyre i kanë mësuar një gjuhë apo dy gjuhë që në vegjëli. Sesioni i dytë mbyllet me pyetjen e cila përforcon më tej informacionin e marrë gjatë pyetësorit: nëse gjithçka që subjektet bilingual të studimit kanë arritur deri tani, e lidhin me faktin që janë persona bilingual.

Në përfundim mund të thuhet se pyetësi është ndërtuar në mënyrë shumë të detajuar dhe në rrjedhë logjike për të marrë informacion sa të saktë dhe real për personat bilingual. Ky pyetësor nuk është i lodhshëm dhe konsumues kohe, por rezultoi si shumë i këndshëm dhe interesant për subjektet e studimit të cilët e plotësuan.

3.3.2. Pyetësi për personat monobilingual

Pyetësi për personat jo bilingual në këtë studim është ndërtuar sipas modelit të pyetësorit të strukturuar të përzier. Pyetjet janë ndërtuar në linjë logjike, që nuk ka të bëjë me formatin. Pyetësi përmban 15 pyetje dhe është i ndarë në dy sesione.

Në sesionin e parë, fillimisht synohen të evidentohen gjeneralitete, si: mosha, gjinia,

statusi civil, profesioni dhe më pas të dhëna të tjera mbi gjuhët e huaja. Personat monolingual në sesionin e parë janë pyetur nëse dinë të flasin një gjuhë të huaj dhe ku e kanë mësuar. Përveç kësaj, është kërkuar të merret informacion se cilat kanë qenë arsyet se pse kanë mësuar një gjuhë të huaj.

Në sesionin e dytë, janë ndërtuar 8 pyetje të hapura dhe 1 pyetje e mbyllur. Ky sesion fillon me pyetjen nëse këta persona janë ndjerë inferiorë nga shokë ose kolegë që dinin të flisnin një ose disa gjuhë të tjera të huaja dhe më pas arsyet që i kanë bërë të ndjehen inferiorë. Në këtë sesion kërkohet të merret opinioni i subjekteve bilingual, nëse mendojnë se mësi- mi i gjuhëve të huaja e konsumon apo e zhvillon trurin. Të qenët bilingual nuk është zgjedhje e fëmijës, por është e paradhënë ose e përcaktuar nga prindërit që ai ka. Subjek- tet monolingual janë pyetur nëse do t'u pëlqente të rriteshin si persona bilingual dhe pse. Gjithashtu, një ndër pyetjet që lidhen drejtpërdrejt me hipotezën e studimit është pyetja e 12-të, e cila u kërkon subjekteve të studimit të rendisin të paktën tri avantazhe që ata mendojnë se ka një person që di të flasë dy gjuhë të huaja që kur është fëmijë.

Intervistat gjysmë të strukturuar

Për të marrë informacion të hollësishëm për studimin një instrument i rëndësishëm për mbledhjen e të dhënave janë edhe intervistat gjysmë të strukturuar. Intervista ka disa pyetje bazë të ndërtuara me rend logjik si udhëheqëse të intervistës, por duke lënë edhe hapësirë për informacion shtesë nga përvoja dhe eksperiencia e secilit subjekt të studimit.

3.3.3. Intervista gjysmë e strukturuar

Intervistat kanë qenë një shtyllë e kërkimit sasior dhe cilësor për dekada të tëra, dhe janë në thelb “biseda me një qëllim” (Burgess, 1984), edhe pse forma dhe struktura e tyre mund të ndryshojnë. Intervistat, si një metodë kërkimore sociale, varen tek premisa se “është e mundur të hetohen elementët e sociale duke ju kërkuar njerëzve të flasin si dhe të mbli- dhen apo ndërtohen njohuri duke dëgjuar dhe interpretuar atë që ata thonë dhe mënyrën se si e thonë” (Silverman, 2000). Intervistat gjysmë të strukturuar janë zgjedhur si një qasje e mirë për të fituar informacion të lirshëm rreth një sërë çështjesh të rëndësishme. Intervistat janë më elastike në mbledhjen e informacionit për një ngjarje dhe kontekst të

caktuar, duke paraqitur realitetin, qëndrimet dhe eksperiencat e shprehura nga pjesëmarrësit. Intervistat gjysmë të strukturuar u krijojnë pjesëmarrësve hapësirën e nevojshme për të folur për veten, me pak ndërhyrje të kërkueses (intervistueses). Intervista gjysmë e strukturuar lejon nivele të ndryshme parashkrimi dhe improvizimi. Në intervistat gjysmë të strukturuar pyetjet zakonisht janë të specifikuara, por intervistuesi është më i lirë për të shqyrtuar përtej përgjigjeve dhe të hyjë në një dialog me të intervistuarit. Në këto situata, zakonisht vetë studiuesi i kryen intervistat, ose jep udhëzime të qarta tematike për atë çështje që konsiderohet e rëndësishme për diskutim. Megjithatë, duhet të theksohet se këto forma më pak të strukturuar të intervistimit, potencialisht mund të çojnë në kërkime që anojnë në drejtime të reja apo të papritura, dhe, nëse ky është rasti dhe zhvillohet më tej, ka shumë gjasa të minojë themelet metodologjike të hulumtimit, duke joshur studiuesit të braktisin qëllimet dhe hipotezat origjinale të kërkimit të tyre dhe të shkruajnë të reja në mënyrë prapavepruese.

Ka pasur kritika të mëdha për përdorimin dhe veçanërisht për interpretimin e intervistave në shkencat sociale. Disa mendojnë se nuk i është kushtuar vëmendje e madhe gjendjes sociale të intervistimit dhe se subjekti i intervistuar mund të manipulojë përgjigjet e tij/saj (Briggs, 1986). Është e rëndësishme të kemi parasysh se intervista është një ngjarje sociale, e formuar nga konteksti i intervistës dhe nga normat e marrëdhëniet sociale që qarkojnë (ngërthejnë) intervistuesit dhe të intervistuarit (Herod, 1993; Herzog, 2005).

Ka shumë rëndësi që intervista të lexohet në mënyrë korrekte. Foddy (1993) vë në dukje se komunikimi zakonisht përbëhet nga zbulimi i mesazheve që tregojnë një koncept dhe jo nga zbatimi i drejtpërdrejtë i kuptimit. Kështu, intervistuesi duhet t'i deshifrojë këto mesazhe, dhe t'i kushtojë vëmendje gjatë intervistës dhe analizës si përmbajtjes së komunikimit, ashtu dhe nëntekstit në të cilin lëvrohet ai (Wengraf, 2001). Për të minimizuar këtë efekt, autorja e këtij punimi kreu dhe transkriptoi intervistat menjëherë pas realizimit të tyre. Më pas, ajo lexoi disa herë materialet e transkriptuara pas një periudhe të gjatë përfshirjeje në fushën që ofroi familjaritet në kontekstin e lëndës dhe në fund të punës në terren formuloi kodimin dhe interpretimin. Madje edhe kështu, intervista gjithmonë

do të zhvillohet në kuadrin e marrëdhënieve të pushtetit, pritshmërive personale dhe vetë interesit që do të zbehtë kuptimin e komunikimit (Rose, 1997). Disa studiuese feministe shkojnë aq larg sa të thonë se në mënyrë efektive kjo nënkupton se për sa kohë që nuk ka pyetje apo përgjigje që të mund të përfshihen, pa marrë parasysh kontekstin apo objektivin, ne nuk mund të supozojmë se rezultatet do të jenë një portretizim plotësisht i saktë i subjektit dhe se duhet të synojmë drejt një interpretimi relativ (Lather 1991).

Intervistat individuale janë realizuar me persona VIP dhe të njohur në kontekstin shqiptar. Në këtë studim janë realizuar 8 intervista me persona bilingual shqiptarë të cilët kanë jetuar edhe përpara viteve 90-të dhe kanë një përvojë të konsiderueshme jetësore. Këta persona janë zgjedhur qëllimisht. Qëllimi ka qenë të merren të dhëna për jetën e këtyre personave të bërë VIP dhe persona të njohur publik, të njohur gjithashtu edhe për eksperiencën e tyre, dhe nëse ka ndikuar dhe ndihmuar fakti i të qenët person i rritur me dy gjuhë në këto arritje.

3.3.4. Procedura

Përdorimi në rritje i kërkimit cilësor kërkon teknika të forta të mbledhjes së të dhënave dhe dokumentim të procedurave të kërkimit (Constas 1992; Mays & Pope 1996; Long & Johnson 2000). Poland dhe Pederson (1998) shpjegojnë se ajo çfarë nuk është thënë me fjalë është po aq e rëndësishme sa ajo që është thënë. Prandaj, transkriptet kërkojnë që studiuesi të përfshijë informacionin kontekstual në lidhje me heshtjen ose pauzat gjatë bashkëbisedimit.

Niveli i transkriptimit duhet të plotësojë nivelin e analizës (Drisko 1997). Nëse një analizë fokusohet në sigurimin e një përshkrimi në thellësi të njohurive, qëndrimeve, besimeve ose përvojave të një individi, grupi individësh, në transkript duhet të përfshihet një numër i madh njësisish të tekstit. Me këtë lloj analize, kërkuesit nuk janë të interesuar vetëm të identifikojnë modele dhe tema të mundshme, por ata duan të tregojnë edhe ndryshime se si janë përshtatur dhe artikuluar fenomenet sociale. Po ashtu, ata duan të tregojnë edhe marrëdhëniet brenda dhe midis elementeve të veçantë të dukurive të tilla. Nëse kërkuesi nuk ka nevojë për një analizë aq të hollësishme, eksplorimi i temave dhe

modeleve të përgjithshme mund të ndërmerret duke shkruar më pak tekst e më pak hollësi. Transkriptimi përgjithësisht kërkohet që të bëhet pas ngjarjes sa më shpejt që të jetë e mundur. Wengraf (2001). Kjo ishte pikërisht qasja e përdorur këtu: intervistat gjysmë të strukturuar janë transkriptuar në po atë javë që u kryen intervistat.

3.3.5. Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave në kërkimin cilësor është pjesa më sfiduese, ky duhet të jetë një proces sistematik dhe i menduar me kujdes. Në kërkimin cilësor shpesh studiuesi përpigjet të gjenerojë thjesht përshtypjet bazuar në rishqyrtimin fillestar të shënimeve ose regjistrimeve dhe më pas të bëjë përmbledhje që errësojnë lidhjen midis asaj që është vëzhguar, dëgjuar ose lexuar. Studiuesi duhet të jetë i kujdesshëm që të bëjë dallimin mes vëzhgimeve dhe interpretimeve të tij dhe asaj që shprehet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga pjesëmarrësit në studim. Për të arritur këtë ai duhet të ndjekë një linjë të qartë për të menaxhuar të dhënat e papërpunuara, për kodimin e tyre (jo numerikisht, por duke përdorur shprehje), me qëllim që të dhënat të mund të kuptohen në kontekstin aktual dhe jashtë tij (Soafer 2002).

Analiza e të dhënave cilësore është një proces që vazhdon përgjatë gjithë kërkimit dhe nuk është një fazë e veçantë e kërkimit. Ely, Anzul et al., (1991) tregojnë se kur zgjedhim kërkimin cilësor me çfarëdo niveli kuptueshmërie të analizës, ne sjellim nga puna e mëparshme modelet e profesioneve dhe disiplinave përkatëse, këshillën e udhëheqësve shkencorë.

Në këtë kërkim është përdorur teoria grounded, e cila e inkurajon kërkuesin të krijojë “kategoritë” dhe “nënkategoritë” drejtpërdrejtë nga të dhënat (Glaser & Strauss, 1996). Kjo formë analize e qasjes induktive siguron që çdo kategori ose nënkategori të bazohet në të dhënat origjinale. Strauss dhe Corbin paraqesin teorinë grounded si një metodë të kërkimit cilësor që përdor një sërë procedurash sistematike për të prodhuar një teori për një dukuri, duke u mbështetur tek të dhënat e mbledhura dhe të analizuara (Strauss & Corbin, 1990; Strauss & Corbin, 1998). Origjina e metodologjisë së teorisë grounded të Strauss dhe Corbins qëndron në idetë e mëposhtme:

- nevoja për të kuptuar kompleksitetin e një dukurie;
- rëndësia e teorisë e zhvilluar sipas një baze të veprimit social;
- roli aktiv i subjekteve në studim;
- të kuptuarit se subjektet kanë kuptimin e tyre interpretues të një dukurie dhe se ky kuptim mund të ndryshojë me anë të ndërveprimeve me subjektet e tjera;
- ndjeshmëria për atë që mund të zbulohet në lidhje me dukurinë (Strauss & Corbin, 1998).

Një nga konceptet kryesore të qasjes induktive është “ngopja” (Glaser & Strauss, 1996). “Ngopja” nxit kërkuesin të vazhdojë të mbledhë të dhëna.

3.3.6. Qëndrueshmëria dhe vlefshmëria e studimit

Qëndrueshmëria

Ja si e përkufizon qëndrueshmërinë Joppe (2000):

“Rezultatet e qëndrueshme që shtrihen përgjatë një kohe të caktuar dhe që prezantojnë një grup të përshtatshëm të popullsisë në përgjithësi që është përfshirë në studim i referohemi si qëndrueshmëri nëse rezultatet e studimit mund të riprodhohen duke përdorur të njëjtën metodologji dhe atëherë instrumenti i kërkimit konsiderohet i besueshëm.”

Qëndrueshmëria në kërkimin cilësor i referohet në mënyrë tipike adoptimit të metodave kërkimore që janë të pranueshme nga komuniteti i kërkuesve dhe shikohen si mënyra të pranueshme për mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Në mënyrë të veçantë, metodat cilësore të besueshme prodhojnë në mënyrë të qëndrueshme përshkrime të pasura dhe kuptimplotë të dukurisë. Në këtë mënyrë, kërkuesit cilësorë që adoptojnë metoda të besueshme cilësore dhe realizojnë analizën e tyre në një mënyrë të përshtatshme, priten të prodhojnë të dhëna që e pasurojnë arsyetimin tonë mbi kuptimet që njerëzit lidhin me dukurinë shoqërore (Burkett & Godkin, 1983). Qëndrueshmëria zbulon kuptimet e pasura e të qenësishme që lidhen me përvojat e njerëzve (Pollio, Henley et al., 1997). Kur këto kuptime ndryshojnë, kjo nuk ka të bëjë me faktin se është përdorur një metodë e pasigurt; sesa me ndryshimet që lidhen me faktin që njerëzit i përjetojnë dukuritë sociale në mënyra të ndryshme. Studim i mirë cilësor na ndihmon “të kuptojmë një situatë që mund të jetë enigmatike ose e paqartë” (Eisner, 1991).

Në metodat e tjera për rritjen e qëndrueshmërisë përfshihen garantimi i saktësisë teknike në regjistrimin dhe transkriptimin e të dhënave. Ndërkohë që disa të tjerë sugjerojnë se intervistat e regjistruara dhe të transkriptuara mund të ndihmojnë në përmirësimin e qëndrueshmërisë, por nga ana tjetër aspekte të rëndësishme të komunikimit joverbal nga njëherë harrohen gjatë transkriptimit (Perakyla 1997). Për të bërë një pasqyrim sa më të saktë të informacioneve të mbledhura nga të intervistuarit, studiuesja ka paraqitur në fund të çdo interviste të gjitha elementët e komunikimit joverbal që janë pasqyruar në formë të ndryshme gjatë intervistës. Analiza e bashkëbisedimeve është zhvilluar në mënyrë të tillë që të përfshihen nuancat e ndryshme të komunikimit, të tilla si pauzat, ndërprerjet, theksimet e çështjeve të ndryshme, etj. (Atkinson & Heritage 1984). Angazhimi intensiv me të dhënat e mbledhura, shfletimi i herëpashershëm i të dhënave dhe interpretimit të bërë nga studiuesja, dhe vendosja e lidhjeve midis interpretimit të studiueses dhe të dhënave, rrit qëndrueshmërinë dhe lehtësinë e të kuptuarit të të dhënave. Gjithsesi, është e rëndësishme që përzgjedhja e civateve ilustruese të përfshijë hapësirën dhe tonin e përgjithshëm të të intervistuarve (Atkinson & Heritage 1984).

Vlefshmëria

Joppe (2000) dha këtë shpjegim për vlefshmërinë në kërkimin cilësor: “Vlefshmëria përcakton nëse kërkimet masin realisht atë që studimi ka si qëllim që të masë ose sa të besueshme janë rezultatet e studimit.” Kërkuesit zakonisht përcaktojnë vlefshmërinë duke bërë një sërë pyetjesh dhe shpesh shikojnë për përgjigjet në kërkimet e të tjerëve. Matja e një qëllimi në kërkimet cilësore do të thotë zgjedhja e një metode të përshtatshme për një pyetje të caktuar dhe zbatimi i asaj metode në mënyrë rigoroze, të kuptueshme dhe të justifikueshme (Kvale, 1994).

Ndërkohë që intervistuesi mund të supozojë se vetëraportimi është i sigurt dhe si rrjedhojë i vlefshëm (Appleton 1995, Burns & Grove 2005), mund të kemi shtrembërime gjatë procesit të analizës dhe interpretimit. Kërkuesit e interesuar, që janë të familjarizuar me të dhënat, mund të shikojnë nuanca të caktuar dhe dykuptimësinë e të dhënave si rezultat i aftësive që ata kanë për të identifikuar informacionet e nënkuptuara nga fusha e studimit.

Kërkimi i mirë shpesh përfshin të shkosh përtej kuptueshmërisë së pjesëmarrësve të studimit mbi situatën e tyre. Një nga strategjitë e zakonshme është ilustrimi i analizës me atë që përshkruhet si “përfundimi i përgjithshëm i të intervistuarve” (Johnson 1997), për të demonstruar që gjetjet bazohen në të dhënat.

Trekëndëzimi është në mënyrë tipike një strategji për përmirësimin e vlefshmërisë dhe qëndrueshmërisë së kërimit ose vlerësimit të gjetjeve (Mathison, 1988). Trekëndëzimi përshkruan kombinimin e dy ose më shumë teorive, burimeve të të dhënave, metodave në një studim (Halcomb & Andrew 2005, Williamson 2005), dhe asiston me përpikmëri ndërtimin logjik të studimit. Në këtë kërkim u kombinua metoda e pyetësorëve dhe intervistave si dhe të dhënat dytësore.

Qasje të tjera për rritjen e vlefshmërisë përfshijnë angazhimin e zgjatur në mjedisin e kërimit (Erlandson, Harris et al., 1993), mbikëqyrje sistematike dhe rishqyrtim të analizës dhe të gjetjeve të kërkuesit (Streubert Speziale & Carpenter 1995). Disa kërkues të fushës cilësore deklarojnë se është i pamundur objektiviteti ose pavarësia absolute në procesin e kërimit (Guba & Lincoln 1981). Sidoqoftë, është e rëndësishme që procesi i kërimit të jetë transparent, me qëllim që lexuesi ta ketë të lehtë të ndjekë dhe të kuptojë proceset e vendimmarrjes në lidhje me orientimin personal dhe kontekstin, teorinë, metodologjinë dhe analizën përgjatë gjithë studimit. Morse dhe Field (1996) rekomandojnë që mënyra e ndjekjes së studimit duhet të bëhet evidente për të demonstruar procesin e mbledhjes së të dhënave. Kjo mund të arrihet zakonisht nëpërmjet ditarit të kërkuesit që mbahet gjatë mbledhjes së të dhënave.

3.3.7. Çështjet etike

Shoqata Sociologjike Britanike e Praktikës Etike (2001) përcakton se “kërkuesi ka përgjegjësinë të sigurojë që mirëqenia fizike, sociale dhe psikologjike e pjesëmarrësit të kërimit nuk do të cenohet nga kërkuesi.” Në të gjitha projektet kërkimore ka çështje etike që mund të ndikojnë në hartimin dhe ekzekutimin e kërimit si dhe në rezultatet e tij përfundimtare dhe këto janë veçanërisht të dukshme në studime të tilla si kjo që merret me njerëzit e paavantazhuar. Këto probleme etike lindin sepse “studiuesi është

etikisht dhe moralisht përgjegjës ndaj pjesëmarrësve të tij/saj, ndaj publikut të gjerë, dhe ndaj besimeve të tij/saj” (Kitchin & Etika procedurale fokusohet në rëndësinë e përpikmërisë duke shmangur falsifikimin, mashtrimin dhe sajimin. Etika procedurale sugjeron gjithashtu që pjesëmarrësit e kërimit të kenë të drejtën të njohin llojin dhe pasojat e mundshme të kërimit dhe të kuptojnë që pjesëmarrja e tyre është vullnetare. Procedura të tilla jo vetëm lidhen me etikën por çojnë edhe në të dhëna më të besueshme: “një formë miratimi e dobët zakonisht çon në të dhëna të varfra: përgjigjedhënesit do të përpiqen që të mbrojnë veten në një marrëdhënie mosbesuese” (Miles dhe Huberman, 1994).

Për të mbrojtur identitetin dhe statusin sieropozitiv të pjesëmarrësve, të dhënat në këtë projekt u mbajtën sekret dhe të sigurta, sidomos pjesët e ditarit, i cili edhe kur është anonim, mund të përmbajë një nivel të atillë detajesh që mund të mundësojnë identifikimin e subjektit. Të intervistuarit mund të përmendin emra të personave të tjerë ose të japin informacione të detajuara rreth jetës së tyre po ashtu si dhe për jetën e të tjerëve. Në këtë rast një kërkues duhet të përcaktojë nëse përfshirja e informacioneve të tilla mund të rezultojë në dëmtimin personal ose social të personit, të rrezikojë identitetin e të intervistuarit, ose përndryshe të thyejë konfidencialitetin (Morse, 1994; Punch, 1994).

3.3.8. Pikat e forta dhe kufizimet e studimit

Përdorimi strategjisë sasiore dhe cilësore, ka patur si qëllim që këto metoda të ishin komplementare, pra, të plotësonin njëra tjetrën, gjë që përforcon edhe kuptueshmërinë e studimit.

Ky studim është përpjekur të sjellë një qasje shumëdimensionale lidhur me eksplorimin e bilinguizmit nga perceptimet e personave të rritur si bilingual në Shqipëri, që kanë jetuar edhe para viteve 90-të, dhe personave monolingual, dhe sa i lidhin arritjet e tyre në jetë me faktin e të rriturit me dy gjuhë.

Kufizimet e studimit:

- **Mungesa e të dhënave dhe studimeve për çështjet e bilinguizmit në Shqipëri.**

Për realizimin e studimit autorja ka përdorur burime të ndryshme. Së pari, për një hulumtim sa më të gjerë në çështjet e perceptimit të personave bilingual mbi bilinguizmin, u

konsultuan studimet e mëparshme të autorëve vendas dhe të huaj. Duhet theksuar se në Shqipëri informacioni lidhur me bilinguizmin është shumë i cungët, për të mos përmendur termin “mungon”.

Nga ana tjetër, literatura botërore është shumë e gjerë në fushën e zgjedhur për të studiuar. Studime me perceptime nga personat bilingual për veten e tyre, artikuj shkencorë, anketa, burime zyrtare për numrin e personave bilingual në Evropë e Amerikë janë nga më të shumëllojshmet. Në këtë kuadër vështirësitë janë ndeshur në përzgjedhjen e informacionit, informacion ky që të përkonte sadopak në ngjashmëri me kontekstin shqiptar.

- **Gjetja dhe evidentimi i personave bilingual dhe mbërritja deri tek ata.**

Gjetja e personave të rritur si bilingual nuk ka qenë e lehtë në këtë studim. Në Shqipëri nuk ka të dhëna statistikore zyrtare për numrin e personave që janë rritur si bilingual. Me iniciativën e saj dhe rrethin e njohur të personave bilingual, studiuesja ka arritur të identifikojë dhe të bëjë pjesë të studimit personat bilingual.

- **Të dhënat e këtij studimi nuk janë shteruese për gjithë Shqipërinë.**

Gjetjet e këtij studimi do të ishin më të plota nëse nga të dhënat zyrtare të INSTAT do të kishim të mirëpërcaktuar popullatën e personave shqiptarë të rritur si bilingual dhe më pas të përcaktohej kampioni i cili statistikisht konsiderohet përgjithësues. Në kushtet kur këto të dhëna nuk ekzistojnë, kampioni është zgjedhur në mënyrë të qëllimshme për të gjeneruar të dhëna sa më ndihmuese dhe shteruese për temën e studimit. Si pasojë e mungesës së numrit real të popullatës, kampioni i marrë në studim nuk mund të konsiderohet përgjithësues për Shqipërinë.

Pavarësisht nga kufizimet e sipërpërmendura, ky studim mbetet një burim i mirë informacioni për të gjithë aktorët e interesuar, qofshin këta individë apo institucione, lidhur me të dhëna dhe perceptime të personave bilingual të rritur në Shqipëri.

KAPITULLI IV: REZULTATET E STUDIMIT

Në këtë çështje do të paraqiten rezultatet e studimit. Të dhënat sasiore të marra nga pyetësorët e realizuar me personat bilingual dhe ato monolingual do të paraqiten në formën e të dhënave statistikore, specifikisht në formën e përqindjeve. Rezultatet e pyetjeve të hapura do të paraqiten duke renditur përgjigjet më të shpeshta që kanë rezultuar nga subjektet e studimit. Të dhënat cilësore të rezultuara nga intervistat do të paraqiten në formën e përshkrimeve cilësore, me anë të citimeve të rezultuara.

Duke qenë se instrumentet e përdorura në këtë studim për mbledhjen e të dhënave, pyetësi i realizuar me personat bilingual, pyetësi i realizuar me personat monolingual dhe intervistat janë të ndara në sesione, po ashtu edhe rezultatet e studimit do të paraqiten të grupuara në bazë të sesioneve të përcaktuara. Rezultatet e studimit do të paraqiten duke krahasuar subjektet bilingual dhe ato monolinguale.


4.1. Të dhënat bazë të subjekteve të studimit

Në këtë studim rezultoi se subjekte monolinguale të studimit ishin 52% meshkuj dhe 48% femra. Pra, kemi një përfaqësim më të madh të meshkujve monolingual.

Përsa i përket subjekteve bilingual të studimit rezultoi e kundërta e subjekteve monolingual. 60% e zënë meshkujt dhe 40% femrat.


Në tërësi të kampionimit të studimit mund të themi se në këtë studim ka patur një përfaqësim pothuajse të bara-

Subjekte monolingual



Grafiku 1

Subjekte bilingual



Grafiku 2

bartë të gjinive, por me një përqindje më të madhe të meshkujve.

4.1.1. Arsimi

Në pyetësin e ndërtuar, një nga pyetjet e vendosura ishte ajo që kërkonte të merrte informacion mbi nivelin e arsimit të subjekteve pjesëmarrëse në kërkim.

Niveli i arsimit të subjekteve monolingual krahasuar me subjektet bilingual rezultoi të ishte i ndryshëm. Pjesa më e madhe e tyre, e shprehur në përqindje, pra 84% e subjekteve, rezultuan të kishin arsimin e lartë. Ndërsa 16% e subjekteve monolinguale rezultuan të


ishin me arsimim të mesëm. Nëse bëjmë krahasim me grupin bilingual rezultoi se personat bilingual që kanë marrë pjesë në këtë studim janë me nivel arsimor më të lartë se ata monolingual. E shprehur në gjuhën e shifrave, rezultoi 10% më shumë.

4.1.2. Statusi civil

Evidentimi i statusit civil ishte një pikë tjetër e të dhënave të marra nga subjektet e kërimit. Pjesa më e madhe e personave bilingual rezultoi të ishin të martuar. E shprehur në përqindje: 79%, dhe vetëm 21% e tyre rezultoi të ishin beqarë.


Në rezultat për personat monolingual, vërejmë një ndryshim krahasuar me

Arsimi i subjekteve bilingual




Grafiku 3

Arsimi i subjekteve monolingual



Grafiku 4

Statusi civil i personave bilingual




Grafiku 5

grupimin bilingual. 27% e personave monolingual që morën pjesë në studim ishin beqarë dhe 73% rezultuan të ishin të martuar. Në rezultatet e statusit civil, rol të rëndësishëm luan mënyra e kampionimit të përdorur. Nga këto të dhëna shohim se pjesa më e madhe e personave që janë bërë pjesë e këtij studimi

janë të martuar dhe një përqindje më e vogël janë beqarë. Kjo për shkak edhe të kufirit të moshës, që është përcaktuar mbi 35 vjeç. Si rrjedhojë, 84% e subjekteve bilingual rezultuan të martuar. Personat në moshë mbi 35 vjeç kanë më shumë probabilitet të jenë të martuar. Ky është një përgjithësim që ka vend në kultura si ajo shqiptare.

Statusi civil i personave monolingual



Grafiku 6


4.2. Dëshira për t'u rritur si person me dy gjuhë ose jo?

Të lindësh si fëmijë bilingul është një gjë që nuk e zgjedh vetë personi. Ai lind nga dy prindër që flasin dy gjuhë të ndryshme dhe automatikisht me dëshirë të prindërve fëmija mëson dy gjuhë. Një çështje e rëndësishme e këtij

studimi ishte evidentimi nëse personat bilingual do të dëshironin vërtet të rriteshin si fëmijë me dy gjuhë ose do të preferonin të kundërtën: të rriteshin si monolingualë. E njëjta çështje u eksplorua edhe tek personat monolingual, por në rastin e tyre pyetja në pyetësor u ndërtua në formën e preferencave që ato do të kishin për t'u rritur si fëmijë bilingual.

Personat bilingual rezultuan 100% se përpos faktit që ata janë rritur si fëmijë bilingual, edhe nëse do kishin mundësi të rriteshin si monolingual, ata përsëri

SB dhe preferenca për t'u rritur si bilingual




Grafiku 7

do të dëshironin të rriteshin si bilingual.

Dëshira e personave monolingual për t'u rritur si persona me dy gjuhë rezultoi të jetë shumë e ndryshme nga perceptimi i personave bilingual. E shprehur në përqindje, rezultoi se 58% e personave monolingual do të dëshironin të rriteshin si fëmijë me dy gjuhë dhe një përqindje e vogël e tyre, 42%, nuk do të dëshironin të rriteshin si persona bilingual .

SM dhe preferenca për t'u rritur si bilingual




Grafiku 8

4.3. Bilinguizmi dhe superioriteti


Nga shumë studime rezultoi se superioriteti dhe bilinguizmi janë të lidhur me njëri-tjetrin. Në këtë studim një nga pyetjet e rëndësishme që lidhet drejtpërdrejt me hipotezën e kërimit ishte pyetja nëse personat bilingual ndjehen superiorë në krahasim me ato monolingual, si pasojë e faktit që janë rritur me dy gjuhë. Gjetjet ishin interesante. Pjesa më e madhe e subjekteve të studimit, 62% e tyre, rezultoi se në shumë situata në jetën e tyre janë ndjerë superiorë krahasur me bashkëmoshatarët ose kolegët e tyre monolingual. Ndërkohë, 33% e tyre janë shprehur se nuk janë ndjerë superiorë në jetë nga fakti i të qenët bilingual. Një pjesë më e vogël e subjekteve bilingual janë shprehur se ka patur

SB dhe superioriteti përballë personave monolingual



Grafiku 9

SM dhe inferioriteti përballë personave bilingual



Grafiku 10

situata ku janë ndjerë pjesërisht ose kanë qenë jo shumë të bindur nëse kjo ndjenjë superioriteti ka ardhur nga fakti i të qenët bilingual. E shprehur në gjuhën e shifrave kjo rezulton 5% e subjekteve bilingualë të studimit.

Nëse dy persona bisedojnë në një gjuhë tjetër dhe një i tretë është monolingual, ka shumë gjasa që personi monolingual të ndjehet inferior. Inferioriteti vjen nga mungesa e mosnjohjes së gjuhës.

Ndërkohë, 53% e personave monolingual, janë shprehur në pyetësor se nuk janë ndjerë inferiorë përballë një shoku ose kolegu të rritur si bilingual, pasi edhe ata vetë edhe pse të rritur si monolingual kanë mësuar gjatë jetës të komunikojnë në një ose më shumë gjuhë të huaj. Ndërsa 47% janë shprehur se janë ndjerë inferiorë dhe në siklet kur kanë patur përballë një person bilingual, pasi njohuritë e tij në gjuhët e huaja nuk kanë qenë në të njëjtin nivel me njohuritë e tyre.

4.4. Gjuhët e huaja

Subjektet bilingual të studimit rezultuan 42% me një prind shqiptar dhe një prind grek, 12% me një prind shqiptar dhe një prind italian, 16% me një prind shqiptar dhe një prind rus, 22 % me një prind shqiptar dhe një prind maqedonas, 2% me një prind shqiptar dhe një prind francez, 4% me një prind shqiptar dhe një prind nga Mali i Zi, 2% nga një prind shqiptar dhe një prind gjerman.

Përveç dy gjuhëve të mësuara që në fëmijëri, nga studimi rezultoi se të gjithë subjektet bilingual të studimit dinin të flisnin dhe kishin njohuri të paktën në një gjuhë të tretë. Por pjesa më e madhe rezultoi të kishin njohuri edhe në një gjuhë të katërt. Dhe një pjesë e vogël e subjekteve kishin njohuri dhe flisnin edhe një gjuhë të pestë ose të gjashtë.

Pjesa më e madhe e tyre kishin njohuri në gjuhën ruse dhe frënge. Kjo lidhet me sistemin arsimor të para viteve 90. Shkolla shqiptare ishte e orientuar në modelin rus të arsimit dhe si pasojë gjuha e huaj që mësohej në shkollë ishte rusishtja. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e subjekteve rezultoi se e kishin mësuar gjuhën frënge në shkollë.

Një përqindje më e vogël rezultoi të kishin njohuri dhe të flisnin anglisht dhe italisht. Kjo përgjigje është dhënë kryesisht nga më të rinjtë që u bënë pjesë e studimit dhe një

përqindje fare e vogël, përfaqësuar vetëm me një person, kishte njohuri mbi gjuhën latine si gjuhë të tretë përveç dy gjuhëve të mësuara në fëmijëri.

Çështja e njohjes së një gjuhe të huaj të tretë ose më shumë është interesante e studiuar në këndvështrimin e bilinguizmit. Ashtu sikurse është vërtetuar nga rezultatet e studimeve të mëparshme në vende të ndryshme të botës, edhe në këtë studim vërtetohet se personat bilingual e kanë më të lehtë të mësojnë një gjuhë të tretë. Pra, të gjithë subjektet bilinguale rezultoi të njihnin dhe flisnin një gjuhë të tretë ose të katërt. Por ky rezultat rezultoi i ndryshëm krahasuar me subjektet monolingual të studimit. Për personat monolingual rezultoi se mësimi i një gjuhe të tretë ose të katërt ishte më i vështirë.

4.5. Bilinguizmi dhe talentet artistike


Nga shqyrtimi i literaturës rezulton se gjetjet e shumë studimeve në Evropë dhe Amerikë flasin për një lidhje midis bilinguizmit dhe talentëve artistike. Kjo çështje ka rëndësi në fushën e psikologjisë përse i përket dhe mënyrës kognitive se si funksionin truri dhe sa i prirur është për talente dhe aftësi artistike. Nga subjektet bilinguale të studimit rezultoi se 67% e tyre kanë talente dhe aftësi në fushat artistike të dëshmuara. Dhe një përqindje më e vogël, 33% nuk kanë talente të dëshmuara në fushat e artit.

Mësimi i një gjuhe të re ndikon në shumë aspekte në jetën e një njeriu.

Subjektet monolinguale në këtë studim


u pyetën se a mendojnë se mësimi i një gjuhe të re ndihmon në zhvillimin

A kanë personat bilingual talente artistike?



Grafiku 11

A e zhvillon trurin mësimi i një gjuhe të re?



Grafiku 12

e trurit. Nga të dhënat rezultoi se pjesa më e madhe e tyre, 92%, e vlerëson mësimin e një gjuhe të re si pozitive dhe në zhvillimi të kapacitetit të tyre intelektual dhe 8% nuk mendojnë e mësimi i një gjuhe të huaj ndikon pozitivisht në zhvillimin e trurit.

4.6. Bilinguizmi dhe arritjet në jetë


Hipoteza mbi të cilën është bërë hulumtimi në këtë studim është çështja nëse ka lidhje bilinguizmi me arritjet dhe sukseset në jetë për personat bilingual. Në pyetësorit e ndërtuar për një eksplorim të drejtpërdrejtë të kësaj çështjeje, subjektet bilinguale u pyetën në mënyrë të drejtpërdrejtë se a lidhet fakti i të rriturit si bilingual me arritjet dhe sukseset e tyre të deritanishme në jetë.

Të dhënat e këtij studimi rezultuan dhe dëshmuuan se përsa i përket personave bilingual të marrë në këtë studim në Shqipëri, pjesa më e madhe e tyre, 60%, janë shprehur se gjithçka kanë arritur në jetë ia dedikojnë faktit që janë rritur si bilingual. Zotërimi i dy gjuhëve që

në fëmijëri për ta ka hapur me lehtësi shumë dyer drejt arritjeve dhe sukseseve. Ndërkohë, ky rezultat mbështetet sërish nga 23% e subjekteve që janë shprehur se arritjet e tyre në jetë kanë ardhur si fakt i të qenët bilingual, por edhe i përkjekjeve, punës dhe ambicieve që kanë patur në jetë. Ndërkohë, një përqindje e vogël e tyre, 17%, nuk i lidhën arritjet e tyre në jetë me faktin e të qenët bilingual.

Bilinguizmi ka shumë avantazhe në jetën dhe arritjet e një njeriu të rritur si bilingual. Duke marrë në konsideratë se personat bilingual të marrë në studim kanë jetuar një pjesë të konsiderueshme të jetës së tyre në periudhën e sistemit komunist në Shqipëri, në pyetësor u ndërtuar edhe një pyetje që synon të evi-

A lidhet bilinguizmi me arritjet dhe sukseset në jetë?




Grafiku 13

dentojë nëse ka patur disavantazhe për personat bilingual, të cilët kanë ardhur si pasojë e të qenët fëmijë të rritur me dy gjuhë. Nga studimi rezultoi se 13% e subjekteve bilingual janë shprehur se ata kanë patur disavantazhe si pasojë e të qenët fëmijë me prindër të dy kombësive të ndryshme. Ndërkohë që pjesa

më e madhe e tyre, 87%, janë shprehur se nuk kanë patur disavantazhe si pasojë e bilinguizmit.

A ka disavantazhe fakti i të rriturit si bilingual?



Grafiku 14

4.7. Rezultatet e të dhënave cilësore

Kjo nënçështje prezanton rezultatet cilësore të studimit të cilat dolën nga analiza e të dhënave të mbledhura nëpërmjet intervistave gjysmë të strukturuar, të realizuara me persona të rritur si bilingual në Shqipëri. Rezultatet e të dhënave cilësore të studimit do të paraqiten duke renditur përgjigjet e ndeshura më shpesh në një rend, nga përgjigjja më e shpeshtë deri tek përgjigjja e ndeshur më rrallë tek personat bilingual të intervistuar, gjithashtu, edhe me citime nga vetë personat e intervistuar.

4.7.1. Superioriteti dhe bilinguizmi

Një pyetje që i është drejtuar të intervistuarve është se a janë ndjerë superiorë ndaj bashkëmoshatarëve apo kolegëve si pasojë e faktit të të qenët bilingual. Nga intervistat rezultoi se pjesa më e madhe e tyre ishin ndjerë superiorë. Për t'u thelluar më tej në këtë çështje, intervistat vijuan me një pyetje tjetër e cila synon të evidentojë arsyet se pse janë ndjerë superiorë.

Tre përgjigjet më të shpeshta të ndeshura vijnë si më poshtë:

- Njohja e dygjuhëve që në fëmijëri jepte akses në leximin e literaturës së huaj në kohën kur kjo ishte e ndaluar në Shqipëri.

- Komunikimi me njerëz nga vende të ndryshme me lehtësi.
- Hapja e dyerve më lehtë se kolegët drejt një vendi pune.

Ja si u shprehësh disa nga të intervistuarit:

Unë kam lexuar shumë libra fshehurazi, sepse ishin të ndaluar dhe kisha fatin e madh të merrja libra dhe nga biblioteka e profesor Jakup Kastratit. (1 Femër, Tiranë).

Sidomos në adoleshencë ndihesha mirë që dija një gjuhë të cilët bashkëmoshatarët e mi nuk e dinin. (3, femër, Tiranë).

Njohja e gjuhëve më ka dhënë mundësi jo vetëm të lexoja dhe të studioja, por edhe të futesha në brendësi të temave, të trajtoja raste pacientësh me të rejtat bashkëkohore të mjekësisë. (5, mashkull, Tiranë).

4.7.2. Njohuritë dhe talentet në fushat artistike

Nga të intervistuarit të cilët janë persona bilingual, që kanë arritur suksese në jetën e tyre, rezultoi se ata krahas profesionit si mjek, politologe, aktor etj., kishin prirje dhe aftësi artistike të caktuara. Tre përgjigjet më të shpeshta të ndeshura rezultuan si më poshtë:

- Njohuri të dëshmuara në kitarë
- Njohuri dhe aftësi të dëshmuara në pikturë
- Njohuri nga letërsia botërore

Ja si janë përgjigjur disa nga të intervistuarit mbi talentet artistike:

Nëna ime kishte studiuar Artet e Bukura në Itali dhe mbi mitologjinë greke. Ajo na tregonte për pikturat e Rafaelos dhe Mikelanxhelos. Këto vepra i pashë nga afër kur m'u dha leja në 1985 për të vizituar njerëzit e mi në Itali. Nëna na kishte transmetuar dëshirën për muzikën klasike, madje unë edhe sot dëgjoj me shumë dëshirë muzikë klasike. (3, femër, Tiranë).

Po, kam praktikuar aktrimin dhe specifikisht humorin. (2, femër, Tiranë).

Mua nga nëna m'u mbrujt dëshira për muzikën vjeneze. Nëna edhe këndonte në shtëpi. Ajo ishte nga Lizfer Danubit, një qytet me kulturë në artin e muzikës. (4, mashkull, Tiranë).

4.7.3. Disavantazhet e bilinguizmit

Nga të dhënat e intervistave rezultuan gjetje interesante të cilat lidhen me disavantazhet e bilinguizmit. Dy përgjigjet më të shpeshta të ndeshura vijnë si më poshtë:

- Diskriminim në periudhën e komunizmit dhe stigmatizim i të gjithë familjes.
- Lëkundje e identitetit.

Ja si janë shprehur disa nga të intervistuarit në lidhje me disavantazhet e të qenët bilingual në periudhën e sistemit konunist në Shqipëri:

Në kohën e diktaturës bënim pjesë në ato familjet e persekutuar, pra që nuk kishin përkrahje. Nëna në shtëpi na mësonte gjuhën italiane me gramatikë, por me shumë kujdes, sepse ishte e ndaluar dhe, siç të thashë, ne ishim të shtypur. (1, femër, Tiranë).

Meqenëse ishim të persekutura, më vonë nuk m'u dha e drejta e studimit për mjekësi, por për agronomi. (1, femër, Tiranë).

Por në periudhën e diktaturës, duke qenë i talentuar edhe në punë ka patur disa disavantazhe. Unë në vitin 1966 mbarova studimet në biokimi dhe më pas kam punuar 25 vite në gjimnazin e Peqinit. Vetëm në vitin 1989 kur komunizmi filloi të lëkundej, më sollën në Tiranë (4, mashkull, Tiranë).

Nëse flas për kohën kur unë jam rritur, mund të them se unë dhe familja ime kemi vuajtur nga regjimi komunist i Enver Hoxhës. Në atë kohë arti në përgjithësi dhe kinematografia e teatri në veçanti, kanë pasur një zhvillim të hovshëm, zhvillim me të cilin shqiptarët mund të mburren edhe sot e kësaj dite. (7, mashkull, Tiranë).

4.7.4. Bilinguizmi dhe arritjet në jetë

Arritjet dhe sukseset në jetë vijnë si pasojë e shumë faktorëve. Pjesa më e madhe e personave të intervistuar rezultoi se pjesën më të madhe të arritjeve në jetë e lidhnin me faktin që ishin persona me dy gjuhë që në lindje. Tre faktorët kryesorë që gjetjet cilësore sjellin në këtë fushë, vijojnë si mëposhtë:

- Gjuha e huaj është një pasuri që më ka hapur lehtësisht dyert në jetë për shkollim dhe punësim.
- Bilinguizmi dhe gjuhët e mësuara në vazhdim kanë bërë që të kem më shumë akses në informacion.
- Bilinguizmi sjell lehtësira në socializim. Njohja e një gjuhë bën që të njohësh dhe pjesë të kulturës së një kombi dhe të pranohesh më lehtësisht nga të huajt.

Ja si janë shprehur personat e intervistuar:

Për mua gjithçka që kam arritur në jetë lidhet me faktin e të rriturit si bilingual. Do të thoja që të zhvillon edhe mendim demokratik, tolerat, fleksibël dhe të jep paqe. Kjo të jep më shumë mundësi të kontribuosh në fusha të ndryshme dhe aty ku shfaq talente personale. Bilinguizmi më ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Mësimi i gjuhëve në këndvështrimin tim është një botë më shumë, një hapësirë e re përpara meje. Mendoj se të jep edhe një rrezatim tjetër. (3, femër, Tiranë).

Patjetër që bilinguizmi ka një ndikim shumë të madh dhe pozitiv në arritjet e mija në jetë. Unë e kam quajtur veten me fat që kam patur prindër aq të shkolluar dhe me kulturë të gjerë. Familja ka luajtur një rol të madhe në ndërtimin tim si person, por edhe unë kam patur talente

dhe aftësë që më kanë ndihmuar të eci përpara. (3, mashkull, Tiranë).

Patjetër që është avantazh. Unë mendoj se gjuhët e huaja janë një pasuri për personin që i zotëron. Kjo pasuri ka një vlerë më të shtuar kur personi rritet si bilingual. Njohja e gjuhëve të huaja të jep akses në leximin e literaturës së huaj dhe sidomos në atë kohë jo të gjithë e kishin këtë mundësi. (7, mashkull, Tiranë).

4.7.5. Çfarë sjell njohja e një gjuhe të dytë që në vegjëli

Nga analiza e intervistave rezultoi se njohja e dy gjuhëve që në vegjëli ka shumë avantazhe. Automatikisht dhe në mënyrë të natyrshme njihet edhe një kulturë e dytë që sjell lehtësira në socializim dhe komunikim në vazhdimësi për vetë personin. Për personat bilingual që kanë jetuar në kohën e periudhës komuniste në Shqipëri, bilinguizmi i hapte rrugë drejt leximit dhe përkthimit të literaturës së të huaj perëndimore.

Ja si janë përgjigjur të intervistuarit në lidhje me këtë çështje:

Ne si fëmijë morëm një kulturë të dytë, pa e kuptuar as vetë. Ajo vjen natyrshëm kur rritesh si një fëmijë bilingul. (1, femër, Tiranë).

E thashë edhe më lart se si një person që njeh gjuhën e një vendi ke përparësi jo vetëm si folës dhe frekuentues i gjuhës, por edhe në udhëtime ti kupton dhe mëson edhe zakone, edhe bëhesh pjesë e kulturave të këtyre vendeve. (5, mashkull, Tiranë).

Arsimi për mua ishte si një byzylyk me vlerë në të gjitha stuhitë e jetës. (1, femër, Tiranë).

...në mars të vitit 1934 përktheu nga anglishtja librin “Shqiptarët” të Xhorxh Fred Uilliams, i cili ishte ministër i Amerikës në Greqi dhe Mal të Zi, si dhe mbikëqyrës i komisionit ndërkombëtar në Durrës. Ai përktheu gjithashtu librin “Asgjë e re në Frontin e Perëndimit” etj. Bilinguizmi, përveç njohjes së gjuhës sjell dhe shumë gjëra pozitive për vetë personin, si njohja e kulturës, njohja e një botëkuptimi tjetër etj. (6, femër, Tiranë).

4.7.6. Mësimi i gjuhës së huaj nga të rinjtë


Në fundin e intervistës personat bilingual u pyetën se çfarë mendimi ndajnë në lidhje me mësimin e gjuhëve të huaja nga të rinjtë. Nga analiza e intervistave rezultoi se të gjithë mendonin se mësimi i gjuhëve të huaja në botën e sotme që po bëhet gjithnjë e më shumë globale, është një domosdoshmëri dhe ndihmon edhe në zhvillimin e trurit. Më poshtë po rendisim disa nga përgjigjet e marra në intervistat e realizuara:

Mësimi i gjuhëve të huaja nga të rinjtë është një gjë e mirë. Të rinjtë duhet të mësojnë gjuhë të huaja dhe të jenë sa më mendjehapur. Sot mundësitë janë të shumta dhe ata janë të lirë për të mësuar dhe për të lëvizur nëpër botë. Sot edhe shkollat janë në gjuhë të huaj dhe kjo është një gjë e madhe. Edhe popujt po lëvizin, po shkojnë me pushime, studime, vizita etj. (6, femër, Tiranë).

Sa më shumë gjuhë të huaj të mësojnë, aq më të lehtë e kanë në jetë për të hapur dyert e suksesit. Në ditët e sotme anglishtja është një domosdoshmëri, italishten pothuajse e njohin të gjithë të rinjtë në Shqipëri. Pra, kërkesa për njohjen e gjuhëve të huaja shkon përtej këtyre dy gjuhëve. Unë inkurajoj mësimin e gjuhëve të huaja, pasi truri është një muskul, dhe si i tillë, sa më shumë të stërvitet me dije, aq më gjatë do të jetë i shëndetshëm. (7, mashkull, Tiranë).

Handikapi i atij që zotëron vetëm një gjuhë, mbetet i konsiderueshëm në shoqërinë e sotme globale. Fëmijëve të mi unë u kam mësuar gjuhën italiane, përkrah shqipes që në vegjëli. Pra, ata janë rritur si bilingual. Më vonë kanë mësuar edhe anglishten, gjuhën e kohës. (8, mashkull, Tiranë)

Skemë e suksesit dhe ndikimit të bilinguizmit



© Alma Vögeli, 2015

KAPITULLI V: DISKUTIMI

Ky sesion përmban krahasimin e rezultateve të studimit me pika të caktuara referimi, të cilat janë paraqitur në rishikimin e literaturës dhe interpretimin e rezultateve. Analiza e të dhënave të studimit do të bëhet duke krahasuar rezultatet që kanë rezultuar nga ky studim në analogji me rezultate të përftuara nga studime të tjera që lidhen ngushtësisht me çështjen e marrë në studim. Në vijim të çështjes do të analizohen avantazhet që kanë patur personat bilingualë në botë si fakt i të qenët bilingual dhe sa avantazhe kanë patur personat bilingual të lindur në Shqipëri si fakt i të qenët bilingual. Gjithashtu evidentimi i arritjeve të tyre në jetë është një çështje tjetër që do të jetë pjesë e diskutimit.

5.1. Mësimi i gjuhëve të huaja

Në ditët e sotme ne jemi të rrethuar nga gjuhët e huaja kudo që shkojmë. Për shumë njerëz tashmë pasuria linguistike nuk përfshin njohjen e një gjuhe të huaj, por më shumë se aq. Në fakt pjesa më e madhe e popullsisë së botës është bilinguale ose multilinguale. Në një studim të bërë nga Komisioni Evropian në viti 2006, rezultoi se 56% e të anketuarve ishin në gjendje të flisnin një gjuhë tjetër përveç gjuhës së nënës, pra ishin bilingual.

Në disa shtete përqindja rezultoi të ishte shumë më e lartë se aq. Në Luksemburg dhe Lituanë 99% e popullsisë rezultoi të flisnin dy gjuhë. Edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët gjerësisht konsiderohen si një vend monolingual, rezultoi se 50% e popullsisë mbi moshën 5 vjeç zotëronin dhe flisnin një gjuhë të dytë. Kjo shifër rezulton në vitin 2007. Por së fundmi studimet flasin për një rritje në 140%. Një gjuhë e dytë përveç anglishtes po përdoret gjerësisht në vendet e punës, kurse, trajnime, shkolla etj. Associated Press raporton se mbi 66% e fëmijëve në të gjithë botën po rriten si trilingual.¹

Në këtë studim një çështje e veçantë i është kushtuar aftësisë dhe dëshirës së subjekteve bilingual dhe monolingual për të mësuar gjuhë të huaja. Nga studimi rezultoi se pjesa më e madhe e subjekte bilinguale kishin njohuri dhe flisnin dy gjuhë të huaja përveç dy gjuhëve të mësuara në fëmijëri dhe rreth 35% e tyre flisnin më shumë se dy gjuhë të tjera.

1 http://dana.org/Cerebrum/2012/The_Cognitive_Benefits_of_Being_Bilingual/#sthash.HdGZWqgK.dpuf

Pra, si përfundim nga ky studim mund të thuhet se personat bilingual kanë një avantazh në mësimin e gjuhëve të tjera të huaja. Duke njohur dhe mësuar dy gjuhë që në fëmijëri truri i tyre është i stërvitur dhe me një mundësi dhe aftësi më të madhe për të mësuar gjuhë të tjera të huaja. Për personat e rritur si bilingual mësimi i një gjuhe të tretë vjen në mënyrë të natyrshme dhe pa ndonjë përpjekje të madhe.

Përfitimet që vijnë në aftësinë kognitive si pasojë e të rriturit me dy gjuhë tek personat bilingual i ndihmon ato në mësimin e një gjuhë të tretë ose të katërt me më shumë lehtësi. Personat bilingual kanë avantazh në mësimin e një gjuhe të tretë, pasi truri i tyre fokusohet tek thelbi i informacionit të ri, ndërkohë që reduktojnë interferencat me gjuhët që tashmë njohin. Kjo aftësi e trurit e fituar që në vegjëli i ndihmon personat bilingual të mësojnë më lehtë një gamë të gjerë fjalori të ri krahasuar me personat monolingual, truri i të cilëve nuk është kaq i stërvitur dhe informacioni i ri synon të konkurrojë me atë të vjetrin. Kjo specifikë duhet theksuar se vlen vetëm për mësimin e gjuhëve të huaja.

Për më tepër, përfitimet që lidhen me përvojën dygjuhësore duket që fillojnë shumë herët, që në fëmijërinë e hershme. Studimet kanë treguar se bilinguizmi ka ndikim shumë pozitiv në vëmendjen dhe menazhimin e konflikteve në foshnjëri, në moshën 7 muajshe. Në një studim, hulumtuesit morën fëmijë të rritur në shtëpi ku flitej një gjuhë dhe fëmijë dygjuhësh. Ideja e ushtrimit ishte që kur fëmijët dëgjonin një zë që tingëllon, një kukull u shfaqej në njërin anë të një ekrani. Më pas në një fazë të dytë, kukullat filluan të shfaqeshin në anën e kundërt të ekranit. Në mënyrë që të merrnin një shpërblim, foshnjat duhet të përshtasnin rregullin që kishin mësuar me situatën e re. Nga studimi rezultoi se vetëm foshnjat dygjuhëshe ishin në gjendje për të mësuar me sukses këtë rregull. Këto rezultate sugjerojnë se edhe për fëmijët shumë të vegjël, rritja në një mjedis shumëgjuhësh jep avantazhe që shkojnë përtej zotërimit të një gjuhe të dytë.

5.2. Inferioriteti nga padija

Në ditët e sotme flitet se dija është pushtet dhe për ta përshtatur këtë fakt, në këtë studim është synuar të mblidhen të dhëna përsa i përket çështjes se a i bën personat bilingual të jenë ndjerë superior fakti se dinin të flisnin dy gjuhë krahasuar me shokët ose kolegët e

tyre. Nga ana tjetër është synuar të studiohet e njëjta çështje, duke pyetur personat monolingual se a janë ndjerë inferiorë me bashkëmoshatarë ose kolegë të tyre që dinin të flisnin dy gjuhë. 69% e subjekteve janë përgjigjur se janë ndjerë inferiorë për shkak të padijes dhe 29% janë rezulton se nuk janë ndjerë inferiorë. Në studim është synuar që kjo çështje të eksplorohej më tej dhe është vijuar me një pyetje të hapur në pyetësor për të eksploruar shkaqet që i bënë të ndjehen inferiorë. Nga studimi rezultoi se njerëzit ndjehen inferiorë përpara një personi bilingual, pasi nuk e njohin gjuhën që ai flet.

“E kam bezdi kur nuk kuptoj çfarë thuhet në një ambient ku jam prezent.” (Librazhd, femër, 28 vjeç).

“Sepse nuk di të flasësh kur shoqet komunikojnë dhe sidomos kur kemi ndonjë seminar në gjuhë të huaj” (Pogradec, femër, 54 vjeç).

Një fakt interesat i gjeneruar në studim është që personat monolingual të cilët kanë patur një shok bilingual që në fëmijëri, kanë ndjerë që shoku bilingual ishte më i avancuar në arritjet në mësim.

Ja si shprehet një prej subjekteve monolingual të studimit:

“Shoku im i fëmijërisë ishte bilingual. Ai gjithmonë ishte një hap përpara meje në mësim”, (Tiranë, burrë, 33 vjeç)

5.3. Gjuha e huaj, një domosdoshmëri në shoqërinë globale

Gjuha e huaj dhe specifikisht anglishtja, konsiderohen si gjuha e teknologjisë. Pjesa më e madhe e pajisjeve elektronike, p.sh., kompjuterat e kanë gjuhën angleze bazë të tyre. Nga studimi rezultoi se një faktor tjetër që i bënë personat monolingual të ndjehen inferiorë përpara një personi bilingual është dhe mos njohja se si funksionojnë mjetet dhe pajisjet elektronike.

“Për t’iu përshtatur teknologjisë dhe rrjeteve sociale, për të lundruar në internet dhe shkarkuar informacione duhet njohuri në gjuhë të huaj.” (Tepelenë, femër, 60 vjeç).

Dita-ditës në Shqipëri po zhvillohen shumë seminare dhe trajnime. Shumë herë ftohen lektorë të huaj për të ndarë eksperiencën dhe përvojën e tyre. Për personat monolingual mosnjohja e një gjuhe të dytë përbën një pengesë në këtë aspekt.

Në fakt, anglishtja tani është gjuha e dytë më e folur gjerësisht në botë, duke tejkaluar të gjitha gjuhët e tjera. Në konkluzion të kësaj çështje mund të thuhet se edhe në Shqipëri per-

sonat monolingual ndjehen të përjashtuar disi nga teknologjia dhe informacioni si pasojë e handikapit në një gjuhë të huaj të dytë. Kjo vlen më shumë për personat mbi 45 vjeç.

Gjithashtu, kërkesat e punës për të qenë të përditësuar me të rejtat e fundit kërkon pjesëmarrjen në trajnime dhe seminare të vazhdueshme, por mosnjohja e gjuhëve të huaja, sidomos anglishtes, sjell një moskuptim të lektorit që mund të jetë i huaj. Këtë pengesë e sjellin dhe e vënë më në pah edhe rezultatet e këtij studimi. Një prej subjekteve shprehet si më poshtë:

“Sepse nuk di të flasësh kur shoqet komunikojnë dhe sidomos kur kemi ndonjë seminar në gjuhë të huaj” (Pogradec, femër, 54 vjeç).

5.4. Të flasësh më shumë gjuhë ndihmon në mbajtjen aktive të trurit

Një studim i kryer nga Dr. Thomas Bak, një lektor në Shkollën e Filozofisë, Psikologjisë dhe Shkencave Gjuhësore në Edinburg, mbështet fuqimisht hipotezën se të flasësh më shumë gjuhë ndihmon në zhvillim e trurit. Për disa kohë Bak kishte studiuar raste të demencës në Indi. Ai kishte arritur në konkluzion se demenca ishte më e rrallë tek personat bilingual ose ata që ishin marrë me mësimin e një gjuhe të huaj edhe më moshë më të rritur.

Në studimin e tij më të njohur, Bak studioi 853 pjesëmarrës në vitin 1947, të cilët ishin fëmijë në moshën 11 vjeç. Ritestimi u krye sërish në vitin 2008 dhe 2010, me të njëjtët subjektë, të cilët tashmë ishin në fillimet e të 70-ve.

Nga studimi rezultoi se performanca ishte më e mirë tek personat e rritur me dy gjuhë. Personat që kishin një performancë të dobët në moshën 11 vjeçare rezultoi se ishin në nivele më të ulëta me kujtesën dhe përqendrimin edhe në moshës 70-73 vjeç. Rezultatet treguan gjithashtu, se të mësuarit e një gjuhë të re në moshën e rritur jep ende rezultate në përmirësimin e aftësisë së trurit.²

Këto gjetje u vërtetuan edhe nga ky studim i realizuar në Shqipëri.

Në studim rezultoi se 100% e subjekteve monolingual mendojnë se mësimi i një gjuhe të dytë e zhvillon trurin dhe e vlerësojnë shumë të rëndësishme sidomos në botën e sotme globale këtë gjë. Ky përfundim konfirmohet shkencërisht edhe nga të dhënat e një studimi

2 <https://www.telc.net/tr/hakkimizda/guencel/detail/how-does-learning-a-new-language-improve-your-brain-1.html>

të kryer në vitin 2008 nga Gitit Kave, studiues nga Tel Avivi, në të cilat rezultoi se njohuria e dy ose më shumë gjuhëve ndihmon për parandalimin e humbjes së aftësive njohëse të personave të moshuar mbi moshën 75 vjeç.

Julie Deardorff, në një artikull të datës 7 nëntor 2014, i përforcon gjetjet e studimit për avantazhin e mësimi të gjuhëve të huaja duke cituar si më poshtë:

Mos u merrni me lojërat, për të cilat mendoni se mund t'ju zhvillojnë trurin; të folurit e shumë gjuhëve e ushtron trurin në mënyrë të rregullt.

“Personat bilingualë e përpunojnë informacionin në mënyrë më të efektshme dhe më lehtësisht sesa ata që dinë vetëm një gjuhë, të folurit e më shumë sesa një gjuhë është e dobishme për trurin.” - konstaton në studimin e saj Viorica Marian e Universitetit Veriperëndimor, autore e studimit dhe profesoreshë në departamentin e shkencave të komunikimit dhe çrregullimeve, e Shkollës së Komunikimit.

Studiuesit kanë vënë re se kur truri ushtrohet vazhdimisht në këtë mënyrë, nuk ka pse të mundohet shumë për të kryer detyra kognitive. Avantazhet janë edhe për të tjerët që kanë praktikuar dhe mësuar gjuhë të ndryshme në moshë madhore dhe jo vetëm për personat që zotërojnë dy gjuhë që në vegjëli.

Një tjetër studim i realizuar në Suedi përforcon të dhënat se mësimi i gjuhëve të huaja e mban trurin në veprim. Hulumtuesit suedezë kryen një studim në dy grupet studentësh: një grup që studionin gjuhë të huaja dhe një grup që studionin lëndë vetëm në një gjuhë. Duke përdorur skanime MRI, ata zbuluan se truri i pjesëmarrësve që studionin gjuhë të huaja ishte rritur në madhësi, ndërsa madhësia e trurit e grupit të dytë kishte mbetur i njëjtë. Rritja e trurit ishte kryesisht në hipokampus dhe në koren cerebrale, pjesë të trurit të lidhura me aftësinë për të mësuar gjuhë.

5.5. Bilinguizmi si avantazh për socializim

Komunikimi dhe gjuha janë dy nga mjetet kryesore me anë të të cilave njerëzit lidhen me njëri-tjetrin. Socializimi nis nëpërmjet komunikimit verbal së pari por edhe gjuhës së trupit ose komunikimit jo verbal. Nëse një person nuk kupton gjuhën në një grup të caktuar social, atëherë ai ndjehet i izoluar.

Një prej subjekteve të studimit shprehet:

“Mungesa e njohurive në gjuhë sjell izolim social.” (Tiranë, femër, 48 vjeç)

Bilinguizmi sjell shumë avantazhe për personat bilingual që në fëmijëri. Përveç faktit të diturit dhe njohurit e dy gjuhëve, ka dhe shumë avantazhe të tjera. Personat bilingual para viteve 1990 në Shqipëri kanë gëzuar një status tjetër. Ata janë ndjerë më superiorë.

“Kisha status tjetër.” (Tiranë, femër, 48 vjeç)

“Isha dikushi në kohën time.” (Tiranë, mashkull, 62 vjeç).

Pra, përgjigjet e marra në pyetjet e hapura e konfirmojnë më së miri këtë fakt.

Një tjetër avantazh lidhet me aksesin më lehtë në informacione. Nëse kthehemi sërish prapa në kohë dhe në një sistem tjetër politik, bilinguizmi kishte avantazh lidhur me aksesin në informacion. Ditët e sotme aksesin në informacion është më i madh dhe më i lehtë. Përpara viteve 90-të gjetja e literaturës në gjuhë të huaj ishte më e vështirë. Por nëse nuk kishe njohuri në gjuhët e huaja, aksesin tek ky informacion ishte edhe më i vështirë. Rrethimisht, personat bilingual ishin superiorë krahasuar me ata monolingual, pasi leximi i literaturës së huaj ishte mëse normal për ta. Kjo pohohet edhe nga subjektet bilingual të studimit me përgjigjet e tyre në pyetësor:

“Shpesh kam ditur të komunikoj dhe të lexoj kur shoqet e mia nuk dinin. Kjo më bën të ndihem ndryshe.” (Gjirokastrë, femër, 55 vjeç)

“Mund të lexoja literaturën profesionale nga libra që nuk ishin të përkthyer në shqip.” (Tiranë, mashkull, 48 vjeç)

“Njohja e gjuhëve të huaj të jep gjithnjë e më shumë akses në informacion.” (Tiranë, mashkull, 57 vjeç).

Përgjigjet e mësipërme janë marrë nga persona që kanë jetuar dhe janë shkolluar në periudhën e para viteve 90-të. Por aksesin në informacion vlen dhe për brezin më të ri se ata.

“Kam mësuar më shumë gjëra nga leximi në gjuhë të huaj”, - përgjigjet një vajzë e rritur si fëmijë bilingual. (Shkodër, femër, 23 vjeç)

Si konkluzion, mund të themi se një nga avantazhet e bilinguizmit është aksesin më i shpejtë në informacion dhe literaturë të huaj.

A është në të vërtetë bilinguizmi një avantazh?

Në studimin e saj, Maria Konnikova u thellua në të dhënat se si funksionon gjuha e dytë, pra bilingualizmi, si dhe mblodhi të dhëna nga studime te ndryshme në lidhje me këtë temë.

Në 1922, në “Tractatus Logico Philosophicus”, filozofi Ludwig Wittgenstein shkroi: “Limiti i gjuhës time do të thotë limiti i botës time”. Fjalët që ne kemi në dispozicion ndikojnë në atë që ne shohim dhe sa më shumë fjalë të kemi, perceptimi ynë është edhe më i mirë.

Kur ne mësojmë të flasim një gjuhë tjetër, ne mësojmë të shohim një botë më të madhe.

Shumë studiues modernë të gjuhës bien dakort me këtë premisë. Duke folur shumë gjuhë jo vetëm që na ndihmon për të komunikuar, por gjithashtu dygjuhësia (ose shumëgjuhësia) në të vërtetë mund të japë avantazhe të dallueshme në zhvillimin e trurit. Duke qenë se një fëmijë është i aftë të ndërrojë gjuhët gjatë komunikimit, teoria tregon se ai, gjithashtu, zgjeron zhvillimin e kontrollit qendror ose aftësinë për të menazhuar ato që quhen procese të larta njohjeje, si p.sh.: zgjidhja e problemeve, kujtesa, mendimet. Fëmija bëhet më i aftë për të ndaluar disa reagime, të nxisë të tjerët, dhe përgjithësisht del me një mendje më elastike dhe më të shkathët. Është një fenomen që studiuesit e quajnë *avantazh bilingual*.

Për gjysmën e parë të shekullit të njëzetë, realisht studiuesit menduan që bilingualizmi e vendoste fëmijën në një disavantazh, dicka që prishte I.Q.-në e saj dhe zhvillimin verbal. Por në vitet e fundit, nocioni i avantazhit bilingual nga studimet e kryera ka hedhur poshtë këtë disavantazh dhe këto studime ishin më faktike dhe bindëse, dhe kjo ishte falë punës së kujdeshme të psikologes Ellen Bialystok. Për shumë detyra, duke përfshirë atë që përfshin kujtesën e punës folësit bilingual duket që kanë një avantazh. Në vitin 2012 duke rishikuar provat, Bialystok tregoi se bilingualët në të vërtetë kanë treguar ngritje të kontrollit ekzekutiv, një cilësi që ka lidhje, midis shumë të tjerave, me një performancë më të mirë akademike. Kur vjen fjala për cilësitë e tilla si vëmendja e qëndrueshme gjatë kalimit nga një detyrë në tjetrën në mënyrë të efektshme, tregon që bilingualët përparojnë më tepër. Duket një provë tepër e qartë, ndaj krijoni mundësinë për të rritur fëmijën tuaj duke folur më shumë se një gjuhë.

Studiuesit thonë që të qenët bilingual ka avantazhet e veta dhe këto avantazhe përfshijnë:

- aftësia për të mësuar lehtësisht fjalë të reja,
- aftësia për të luajtur me lojëra fjalësh që rimojnë,
- ndarja e fjalëve në bazë të tingujve që kanë,
- aftësia për të përdorur informacionin në mënyra të reja,
- kategorizimi i fjalëve,
- aftësia për të zgjidhur probleme,
- aftësi të mira në të dëgjuar,
- lidhje me të tjerët.

Të gjitha avantazhet sa më lart konfirmohen edhe nga gjetjet e këtij studimi. Analiza e të dhënave nga intervistat gjysmë të strukturuar dhe pyetësoret e realizuar me personat bilingual rezultuan se personat bilingual e kanë patur shumë të lehtë për të mësuar një gjuhë të tretë ose të katërt. Rrjedhimisht, kjo i ka ndihmuar në rritjen e aftësisë për të përdorur informacionin në mënyra inovative dhe më të përparuara, krahasuar me bashkëmoshatarët ose kolegët në punë.

Më tej, materialet e mbledhura nga “Creativity and Bilingualism”, “Cognitive Advantages of Bilingual Five Year Olds”, “A Bilingual Advantage in TaskSwitching”, “Bilingualism Reduces Native Language Interference During Novel Word Learning” dhe “Good Language Switchers Are Good Task Switchers”, dhe librat që rezultojnë më provokative me tituj të tillë si “The Bilingual Edge” dhe “Bilingual Is Better”, sugjerojnë që të rrisësh një fëmijë bilingual, në pjesën më të madhe është një recetë në rritjen e një fëmije të sukseshëm.

Rasti i Angela de Bruin

Nga mosha 11, Angela de Bruin mund të fliste dy gjuhë. Kishte lindur në 1998 në Nijmegen, një qytet i vogël në Holandë. De Bruin fliste holandisht në shtëpi, ndërsa në shkollë fliste anglisht. Ajo filloi të magjepsej nga bilingualët dhe filloi të lexonte në mënyrë të zellshme avantazhet që mund të përfitoje duke qenë njohës i mirë dhe se sa mund të sigurosh kur flet në më shumë se një gjuhë në kolegji. Ajo studioi, gjithashtu, edhe linguistikën

neuroscience. Në vitin 2012, de Bruin u regjistrua dhe u diplomua në psikologji në Universitetin e Edinburgut me qëllimin që të bënte lidhjen midis njohjeve dhe bilinguizmit. Ajo u regjistrua në këtë program, e përkushtuar për të studiuar se si truri i saj bilingual ishte përshtatur për patur sukses. “Pata përshtypjen që kishte një ndikim shumë të fortë të bilingualizmit në funksionin ekzekutiv”, - më ishte shprehur së fundmi de Bruin. Më pas ajo fillon të kryejë studimin e saj të parë. Zakonisht për të testuar një avantazh në funksionin ekzekutiv ju jepni një version me një detyrë ku njerëzit duhet të injorojnë disa stimulime të caktuara, dhe në mënyrë selektive duhet të fokusohen tek të tjerat. P.sh., zakonisht përdoret detyra e Simonit, ku u tregohet (shpesh) foto që mund të jenë në anë të majtë ose në anë të djathtë të ekranit. Nëse ju shikoni një shiqetë në krahun e djathtë, ju shtypni butonin e djathtë. Nuk ka rëndësi se në cilën krah të ekranit shfaqet shigjeta; rëndësi ka se në cilin drejtim është drejtuar. Zakonisht, njerëzit kanë një reagim më të shpejtë në provat që kanë një harmoni – kur shigjeta në krahë të djathtë shfaqet në krahë të djathtë dhe e kundërta. Bilingualët supozohet të kenë një avantazh në provat që nuk ekziston harmonia.

Një nga zonat ku shfaqet avantazhi bilingual më i qëndrueshëm nuk ka lidhje me një detyrë apo aftësi të veçantë; është një përfitim i përgjithshëm që duket se ndihmon trurin të plakët. Të rriturit që flasin shumë gjuhë duket se u rezistojnë efekteve të çmendurisë më tepër se sa mund t’u rezistojnë monolingualët. Kur Bialystok studioi të dhënat e një grupi të rriturish që ishin regjistruar në një klinike në Toronto me ankesa të kujtesës apo të gjërave të ngjashme, zbuloi se bilingualët i shfaqnin simptomat e çmendurisë 4 vjet më vonë se monolingualët. Në një studim në vazhdim, por me një grupim tjetër pacientësh që këtë herë ishin të prekur nga sëmundja Alzheimer, ajo bashkë me kolegët e saj zbuluan se pavarësisht nivelit të dijeve, profesionit që kishin pasur më parë apo të edukimit të tyre, bilingualët u diagnostikuan 4.3 vjet më vonë se monolingualët. Me fjalë të tjera, me sa duket bilingualët kanë një efekt mbrojtës në rënien e tyre. Kjo do të ishte në përputhje me një historik të të mësuarit; ndaj ne e dimë që mbajtja e vetes të shkathët në moshë të vjetër është një prej mënyrave më të mira për t’u mbrojtur kundër çmendurisë (rrit përdorimin

e fjalëkryqeve). Kur truri vazhdon së mësuari, ashtu siç duket që vepron tek njerëzit që mësojnë më shumë se një gjuhë, ka më shumë kapacitet në mbajtjen e funksionimit në një nivel më të lartë. Kjo në vetvete është një arsye e mjaftueshme për t'ju shtyrë në mësimin e një gjuhe të dytë, të tretë, të katërt, apo të pestë – dhe të vazhdosh t'i mësosh për aq kohë sa ti ke mundësi. Avantazhi bilingual ndoshta nuk mund të shfaqet pikërisht në fazën që studiuesit e përcaktojnë në ditët e sotme, por në një nivel themelor. Përfitimet reale të bilingualizmit mund të jenë shumë më të rëndësishme.

5.5.1. Avantazhet e të qenët bilingual

Studiuesit thonë që të qenët bilingual ka avantazhet e veta dhe këto avantazhe përfshijnë:

- aftësia për të mësuar lehtësisht fjalë të reja,
- aftësia për të luajtur me lojëra fjalësh që rimojnë,
- ndarja e fjalëve në bazë të tingujve që kanë,
- aftësia për të përdorur informacionin në mënyra të reja,
- kategorizimi i fjalëve,
- aftësia për të zgjidhur probleme,
- aftësi të mira në të dëgjuar,
- lidhje me të tjerët .

Sipas Studimit të Komunitetit Amerikan (American Community Survey), më shumë se një në 5 individë mbi moshën 5 vjeç (21%) flasin një gjuhë tjetër në shtëpi përveç anglishtes. Ky numër i folësve bilingual mendohet të rritet në vitet e ardhshme.

Fëmijët, të cilët po mësojnë të flasin dy gjuhë, ndjekin një model të mësuari. Tingujt e gjuhës së parë mund të ndikojnë në mënyrën se si ata e mësojnë dhe e përdorin gjuhën e dytë. Është e lehtë të mësosh tinguj dhe fjalë kur gjuhët që po mëson kanë ngjashmëri njera me tjetrën. Fjalët dhe tingujt më të vështirë do të mësohen me kalimin e kohës.

Fakt: Çrregullimet e komunikimit prekin më shumë se 42 milion amerikanë. Nga këta, 28 milionë kanë humbje të dëgjimit dhe 14 milion kanë çrregullime në të folur ose të gjuhës. Nëse një fëmijë ka probleme me të folurin ose me gjuhën, ky problem do të shfaqet në të dyja gjuhët. Sidoqoftë, këto probleme nuk shkaktohen aspak nga mësimi i dy gjuhëve.

Nëse keni kontakt me një fëmijë, i cili po mëson një gjuhë të dytë dhe të shqetëson fakti i të folurës apo zhvillimit të gjuhës, ASHA rekomandon të kontaktoni me një patolog për dygjuhësinë. Nëse nuk keni mundësi të takoni një patolog, flisni me dikë që i di rregullat dhe strukturat e të dyja gjuhëve dhe i cili ka edhe një përkthyes.

Personat bilingual që kanë jetuar edhe në periudhën e sistemit komunist kanë patur disa avantazhe krahasuar me ata monolingual. Ja si është shprehur një prej të intervistuarve të marrë në studim:

“Mendoj se për periudhën që merrni në analizë kur përkthimet ishin edhe më të pakta, vetëm me gjuhën shqipe nuk mund të bëheshe njeri i kulturuar, dhe aq më tepër specialist i mirë në çfarëdolloj dege. Handikapi i atij që zotëron vetëm shqipen mbetet i konsiderueshëm. Pra, mund të themi që njohja dhe zotërimi i gjuhëve të huaja të hap më shumë dyer suksesi për arritjet në jetë. Në shekullin e 21-të në të cilin jetojmë, zotërimi i gjuhëve të huaja është një faktor kyç. Globalizimi ka bërë që bota të konsiderohet si një e tërë dhe shumë barrierat kufijnsh të bien poshtë. Por gjuha është ajo që vendos ura lidhëse. Në këto kushte, mosnjohja e gjuhëve të huaja mund të konsiderohet pa asnjë dyshim si një nga handikapet më të mëdha. Nga ana tjetër, personat që zotërojnë më shumë gjuhë të huaja kanë më shumë mundësi komunikimi dhe rrjedhimisht më duhet të pohoj me bindje se të qenët bilingual, e aq më tepër trigjuhësh, është një premisë dhe faktor shumë pozitiv dhe kjo është vërtetuar nga dijetarë dhe studiues të këtyre çështjeve. (Mashkull, Tiranë 08)

Madje tendenca aktuale në vendet e zhvilluara është ta nisin mësimin e gjuhës së huaj në moshat sa më të vogla, me mjete, metoda e pikësynime të përcaktuara qartë.

5.5.2. Përfitimet që sjell në karrierën tuaj, fakti i të qenët bilingual³

Në vijimësi të avantazheve të bilinguzmit do të përmendim shkurtimisht rastin e Ana Flores, Universiteti i Feniksit, SHBA, 4 qershor 2015.

Ana u rrit si një fëmijë bilingual duke mësuar dhe folur anglisht dhe spanjisht, si pjesë e pandarë e jetës së saj së përditshme. Në vitet 70, prindërit e saj as që e mendonin



Figura 6, Ana Flores

Marrë nga: <http://leanin.org/stories/ana-l-flores/>

3 Marrë nga: <http://superate.phoenix.edu/article/how-bilingualism-benefits-your-career/>

se fakti i të rriturit të Anës si fëmijë bilingual do të ishte faktori kyç në karrierën e saj si sipërmarrëse. Aftësia për të komunikuar si në anglisht, ashtu edhe në spanjisht, është shumë e dobishme për të konkuruar sot në botën e biznesit të shekullit të 21-të. Sot, është i padiskutueshëm fakti që të qenët bilingual apo multilingual në çfarëdolloj kombinimi gjuhësh, është një aftësi jete shumë e çmuar, e cila hap dyer kulture, profesionale dhe kognitive.

Më lejoni të eksplorojmë tre përfitime profesionale kyç, në aftësinë e të diturit më shumë se një gjuhë.

1. Rritje e numrit të mundësive

Punëdhënësit, ndërkohë që të punësojnë, i kanë sytë tek aftësitë dhe në rrjedhshmërinë e përdorimit të një gjuhe të dytë, si një karakteristikë dobiprurëse për ta. Në fakt, nga një studim i kryer në “careerbuilder.com” rreth fjalës “bilingual”, u gjetën 14 097 punë të renditura brenda 30 ditëve të fundit. Nga këta, 2 081 ishin punë si shitëse, 1 206 në infermieri dhe 280 si mikpritëse në hotel, tre industri këto që kërkojnë individë të aftë për një kontakt apo komunikim të përditshëm dhe të drejtpërdrejtë me njerëz nga vende të ndryshme, ku të qenët e aftë për të komunikuar në mënyrë të efektshme është çelësi i karrierës. Nëse në CV-në tuaj përfshini bilingualizmin si një nga aftësitë tuaja më të mira, veçanërisht kur bëhet fjalë për kërkesa pune në industritë me në qendër klientin, atëherë keni për ta parë që do të jeni një shkallë më lart nga kolegët e tjerë, të cilët mund të mos ta kenë këtë mundësi

2. Më shumë mundësi për një rrogë më të lartë

Për momentin, nuk ka një studim që bën lidhjen e drejtpërdrejtë të një norme më të lartë të pagesës për të gjithë punëmarrësit, me faktin e të qenët bilingual. Sidoqoftë, ashtu siç është theksuar në një artikull në “Forbes.com”: “Njohja e më shumë se një gjuhe, i shton vlerë kapitalit tuaj njerëzor, duke i rritur më shumë shumën e gjasat e mundësive financiare me kalimin e kohës.” Fakti i thjeshtë se ju si bilingual jeni në gjendje t’i shtoni më shumë vlerë punëdhënësit tuaj, duke qenë në gjendje të fitoni më shumë njerëz, dhe i cili mund t’ju bëjë të “kapërceni” nëpër më shumë mundësi për rritjen tuaj, pra, ku përfshihet njohja

e një gjuhe të dytë, ju bën të jeni një kandidat mjaft i mirë për të diskutuar rreth një roge më të lartë dhe për t'u ngjitur një shkallë më lart në karrierën tuaj.

3. Mundësitë për lidhje, kultura dhe udhëtime

Sa më shumë globalë të bëhemi dhe sa më shumë lidhje të krijojmë, falë medias sociale dhe lehtësimit të udhëtimeve, aq më shumë gjuhët do të bëhen një mjet që hap dyer dhe ndërton ura të reja. Të qenët bilingual apo multilingual ju ofron më shumë alternativa për të zgjeruar shtegun e karrierës tuaj edhe në shkallë ndërkombëtare, qoftë duke punuar jashtë vendit tuaj ose thjesht duke qenë në gjendje të kryeni detyra për të cilat ju nevojitet të udhëtoni, duke hapur kështu tregje dhe lidhje të reja brenda për brenda grupeve të ndryshme kulturore. Zotërimi i dy ose më shumë gjuhëve të hap shumë dyer. Për më tepër, ju mund të rrisni potencialin tuaj edhe më shumë, me anë të një arsimi “online” ose duke kryer një shkollë për një fushë ku gjuhët që ju zotëroni janë të kërkuara.

5.6. Bilinguizmi dhe ndikimi pozitiv në shëndetin mendor

Nga të dhënat e studimit rezultoi se mësimi i një gjuhe të huaj e ndihmon trurin duke e mbajtur në veprim aktiv. Truri është një muskul dhe si i tillë duhet të mbahet në gjendje pune duke e stërvitur. Leximi, mësimi i njohurive dhe gjuhëve të reja është një mënyrë shumë efektive. Më poshtë do të eksplorohet se cilët janë faktorët që ndikojnë në mësimin e një gjuhet të re dhe si funksionon në sistemin e trurit mësimi i kësaj gjuhe të re.

Ekziston një luhatje e konsiderueshme e shkallës në të cilën individët mësojnë gjuhët e dyta, si dhe në nivelin gjuhësor që ata përfundimisht arrijnë. Disa nxënës mësojnë më shpejt, deri në atë pikë sa arrijnë një shkallë të të folurit si vendasit të cilët flasin atë gjuhë. Por ka të tjerë që mësojnë më ngadalë dhe ngecin që në fazat e para të mësimin të gjuhës, pavarësisht se ata jetojnë në vendin ku gjuha flitet për vite me radhë. Arsyeja për këtë çekuilibrim u prek me studimin e aftësisë së mësimin të gjuhës, studim që u krye në 1950, dhe më vonë me studimet mbi nxënësit e mirë në mësimin e gjuhës, i kryer në vitin 1970 në USA. Kohët e fundit studimet janë përqendruar në një numër faktorësh të ndryshëm, që ndikojnë mësimin e një gjuhe nga nxënësi, veçanërisht në strategjinë e përdorur,

ndikimet shoqërore, personalitetin, motivimin dhe ankthin. Lidhja ndërmjet moshës dhe aftësisë për të mësuar gjuhët ka qenë gjithashtu një temë e një debati afatgjatë.

5.6.1. Mosha

Çështja e moshës u prek fillimisht me hipotezën e periudhës kritike. Versioni i caktuar i kësaj hipoteze theksonte që ka një cak moshe, rreth moshës 12, pas së cilës nxënësit e humbasin aftësinë për të mësuar plotësisht një gjuhë. Por ky version i caktuar në lidhje me mësimin e një gjuhe të dytë u hodh poshtë që atëherë, pasi, nga vëzhgimet që u kryen, nxënësit e rritur në moshë kishin arritur një nivel shqiptimi të gjuhës, në ngjasim me folësit vendas të asaj gjuhe dhe madje edhe një rrjedhshmëri në të folur. Megjithatë, përgjithësisht, nxënësit e rritur në moshë të cilët mësojnë një gjuhë të dytë, rrallëherë arrijnë shkallën e rrjedhshmërisë në të folur, krahasuar me nxënësit në moshë të vogël, edhe pse duken se përparojnë më shpejt në fazat fillestare të të mësuarit. Kjo ka çuar në spekulimin se mosha nuk është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me faktorë të tjerë më themelorë, të cilët ndikojnë në mësimin e gjuhës.

5.6.2. Strategjitë

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar strategjive që përdorin nxënësit për të mësuar një gjuhë të dytë. Ka rezultuar se strategjitë kanë një rëndësi kritike, aq shumë sa që kompetenca strategjike është sugjeruar si një përbërës i rëndësishëm i kompetencës komunikuese. Strategjitë zakonisht ndahen në strategji të të mësuarit dhe strategji të komunikimit, pa anashkaluar faktin që ka edhe mënyra të tjera për t'i kategorizuar ato. Strategjitë e të mësuarit janë teknika që përdoren për të përmirësuar mënyrën e të mësuarit, të tilla si përdorimi i fjalorit. Strategjitë e komunikimit janë strategji që një nxënës përdor për të përcjellë kuptimin e asaj që ai thotë, edhe nëse ai nuk e ka në dispozicion formën e saktë të të shprehurit për momentin. Për shembull, përdorimi i fjalës në anglisht “thing” (gjë), për të shprehur një fjalë specifike, ose duke përdorur mjete joverbale të tilla si gjestet apo shenjat.

5.6.3. Faktorët ndikues

Qëndrimi apo reagimi i nxënësit ndaj procesit të mësimin të një gjuhe të dytë, është iden-

tifikuar si mjaft kritik dhe i një rëndësie të veçantë. Në situatat në të cilat mësohet një gjuhë, është pohuar pothuajse unanimisht, se ankthi luan një rol dëmtues. Një faktor tjetër që ka lidhje me të, personaliteti, ka marrë gjithashtu vëmendjen e duhur. Ka pasur gjithashtu diskutime rreth efekteve të personaliteteve “extravert” dhe “introvert”. Sidoqoftë, nga një studim i kryer ka rezultuar se nuk kishte ndryshime të dukshme ndërmjet tipave “extravert” dhe atyre “introvert” në mënyrën se si ata e arrinin suksesin në mësimin e një gjuhe të dytë. Qëndrimet kulturore, të tilla si rolet e gjinisë dhe pikëpamjes së komunitetit ndaj gjuhëve, janë provuar se luajnë gjithashtu një rol kritik. Mësimi i një gjuhe mund të pengohet keqas nga qëndrimet kulturore. Si një shembull për këtë ia vlen të përmendet vështirësia që kanë fëmijët e fisit Navajo, në mësimin e gjuhës angleze. Gjithashtu, motivimi që ka nxënësi që mëson gjuhën luan një rol shumë të rëndësishëm për suksesin e të mësuarit. Studimet kanë treguar në mënyrë të vazhdueshme që motivimi i brendshëm, ose interesi i pastër për vetë gjuhën, është shumë më i efektshëm përkundërt motivimit të jashtëm, siç mund të jetë rasti i mësimin të një gjuhe vetëm për të marrë një shpërblim apo nota të mira.

Faktorët social-kulturore.

Që prej fillimit të disiplinës, studiuesit e kanë pranuar gjithashtu se aspektet sociale luajnë një rol të rëndësishëm. Ka pasur shumë qasje të ndryshme ndaj studimeve social lingvistike për mësimin e një gjuhe të dytë. Dhe për më tepër, sipas Rod Ellis, kjo mori do të thotë që “MGJD social-lingvistike është e “ngopur” me një pështjellim termash, që u referohen aspekteve sociale për mësimin e L2”. Sidoqoftë, një gjë e zakonshme për secilën nga këto qasje, është një refuzimi i gjuhës si një fenomen i pastër psikologjik. Përkundër kësaj, studimi social-lingistik, e shikon kontekstin social në të cilin është mësuar gjuha si themelor, për të kuptuar siç duhet procesin e të mësuarit. Ellis identifikon tre tipa të strukturës sociale, të cilët mund të ndikojnë në mësimin e një gjuhe të dytë: mjedisi social-lingistik, faktorët shoqërorë specifikë dhe faktorët rrethanorë.

Mjedisi social-lingistik i referohet rolit që ka gjuha e dytë në shoqëri, pra, nëse flitet nga shumica apo pakica e popullsisë së vendit; nëse përdorimi i saj është i gjerë, i kufizuar

vetëm në role të vogla funksionale apo nëse shoqëria është kryesisht bilinguale ose monolinguale. Ellis, gjithashtu, përmend edhe dallimin nëse gjuha e dytë është mësuar në një mjedis të natyrshëm apo në një mjedis arsimor.

Faktorët shoqërorë specifikë që mund të ndikojnë në mësimin e një gjuhe të dytë përfshijnë moshën, gjininë, klasën shoqërore dhe identitetin etnik, ku me identitet etnik kuptojmë atë që ka marrë më shumë vëmendje studimore.

Faktorët rrethanorë janë ata faktorë që variojnë ndërmjet çdo ndërveprimi shoqëror. Për shembull, një nxënës mund të përdorë një gjuhë më të sjellshme me dikë që ka një status më të lartë në shoqëri dhe një gjuhë më informale kur komunikon me shoqërinë.

Për të shpjeguar ndikimin e efekteve shoqërore në mësimin e gjuhës, janë zhvilluar disa modele. Modeli i Përshtatjes i Schumann, propozon që shkalla e zhvillimit të nxënësit dhe niveli përfundimtar i arritjes së gjuhës është një funksion i “distancës shoqërore” dhe “distancës psikologjike” ndërmjet nxënësit dhe komunitetit që përdor gjuhën e dytë. Në modelin e Schumann, më të rëndësishmit janë faktorët shoqërorë, por, gjithashtu, një rol luan edhe shkalla në të cilën nxënësit ndihen më rehat kur mësojnë gjuhën e dytë. Një model tjetër social-linguistik është edhe modeli social-arsimor i Gardnerit, i cili u krijuar për t’i dhënë shpjegim mësimin të gjuhës në klasë. Modeli ndërgrupor propozon “gjallërinë etnolinguistike” si një teori kyç për mësimin e gjuhës së dytë. Socializimi gjuhësor është një qasje me premisën që “njohuria gjuhësore dhe njohuria kulturore ndërtohen përmes njëra-tjetrës”, qasje të cilës iu kushtua një vëmendje e madhe pas vitit 2000. Së fundi, teoria e identitetit shoqëror e Norton, është një përpjekje për të vendosur në një mënyrë sistematike marrëdhënien ndërmjet pushtetit, identitetit dhe mësimin të gjuhës. (Vögeli, Alma 2013).

5.6.4. Interferencat

Në shkencën e gjuhësisë ashtu si edhe në mësimin e gjuhëve, një aspekt i rëndësishëm është edhe interferenca e gjuhëve. Në studimin e gjuhësisë me interferencë nënkuptojmë devijimin apo transferimin e zanoreve, fjalëve apo rregullave se si është formuar fjalia apo pozicionimi i fjalëve në të. Pra, spostimet nga njëra gjuhë në tjetrën (Mackey 1968,

fq. 569). Sipas (Kiehofer dhe Jonekeit 1993, fq. 64) me konceptin interferencë nënkupetohet mbi vendosja e rregullave të të 2 gjuhëve, dhe si pasojë ndodhin gabime në strukturim. Kjo për dëgjuesin e jashtëm i cili nuk e njeh fenomenin kuptohet si gabim në fjali ose në të shprehur.

Por duhet theksuar që në këtë rast të interreferencës nuk flitet për çrregullime të të folurit ose gjuhës, por kjo interferencë vjen si pasojë e ndikimit të gjuhës më të fortë, pra të më suar më mirë, mbi gjuhën më të dobët. Interferencat mund të shfaqen (Kiehofer/Jonekeit 1993) si në gjuhën e shkruar, ashtu edhe në atë të folur dhe varet shumë nga fakti se çfarë rëndësie ka secila gjuhë për individin.

Sipas (Jedik 2002 a) ekzistojnë tri forma me të cilat shfaqen interferencat:

- *Interferenca fonetiko fonologjike*—në këtë pjesë preken bashkëtingëlloret dhe ritmi i fjalëve në fjali. Po ashtu preket dhe intonacioni.
- *Interferenca në morfologjinë sintaksës*—këtu transferohen dhe mbivendosen rregullat dhe modelet sintaksore si në rastin e studiuesit ku gjuha L1 mbi atë të dytë L2, kështu fjalitë duket sikur nuk janë korrekte.
- *Interferenca leksikosemantike*—këtu përfshihet marrja apo tranferimi i disa fjalëve (Jedik 2002.a) nga njëra gjuhë në tjetrën dhe këtu flitet për fjalë që në të dy gjuhët kanë të njëjtin kuptim.

5.7. Bilinguizmi dhe kultura

Fuqia e gjuhës për të reflektuar kulturën dhe ndikimi i të menduarit u propozua për herë të parë nga një gjuhëtar amerikan dhe antropolog, Edward Sapir (1884-1939), dhe studenti i tij, Benjamin Whorf (1897-1941). Hipoteza Sapir-Whorf tha se mënyra se si mendojmë dhe të shohin botën përcaktohet nga gjuha jonë. (Anderson & Lightfoot, 2002, Crystal, 1987; Hayes, Ornstein, dhe Gage, 1987). Raste të dallimeve gjuhësore kulturore evidentohen nëse disa gjuhë kanë fjalë të veçanta për konceptet, ndërsa gjuhët e tjera përdorin disa fjalë për të përfaqësuar një koncept të veçantë. Për shembull, gjuha arabe përfshin shumë fjalë specifike për përcaktimin e një lloji të caktuar të kalit apo të devesë (Crystal, 1987). Për të bërë dallime të tilla në anglisht, ku fjalë të veçanta nuk

ekzistojnë, do të përdoren mbiemra për t'u parapritë koncepteve “etiketë”, të tilla si çerek kalë ose kalë qerre.⁴

Përveç faktit që një person bilingual njih dy gjuhë, automatikisht ai njih dhe dy kultura. Në 1922, në “Tractatus Logico Philosophicus”, filozofi Ludwig Wittgenstein shkroi: “Limiti i gjuhës time do të thotë limiti i botës time.” Fjalët që në kemi në dispozicion ndikojnë në atë që ne shohim dhe sa më shumë fjalë të kemi, perceptimi ynë është edhe më i mirë. Kur ne mësojmë të flasim një gjuhë tjetër, ne mësojmë të shohim një botë më të madhe.” Shumë studiues modernë të gjuhës bien dakort me këtë premisë. Gjuha është një pasuri e cila sjell edhe pasuri kulturore për personin që e zotëron atë. Përveç njohjes së dy kulturave personat bilingual kanë një aftësi përshtatjeje më të lehtë edhe me kultura të tjera. Truri i tyre ka funksionuar që në vegjëli me njohjen e dy kulturave. Ky konfirmim vjen edhe nga subjektet bilingual të këtij studimi.

“Kisha avantazh ndaj shokëve si në shkollim ashtu dhe në kulturën që më kishte transmetuar.” (Tiranë, mashkull, 62 vjeç).

Gjithashtu një person tjetër shpehet:

“Je praktikisht njeri i botës” (Shkodër, mashkull, 48 vjeç).

Pra, bilinguizmi sjell përshtatshmëri jo vetëm më lehtë me gjuhën, por edhe me kulturën që mbartin personat me të cilët jemi në një marrëdhënie.

Të njohësh një gjuhë tjetër automatikisht fillon njohja edhe e një kulture tjetër. Por duke njohur një kulturë tjetër njeriu fillon dhe e shikon kulturën e tij nga një perspektivë tjetër. Përpjekja për të kuptuar kulturën vetëm nga brenda, i ngjan përpjekjes për të kuptuar atë që bën dhe ka një autobus, por që gjatë gjithë kohës jeni vetëm brenda tij duke udhëtuar. Ju nuk arrini të shihni as rrotat e autobuzit, as ngjyrën e jashtme dhe as motorin që e drejton atë.

Dygjuhësia dhe bikulturalizmi janë të lidhura, por ato shpeshherë nuk janë e njëjta gjë. Disa njerëz supozojnë se në qoftë se një fëmijë rritet si dygjuhëshe, automatikisht do të ketë qasje në një kulturë tjetër. Gjuha ka një lidhje shumë të madhe me kulturën, por kjo lidhje nuk është aq e thjeshtë. Dygjuhësia është më shumë një derë që të çon drejt bikul-

4 <http://www.education.com/reference/article/culture-language/>

turalizmit. Dygjuhësia është aftësia për të komunikuar në dy gjuhë. Ajo përgjithësisht përfshin shkrim, lexim, dhe të folurën rrjedhshëm, edhe pse termi ndonjëherë përdoret për individët të cilët janë vetëm folës të dy gjuhëve dhe nuk dinë shkrim dhe lexim të gjuhës së dytë. Bikulturalizmi është një zhytje në dy kultura të ndryshme, që nënkupton pjesëmarrjen në praktikën e trashëgimisë tradicionale si ushqim, veshje, traditat familjare, folklorike popullore, artit etj.

Rasti i brazilianëve japoneze janë një shembull interesante që dëshmon për dallimet midis bikulturalizmit dhe dygjuhësisë. Një lëvizje e madhe emigrimi nga Japonia në Brazil në fillim të shekullit 20-të, rënia e feudalizmit në Japoni dhe një mungesë e krahut të punës në plantacionet e kafes në Brazil çoi në një traktat mes dy qeverive që inkurajoi emigracionin e japonezëve drejt Brazilit. Pas një kohe të gjatë, popullsia japoneze në Brazil ka mbetur disi e izoluar. Në Brazil u hapën shkollat në gjuhën japoneze për gjeneratën e parë të fëmijëve të lindur në Brazil. Martesat ishin kryesisht në mes të emigrantëve japonezë.

Kur ekonomia japoneze filloi të rimëkëmbej në vitet 1970 dhe 1980, një pjesë e popullsisë japoneze e lindur në Brazil, pra, gjenerata e parë dhe e dytë e fëmijëve të emigrantëve u kthye në Japoni. Ata filluan të punonin kryesisht në fabrika. Edhe pse ata ishin rritur duke folur gjuhën folur japoneze si gjuhën e tyre të parë, kur u kthyen në Japoni ata u panë si të huaj ose të jashtëm. Automatikisht, kjo pjesë e emigrantëve të kthyer jetuan në provinca dhe territore të veçuara, pasi vlerat dhe traditat e tyre nuk ishin të njëjta si ato të japonezëve vendas. Qeveria japoneze po bën përpjekje për të nxitur kthimin e tyre në Brazil. Këtyre njerëzve japonezo-brazilianë, që u cilësuan si “dekasegi” qeveria po u ofron rreth 3 000 dollarë për të lëvizur përsëri në vendin e tyre të origjinës, me kusht që ato të mos ri-aplikojnë për vizë apo shtetësi japoneze.

Gjuha dhe festimet e kulturës braziliane janë më të zakonshme në Japoni se kudo tjetër në botë, përveç vetë Brazilit. Karnavalet janë një ngjarje e madhe në qytetet “dekasegi”, si p.sh., Oizumi. “Dekasegi” janë një shembull interesant i asaj që ndodh kur një popullsi e madhe është rritur si bilingual por jo bikultural. Kultura japoneze dhe kultura Braziliano-

Japoneze ishte shumë të ndryshme nga njërat tjetra dhe kjo bëri që emigrantët të ktheheshim në Brazil edhe pse me origjinë dhe gjuhë të parë kishin atë japoneze.⁵

5.8. Bilinguizmi përpara viteve 40-të në Shqipëri

Për të evidentuar fenomenin “dygjuhësi” në Shqipëri para viteve 40-të, si dhe avantazhin e suksesin individual që kanë pasur këta persona në jetë në krahasim me bashkëmoshtarët e tyre të cilët nuk e kishin këtë mundësi, u realizua edhe një intervistë interesante, e cila solli gjetje të rëndësishme për këtë studim. Hatixhe Xhoxhi Balla, tashmë në një moshë të thyer, 91 vjeçare, është motra e Shaban Ballës, hero i rënë për demokracinë. Sipas intervistës së realizuar me zonjën Balla, vëllai i saj ka zotëruar disa gjuhë të huaja.

Por unë e di që në moshe të re ai fliste anglisht shumë mirë, sepse kishte bërë shkollën e Fultzit, siç i thonim në atë kohë një shkolle teknike që përgatiste studentë apo inxhinierë të ardhshëm për Shqipërinë. Ai ishte student i mirë dhe e donin shumë edhe profesorët. Ai udhëtonte edhe në Turqi, Itali e vende të tjera. Ishte me mendje të hapur dhe shumë tolerant, kishte shumë miq gjithandej që e donin shumë. Ai ishte aktiv dhe bashkë me të rinj të tjerë të asaj kohe e donte Shqipërinë ndryshe. Ishte pjesëtar i grupit “Bashkimit Demokratik” në 1945, të cilët donin që në zgjedhje të merrnin pjesë shumë parti dhe zgjedhjet të ishin të hapura. Pas zgjedhjeve ishte Shabani, i cili çoi notën e protestës tek anglezët dhe një kopje tek amerikanët. Ai dinte se ç’po kërkonin, sepse ishte mendje hapur.

Krahasuar me personat e njohur dhe të rëndësishëm të asaj kohe, dhe këtu flasim për vitet 1930, Shabani, si rezultat i njohjes së gjuhëve të huaja, ka përkthyer disa libra në shqip. Në mars të vitit 1934 ai përktheu nga anglishtja librin “Shqiptarët” të Xhorxh Fred Uilliams, i cili ishte ministër i Amerikës në Mal të Zi dhe Greqi, si dhe vëzhgues i komisionit ndërkombëtar në Durrës; përktheu librin “Asgje e re në Frontin e Perëndimit” etj. Bilinguizmi, përveç njohjes së gjuhës sjell dhe shumë gjëra pozitive për vetë personin si p.sh. njohjen e kulturës, njohjen e një botëkuptimi tjetër etj. Zonja Hatixhe, gjatë intervistës tregon se vëllai i saj ishte me mendje të hapur dhe lexonte shumë:

Njohja e gjuhëve, leximi i librave, bisedat me politikanë të huaj dhe vendas, e fuqizoi medokemos botëkuptimin e tij dhe ndikimin e tij për kohën. Po në atë kohë, siç e shikoni edhe nga historia, pak njerëz kishin ndikim kaq të madh, vetëm ata të cilët kishin një pikëpamje dhe horizont tjetër për Shqipërinë. Suksesi nuk matet me jetëgjatësinë, por me ndikimin që ka individ. Shabani ndikoi në kohën e vet dhe jo më kot e kanë quajtur “Iajmëtari i demokracisë”. Shabani ishte mendjehapur dhe shumë i dashur. E donte vendin e tij, por udhëtonte gjithashtu edhe në vende të tjera. Ai kishte profesorë dhe miq me të cilët fliste dhe kalonte kohën. Ai

5 <http://bilingualkidsrock.com/bilingualism-vs-biculturalism/>

kishte edhe një mënyrë tjetër të foluri me respekt dhe mirësjellje. Kjo tregon kulturën perëndimore. Ai lexonte shumë.

Nisur nga eksperiencia me vëllain e saj, Zonja Hatixhe e shikon mësimin e gjuhëve të huaja nga të rinjtë si një gjë shumë të mirë dhe plot përfitim për ta.

Mësimi i gjuhëve të huaja nga të rinjtë është një gjë e mirë. Të rinjtë duhet të mësojnë gjuhë të huaja dhe të jenë sa më mendjehapur. Sot mundësitë janë të shumta dhe ata janë të lirë për të mësuar dhe për të lëvizur nëpër botë. Sot edhe shkollat janë në gjuhë të huaj dhe kjo është një gjë e madhe. Edhe popujt po lëvizin, po shkojnë me pushime, studime, vizita etj.

Nga kjo intervistë arrijmë në përfundimin se gjuha e huaj është një mjet i domosdoshëm që hap me lehtësi më shumë dyer për personin që e zotëron. Përveç asaj, ashtu sikur heroi Shaban Balla dëshmon me eksperiencën e tij jetësore, dy gjuhësi ose njohja e më shumë gjuhëve krijojnë lehtësisht lidhje me persona të kombësive të ndryshme, njeh botëkuptimin e tyre dhe je më lehtë i pranueshëm në një kulturë të dytë ose të tretë.

5.9. Arritjet e personave bilingual në jetë

Nga ky studim rezultoi se arritjet e personave bilingual në jetë kanë një lidhje pozitive me të qenët bilingual. Zotërimi i një gjuhe të dytë mund të konsiderohet si një pasuri personale që hap lehtësisht dyert në jetë për punësim dhe shkollim. Bilinguizmi të jep më shumë akses në informacion dhe kjo përpara viteve 1990 ka patur një vlerë shumë të madhe. Përsosur me prindër të kombësive të ndryshme kishin më shumë akses në botën perëndimore sepse dëgjonin radio, shikonin filma dhe lexonin literaturë të huaj falë gjuhës që zotëronin. Një faktor tjetër ndikues është se zotërimi i një gjuhe të dytë të jep mundësi për t'u socializuar me njerëz nga kombësi të ndryshme. Hipoteza e këtij studimi vërtetohet nga rezultatet se arritjet dhe sukseset në jetën e personave bilingual kanë një lidhje pozitive dhe varen në pjesën më të madhe nga fakti i të qenët bilingual.

A mendoni se gjithçka që keni arritur është avantazh i të qenët i rritur bilingual?

Po, për mua po. Një avantazh është leximi, zgjerimi i horizontit, komunikimi etj. Të gjitha këto të bëjnë më të urtë e tolerant, dhe do të thoja që zhvillon tek ti një mendim demokratik tolerance, fleksibiliteti dhe paqeje. Kjo të jep edhe më shumë mundësi të kontribuosh në fusha të ndryshme dhe aty ku shfaq talentet personale. Katër avantazhe si person bilingual do të përmendja: mundësi punësimi, jo diskriminim, burim informacioni, komunikim dhe hyrje më të shpejtë në shoqëri.

Intervista e realizuar me Z. Qemal Xhomo ka sjellë gjetje shumë të vlefshme në kuadrin

e studimit të bilinguizmit. Z. Xhomo, ashtu si të gjithë subjektet bilingual të studimit, ka veçori që vlejnë për t'u analizuar në këtë studim. I lindur nga një nënë italiane, një baba shqiptar dhe duke u rritur në Selanik deri në moshën 16 vjeçare, z. Xhomo u rrit si një fëmijë trilingual. Gjatë rinisë së tij dhe moshës shkollë ai mësoi edhe tri gjuhë të tjera: atë frënge, ruse dhe serbokroate. Në këtë pikë theksohet dhe forcohet më shumë fakti që personat e rritur si bilingual e kanë më të lehtë mësimin e një gjuhe të tretë apo të katërt. Për shkak të natyrës së punës që tij, Z. Xhomo u thellua më shumë në mësimin dhe njohjen e gjuhëve të huaja. Dashuria për njohjen e gjuhësisë bëri që ai të studionte gjuhë dhe letërsi shqipe në fakultet. Eksperienca e tij jetësore flet vetë. Për vite me radhë ai ka qenë pedagog i gjuhës shqipe dhe asaj italiane në fakultetin e gjuhëve të huaja, Tiranë. Gjithashtu, ai është angazhuar me përkthime të karakterit politik, shkencor dhe kulturor. Gjithashtu, ka punuar në shtëpinë botuese të librit shkollor dhe në televizion si redaktor për çështjet e arsimit. Pra, e gjithë përvoja dhe eksperienca e z. Xhomo është e lidhur ngushtë me gjuhësinë. Z. Xhomo, si pasojë e njohjes dhe zotërimit të shumë gjuhëve të huaja, ka patur kaq shumë arritje në jetë. Pra, njohja e gjuhëve ka hapur shumë dyer për të. Mund të themi se, krahasuar me një person monolingual të kohës kur ai ka qenë i angazhuar në pozicionet e punës si më lart, ai ka patur më shumë avantazhe. Pra, edhe një herë, me këtë rast të marrë në studim vërtetohet hipoteza e studimit se të qenët person bilingual sjell më shumë arritje dhe hap më shumë dyer mundësish në jetë.

5.10. Bilinguizmi dhe prirjet artistike

A ekziston vërtetë një lidhje ndërmjet bilinguizmit dhe prirjeve artistike të personave bilingual? Në shumë studime është ngritur kjo pyetje kërkimore dhe rezultatet janë nga më të ndryshmet. Edhe në këtë studim kjo pikë është prekur si pjesë e studimit. Nga të dhënat rezultoi se personat bilingual në Shqipëri kanë prirje dhe talente artistike të dëshmuara dhe provuara. Pjesa më e madhe e tyre duke patur prindër me kombësi nga më të ndryshmet si Itali, Gjermani, Rusi që në fëmijëri kanë mësuar të luajnë në instrumente muzikore, të pikturojnë, të njohin artin e vjetër venecian etj. Duhet theksuar se përpara viteve 90-të të pakta kanë qenë familjet me prindër shqiptar që i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë

mësimi të instrumenteve muzikore, pikturës ose baletit. Për të shtuar këtu edhe faktin se në atë periudhë jo çdo person që kishte prirje ose talente në një fushë të veçantë ishte i lirë për të ndjekur një shkollë ose kurs.

Prirjet artistike dhe kreativiteti vijnë si rezultat i ndërveprimit të individit me mjedisin ku rritet, kulturës dhe gjuhët që flasin. (Raina, 1999). Eksperiencat shumë kulturore, rritja me prindër nga dy kultura të ndryshme, imigrimi në shumë vende të botës, zotërimi dhe njohja e gjuhëve të ndryshme, bashkëveprimi dhe kontakti me njerëz nga kultura të ndryshme rrisin shanset për të zhvilluar kreativitetin dhe prirjet artistike. (Leung, Madduz, Galinsky, dhe Chiu, 2008). Sipas studiuesve të mësipërm, të rriturit si një fëmijë bilingual me prindër nga kultura të ndryshme rrit mundësit për të zhvilluar me shumë prirje artistike dhe sidomos kreativitetin. Csikszentmihaly (1999) thekson se kreativiteti dhe prirjet artistike duhet të konsiderohen më shumë si një fenomen kulturor dhe social sesa një proces mendor. Sipas perspektivës kulturore kreativiteti shprehet në mënyra të ndryshme në kultura të ndryshme. Kultura Aziatike është shumë e ndryshme krahasuar me kulturën Amerikane ose atë Evropiane. Vlerat e kulturës Aziatike theksojnë kolektivizmin ndërsa vlerat e kulturës Amerikane theksojnë pavarësinë dhe individualizmin (Kim, 2009).

Nga një studim amerikan i vitit 2010, i realizuar nga Universiteti i Xhorxhas vijnë gjetje interesante në lidhjen midis bilinguizmit dhe prirjeve artistike. Pjesë e këtij studimi ishin studentë me prejardhje Koreane, por që ishin rritur në Amerikë. Pra, persona bilingual amerikano-korean. Në total u morën në studim 116 studentë, nga të cilët 49 djem dhe 65 vajza nga mosha 7 deri në 18 vjeç. WAT (World Association Test Lambert, 1956) është një nga shkallët që përdoret gjerësisht për matjen e nivelit të bilinguizmit. Kjo shkallë matjeje u përdor edhe në këtë studim. Nga studimi rezultoi se bilinguizmi është i lidhur pozitivisht dhe ndikon në zhvillimin e kreativitetit. Studentët që kishin një shkallë më të lartë të njohjes së të dy gjuhëve dhe një balancë ndërmjet tyre, kanë tendencën të jenë më kreativ dhe me më shumë prirje artistike. Përsa i përket gjinisë rezultoi se vajzat kishin një balancim më të madh të të dy gjuhëve. Winter dhe Pauwels (2000) theksojnë se femrat i kanë më shumë gjasat për të mësuar një gjuhë të dytë dhe gjithashtu më të prirura

për ta përvetësuar dhe mbajtur më gjatë atë. Sipas Kim (2006), femrat bilinguale janë më kreative përsa i përket fushave abstrakte dhe nivelit të përpunimit të informacionit krahasuar me djemtë. Në lidhje me moshën rezultoi se nuk ka një lidhje përsa i përket bilinguizmit dhe kreativiteti artistik.

Si konkluzion i kësaj çështjeje mund të themi se ekziston një lidhje pozitive midis personave që janë bilingual dhe prirjeve të tyre artistike. Personat bilingual në Shqipëri kanë prirje artistike dhe talente të dëshmuara.

5.11 Avantazhet e mësimi të gjuhës së huaj tek të rinjtë

Ka shumë arsye pse të rinjtë duhet të mësojnë gjuhë të huaja. Avantazhet psikologjike janë të shumta. Mësimi i gjuhëve të huaja fuqizon rritjen e trurit. Qendrat e gjuhës në tru marrin një zhvillim më të madh sa herë truri aktivizohet për të mësuar një gjuhë të re.

Është vërtetuar nga shumë studime që bilinguizmi vonon sëmundjen e Alzheimer në 5 vjet më vonë në personat që i kanë më shumë gjasat të preken nga kjo sëmundje. Mësimi i një gjuhe të dytë rezulton të ketë një efekt më të fuqishëm se çfarëdolloj mjekimi.

Të mësuarit e një gjuhe të huaj rrit gjithashtu aftësinë e të dëgjuarit, ndërkohë që trurit i duhet të punojë më shumë për të dalluar tinguj të ndryshëm që vijnë nga gjuhë të ndryshme.

Fuqizimi i kujtesës është një avantazh tjetër i personave që mësojnë një gjuhë të huaja. Fëmijët e rritur si bilingual, pra në një ambient ku kanë dëgjuar dy gjuhë njëkohësisht kanë një kujtesë më të zhvilluar se ata që janë rritur me një gjuhë. Fëmijët e rritur si bilingual, por edhe ata që kanë mësuar një gjuhë të dytë që në fëmijëri, është provuar se kanë më shumë aftësi në të përmbushurit e disa detyrave njëkohësisht.

Personat bilingual mund të kalojnë nga një detyrë në tjetrën me më shumë shpejtësi dhe saktësi. Ata performojnë me një elasticitet më të madh kognitiv dhe përshtaten shumë më lehtë me rrethanat e paparashikuara. Kalimi i vazhdueshëm dhe komunikimi nga një gjuhë në tjetrën mban trurin në veprim dhe automatikisht dyfishon aktivitetin cerebral.

Gjithashtu mësimi i një gjuhe të re nga të rinjtë jep një vizion të ri mbi botën. Të mësosh një gjuhë të re mund të ndryshojë kuptimin rreth shumë objekteve dhe perceptimeve mbi botën.

Këtu mund të merret si shembull mësimi i gjuhës japoneze. Në këtë gjuhë, p.sh., përdoren terma të caktura për nuancat e ngjyrës blu dhe bojëqielli. Duke mësuar këto terma truri filon dhe percepton ngjyrat dhe nuancat, që më parë në gjuhën mëmë nuk ishin menduar.

Në momentin kur fillohet të mësohet një gjuhë e dytë rritet përqëndrimi mbi rregullat dhe strukturën se si është e ndërtuar një gjuhë. Automatikisht, edhe gjuha mëmë fillon të ketë përfitime. Faktet e mësipërme i referohen më tepër personave që janë rritur si bilingual ose që kanë mësuar një gjuhë të dytë që në fëmijërinë e hershme. Megjithatë, avantazhet që sjell mësimi i një gjuhe të dytë vlejnë edhe për të gjithë ata që fillojnë të mësojnë një gjuhë të dytë në çfarëdo moshe.

Duke parë se njohja e sa më shumë gjuhëve po bëhet çdo ditë e më e rëndësishme, Anne Merritt po hulumton lidhjen e mundshme ndërmjet komponentëve gjenetik dhe aftësisë së të mësuarit të një gjuhe

Kemi parë se njerëzit të cilët arrijnë me shumë mund për ta mësuar një gjuhë dhe nuk mundën, arrijnë në pikën kur thonë: “S’ma ka dhënë Zoti aftësinë për gjuhë të huaja.”

Është e lehtë ta imagjinosh se dhuntia për të mësuar një gjuhë ekziston diku jashtë kontrollit tonë, ndoshta në gjakun tonë ose në kiminë e trurit apo edhe në ujin e pijshëm që rrjedhë në Evropën Veriore që i ushqen në mënyrë të furishme skandinavët që flasin gjuhën angleze rrjedhshëm, që nga Oslo e deri në Helsinki.

Mësuesit e gjuhëve ua shpjegojnë studentëve se çdonjëri mund ta mësojë një gjuhë të huaj, dhe se kjo aftësi vjen nga edukimi dhe jo nga natyra. Por, a luan ndonjë rol biologjia në këtë mes? A ka ndonjë pjesë në ADN-në tonë që mund ta parashikojë nëse mundë të jemi poliglot të suksesshëm apo jo ?

Në fakt, neurobiologjistët e kanë identifikuar një gjen që ka lidhje me gjuhët. Gjени FOXP2 u zbulua në vitet 90-të, përmes një studimi të një familjeje angleze, në të cilën tre gjenerata kishin vuajtur nga një problem i rëndë në të shqiptuarit e gjuhës. Të pesëmbëdhjetë anëtarët e kësaj familjeje kanë të trashëguar gjenin FOXP2, gjen ky i cili luan rolin kryesor në procesin e prodhimit të gjuhëve në trurin tonë. Së fundmi, gjeni i deformuar FOXP2 i zbuluar në familjen angleze, çuditërisht, ka qenë i lidhur me aftësinë e të mësuarit të gjuhës.

arit të gjuhëve, sipas disa hulumtuesve në Universitetin e Texas-it në Austin.

Hulumtimi i publikuar në maj, i gazetës “Journal of Neuroscience”, kishte përfshirë 204 të rinj, të cilëve u është dhënë për detyrë të dëgjojnë gjuhë të panjohura dhe në këtë mënyrë duke i kategorizuar ata.

Pjesëmarrësit kishin dhënë mostrat e pështymës, nga e cila hulumtuesit zbuluan se personat me një lloj ndryshimi në gjenin FOXP2, ishin më të shpejtë dhe më të saktë në kryerjen e detyrës së dëgjimit të gjuhëve të huaja.

Ndërsa, hulumtimi i lartpërmendur referon një “gjen të gjuhëve” specifik në trurin e njeriut, për të studiuar një gjuhë dhe nevojiten shumë pjesë të trurit, të përbërë nga disa gjene të ndryshme për të funksionuar së bashku. Këtu përfshihet procesi i njohjes së kujtesës, arsyetimit, perceptimit dhe i dhënies së informacioneve, por që forca dhe efektshmëria e këtyre proceseve ndryshon nga personi në person.

Edhe pse hulumtimi gjenetik vazhdon të forcojë lidhjen në mes biologjisë dhe gjuhës tek njerëzit, ne ende kemi një rrugë të gjatë para për ta përcaktuar se si ta zbatojmë këtë njohuri në botën e mësimin të gjuhëve.⁶

6 <http://www.gazetaexpress.com/shneta/a-ndikojne-gjenet-ne-aftesine-e-te-mesuarit-te-gjuheve-111160/>

KAPITULLI VI: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

Ky kapitull parashtron përfundime të detajuara mbi të gjitha çështjet e marra në studim dhe rekomandimet përkatëse për të ardhmen lidhur me avantazhet që vijnë nga mësimi i një gjuhe të dytë.

Pas këtij studimi, duke pasur parasysh edhe shumë studime të bëra në këtë fushë nga studiues të huaj, kuptojmë se nëse mësohet dygjuhësia që në vogëli dhe personi rritet si bilingual, ka shumë avantazhe në shoqërinë e sotme globale.

Komunikimi (gjuha), është një nga mjetet kryesore të lidhjes me njerëzit. Socializimi nis nëpërmjet komunikimit verbal. Nëse një person nuk kupton gjuhën në një grup të caktuar social, atëherë ai ndjehet i izoluar. Personat bilingual kanë më shumë avantazhe për socializim në grupe të caktura shoqërore.

Çështja e njohjes së një gjuhe të huaj të tretë ose më shumë është interesante, e studiuar në këndvështrimin e bilinguizmit. Ashtu sikurse është vërtetuar nga rezultatet e studimeve të mëparshme në vende të ndryshme të botës, edhe në këtë studim vërtetohet se personat bilingual e kanë më të lehtë të mësojnë një gjuhë të tretë. Pra, të gjithë subjektet bilinguale rezultuan të njihnin dhe flisnin një gjuhë të tretë ose të katërt. Por ky rezultat rezultoi i ndryshëm krahasuar me subjektet monolingual të studimit. Për personat monolingual ishte më e vështirë mësimi i një gjuhe të tretë ose të katërt. Tek personat bilingual truri ka më shumë elasticitet në pranimin e një informacioni të ri lidhur me gjuhët e huaja në ndryshim nga personat monolingual, ku informacioni i ri shpesh konkurren me atë të vjetrin dhe është më lehtë të asimilohet nga truri.

Bilinguizmi sjell shumë avantazhe për personat bilingual që në fëmijëri. Përveç faktit të të diturit dhe të njohurit të dy gjuhëve, ka dhe shumë avantazhe të tjera. Bilinguizmi sjell tek personat që zotërojnë dy gjuhë edhe njohjen e një kulture të dytë. Bikulturalizmi rrjedhimisht sjell përshtatjen më lehtë me një kulturë të tretë ose të katërt.

Personat bilingual para viteve 90-të në Shqipëri kanë gëzuar një status tjetër. Ata janë ndjerë më superiorë si pasojë e njohjes së gjuhëve të huaja që bashkëmoshatarët ose ko-

legët e tyre nuk i njihnin. Si pasojë e njohjes së gjuhëve të huaja që në vegjëli personat e rritur si bilingual në Shqipëri e kanë më patur më të lehtë të gjejnë një punë, të ndjekin studime jashtë vendit dhe të lidhin miqësi të reja me shtetas të huaj.

Krahas avantazheve, personat bilingual të cilët kanë jetuar edhe gjatë periudhës së regjimit komunist në Shqipëri kanë patur dhe disavantazhe. Në këtë periudhë shumë familje janë persekutuar dhe nuk janë lejuar të studiojnë në degën e preferuar në shkollë. Gjithashtu, shumë familje nuk janë lejuar të vizitojnë vendin e origjinës së nënës ose babait, p.sh., Italinë, Francën etj. Ata i kanë vizituar këto vende dhe të afërmit e tyre atje vetëm pas rënies së sistemit komunist.

Personat bilingual në Shqipëri kanë prirje artistike dhe talente të dëshmuara më të shumta se personat monolingual. Ekziston një lidhje pozitive ndërmjet bilinguizmit dhe kreativitetit e prirjeve artistike. Pjesa më e madhe e tyre duke patur prindër me kombësi nga më të ndryshmet si Itali, Gjermani, Rusi, qysh në fëmijëri kanë mësuar të luajnë në instrumente muzikore, të pikturojnë, të njohin artin e vjetër venecian etj.

Personat e rritur si bilingual në Shqipëri në pjesën më të madhe të rasteve kanë rritur dhe fëmijët e tyre me dy gjuhë që në vegjëli.

Personat monolingual e vlerësojnë bilinguizmin si shumë pozitiv në botën e sotme globale. Nëse do kishin mundësi ata do t'i rrisnin fëmijët e tyre me dy gjuhë.

Në shoqërinë e sotme globale gjuha e huaj është bërë një domosdoshmëri. Nga studimi rezultoi se një faktor tjetër që i bën personat monolingual të ndjehen inferiorë përpara një personi bilingual, është edhe padituria se si funksionojnë mjetet dhe pajisjet elektronike.

Një tjetër avantazh lidhet me lehtësinë e aksesit të informacionit. Nëse kthehemi sërish prapa në kohë dhe në një sistem tjetër politik, bilinguizmi kishte avantazh lidhur me aksesin në informacion. Ditët e sotme aksesin në informacion është më i madh dhe më i lehtë. Përpara viteve 90-të gjetja e literaturës në gjuhë të huaj ishte më e vështirë. Por nëse nuk kishe njohuri në gjuhët e huaja, aksesin në informacion ishte shumë i vështirë. Rrethimisht, personat bilingual ishin superiorë krahasuar me ata monolingual, pasi leximi i literaturës së huaj ishte mëse normal për ta.

Bilinguizmi sjell përshtatshmëri më të lehtë jo vetëm me gjuhën, por edhe me kulturën që mbartin personat me të cilët jemi në një marrëdhënie. Një avantazh është leximi, zgjerimi i horizontit dhe komunikimi – të gjitha këto të bëjnë më të urtë e tolerant, zhvillon një mendim demokratik, tolerance, fleksibiliteti dhe paqeje. Kjo të jep edhe më shumë mundësi të kontribuosh në fusha të ndryshme, si dhe aty ku shfaq talentet personale.

Ndër avantazhet kryesore që ka një person bilingual, rezulton të jetë akses i lehtë në informacion, komunikimi dhe ndërtimi më i shpejtë i marrëdhënieve shoqërore; mundësi dhe oportunitet punësimi, ndërtimi i një mendimi dhe arsyetimi, jodiskriminim dhe lehtësisht pranues.

Kjo del qartë nga studimi: sa më herët të fillohet me mësimin e gjuhëve të reja, aq më mirë është, si për zhvillimin e trurit, po ashtu dhe për zhvillimin e vetë fëmijës, edhe në aspektin social dhe kulturor kur ai rritet.

Siç e shohim pra, vërtetohet edhe thënia e profesoreshës së Universitetit të Gjuhëve në Gjermani, Ruth Tobias, se: “Mësimi i gjuhëve të reja është baza për formimin e një mendimi të gjerë dhe të ri”.

Mësimi i gjuhëve të huaja ndihmon në mbajtjen e trurit në gjendje më të shëndetshme. Kalimi i vazhdueshëm dhe komunikimi nga një gjuhë në tjetrën mban trurin në veprim dhe automatikisht dyfishon aktivitetin cerebral. Gjithashtu, mësimi i gjuhës së huaj ndihmon në kujtesë, aftësinë për të bërë disa gjëra njëkohësisht, rrit përqendrimin dhe shton perceptimin për koncepte të reja në botë.

Si përfundim, mund të themi se arritjet dhe sukseset në jetën e personave bilingual në Shqipëri kanë një lidhje pozitive dhe varen në pjesën më të madhe nga fakti i të qenët bilingual. Bilinguizmi hap më lehtë dyert drejt sukseseve dhe arritjeve në jetë.

KAPITULLI VII: SUGJERIM PËR STUDIME TË TJERA

E quajmë me vend se në këtë fushë do të ishte mirë të thelloheshin studimet.

Një nga sugjerimet që do të jepnim është se: Një rëndësi duhet t'i jepet fillimit të mësimit të gjuhëve në familje, mbase edhe që në kopshte.

Kurrikula shkollore, nëse kemi të bëjmë me një shkollë njëgjuhëshe, të plotësohej me orë shtesë për lëndët e gjuhëve të huaja (përparësi këtu: anglishtja, spanjishtja, gjermanishtja etj.), pra, gjuhë të cilat japin mundësi dhe avantazhe për këtë target grup në shoqërinë e sotme globale.



Figura 7. Marrë nga një reportazh i Pablo Colado, publikuar 2011

Për Shqipërinë besojmë se ka mjaft hapësira studimi në këtë fushë:

1. mund të studiohen pakicat kombëtare;
2. mund të studiohen refugjatët që kanë shkuar në vende të ndryshme (fëmijët e tyre që tashmë janë bërë pjesë e atyre shoqërive);
3. si dhe çiftet e martuara me të huaj pas viteve 90-të, ku fëmijët rriten nën ndikimin e dy gjuhëve.

Pas këtyre studimeve mund të dalim në përfundime më të thelluara për ndikimin e dygjuhësisë në Shqipëri dhe favoret e mbartura si pasojë e këtij efekti. Të dhënat e studimit të mësipërm nuk mund të konsiderohen gjithëpërfshirëse, duke pasur parasysh se ka akoma vend për studime të tjera në këtë fushë.

SHTOJCA 1

Deklarata e miratimit të informuar

Përshëndetje!

Unë jam Alma Vögeli-Peto dhe për studimin tim të doktoratës pranë UET kam zgjedhur temën “Perceptimi i personave bilingual mbi arritjet e tyre në jetë”. Qëllimi i studimit është hulumtimi i perceptimeve të personave bilingual dhe monolingual mbi arritjet e tyre në jetë. Do ta vlerësoja shumë pjesëmarrjen tuaj në këtë studim. Eksperienca dhe përvoja juaj do të ishte një vlerë e shtuar në gjetjet e këtij studimi.

Të gjitha përgjigjet tuaja do të jenë konfidenciale. Pjesëmarrja juaj në studim është tërësisht vullnetare. Nëse nuk dëshironi t’i përgjigjeni ndonjë pyetjeje, mund të kaloni në pyetjen tjetër ose mund ta ndërprisni intervistën në çdo moment.

SHTOJCA 2

Pyetësor për personat bilingual

SESIONI I

☐ Mashkull ☐ Femër

Mosha _____ vjeç
Statusi _____

1. Çfarë profesioni keni?

2. Ku keni lindur?

3. Cila është kombësia e prindërve tuaj?

4. Cilat janë gjuhët që keni mësuar që në vegjëli?

5. Përveç dy gjuhëve që keni mësuar nga prindërit, a keni mësuar ndonjë gjuhë tjetër?

6. Në çfarë dege keni studiuar?

7. Në cilën gjuhë e keni zhvilluar mësimin?

8. Aktualisht, sa gjuhë dini të flisni dhe cilat janë ato?

9. A ju ka ndihmuar fakti i të qenët bilingual në mësimin e gjuhë së tretë apo të katërt dhe pse?

SESIONI II

10. A jeni ndjerë superiorë me bashkëmoshatarët apo kolegët që dinin vetëm një gjuhë?

☐ Po ☐ Jo

11. Nëse po çfarë ju ka bërë të ndjeheni kështu?

12. A keni njohuri dhe talente artistike, të cilat i keni praktikuar dhe dëshmuar?

13. Nëse po, rendisni një ose më shumë prej tyre?

14. Rendisni të paktën katër avantazhe që keni patur deri tani në jetë, si pasojë e të qenët person bilingual?

15. Rendisni të paktën katër disavantazhe që keni patur deri tani në jetë, si pasojë e të qenët person bilingual?

16. Në çfarë mënyrash ju ka ndihmuar në arritjet në jetë fakti që ju keni qenë që fëmijë bilingual?

17. Sipas perceptimit tuaj, sa lidhet bilinguizmi me atë çfarë keni arritur deri tani në jetë:

18. Nëse do të kishit mundësi të zgjidhnit, a do të dëshironit të rriteshit si një fëmijë bilingual, pra, ashtu si jeni rritur, apo do të zgjidhnit që prindërit t'ju rrisnin si një fëmijë monolingual, pra, t'ju mësonin vetëm një gjuhë në vegjëli?

19. Nëse keni fëmijë, në vegjëli atyre u keni mësuar dy gjuhë apo një gjuhë njëkohësisht dhe pse?

20. A ndjeheni të veçantë si pasojë e faktit që jeni rritur si person bilingual dhe pse?

Faleminderit që u bëtë pjesë e këtij studimi!

SHTOJCA 3

Pyetësor për personat monolingual

SESIONI I

☐ Mashkull ☐ Femër

Mosha _____ vjeç
Statusi _____

1. Çfarë profesioni keni?

2. Ku keni lindur?

3. A dini të flisni një gjuhë tjetër përveç gjuhës shqipe?

4. Kur keni filluar të mësoni një gjuhë të dytë?

5. Pse keni mësuar një gjuhë tjetër të dytë?

6. Ka qenë vendimi i prindërve apo ju keni dashur të mësoni një gjuhë tjetër të dytë?

7. Aktualisht sa gjuhë dini të flisni?

SESIONI II

8. A jeni ndjerë inferiorë me bashkëmoshatarët apo kolegët që dinin të flisnin më shumë gjuhë te huaja se ju?

☐ Po ☐ Jo

9. Nëse po pse?

10. A keni njohuri dhe talente artistike, të cilat i keni praktikuar dhe dëshmuar?

11. Nëse po, rendisni një ose më shumë prej tyre?

12. Çfarë avantazhezh mendoni se ka një person që di të flasë dy gjuhë? Rendisni të paktën tre prej tyre.

13. A mendoni se mësimi i gjuhëve të huaja e konsumon apo e zhvillon trurin e njeriut?

14. A do të dëshironit që prindërit tuaj t'ju kishin mësuar dy gjuhë që në vegjëli dhe pse?

15. Nëse keni fëmijë, në vegjëli i keni mësuar dy gjuhë apo një gjuhë njëkohësisht dhe pse?

Faleminderit që u bëtë pjesë e këtij studimi!

SHTOJCA 4: INTERVISTAT

Intervista me persona të famshëm bilingual në Shqipëri

Në këtë studim u vlerësua si e rëndësishme për gjenerimin e të dhënave dhe realizimi i intervistave me persona të njohur që janë rritur si bilingual. Këta persona i përkasin botës së artit, si aktori i madh Timo Fllloko, por edhe botës së shkencës, mjekësisë, mësuesisë dhe historisë.

Është me vend të theksohet se realizimi i intervistave me të gjithë këta persona ka qenë një kënaqësi e veçantë për studiuesin. Personat janë kontaktuar personalisht dhe me shumë dashamirësi janë bërë pjesë e studimit. Të gjithë të intervistuarit e kanë vlerësuar shumë të veçantë studimin e bilinguizmit në Shqipëri dhe e çmojnë të udhës që ky studim të realizohet me persona që kanë jetuar edhe në kohën e regjimit komunist. Kjo pjesë nuk është prekur nga studime të mëparshme. Në faqet në vijim paraqiten të dhënat e intervistave të realizuara.

Intervista 1

<i>Emri:</i>	Lili Tirana
<i>Mosha:</i>	80 vjeçe
<i>Gjinia:</i>	Femër
<i>Institucioni:</i>	Pensioniste
<i>Adresa:</i>	Punishtja e pastave, Tiranë
<i>Data e intervistës:</i>	Shtator 2015
<i>Tema e studimit:</i>	Ndikimi i bilinguizmit në suksesin individual

Kjo është tema që unë kam zgjedhur për studimin tim të doktoratës, pranë UET-së. Qëllimi i studimit është evidentimi i fenomenit “dygjuhësi” në Shqipërinë e para viteve ‘90 dhe avantazhi e sukcesi individual që kanë pasur këta persona në jetë, në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, të cilët, si monolingual nuk e kishin këtë mundësi.

Zonja Lili, më tregoni pak për prindërit tuaj

Nëna ime ishte italiane dhe një grua e shkolluar. Në atë kohë, ajo erdhi në Shqipëri me një diplomë italiane në Artet e Bukura. Ishte një grua me shumë vlera, intelektuale dhe e rrallë për kohën. Megjithatë, dua të të them që ne, në kohën e diktaturës, bënim pjesë në ato familjet e persekutuar, pra që nuk kishin përkrahje. Babai im ishte me shkollë të lartë dhe ai ishte burrë shumë i zgjuar. Në shtëpi nëna na mësoi gjuhën italiane me gramatikë. Ajo vetë në fakt, nuk dinte shqip dhe na mësonte me shumë kujdes, sepse ishte e ndaluar dhe siç të thashë, ne ishim të shtypur. Gjyshërit e mi unë i pashë për herë të fundit kur isha vetëm 5 vjeçe.

Sa e lehtë ishte për ju si një fëmijë bilingual të gjendeshit në atë sistem?

Nuk ka qenë aspak e lehtë, as për mua dhe as për familjen time. Meqenëse kishte nevojë për mësues dhe nuk kishte kuadro, pra, nuk kishin dalë akoma kuadrot e rinj, mamanë e caktuan të jepte mësim në shkollë të mesme. Ajo edhe më parë kishte përvojë në mësimdhënie.

Meqenëse ishim një familje e persekutuar, më vonë mua nuk m'u dha e drejta e studimit për mjekësi, por për agronomi. Me shumë mundime e ndryshova me një person tjetër dhe unë studiova në shkollë 2-vjeçare si arsimitare për matematikë dhe më vonë, po me korrespondencë u diplomova. Arsimi për mua ishte si një byzylyk me vlerë në të gjitha stuhitë e jetës.

Si mendoni, a ndikon bilinguizmi në suksesin dhe arritjet pozitive në jetë? Cilat janë gjuhët që keni mësuar që në fëmijëri?

Po nuk mund të flas shumë për sukses, sepse të thashë edhe më lart që kishte shumë vështirësi të ngriheshe kur ishe e shtypur nga regjimi, por kur njeriu ka dëshirë dhe vullnet arrin gjëra në jetë, dhe rrethanat luajnë një rol të madh. Të qenët një person bilingual më ka ndihmuar shumë, sidomos në shkollë. Unë kisha një bagazh të marrë që në fëmijërinë e hershme, e cila më shërbeu në jetë. Në shkollën fillore mësova rusisht, pra, një gjuhë me prejardhje sllave dhe që nuk ngjante me italishten, por që e mësova me dëshirë dhe komunikojta e lexoja mirë.

Çfarë mbart tjetër një person bilingual, përveç mësimit të dy gjuhëve njëkohësisht në vegjëli?

Megjithëse në fshehtësi, nëna bashkë me mësimin e gjuhës, na tregonte edhe përralla. Më vonë, kur u rrita, kuptova se në fakt përrallat e saj ishin fabulat e LaFonten-it, apo edhe pjesë nga Odiseja, për të cilat më vonë kuptova se ishin vepra të mëdha. Nëna ime kishte studiuar Artet e Bukura në Itali, pra, mitologjinë greke dhe na tregonte për pikturat e Mikelanxhelos apo Rafaelos. Këto vepra i pashë në vitin 1985, kur m'u dha leja për të takuar njerëzit e nënës në Itali. Bashkë me një vajzë tezeje shkova në Firence nëpër muze e kisha dhe nuk ngopesha duke parë veprat e artit, për të cilat na kishte folur nëna në fshehtësi. Edhe sot, në shtëpi kam akoma dy piktura nga Venecia të nënës time si kujtime të paharrueshme.

Nëna na kishte transmetuar dëshirën për të dëgjuar muzikë klasike dhe unë e dëgjoj me

shumë kënaqësi edhe sot, madje më kujtohet një shok gjimnazi, i cili vinte tek ne në shtëpinë tonë në Shkodër, pasi një pjesë të mirë të jetës sonë e kaluam atje. Kur e takova pas disa vitesh, ai më tha që dashurinë për muzikën operistike e kishte mësuar nga nëna ime.

Por nuk mund të mburrem, sepse njeriu nuk i zgjedh prindërit dhe është me fat nëse ata janë nga kombësi të ndryshme, pasi fëmijët rriten si bilingualë. Por familja ndikon shumë në formimin e fëmijës në jetë. Ajo që dua të them është se nëna ime, megjithëse nuk u trajtua ashtu siç e meritonte në atë kohë në Shqipëri, na ka transmetuar shumë dashuri për Shqipërinë. Thuhet se zakonisht gratë tërheqin nga vetja, por ajo ishte një grua e zgjuar dhe me një kulturë të rrallë. Më ka transmetuar dashurinë për artin, pikturën leximin dhe historinë. Pra, përveç gjuhës, ne si fëmijë morëm një kulturë të dytë, pa e kuptuar as vetë. Ajo vjen natyrshëm kur rritesh si një fëmijë bilingual

A mendoni se është avantazh të qenët i rritur bilingual?

Patjetër që është avantazh dhe fat i madh. Për shembull, unë kam lexuar shumë libra fshehurazi, sepse ishin të ndaluara dhe kisha fatin e madh të merrja libra edhe nga biblioteka e profesor Jakup Kastratit.

Pra ajo që kam marrë në rini, ka qenë një bagazh i madh. Mësimi i gjuhës italiane me gramatikë nga nëna ime ishte një avantazh. Kur m'u desh të jepja mësim, mua thjeshtë m'u desh të kujtoja gramatikën dhe kjo ishte shumë e lehtë për mua. Rreth moshës 50 vjeçe vendosa të mësoja gjuhën angleze. Kjo gjuhë më pëlqente dhe vendosa të mësoja në mënyrë autodidakte për të vënë trurin në punë. Më pëlqen të lexoj dhe të mësoj vazhdimisht, megjithëse mosha bën të vetën.

Znj. Lili, sa e rëndësishme është për të rinjtë të mësojnë gjuhë të huaja, në kënvështrimin tuaj si një njeri i rritur me dy gjuhë?

I shikoj brezat e rinj që luajnë me kompjutera e gjëra të tjera elektronike, por vë re që lexojnë pak. Sigurisht, edhe nga kompjuteri mbase marrin informacion, por nuk lexojnë libra aq sa duhet dhe është e nevojshme për ta. Sa më shumë të aktivizosh trurin në vegjëli

e rini, aq më shumë bagazhe mbeten për më vonë, sepse asnjëherë nuk i dihet në jetë. Fëmijët nga natyra janë dembelë dhe më shumë kanë dëshirë të luajnë se sa të mësojnë. Por është detyra e prindërve të kujdesen që fëmijët të mësojnë edhe gjuhë të huaja. Kështu që të mësuarit që në fëmijeri është gjë e madhe edhe për të ardhmen.

Faleminderit zonja Lili. Ishte një kënaqësi intervista me ju.

Tiranë, shtator 2015.

Intervista 2

Emri: Rezarta Ajazi

Mosha: 43 vjeçe

Gjinia: Femër

Vendlindja: Berlin

Adresa: Tiranë

Kombësia e prindërve: Shqiptare

Gjuhë e mësuara që në vegjëli: Shqip, gjermanisht

Data e intervistës: 12.04.2015

Tema e studimit: Ndikimi i bilinguizmit në suksesin individual

Kjo është tema që unë kam zgjedhur për studimin tim të doktoratës, pranë UET-së. Qëllimi i studimit është evidentimi i fenomenit “dygjuhësi” në Shqipërinë e para viteve ‘90 dhe avantazhi e sukcesi individual që kanë pasur këta persona në jetë, në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, të cilët, si monolingual nuk e kishin këtë mundësi.

Përveç dy gjuhëve që keni mësuar nga prindërit, a keni mësuar ndonjë gjuhë tjetër?

Anglisht.

Në çfarë dege keni studiuar?

Politologji, sociologji, histori etj.

A jeni ndjerë superiore me shoket që mësojnë vetëm një gjuhë?

Jo.

Nëse po, çfarë ju bën të ndiheni kështu?

Veçantia e gjuhës.

A keni njohuri dhe talente artistike, të cilat i keni praktikuar dhe dëshmuar?

Po, aktrim, humor.

Katër avantazhet si person bilingual

Mundësi punësimi, jodiskriminim, burim informacioni, komunikimi, hyrja më shpejtë në shoqëri.

Disavantazhet si person bilingual

Lëkundje identiteti.

A mendoni se arritjet tuaja personale lidhen me statusin financiar apo me atë kulturor?

Deri diku, po.

Nëse do të kishit një mundësi të dytë për të bërë zgjedhje, a do të zgjidhnit prapë dygjuhësinë?

Definitivisht, po.

Ju falënderoj zonja Ajazi

Tiranë, prill 2015

Intervista 3

<i>Emri:</i>	Migena Beqiri-Lerch
<i>Mosha:</i>	44 vjeçe
<i>Gjinia:</i>	Femër
<i>Institucioni:</i>	Freelenzer, Tiranë
<i>Adresa:</i>	Rruga “Jani Vreto”, Tiranë
<i>Data e intervistës:</i>	18.03.2015
<i>Tema e studimit:</i>	Ndikimi i bilinguizmit në suksesin individual

Kjo është tema që unë kam zgjedhur për studimin tim të doktoratës, pranë UET-së. Qëllimi i studimit është evidentimi i fenomenit “dygjuhësi” në Shqipërinë e para viteve ‘90 dhe avantazhi e suksesi individual që kanë pasur këta persona në jetë, në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, të cilët, si monolingual nuk e kishin këtë mundësi.

Cilat janë gjuhët që keni mësuar që në vogëli?

Që në moshën 3-vjeçare fillova kopshtin në Gjermani, për arsye se prindërit shkuan në ambasadë atje, kështu që fillova të mësoj gjermanisht me bashkëmoshatarët në kopsht; dhe në shtëpi mamaja më mësonte vjersha dhe këngë shqip.

A ju ka ndihmuar të qenët bilingual në mësimin e gjuhës së tretë apo të katërt?

Po, absolutisht shumë. Më ka ndihmuar dhe ishte një avantazh që më bënte të ndjehesha mirë. Sidomos në adoleshencë ndihesha mirë që dija një gjuhë të cilën bashkëmoshatarët e mi nuk e dinin.

A ndikon bilinguizmi në suksesin dhe arritjet pozitive në jetë?

Po, mua më ka ndihmuar jashtëzakonisht shumë. Mësimi i gjuhëve në këndvështrimin tim është një botë më shumë, një hapësirë e re përpara teje. Mendoj se të jep edhe një “rrezatim” tjetër. Sa për arritjet personale, sigurisht kjo lidhet edhe me ambiciet personale dhe profesionale. Gjuha në bashkëpunim dhe në kombinim me vullnetin profesional, të çon përpara.

Çfarë mbart tjetër një person bilingual, përveç mësimit të të dy gjuhëve njëkohësisht në vegjëli?

Po e thashë edhe më lart, se bashkë me gjuhën ti mëson edhe kulturën e vendit prej të të cilit vjen ajo gjuhë, si dhe komunikimin me folësit e asaj gjuhe. Më kujtohet që në vegjëli mësova si sillen fëmijët në kopësht në Gjermani dhe kur vinim këtu në Shqipëri, shpesh “stonoja”, apo të them të drejtën kisha një “rrezatim” tjetër. Përveç këtyre gjërave, më kujtohet që prindërit, kur ishim të vogla na nxirrnin shëtitje nëpër qytet në Gjermani dhe shikonim plot gjëra, dyqane e ndërtesa të bukura. Në këtë mënyrë përshtypjen ngelen, si dhe mënyra e të menduarit. Fantazia është më e zgjeruar.

A mendoni se gjithçka që keni arritur është avantazh i të qenët e rritur bilingual?

Po, për mua po. Një avantazh është leximi, zgjerimi i horizontit, komunikimi. Të gjitha këto të bëjnë më të urtë e më tolerant. Do të thoja që të zhvillon edhe një mendim demokratik, tolerant, fleksibël dhe të jep paqe. Kjo të jep edhe më shumë mundësi të kontribuosh në fusha të ndryshme dhe aty ku shfaq talente personale.

Sipas jush, a është mirë të mësohen nga të rinjtë gjuhët e huaja?

Po, dhe jam e bindur se është një gjë e mirë. Edhe djali ynë përveç gjuhës shqipe dhe gjermane po mëson anglisht. Edhe frëngjishtja i pëlqen shumë. Besoj se gjuhët janë një mundësi e mirë dhe një avantazh i madhe në jetë.

Ju falënderoj zonja Beqiri-Lerch

Tiranë, mars 2015

Intervista 4

Emri: Luan Belegu

Mosha: 73 vjeç

Gjinia: Mashkull

Institucioni: Pension

Adresa: Tiranë

Data e intervistës: 18.03.2015

Tema e studimit: Ndikimi i bilinguizmit në suksesin individual

Përshëndetje z. Belegu! Kjo është tema që unë kam zgjedhur për studimin tim të doktoratës, pranë UET-së. Qëllimi i studimit është evidentimi i fenomenit “dygjuhësi” në Shqipërinë e para viteve ‘90 dhe avantazhi e suksesi individual që kanë pasur këta persona në jetë, në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, të cilët, si monolingual nuk e kishin këtë mundësi.

Cilat janë gjuhët që keni mësuar që në fëmijëri?

Nëna ime ka qenë austriake dhe fliste gjermanisht në rrethin tonë të ngushtë familjar. Babai ka qenë diplomat që në kohën e Zogut. Kur linda unë, prindërit morën një dado, e cila fliste me mua italisht. Kur ne u kthyem në Elbasan me njerëzit, kushërinjtë dhe rrethin e gjerë familjar, mësova gjuhën shqipe. Më vonë në shkollë kam mësuar rusisht, dhe të jem i sinqertë kam qenë më i miri dhe dalloja si një talent në mësimin e gjuhëve të huaja. Pra, që i ri unë dija dhe zotëroja katër gjuhë. I doja dhe akoma i dua gjuhët e huaja, i mësoj dhe i dëgjoj me shumë dëshirë.

Si mendoni, a ndikon bilinguizmi në suksesin dhe arritjet pozitive në jetë?

Patjetër që bilinguizmi ka një ndikim shumë të madh dhe pozitiv në arritjet në jetë. Unë e kam quajtur veten me fat që kam pasur prindër aq të shkolluar dhe me kulturë të gjerë. Nëna më kishte mësuar të isha i matur, pra të mos flisja pa patur baza apo pa u menduar mirë. Shpesh këtë ma merrnin për dobësi. Por në një periudhë si ajo e diktaturës, duke qenë i talentuar edhe në punë, kam patur disa avantazhe.

Unë në vitin 1966 mbarova studimet në Bio-Kimi dhe më pas kam punuar 25 vite në gjimnazin e Peqinit. Vetëm kur filloi të lëkundej komunizmi, më sollën në Tiranë në vitin 1989. Unë prap spikasja me talentin dhe aftësitë e mia. Më janë akorduar dy çmime: “Naim Frasheri, Klasi i Parë” dhe “Mësues i Merituar”. Mendoj se këto çmime i kam merituar, pasi kam lexuar dhe punuar shumë për të arritur rezultate në jetë. Njohja e gjuhëve të huaja italisht, gjermanisht, rusisht dhe më vonë anglisht, më kanë ndihmuar për të lexuar literaturë të huaj dhe nuk jam ndarë asnjëherë nga libri.

Çfarë mbart tjetër një person bilingual përveç mësimit të dy gjuhëve njëkohësisht në vegjëli?

Në radhë të parë do të veçoja një kulturë që ka spikatur, në krahasim me injorancën që na rrethonte në atë kohë. Prindërit e mi u martuan në vitin 1928 dhe celebrimin e kanë bërë në Durrës. Imagjino ku ishte Shqipëria në atë kohë! Mua, për shembull, nga nëna m'u mbujt dëshira për muzikën vjeneze. Nëna edhe këndonte në shtëpi. Ajo vinte nga Lizfer Danubit, një qytet me kulturë në artin e muzikës. Përveç kësaj muzike, mua më pëlqente dhe muzika Ça-Ça-Ça e kohës sime, Rita Pavone, Adriano Çelentano, Koli Francis etj. Unë kam patur dy daja që kishin mbaruar për muzikë dhe mbase dashurinë për muzikën e kam marrë prej tyre. Por edhe një pjesë të madhe të pamjes e kam marrë nga nëna ime. Shpesh nëpër takime njerëzit më thonë dhe më pyesin: “Nga je?”. Pra, mendoj që geni që trashëgohet është një gjë e madhe.

A mendoni se gjithçka keni arritur në jetë është avantazh i të qenët i rritur bilingual?

Patjetër që bilinguizmi ka patur një ndikim shumë të madh në arritjet e mia në jetë. Unë kam patur një privilegj të rrallë që të lindja dhe të rritesha në një familje si ajo e imja. Familja ka luajtur një rol të madh në ndërtimin tim si person, por edhe unë kam patur talente dhe aftësi që më kanë ndihmuar të ecin përpara: gjuhët e huaja.

Sipas mendimit tuaj, a është mirë të mësohen gjuhë të huaja nga të rinjtë dhe pse?

Po, do të thoja që prindërit duhet të kujdesen që fëmijët e tyre të mësojnë gjuhë të reja dhe të lexojnë shumë. Do të rekomandoja të tregohen të kujdesshëm dhe mos t'i bombardojnë, por të jenë të matur në mënyrën se si ua mësojnë ato. Mendoj që sot duhet të mësohen edhe gjuhët Orientale, sepse edhe këto vende kanë kulturë dhe histori për të transmetuar e mësuar. Sigurisht, edhe gjuhët evropiane janë të rëndësishme, të tilla si: gjermanishtja, frëngjishtja, anglishtja edhe gjuhë të tjera. Gjuhët janë një pasuri e madhe dhe kur njeh gjuhën e një vendi ndihesh me i sigurt në vetvete. Sot, me mundësitë e shumta që kanë brezat, mund të mësojnë dhe lexojnë pa pasur kufij dhe censurë, siç kishim ne në kohën tonë. Mjafton vetëm dëshira dhe vullneti i mirë për të mësuar.

Faleminderit për kohën tuaj dhe përvojën jetësore që ndatë për realizimin e këtij studimi z. Luan Belegu. Ishte një kënaqësi intervista me ju.

Tiranë, mars 2015.

Intervista 5

Emri: Luli Kraja
Mosha: 56 vjeç
Gjinia: Mashkull
Profesioni: Prof. Doktor
Institucioni: Spitali “Nënë Tereza”, Tiranë
Adresa: Rruga “Myslym Shyri”, nr. 44, Tiranë
Data e intervistës: 11.02.2015
Tema e studimit: Ndikimi i bilinguizmit në suksesin individual

Kjo është tema që unë kam zgjedhur për studimin tim të doktoratës, pranë UET-së. Qëllimi i studimit është evidentimi i fenomenit “dygjuhësi” në Shqipërinë e para viteve ‘90 dhe avantazhi e sukcesi individual që kanë pasur këta persona në jetë, në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, të cilët, si monolingual nuk e kishin këtë mundësi.

Ju keni lindur në Tiranë, apo jo?

Po, kam lindur këtu nga dy prindër të mrekullueshëm. Babai ishte shqiptar dhe në atë kohë profesor, ndërsa mamaja ishte italiane dhe punonte si prezantuese në Radio Televizionin Shqiptar, në degën e lajmeve.

Cilat janë gjuhët që keni mësuar që në vogëli?

Po, në shtëpi ne flisnim italisht dhe mamaja donte që edhe ajo të mësonte shqip, kështu që ne i flisnim të dy gjuhët në shtëpi, si një pjesë e pandarë e komunikimit të përditshëm. Por bashkë me gjuhën mamaja na mësoi kulturën dhe sjelljen, pra, të folurën me zë normal, bashkëbisedimin kur njëri flet dhe tjetri dëgjon dhe gjëra të tjera të ngjashme. Edhe gatimin ajo e bënte siç dinte ajo. Kur unë shkoja në shtëpitë e shokëve, haja gjellët që gatuanin mamatë e tyre dhe kështu, bashkë me gjuhën, ne mësuam edhe kulturën, e cila ishte e rrallë për kohën kur jam rritur – para viteve ‘90.

Po përveç dy gjuhëve që keni mësuar nga prindërit, a keni mësuar gjuhë të tjera?

Po, kam mësuar frëngjisht, anglisht dhe rusisht. Janë gjuhë që më janë dashur në studimet e mia për mjekësi. Këto gjuhë më kanë dhënë mundësinë që jo vetëm të lexoj e studioj, por edhe të futem në brendësi të temave për të cilat studioja; të trajtoj raste pacientësh me të rejat bashkëkohore të mjekësisë.

Si mendoni ju zoti Kraja, a ndikon bilinguizmi në suksesin dhe arritjet pozitive në jetë?

Jashtëzakonisht shumë. Mësimi i gjuhëve të jep mundësi dhe të hap horizonte jo vetëm gjuhësore, por edhe profesionale e kulturore. Unë gjithmonë e kam përjetuar këtë. Jam ndier shumë i privilegjuar, për shembull, kur shkoja në pritje apo darka pune. Dija si të sillesha dhe të përdorja thikën e pirunin. Mbase sot mund të duket qesharake, por kisha shumë kolegë që hanin si mos më keq dhe përdornin ose lugën për çdo gjë, ose pirunin. Por edhe leximi e studimi në gjuhë të ndryshme të jep mundësinë të mësosh dhe të zgjerosh horizontin tënd, si edhe të eksplorosh. Për shembull, neve si mjekë na duhet të mësojmë se çfarë studimesh janë bërë rreth “X” sëmundje në vende të ndryshme, cilat janë përfundimet e këtyre studimeve dhe a ia vlen t’i përshtasim ato edhe këtu në Shqipëri. Kështu, dashje pa dashje ti si mjek jo vetëm informohesh me të rejat e shkencës, por i sjell ato edhe si një risi për pacientët këtu në spital.

A ka përparësi një person bilingual, krahasuar me një person monolingual?

Po, patjetër. E thashë edhe më lart se si një person që njeh gjuhën e një vendi ke përparësi jo vetëm si folës dhe frekuentues i gjuhës, por në udhëtime ti kupton dhe mëson edhe zakone, dhe bëhesh pjesë e kulturave të këtyre vendeve. Kur ti zotëron një gjuhë tjetër përveç gjuhës tënde dhe lexon në atë gjuhë, të është hapur një horizont. Më pas, varet nga ti se çfarë bën me atë që të është dhënë. Unë personalisht e quaj përparësi dhe avantazh, që ia dedikoj prindërve të mi, të cilët zgjodhën të më edukonin kështu, dhe sot mund të them se këtë mënyrë edukimi nuk do ta ndërroja me asnjë gjë tjetër. E quaj avantazh mësimin e gjuhëve dhe edukimin që në vegjëli.

Çfarë mbart tjetër një person bilingual, përveç mësimit të dy gjuhëve njëkohësisht në vegjëli?

Po e thashë edhe më përpara që me gjuhën ti mëson edhe kulturën e vendin nga vjen ajo gjuhë. Për shembull, bashkë me italishten që na u mbrujt që në vegjëli, ne mësuam edhe kulturën, edhe pse nuk shkonim dot te gjyshërit tanë në Itali. Megjithatë nëna na mësonte, sepse ishte vetë italiane. Ajo na tregonte përralla të cilat i kishte mësuar kur ishte e vogël, apo këngët, ushqimin dhe sjelljen.

A mendoni se gjithçka që keni arritur është avantazh i të qenët i rritur bilingual?

Po, jashtëzakonisht shumë.

Sipas jush, a është mirë të mësohen gjuhët e huaja nga të rinjtë?

Po, dhe jam i bindur se është një gjë e mirë. Edhe brezat e ardhshëm duhet të mësojnë sa më shumë gjuhë, sepse sot kjo është një kërkesë e pashmangshme në shoqërinë globale.

Faleminderit zoti Kraja.

Tiranë, shkurt 2015

Intervista 6

<i>Emri:</i>	Hatixhe Xhoxhi-Balla
<i>Mosha:</i>	91 vjeçe
<i>Gjinia:</i>	Femër
<i>Pozicioni:</i>	Motra e Shaban Ballës
<i>Institucioni:</i>	Në pension
<i>Adresa:</i>	Rruga e Kavajës, Tiranë
<i>Data e intervistës:</i>	05.2015
<i>Tema e studimit:</i>	Ndikimi i bilinguizmit në suksesin individual

Për të evidentuar fenomenin “dygjuhësi” në Shqipërinë e para viteve ‘90, si dhe avantazhin e suksesin individual që kanë pasur këta persona në jetë, në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre të cilët nuk e kishin këtë mundësi, u realizua edhe një intervistë interesante, e cila solli gjetje të rëndësishme për këtë studim. Hatixhe Xhoxhi-Balla, tashmë në një moshë të thyer, 91-vjeçare, është motra e Shaban Ballës, hero i rënë për demokracinë. Sipas intervistës së realizuar me zonjën Balla, vëllai i saj ka zotëruar disa gjuhë të huaja.

Ju më thoni që vëllai juaj, heroi për demokraci, ka zotëruar gjuhë të huaja?

Po, unë e di që në moshë të re ai fliste anglisht shumë mirë, sepse kishte bërë shkollën e Fultzit, siç i thonim në atë kohë, një shkollë teknike, që përgatiste studentë apo inxhinierë të ardhshëm për Shqipërinë. Ai ishte student i mirë dhe e donin shumë edhe profesorët. Ai udhëtonte në Turqi, Itali e në vende të tjera. Ishte me mendje të hapur dhe shumë tolerant, kishte shumë miq gjithandej, të cilët e donin shumë. Ai ishte aktiv dhe bashkë me të rinj të tjerë të asaj kohe, e donte Shqipërinë ndryshe. Ishte pjesetar i grupit “Bashkimit Demokratik” në 1945. Ata donin që në zgjedhje të merrnin pjesë shumë parti dhe zgjedhjet të ishin të hapura. Pas zgjedhjeve, ishte Shabani ai i cili çoi notën e protestës tek anglezët dhe një kopje tek amerikanët. Ai e dinte se çfarë po kërkonin, sepse ishte mendje hapur. Krahasuar me personat e njohur dhe të rëndësishëm të asaj kohe, dhe këtu flasim për vitet 1930, Shabani, si rezultat i njohjes së gjuhëve të huaja, ka përkthyer disa libra në shqip.

Në mars të vitit 1934 përktheu nga anglishtja librin “Shqiptarët” të Xhorxh Fred Uilliams, i cili ishte ministër i Amerikës në Greqi dhe Mal të Zi, si dhe vëzhgues i komisionit ndërkombëtar në Durrës. Ai përktheu gjithashtu librin “Asgjë e re në Frontin e Perëndimit” etj.

Bilinguizmi, përveç njohjes së gjuhës sjell dhe shumë gjëra pozitive për vetë personin, si njohja e kulturës, njohja e një botëkuptimi tjetër etj.

Zonja Hatixhe gjatë intervistës tregon se vëllai i saj ishte me mendje të hapur dhe lexonte shumë.

Njohja e gjuhëve, leximi i librave, biseda me politikanë të huaj dhe vendas e fuqizoi me-demos botëkuptimin e tij dhe ndikimin e tij për kohën. Po në atë kohë, siç e shikoni edhe nga historia, pak njerëz kishin ndikim kaq të madh, vetëm ata të cilët kishin një pikëpamje dhe horizont tjetër për Shqipërinë. Suksesi nuk matet me jetëgjatësinë, por me ndikimin që ka individit. Shabani ndikoi në kohën kur ka jetuar dhe jo më kot e kanë quajtur “lajmë-tari i demokracisë”.

Shabani ishte mendje hapur dhe shumë i dashur, e donte vendin dhe udhëtonte edhe në vende të tjera. Ai kishte profesorë dhe miq me të cilët fliste dhe kalonte kohë. Ai kishte edhe një mënyrë tjetër të foluri me respekt dhe mirësjellje, gjë e cila tregon kulturë perëndimore. Ai lexonte shumë dhe kishte një dashuri të madhe për dijen dhe librat.

Nisur nga eksperiencia me vëllain e saj, zonja Hatixhe e shikon mësimin e gjuhëve të huaja nga të rinjtë si një gjë shumë të mirë dhe me përfitime për ta.

Mësimi i gjuhëve të huaja nga të rinjtë është një gjë shumë e mirë. Që të rinjtë të mësojnë gjuhë të huaja dhe të jenë sa më mendje hapur. Sot, ka shumë mundësi dhe janë të lirë për të mësuar dhe për të lëvizur nëpër botë. Kjo është një gjë e madhe dhe sot edhe shkollat janë me gjuhë të huaja. Edhe njerëzit po lëvizin më shumë dita ditës, shkojnë me pushime, studime, vizita etj.

Nga kjo intervistë arrijmë në përfundimin se gjuha e huaj është një mjet i domosdoshëm, që hap me lehtësi më shumë dyer për personin që e zotëron. Përveç asaj, ashtu sikur heroi Shaban Balla dëshmon me eksperiencën e tij jetësore, dygjuhësia ose njohja e më shumë gjuhëve krijojnë lehtësisht lidhje me persona të kombësive të ndryshme, njeh botëkuptimin e tyre dhe je më lehtë i pranueshëm në një kulturë të dytë ose të tretë.

Tiranë, maj 2015

Intervista 7

Emri: Timo Flloko

Data e intervistës: 09.2015

Tema e studimit: Ndikimi i bilinguizmit në suksesin individual

Në kuadrin e këtij studimi është realizuar edhe një intervistë me aktorin e mirënjohur shqiptar, Timo Flloko. Timo Flloko, pa mëdyshje mund të quhet një yll i kinematografisë shqiptare, nga të paktët aktorë shqiptarë, të cilët ia kanë kushtuar karrierën e tyre ekskluzivisht filmit. Është gjithashtu një nga pedagogët më të respektuar të Akademisë së Arteve. Prej disa vitesh ka zgjedhur të jetojë duke ndarë kohën e tij mes Amerikës dhe Shqipërisë. Gjatë qëndrimit të tij në Amerikë prej shtatë vitesh, arriti të futet edhe në botën e Hollywood-it, ku luajti në disa filma. Pas kthimit nga Amerika u kthye në Tiranë, ku tani punon si pedagog në Akademinë e Arteve në Tiranë, në degën e aktrimit dhe regjizurës.

Përshëndetje Z. Flloko! Unë për studimin tim të doktoratës pranë UET kam zgjedhur temën “Ndikimi i Bilinguizmit në suksesin individual”. Qëllimi i studimit është evidencimi i fenomenit “dygjuhësi” në Shqipërinë e para viteve ‘90 dhe avantazhi e suksesi individual që kanë pasur këta persona në jetë, në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, të cilët, si monolingual nuk e kishin këtë mundësi.

Z. Timo, më flisni pak për fëmijërinë tuaj dhe mënyrën si jeni rritur?

Unë kam lindur dhe kam jetuar në Pejë deri në moshën 8-vjeçare, ndërsa në gjashtë prej këtyre vjetëve kam jetuar i ndarë nga babai dhe vëllai i tij. Kur isha veçse 2-vjeç, Shqipëria ishte prishur me Jugosllavinë dhe babanë tim e detyruan të largohej nga Peja dhe të kthehej në Shqipëri. Kur shkuam në kufi, kufitarët i njoftuan babait se kanë urdhër që të lejojnë vetëm atë të kalojë, por jo familjen. Pas shumë lutjeve e përpjekjeve, i lejuan që me vete ta merrte vetëm vëllanë tim të madh, Aleksandrin, dhe kështu unë e nëna ime ishim të detyruar të ktheheshim e të jetonim në Pejë, deri në zhvillime të

tjera politike, kur na u mundësua të ktheheshim në Shqipëri, konkretisht në qytetin e Vlorës.

Si mendoni a ndikon bilinguizmi në suksesin dhe arritjet pozitive në jetë? Cilat janë gjuhët që keni mësuar që në fëmijëri?

Që në fëmijëri unë kam mësuar shqip dhe jugosllavisht. Gjyshi im nga babai ka qenë protestant. Grigor Flloko quhej, gjirokastrit. Kemi pasur shtëpinë përballë gjimnazit të Gjirokastrës, në Varosh. Ka qenë praktikant dhe njëfarë lideri. Mblidheshin zakonisht të dielave. Ai përgatitej, bënte ato konspektet, përkthente nga greqishtja në shqip. Babai kishte mbaruar Sorbonën, ishte mjek patolog, nga mjekët patologë të Vlorës. Kishte punuar në Tiranë, në Romë më përpara deri në ish-Jugosllavi.

Pra, edhe gjyshi im njihte gjuhë të huaj dhe kjo i jepte akses të bënte punë që të tjerët nuk mund t'i bënin. Bilinguizmi më ka ndihmuar definitivisht në arritje e mia në jetë. Për një aktor dhe njeri të skenës njohja e gjuhëve të huaja është e rëndësishme. Përveç gjuhëve, njëkohësisht njihet edhe kultura dhe vlera të tjera të një vendi.

A mendoni se është avantazh i të qenët i rritur bilingual?

Patjetër që është avantazh. Unë mendoj se gjuhët e huaja janë një pasuri për personin që i posedon. Kjo pasuri ka një vlerë më të shtuar kur personi rritet si bilingual. Nëse flas për kohën kur unë jam rritur, mund të them se unë dhe familja ime kemi vuajtur nga regjimi komunist i Enver Hoxhës. Në atë kohë arti në përgjithësi dhe kinematografia e teatri në veçanti, kanë pasur një zhvillim të hovshëm, zhvillim me të cilin shqiptarët mund të mburren edhe sot e kësaj dite. Njohja e gjuhëve të huaja të jep akses në leximin e literaturës së huaj dhe sidomos në atë kohë jo të gjithë e kishin këtë mundësi.

Sipas jush, sa e rëndësishme është të mësohen gjuhë të huaja nga të rinjtë?

Patjetër që është e rëndësishme. Sa më shumë gjuhë të huaj të mësojnë, aq më të lehtë e kanë në jetë për të hapur dyert e suksesit. Në ditët e sotme anglishtja është një domosdoshmëri, italishten pothuajse e njohin të gjithë të rinjtë në Shqipëri. Pra, kërkesa për njo-

hjen e gjuhëve të huaja shkon përtej këtyre dy gjuhëve. Unë inkurajoj mësimin e gjuhëve të huaja si një domosdoshmëri në shoqërinë e sotme globale.

Z. Flloko, unë ju falënderoj për këtë intervistë. Informacioni dhe eksperiencia që ndatë me ne është një vlerë që i shtohet këtij studimi mbi bilinguizmin.

Tiranë, shtator 2015.

Intervista 8

Emri: Qemal Xhomo
Gjinia: Mashkull
Institucioni: Pension
Adresa: Bergamo, Itali
Data e intervistës: 8.02.2016
Tema e studimit: Ndikimi i bilinguizmit në suksesin individual

Përshëndetje z. Xhomo! Kjo është tema që unë kam zgjedhur për studimin tim të doktoratës, pranë UET-së. Qëllimi i studimit është evidentimi i fenomenit “dygjuhësi” në Shqipërinë e para viteve ‘90 dhe avantazhi e suksesi individual që kanë pasur këta persona në jetë, në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, të cilët, si monolingual, nuk e kishin këtë mundësi.

Cilat janë gjuhët që keni mësuar që në fëmijëri?

Para se të hyj në temë dëshiroj t’ju tregoj se rasti im ka diçka të veçantë, që me vështirësi mund të barazohet me personat e tjerë bilingual që ju keni takuar. Unë jam lindur në Selanik, në Greqi dhe në moshën 16 vjeç kam ardhur familjarisht në Shqipëri. Im atë ishte shqiptar, nëna italiane, mjedisi përreth ishte grek. Kështu që unë nuk mund ta quaj veten bilingual, por diçka më tepër. Në Greqi ndoqa filloren, gjimnazin dhe klasën e parë të liceut në një shkollë italiane. Natyrisht, në programet e shkollës përfshihej edhe gjuha greke (e reja dhe e vjetra). Flisja një shqipe “familjare” dhe librat shqip i pata të pakta dhe jo në mënyrë sistematike. Zbrazëtitë në fjalorin shkencor e kulturor i plotësova me ardhjen në Shqipëri, ku ndoqa pa vështirësi liceun në shqip.

Në shkollë kam ndjekur mësimin e disa gjuhëve: në shkollën italiane mora bazat e frengjishtes, të cilën e vazhdova si autodidakt me mjaft sukses, por me mundësi të pakta komunikimi me frankofonë. Ngjarjet politike patën ndikimin e tyre edhe në lëmin e gjuhëve. Në liceun e Tiranës bënim mësimin e gjuhës italiane (në nivel shumë më të ulët se ai që kisha mësuar), pastaj bëra dy vjet gjuhe serbokroatishte, dhe pasi u prishën marrë-

dhënit me Jugosllavine, bëra dy vjet rusisht. Pra, mund të them që u rrita si trilingual me gjuhën shqipe, greke dhe italiane, dhe gjatë shkollës mësova dhe tri gjuhë të tjera, atë frënge, ruse dhe serbokroate.

Çfarë profesioni keni?

Studimet e larta i kam kryer për gjuhë shqipe dhe letërsi. Kam punuar si mësues i gjuhës shqipe, si metodist i kësaj lënde në Institutin e Perfeksionimit të mësuesve, në Ministrinë e Arsimit, në shtëpinë botuese të librit shkollor, në televizion si redaktor për çështjet e arsimit. Më pas punova si mësues dhe pedagog i gjuhës italiane në shkollën e gjuhëve të huaja dhe në fakultet. Jam marrë gjithashtu me përkthime me karakter politik, shkencor dhe kulturor. Pra, e gjithë përvoja dhe eksperiencia ime është e lidhur ngushtë me arsimin dhe gjuhësinë.

Si mendoni, a ndikon bilinguizmi në suksesin dhe arritjet pozitive në jetë?

Duhet gjithashtu të theksoj një veçori tjetër dalluese: rasti im ndryshon nga ai i një personi (po marr si shembull) me atin shqiptar dhe nënën hungareze ose polake, i cili këtë gjuhë të dytë nuk ka patur mundësi ta kultivojë në një shkallë më të lartë. Për vetë natyrën e punëve që kam kryer, mua më është dashur (dhe kjo më ka pëlqyer dhe favorizuar) të thellohem në mësimin e gjuhëve të huaja. Këtë gjë nuk do të mund ta bëja, po të kisha qenë mjek, gjeometër ose ekonomist. Gjuhët e huaja patjetër që kanë një rol kyç në hapjen e dyerve të shumë mundësive.

Çfarë mbart tjetër një person bilingual përveç mësimin të dy gjuhëve njëkohësisht në vegjëli?

Duhet të pohoj me bindje se të qenët bilingual (e aq më tepër trigjuhësh) është një premisë dhe faktor shumë pozitiv dhe kjo është vërtetuar nga dijetarë dhe studiues të këtyre çështjeve. Madje tendenca aktuale në vendet e zhvilluara është ta nisin mësimin e gjuhës së huaj në moshat sa më të vogla, me mjete, metoda e pikësnyime të përcaktuara qartë. Në

periudhën që keni në studim unë ua kam mësuar që në moshë më të vogël gjuhën italiane dy djemve të mi dhe ata mund të konsiderohen bilingual. Më vonë ata kanë mësuar mirë anglishten, gjuhën e kohës.

A jeni ndjerë superior ndaj personave që dinin vetëm një gjuhë?

Ju shtroni problemin a ndihemi superior me ata që dinë vetëm një gjuhë. Mendoj se për periudhën që merrni në analizë, kur përkthimet ishin edhe më të pakta, vetëm me gjuhën shqipe nuk mund të bëheshe njeri i kulturuar, edhe aq më tepër specialist i mirë në çfarëdo dege. Megjithatë tani përkthimet janë shtuar dhe zgjeruar si tematike, handikapi i atij që zotëron vetëm shqipen mbetet i konsiderueshëm.

Mendoj se studimi juaj të çon te një problem themelor: mësimdhënia e gjuhëve te huaja për mosha sa më të vogla. Për këtë duhen studime, duhen mësues të përgatitur, duhet ngjallur dëshira nga ana e fëmijëve. Kjo është vështirë të zbatohet gjerësisht në një vend të varfër, ku shumë fëmijë nuk ndjekin shkollën si duhet ose e braktisin; kur shkolla jonë ka ende të pazgjidhura probleme serioze të përmbajtjes dhe të cilësisë së punës mësimore edukative. Por kjo nuk duhet të na ndalë ose të na frenojë. Studimi juaj mund të japë një ndihmesë në njohjen më të thelluar të problematikave dhe në rrugët që duhen ndjekur në kushtet aktuale.

Ju përshëndes përzemërsisht

Qemal Xhomo

Faleminderit për kohën tuaj dhe përvojën jetësore që ndatë për realizimin e këtij studimi z. Xhomo. Ishte një kënaqësi intervista me ju.

Bergamo, shkurt 2016

BIBLIOGRAFIA

- Ackerman, P., 1989. "Dallimet individuale dhe përvetësimi i shkathtësive" (Individual Differences and Skill Acquisition). Në: P. Ackerman, R. Sternberg & R. Glaser, redaktorë. "Të nxënit dhe dallimet individuale" (Learning and Individual Differences). New York: Freeman, f. 165-217.
- Albert M. & L. Obler, 1978. "Truri dygjuhësh" (The Bilingual Brain). New York: Academic Press.
- Anderson, J., 1976. "Gjuha, kujtesa dhe mendimi" (Language, Memory and Thought). Hillsdale, N.J.: Erlbaum.
- Baetens Beardsmore, Hugo (1982): Bilingualism: Basic Principles. Clevedon: Tieto.
- Baca & Cervantes, 1989. Marrë nga: www.teachervision.fen.com/bilingual_education (parë në shtator 2012).
- Bruner, J., 1996. "Kultura e edukimit" (The Culture of Education). Cambridge, Mass.: Harvard University Press.
- Cook, V., 1997. "Pasojat e dygjuhësisë në procesin e të njohurit" (The Consequences of Bilingualism for Cognitive Processing). Në: A. de Groot & J. Kroll, redaktorë. "Puna praktike në dygjuhësi" (Tutorials in Bilingualism.). Mahwah, N. J.: Erlbaum, 279-299.
- Cummis & Swain, 1990-1991. Marrë nga: www.corla.unn.edu/cobaltt/strategies/imer-sion (parë në shtator 2012).
- Cunningham-Andersson, Una/Andersson, Staffan (2004): Growing up with two Languages. A Practical Guide. Second Edition. London: Routledge.
- De Bot, K., 1992. "Një model i prodhimit dygjuhësh: modeli i adaptuar i Leveltit për 'të folur'". Gjuhësia e aplikuar 13:1-24" (A Bilingual Production Model: Levelt's 'speaking' model adapted. Applied Linguistics 13:1-24). Po ashtu në: Wei 2000.
- Ellis, R., 1990. "Të nxënit e gjuhës së dytë me udhëzime" (Instructed Second Language Acquisition). Oxford: Blackwell.

- Ellis, R., 1994. "Studimi i të nxënit të gjuhës së dytë" (The Study of Second Language Acquisition). Oxford: Oxford University Press.
- Erzeberg, 2000. Marrë nga: Bilingual Teaching Strategies gold.com (parë në mars 2012).
- Fabbro, F., 1999. "Neurolinguistika e dygjuhësisë" (The Neurolinguistics of Bilingualism). Hove: Psychology Press.
- European Commission, February 2006, "Europeans and their Languages"
- Fantini, Alvino E. (1985): Language Acquisition of a Bilingual Child: A Sociolinguistic Perspective (To Age Ten). Clevedon: Multilingual Matters.
- Fishman, Joshua A. (1977): Sociolinguistics: a brief introduction. Sixth Printing. Rowley: Newbury House.
- Gajo, L., 1999. Enseignement des langues par immersion et activité métalinguistique. Enjeux didactiques, interactionnels et sociopolitiques. Lausanne: Dissertation.
- Gazzaniga, M., redactor, 2000. "Neurologjia kognitive. Përmbledhje" (Cognitive Neuroscience. A Reader). Oxford: Blackwell.
- Hamers, Josiane F./Blanc, Michael H. A. (2000): Bilinguality and Bilingualism. Second Edition. Cambridge: Cambridge University Press. Harmensley, 1996.
- Herald. H "Europe's Mosaic of Languages", Original in German, displayed in English. Published: 2011-10-05
- Hill, W., 1980. "Të nxënit: studim i interpretimeve psikologjike" (Learning: A Survey of Psychological Interpretations). London: Methuen, botimi i tretë. Botimi i parë: 1964.
- Huybregtse, I., W. Admiraal & L. Coleman, 2000. Effecten en didactiek van tweetaligvoortgezet onderwijs in Nederland. Onderzoeksrapport. Utrecht: IVLOS en Nijmegen: Katholieke Universiteit.
- Julie Deardorff, 7 nëntor 2014. Marrë nga <http://www.northwestern.edu/newscenter/stories/2014/11/bilingual-brains-better-equipped-to-process-information.html>
- Kelly, 1999. University Nottingham. Marrë nga: www.earlyliteracyinfo.org/documents/pdf/doc. (parë në vitin 2012).

- Kielhöfer, Bernd/Jonekeit, Sylvie (1983): Zweisprachige Kindererziehung. Tübingen: Stauffenberg.
- Klein, Wolfgang (1992): Zweitspracherwerb. Eine Einführung. 3. Auflage. Frankfurt am-Main: Hain.
- Kutas, M., 1998. "Mendimet e tashme për strukturat gjuhësore. Psikologjia aktuale kognitive" (Current Thinking on Language Structures. Cahiers de psychologie cognitive/ Current Psychology of Cognition 17(4-5), 951-69. Po ashtu në Gazzaniga 2000.
- Kirstin Kannwischer (2008). Bilingualismus in der frühen Kindheit.
- Lambeck, Klaus (1984): Kritische Anmerkungen zur Bilingualismusforschung. Tübingen: Narr.
- Marsh, D. & B. MarNGJDnd., 1999. "Iniciativat CLIL të mileniumit" (CLIL Initiatives for the Millennium.) Jyväskylä: Qendra e edukimit të vazhdueshëm, University of Jyväskylä.
- Musai, Bardhyl, 1999, "Psikologji Edukimi".
- Munishi, Shkumbin (2009). Barazia e gjuhëve në Kosovë dhe perspektiva evropiane, (Kongresi I Ndërkombëtar Ballkanik), 10-16 Mj, 2009, Kosovë, Prishtinë. (shih edhe në Internet: <http://www.linguasocio.blogspot.com/>)
- Munishi, Shkumbin (2010). Probleme të zbatimit të dygjuhësisë shqip/serbisht në Kosovë.
- Nauwerck, Patricia (2005): Zweisprachigkeit im Kindergarten: Konzepte und Bedingungen für das Gelingen. Freiburg: Fillibach.
- Oiwi Parker Jones, David W. Green, Alice Grogan, Christos Pliatsikas, Konstantinos Filipopolitis, Nilufa Ali5, Hwee Ling Lee, Sue Ramsden, Karine Gazarian, Susan Prejawa, Mohamed L. Seghier and Cathy J. Price Marrë nga: <http://cercor.oxfordjournals.org/>, <http://www.ncbi.nlm.nih.gov/pmc/articles/PMC2643466/> (Bilingual and Monolingual Brains Compared: A Functional Magnetic Resonance Imaging Investigation of Syntactic Processing and a Possible "Neural Signature" of Bilingualism) Ioulia Kovelman, Stephanie A. Baker, dhe Laura-Ann Petitto
- Paradis, M., 1990. "Tingujt anësorë në rastet e dygjuhësisë. Truri dhe gjuha, 39:370-86"

- (Language Lateralization in Bilinguals. *Brain and Language* 39:370-86). Po ashtu në Wei 2000.
- Paradis, M., 1997. “Neuropsikologjia kognitive e dygjuhësisë” (The Cognitive Neuropsychology of Bilingualism). Në: A. de Groot & J. Kroll, redaktorë. “Ushtimet në rastet e dygjuhësisë” (Tutorials in Bilingualism). Mahwah, N. J.: Erlbaum, 331-354.
- Pinker, S., 1994. “Instikti i gjuhës” (The Language Instinct). London: Weidenfeld & Nicolson.
- Pinker, S., 1999. “Fjalët dhe rregullat” (Words and Rules). London: Weidenfeld & Nicolson.
- Porsché, Donalds C. (1983): Die Zweisprachigkeit während des primären Spracherwerbs. Tübingen: Narr.
- Raith, Joachim / Schulze, Rainer / Wandt, Karl-Heinz (Hrsg., 1986): Grundlagen der Mehrsprachigkeitsforschung: Forschungsrahmen, Konzepte, Beschreibungsprobleme, Fallstudien. Herausgegeben und übersetzt von Joachim Raith, Rainer Schulzen und Karl-Heinz Wandt. Stuttgart: Steiner-Verlag-Wiesbaden.
- Rodrigues, 1997. Marrë nga: <http://www.utexas.edu/cola/files> (parë në vitin 2012). Bilingual Special Education Teacher. NYSABE Journal.12,1997 St. Johns University
- Röhner, Charlotte (Hrsg., 2005): Erziehungsziel Mehrsprachigkeit. Diagnose von Sprachentwicklung und Förderung von Deutsch als Zweitsprache. Weinheim: Juventa- Verlag.
- Romaine, Suzanne (1996): Bilingualism. Second Edition. Oxford: Blackwell.
- Sapir, E., 1939. “Rëniet psikiatrike dhe kulturore gjatë tentimit për ta jetuar jetën” (Psychiatric and Cultural Pitfalls in the Business of Getting a Living). Në: D. Mandelbaum, redaktor, 1949. “Shkrime të zgjedhura të Edward Sapir” (Selected Writings of Edward Sapir). Berkeley, Ca.: University of California Press, 578-589.
- Segalowitz, 1997. Marrë nga: www.see-educoop.net/shtator 2012 [www. anadolu.edu.tr/](http://www.anadolu.edu.tr/) (parë në shtator 2012).
- Seiten für Schul-und Lernsoftware (2006-06-02) = Website PädBoutique®: Der Schulund Lernsoftware Verlag. Im Internet: <http://www.paedboutique.de/> (Aufruf: 2006-06-02).
- Several, 1990. Marrë nga: www.ecudaton.com/referenc/artikel/atacks-bilingual-educat. (parë në tetor 2012)

Skutnabb-Kangas, Tove (1981): Bilingualism or Not. The Education of Minorities. Clev-
edon: Multilingual Matters.

Singapore Management University. "Bilingualism and the brain: How language shapes
our ability to process information." ScienceDaily. ScienceDaily, 24 August 2015.
<www.sciencedaily.com/releases/2015/08/150824114907.htm>.

Trueba, 1987. Marrë nga: www.ncela.gwu.edu/files/res/BE021540/views.04Bilingualism
(parë në tetor 2012)

Van de Craen & D'hondt, 1997. Marrë nga: www.see_ecoop.net/education-in (parë në
nëntor 2012).

Van de Craen, 1999. Marrë nga: www2.uoh.es/masters-tefl_alcola

Variationist Approaches to language and Education_ dialect. english.wvu.edu/r/ (parë në
vitin 2012).

Vögel, Alma (2013). Bilinguizmi si një avantazh në shoqërinë e sotme globale.

Wandruszka, Mario (1981): Die Mehrsprachigkeit des Menschen. München: Deutscher
Taschenbuch Verlag.

Webber-Fox, C., and H. J. Neville. (1996). Maturational constraints on functional special-
izations for language processing: ERP and behavioral evidence in bilingual speakers.
Journal of Cognitive Neuroscience 8: 231–256.

Weinreich, Uriel (1974): Languages in Contact. Findings and Problems.

Wexler & Culicover, 1980. Marrë nga: www.see_educoop.net/education-in/, www.bcs.rochester.edu/people/newport (parë në nëntor 2012).

Burime nga interneti

<http://www.northwestern.edu/magazine/spring2015/campuslife/benefits-of-bilingualism.html>
(vizituar për herë të fundit në gusht 2015).

<http://www.raosoft.com/samplesize.html> (vizituar për herë të fundit në shtator 2015).

<http://www.omniglot.com/language/articles/bilingualadvantages.htm> (vizituar për herë të
fundit në janar 2015).

<http://www.mastersportal.eu/articles/1465/10-multilingual-vips-that-speak-several-languages.html> (vizituar për herë të fundit në dhjetor 2015).

http://dana.org/Cerebrum/2012/The_Cognitive_Benefits_of_Being_Bilingual/#sthash.HdGZWqgK.dpuf

<http://www.education.com/reference/article/culture-language/>

<http://bilingualkidsrock.com/bilingualism-vs-biculturalism/>

<https://www.telc.net/tr/hakkimizda/guencel/detail/how-does-learning-a-new-language-improve-your-brain-1.html> (vizituar për herë të fundit: janar 2016)

<http://www.goethe.de/ges/spa/prj/sog/mud/de362129.htm>

https://en.wikipedia.org/wiki/Languages_of_Albania

<http://www.independent.co.uk/news/science/bilingual-babies-benefit-from-faster-learning-9713028.html>

<https://faculty.washington.edu/chudler/second.html>